monumentet



DO NOT COPY

1/1989

DO NOT COPY

KOPERTINA PARË

Tavan dekorativ (shek. 19)

KOMITETI I KULTURËS DHE I ARTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

1/1989 (37)

DO NOT COPY

KOLEGJIUMI I REDAKSISË

EMIN RIZA (KRYEREDAKTOR)
APOLLON BAÇE (ZV/KRYEREDAKTOR)
ALEKSANDËR MEKSI, GJERAK KARAISKAJ, GJERGJ FRASHËRI,
HASAN NALLBANI, NERITAN CEKA, PIRRO THOMO.

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Komitetit të Kulturës dhe Arteve

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7.

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ

Faqe

Apollon BAÇE
Vera BUSHATI
Vështrim mbi banesën prehistorike dhe qytetare në Iliri dhe Epir 5

Gjerak KARAISKAJ
Kështjella mesjetare në Shqipërinë Jugperëndimore. 49

Ylli DRISHTI
Adrian DEVOLLI
Teqeja e Dollmës, piktura murore dhe restaurimi i saj 69

Leonard SULI
Banesa popullore e zonës së Vurgut dhe të Mursisë. 81

Latif LAZIMI
Oda e mirë dhe elementet arkitektonike të sajë në banesën qytetare gjirokastrite dhe beratase 107

Mirela STRAZIMIRI
Eduard SOPPI
Restaurimi i tablosë «Dasma Shkodrane» 137

INFORMACIONE

Valter SHTYLLA
Kliti KALLAMATA
Mbi pjesëmarrjen e vendit tonë në seminarin ndërkombëtar me temë «Principet moderne të konservimit dhe restaurimit të pasurive urbane dhe kulturore në rajonet sizmike» 142

Moikom ZEQO
Një mozaik tjetër i lashtë në Durrës 145

Irma KABASHI
Dëshmi të reja nga dy monumente të antikitetit të vonë në qytetin e Durrësit 149

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

Moikom ZEQO
Andrija Mutnjakovia, «Andreas Alexius Epirota», Prishtinë 1981 153

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TABLE DE MATIERES

ARTICLES

		Page
Apollon BAÇE *Vera BUSHATI*	Aperçu sur l'habitation préhistorique et antique en Illyrie et en Epire	41
Gjerak KARAISKAJ	Forteresses médiévales de l'Albanie sud-occidentale.	63
Ylli DRISHTI *Adrian DEVOLLI*	Le tekke de Dollme, la peinture murale et sa restauration	80
Leonard SULI	L'habitation populaire de la région de Vurgu et de Mursia	105
Latif LAZIMI	La chambre d'amis et ses éléments architectoniques dans l'habitation citadine de Berat et de Gjirokastra	135
Mirela STRAZIMIRI *Eduard SOPPI*	La restauration du tableau «Noce Shkodrane»	141
	INFORMATIONS	
Valter SHTYLLA *Kliti KALLAMATA*	A propos de la participation de notre pays au séminaire international sur «Les principes modernes de la conservation et de la restauration du patrimoine urbain et culturel dans les régions séismiques.	143
Moikom ZEQO	Une autre mosaïque ancienne dans la ville de Durrës.	147
	CRITIQUES ET BIBLIOGRAPHIE	
Irma KABASHI	Nouveaux témoignages sur deux monuments de la basse Antiquité dans la ville de Durrës	152
Moikom ZEQO	Andrija Mutnjakovič, «Andreas Alexius Epirota» Prishtina 1981	156

Nr. 1 1989

monumente

DO NOT COPY

Apollon BAÇE
Vera BUSHATI

VËSHTRIM MBI BANESËN PREHISTORIKE DHE QYTETARE NË ILIRI DHE EPIR*

Banesa, si element i domosdoshëm për rrjedhën normale të jetës njerëzore, i ka paraprirë në çdo kohë gjinitë e tjera, fortifikimet, ndërtimet inxhinjerike dhe ato shoqërore[1]. Nëpërmjet programit dhe trajtimit arkitekturor ajo pasqyron me besnikëri kërkesat, arritjet, gjendjen dhe fuqinë ekonomike të njësive përbërëse të shoqërisë: klasave, shtresave, nënshtresave. Si pronë private elementare, banesa, paraqet një barometër tepër të ndjeshëm ndaj luhatjeve ekonomike dhe proçesit të diferencimit shoqëror. Në të njëjtën kohë ajo është një tregues i organizimit dhe mënyrës së jetesës së njësisë bazë të shoqërisë, familjes.

Zhvillimi i banesës në Iliri ka kaluar nëpër një rrugë të gjatë mijëravjeçare, e cila ndiqet që nga hallkat më të hershme e më të thjeshta, nga Kolibet një kthinëshe të substratit parailir neolitik e deri tek banesat e pasura qytetare, me afreske dhe mozaikë. Ky zhvillim i brendshëm, rrjedhojë e përparimit ekonomik, nuk pati një përshpejtim të njëtrajtshëm në hapësirë dhe në kohë. Në hapësirë, ndryshimi i nivelit ekonomik nga krahina në krahinë shprehet me stade dhe ritme të ndryshme zhvillimi të banesës. Në kohë, brenda harkut në shqyrtim, veçohen cilësisht dy periudha, periudha prehistorike, nga neoliti në shek. e VI p.e.sonë, dhe ajo antike ose qytetare deri në fillim të erës sonë. Fundi i periudhës prehistorike, shek. VIII-VII deri në shek. e VI-V p.e.sonë, mund të shihet dhe si prelud i banesës qytetare, gjatë së cilës grumbullimet sasiore nisën të krijojnë embrionet e tipave. Në periudhën e parë, ndonëse mjaft më të shtrirë në kohë, zhvillimi i banesës rrodhi tepër ngadalë. Në të kundërt, në të dytën, në përgjigje të hopit ekonomiko-shoqëror, ajo merr një zhvillim të përshpejtuar. Për këtë arsye dhe banesat e trajtuara në artikull i kemi grupuar në banesa prehistorike dhe banesa antike.

Zgjidhja planimetriko-stereometrike e këtyre ba-

---

* Skicat e artikullit, përjashtuar Nr. 21,22,24,31,33,44,50 dhe fotot 20,23,25,28, 45, 46 janë nxjerrë në terren. Të tjerat janë marrë nga artikujt e cituar në tekst të: Ç. Truhelkës 5-7, 10-12, L. Rejit 32 (41,42,49), F. Prendit 9, M. Korkutit 1 (2,8), S. Batoviçit 4, J. Vokotopullos 3, Dh. Budinës 39, 43; L. Papajanit 37 (38, 40), N. Cekës 30, 47, E. Rizës 19, V. Hopfner – E. Shvandnerit, 17, 18, 48 (14-16).

1) Megjithë interesin që paraqet banesa prehistorike e antike në Iliri, si në drejtimin arkitekturor ashtu dhe shoqëror, studimet për të janë ende të mangëta. Përjashtuar Kasopenë, banesat në këto studime trajtohen anësisht, pa synuar ndaj rikonstruksionit, nxjerrjes së tipologjisë dhe ndjekjes së zhvillimit. Negativisht ka ndikuar dhe materiali, shpesh fragmentar, që nuk lejon nxjerrjen e planimetrive të plota. Megjithëkëtë materiali i derisotëm e lejon një sprovë paraprake për një vështrim të grupuar të sajin. Gjurmimi i banesës nis në fillim të shekullit tonë me stacionin palafit të Donja Dolinës e vijon në vitet 30 me banesat antike në Apolloni. Në territorin tonë ai përshpejtohet në vitet 50 me gërmimet në qendra prehistorike (Maliq, Gajtan, Kamnik, Cakran, Kolsh, Dunavec) dhe antike (Çukë e Ajtoit, Amantie, Antigone, Bylis, Margëlliç). Kësaj kohe i përkasin dhe një sërë të dhënash për territorin jugosllav (Ripaç, Otok, Radovinë, Gadimje, Slankamen, etj), e grek (Vica, Amotopo). Në artikujt pasues sillen të dhënat për banesat përkatëse por pa sprovuar ndaj rikonstruksionit dhe krahasimit tipologjik.

nesave nuk është shablone. Në të, krahas zhvillimit ekonomiko-shoqëror, parësor, ndikuan dhe faktorë të tjerë, ndonëse pa ndërhyrë në program. Këta faktorë janë: klima, më e butë në anëdetjen dhe më e ashpër në brendi; materialet rrethanore, prania e gurit shistor, pyjeve, argjilës, terreni, i sheshtë ose i pjerrët, i thatë ose buzë detar. Duke u nisur nga këto veçori e materiali në dispozicion, artikulli synon në përcaktimin e formave e tipave, ndjekjes së zhvillimit të tyre në kohë dhe shpjegimit të dukurive të veçanta.

BANESA PREHISTORIKE

Megjithëse banesa prehistorike i përket një harku kohor 5500 vjeçar, që nga neoliti i hershëm (v. 6000 p.e.s) e deri në shek. VI-V p.e.s)[2], evolucioni i saj, si në drejtim të programit ashtu dhe teknikës së ndërtimit, është minimal. Kjo ndodhi nga që banesa e mësipërme i përkiste një shoqërie pa diferencim klasor, rrjedhimisht pa kërkesa ndaj një jete të ngritur ekonomiko-shoqërore. Kjo banesë, me karakter thjesht utilitar u ndërtua në përshtatje me terrenin e kushtet klimaterike dhe në funksion të materialeve në dispozicion, gjithnjë duke ruajtur të njëjtin program të thjeshtë, me një ose dy kthina, pa arritur të krijojë tipa. Si pasojë ajo nuk mund t'i nënshtrohet analizës tipologjike, por vetëm grupimit dhe një analize sipas raportit me terrenin, formës planimetrike, teknologjisë së përdorur, dhe bashkëlidhjes. Brenda këtyre kritereve do ndjekim zhvillimin e elementeve përbërëse dhe parapëlqimet në kohë.

Raporti me terrenin përcakton dy grupe kryesore: mbi taban dhe nën taban. Në grupin e parë veçohen banesat e ndërtuara mbi tokë në terrene të rrafshëta dhe banesat e ndërtuara mbi platforma trarësh, mbi ujë ose buzë ujërave. Në të kundërt, banesat e ndërtuara në terrene të pjerrëta, banesat e shpatit, në këtë periudhë nuk dëshmohen. Kjo mungesë shpjegohet me vështirësitë statike dhe programin më të pasur e më të kushtueshëm që bartnin ato, program ky i pakërkuar në këtë kohë.

Për të nxjerrë parapëlqimin e njërës ose tjetrës mënyrë lidhjeje me terrenin po paraqesim në mënyrë tabelare raportin sasior në kohë. Por, përderisa numuri i banesave të zbuluara është ende i pakët, përfundimet e nxjerra kanë karakter hipotetik.

Në neolitin e hershëm dy nga banesat e zbuluara janë të ndërtuara mbi taban, në tokë[3] (Vashtëmi rr. Korçës, Kolsh, rr. Kukësit) dhe një platformë trarësh mbi ujë (Dunavec rr. Korçës)[4]. Në neolitin e mesëm ky raport ndryshon në dobi të banesave nëntokë dhe pjesërisht nëntokë. Të tilla janë tri (Kolshi, Cakrani I a, b, II rr. Fierit), ndërsa banesa mbi taban përfaqësohet me një shembull të vetëm, për

Periudha	Banesa mbi tokë	Banesa nën tokë	Banesë pjesërisht nën tokë	Banesa palaite
Naolit i hershëm	2 (Vashtëmi, Kolsh)	—	—	1 (Dunavec I)
Neolit i mesëm	1 (Dunavec II)	2 (Kolsh, Cakran Ia)	2 (Cakran I, IIB)	—
Neolit i vonë	2 (Kamnik, Maliqi)	—	—	—
Eneolit	1 (Maliq IIb)	—	—	1 (Maliq IIa)
Bronx	1 (Badhër)	—	—	3 Ripaç.Otok, Donja Dolina)
Hekur I	7 (Karo, Vica, Nin, Rovinjë, Cres Loshinj, Susak)	3 (Gadimje e Sipërme, Gomolavë, Stari Slankamen).		1 (Donja Dolina)

2) Banesa prehistorike është trajtuar shkurtimisht nga Gj. Karaiskaj (A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo, **Historia e arkitekturës shqiptare,** (nga fillimet deri në v. 1912) (maket) f. 18-19, i cili i ndan banesat prehistorike në 3 tipa: banesa të futura krejtësisht në tokë, gjysmë nëntokësore dhe mbi tokë.

3) M. Korkuti, **Vashtëmia një vendbanim i neolitit të hershëm,** Iliria, 1982, 1, f. 94, **Vendbanimi neolitik i Kolshit,** Iliria, 1983, 2, f. 15 v.

4) M. Korkuti, **Mbi rezultatet e gërmimeve të vitit 1973 në vendbanimin neolitik të Dunavecit,** Iliria 1974, 3, f. 384-387.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

më tepër derivat i një banimi palafit (Dunaveci II)[5]. Kjo dukuri ndoshta shpjegohet me një ftohje eventuale të klimës dhe me perfeksionimin e veglave të punës që jepnin mundësi për gërmimin e gropave të banesave. Në neolitin e vonë ky raport ndërron përsëri në dobi të banesave mbi tokë (Kamnik, Maliq I)[6], mundet, si pasojë e një ringrohjeje. Por ky përfundim vlen vetëm për zonat me klimë relativisht të ngrohtë, pasi në zonat e thella me klimë të ftohtë kontinentale (Dardani, tokat e Skordiskëve etj)[7] ky tip vazhdoi pa ndërprerje deri në fund të periudhës në shqyrtim. Madje në Shqipërinë e Veriut ai haset deri në mesjetë.

Në periudhën e eneolitit dhe bronxit raporti kthehet në 4 : 2 në dobi të banesave palafite (Maliq, II a, Donja Dolina, Ripaç, Otok) ndaj banesave në tokë (Maliq II b, Badhër rr. Sarandës)[8]. Përforcimi i mëtejshëm i numrit të banesave mbi tokë nëpërmjet kthimit të vendbanimit palafit të Maliqit në vendbanim në tokë (Maliq II b)[9] tregon synimin për një rikthim në raportin e parë. Por banesa palafite vazhdon të mbijetojë edhe gjatë periudhës së hekurit, si në Donja Dolina[10] ose në brigjet e liqenit Prasias (Herodot V, 16).

Mbizotërimin e vendbanimeve palafite në periudhën e eneolitit dhe bronxit do ta shpjegonim me përparësinë që fitoi zënia e peshkut me anën e grepave metalike dhe kthimin e tij në një nga ushqimet bazë, si dhe me synimet për një mbrojtje elementare, në kushtet e lindjes së pronës private dhe inkursioneve për grabitje.

Banesa nëntokësore më e hershme i përket stacionit të neolitit të mesëm në Cakran (rr. Fierit)[11]. Niveli i dyshemesë, 2,20 m nën taban, dëshmon se kjo banesë zhvillohej e tëra nën tokë. Por me kohë, si pasojë e depozitimit në brendi të shtresës kulturore, niveli i dyshemesë u ngrit në 0.60 m. Kjo solli kthimin e saj në një fazë të dytë, në një banesë pjesërisht nën tokë dhe pjesërisht mbi tokë. Dyshemetë e banesave të tjera 1,30-1,60 m nën taban, tregojnë se ato u ndërtuan që në fillim si të tilla.

Një fragment i shkurtër i Strabonit (VII – 5, 7), tregon se banesa nëntokësore në Dardaninë me klimë të ftohtë ishte mbizotëruese edhe në kapërcyellin e erës sonë. Kjo vërtetohet nga gjetja e banesave të tilla, të fillimeve të erës sonë, në Dardani (Gadimje e Sipërme) dhe tokat e Skordiskëve (Gomalavë, Stari Slankamen)[12].

Rikonstruksionin e kësaj banese mund ta arrijmë duke u nisur nga arkitektura e disa ndërtimeve ndihmëse të shekullit tonë në Shqipërinë e Veriut (Has, Lezhë, Pukë, Mbishkodër etj)[13] dhe një përshkrim i Frang Bardhit i v. 1637[14]. Sipas tyre këto banesa kishin planimetri drejtkëndëshe me faqet e gjata paksa të lartësuara mbi taban. Në faqet e ngushta të trajtuara në formë kallkani mbështetej çatia dyujëse, e mbuluar me kashtë ose pleh. Mbulimin me plehun e bagëtisë, që shquan për cilësitë termoizoluese e kuptojmë dhe nga fragmenti i Strabonit (VII, 5, 7).

Banesat mbi taban për nga forma planimetrike ndahen në banesa me planimetri rrethore dhe katërkëndëshe. Formë kalimtare paraqesin banesat me planimetri drejtkëndëshe, me skaje të lakuara. Prej këtyre formave, më të lehta për t'u ndërtuar, rrjedhimisht më të hershme, duhet të jenë banesat me

5) M. Korkuti, **Vendbanimi i Kolshit...**, f. 16-17, M. Korkuti-Zh. Andrea, **Stacioni i neolitit të mesëm në Cakran të Fierit,** Iliria, 1974, 3 f. 49-53, M. Korkuti, **Mbi rezultatet e gërmimeve...**, f. 384-387.

6) S. Aliu, **Zbulime të reja të kulturës Ilire në rrethin e Kolonjës,** Studime Historike, 1969, 1, f. 159, F. Prendi, **La civilisation prehistorique de Maliq,** Studia Albanica, 1966, 1 f. 256.

7) Strab. VII, 5, 7 Banesa e Gadimjës përmendet nga Z. Mirdita (pasthënia e librit të A. Stipçeviçit, **Ilirët, Historia, jeta, kultura,** Prishtinë, 1980, f. 251). Banesa e Gomolavës tek B. Jovanović, **Gomolava,** Rad Vojvodanskih, muzeja, 14, 1965, f. 113-135. Për banesën e stari Slan Kamenit nga A. Stipçeviç, **vep.cit,** f. 111).

8) M. Korkuti, **Die Siedlungen der späten Bronzezeit und der frühen Eisenzeit in Südwest Albanien,** Südosteuropa zwischen 600 und 1000 v. chr, Berlin, 1982, I, f. 235-255.

9) F. Prendi, **vep.cit,** f. 256, v.

10) Č. Truhelka, **Der vorgeschichtliche Pfahlbau in Savebette bei Donja Dolina,** Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und Hercegowina, Wien, 1904, **Der Pfahlbau von Donja Dolina,** Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und Hercegowina, Wien 1905.

11) M. Korkuti – Zh. Andrea, **vep.cit,** f. 49-55.

12) Z. Mirdita tek A. Stipčević, **vep.cit,** f. 251, B. Jovanoviç, **vep.cit,** f. 113-135, A. Stipčević, **vep.cit,** f. 111.

13) P. Thomo, **Arkitektura fshatare e Shqipërisë Veriore,** Tiranë 1981.

14) I. Zamputi, **Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shek. XVII,** Tiranë 1965.



KALAJA
E BADHRES

0 25 50 m



DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2

planimetri rrethore, ndonëse gjurmët e zbuluara janë më të vona se ato të banesave me planimetri drejtkëndëshe.

Banesat më të hershme me planimetri rrethore, që njohim deri më sot, i përkasin horizontit të neolitit të mesëm në Kolsh. Në këtë përfundim na shtyn trajektorja e lakuar e gropave të skeletit. Gjurmët e para të sigurta i përkasin vendbanimit të bronxit të vonë në kalanë e Badhrës (rr. Sarandës)[15]. Nga të 15 banesat që shtrihen në shpatin veriperëndimor të një kodre anëdetare, jashtë mureve të fortifikimit, tri kanë planimetri rrethore, ndërsa të tjerat drejtkëndëshe me qoshe të lakuara. (fig. 1). Prej tyre, banesat me planimetri rrethore kanë një sipërfaqe më të vogël se ato me planimetri drejtkëndëshe (8 – 14 ndaj 19 – 32 m). Për më tepër njëra nga banesat me planimetri drejtkëndëshe, duket se ndahej tërthorazi, prej terrenit dhe një muri, në dy pjesë të veçanta. Ndërtimi i tyre larg njëra-tjetrës (6 – 20 m), ndryshimi deri në katër herë i sipërfaqes (8 ndaj 32 m^2), fillimi i ndarjes së banesës në dy kthina dhe së fundi kalimi nga forma rrethore më e thjeshtë për ndërtimin me material të lehtë, në atë drejtkëndëshe, dëshmon lindjen e përvojave të reja ndërtimore. Shtroja prej dheu, pa ndonjë depozitim e këtyre banesave, tregon se ato shërbenin për fjetje, ndërsa zjarri ndizej jashtë. Vlera e tyre, relativisht e pakët, kuptohet nga ndërtimi jashtë mureve të kështjellës. Kjo e fundit, e pazënë nga ndërtimet, shërbente vetëm si vendstrehim në çaste rreziku për banorët e kësaj qendre dhe zonës përreth. Në këto raste banesat e mësipërme braktiseshin. Kjo banesë duket se rezistoi më gjatë në Ilirinë Veriore, Istrie, Dalmacinë e Veriut dhe të Mesme[16].

Renditja e drejtë e trarëve të skeletit në banesën e neolitit të mesëm në Kolsh, dëshmon për një



Fig. 3

15) M. Korkuti, **Die Siedlungen** ..., f. 235-255.
16) A. Stipçeviç, **vep.cit**, f. 112-113.

planimetri katërkëndëshe (fig. 2, 3). Kjo formë që shfaqet më qartë në banesat e neolitit të vonë në Kamnik dhe Maliq, kapet e plotë në banesat njëkthinëshe të periudhës së hekurit (Karo, Vica, Nin, Jadër, Rovinjë etj)[17]. Tipike ndër to janë banesat arkaike mollose në Vica (Janinë) (fig. 4). Në këto banesa, që gjenden 11 m larg njëra-tjetrës, i vetmi burim ndriçimi është hyrja një metërshe.

Nga fundi i periudhës së hekurit banesat me planimetri drejtëkëndëshe vargëzohen njëra pas tjetrës, si në vendbanimin liburn në Radovinë (shek. VIII — VII p.e.sonë), ku ato pasi i kthejnë shpinën murit rrethues i ngjishen njëra-tjetrës, duke krijuar një varg të paktën gjashtëkthinësh[18] (fig. 5). Kthinat më të gjata se të gjera (6 x 5 m), hapen drejt veriut të ftohtë me një hyrje dy metërshe. Pythosat dhe vatrat tregojnë se ato shërbenin si kthina për fjetje, qëndrim dhe gatim. Në njërën prej tyre vërehet dhe veçimi i kthinës së zjarrit nga kthina për fjetje, duke lindur kështu embrionin e banesës me shtëpi zjarri. Rreth shek. III p.e. sonë në Radovinë u ndërtuan banesa të reja me program të pasur, të cilat në shekujt e erës sonë u pajisën me hipokaust dhe mozaikë. Megjithëkëtë banesat e para nuk u



Fig. 4



Fig. 5

braktisën, por u rindërtuan dhe u banuan deri në shek. e VI të e.s. Por, ndërsa në shek. e VIII – VII kjo ishte banesa standart për tërë shtresat, në shek. e III p.e.s. ajo u kthye në banesë të shtresave të varfëra. Ky është dhe një nga shembujt e qartë ku forma e vjetër bashkëjetoi me të renë, por duke e ndërruar përkatësinë shoqërore. Këto banesa hasen edhe në vendbanimet e tjera liburne, në Cres, Lo-

17) Banesa e Karosë (rr. Sarandës) tek J. Koçi, **Gërmimet arkeologjike në fshatin Qeparo,** Saranda, Almanak, Tiranë 1981, 1, f .68-69 e Vicës tek J. Vokotopoulou **Epirotika Chronika,** 23, 1981, f. 146, Banesat e Ninit dhe Jadrës tek S. Batović, J. Belosević, **Nin,** Zadar, 1968, f. 16. Banesa e Roviniit tek R. Bataglia, **Ricerce paleoetnologiche e folkloristiche sulla casa Istriana primitiva,** Atti e memorie della societa Istriana di archeologia, 38, 1926, f. 31-79. Sipas tij banesa është njëkthinëshe 6 x 7 m. Në fotografinë e sjellë në artikull shihet se muret e banesës janë me blloqe të punuara me çekan, çka e daton këtë banesë nga fundi i kësaj periudhe.

18) S. Batoviç, **Istrazivaniaj ilirskog naselja u Radovinu,** Diadora, 4, Zadar, 1968, f. 53-70.

DO NOT COPY

shinj, Susak[19], Rifnik[20]. Nga fundi i periudhës së hekurit banesat njëkthinëshe japode në Maribor fitojnë trajtën e Magaronit nëpërmjet shtimit të një kthine dhe një hajati të hapur. Në ndryshim prej tyre, banesat japode në Turishka Vasa, Ptuj dhe Vaçe u ndërtuan që në fillim me hajat në ballë[21].

Banesat e palafitëve. Përhapjen e palafitit në Iliri e dëshmojnë gjurmët e 7 vendbanimeve të tilla dhe burimet shkrimore (Dunavec, Maliq, Lin, Ripaç, Otok, Donja Dolina, Liqeni i Prasias). Këto gjurmë tregojnë për një shtrije të gjerë në kohë, që nga neoliti i hershëm (Dunavec) e deri në fillimet e erës sonë (Ripaç), dhe në hapësirë. Palafitet dëshmohen në territorin japod, mbi Savë (Donja Dolina, Ripaç), në Dalmaci, mbi lumin Çehotina (Cetinja, Otok); në Dasareti, në liqenin e Ohrit (Maliq, Lin) e mbi lumin e Dunavecit (Dunavec); dhe së fundi në Pajoni, buzë liqenit Prasias. Përshkrimi i palafitit të fundit nga Herodoti, në shek. e V p.e.sonë, është dhe përshkrimi më i plotë i një palafiti.

Sipas Herodotit «Në mes të liqenit, mbi trarë të vënë, kryq, janë vendosur shtroje dërrasash. Ato lidhen me tokën me anën e një ure. Trarët mbi të cilët qëndrojnë shtrojet, në kohët e vjetra i vendosnin bashkarisht të gjithë banorët. Më vonë, secili nga ata që martohej, për çdo grua sillte tre trarë nga mali i quajtur Orbel dhe i vendoste në shtrojën. Çdo burrë martohej me shumë gra. Gjithkush mbi këto shtroje kishte një kasolle në të cilën banonte. Në mes të saj ndodhej një qepen i lidhur mirë, i cili hapej mbi liqen», (Herodot V, 16). Nga ky tregim kuptojmë se fillimet e palafitit i përkisnin një periudhe mjaft më të hershme se shek. V p.e. sonë, kur ende ishte në fuqi martesa me grupe, si dhe zgjerimin e vazhduar të platformës së palafitit, nëpërmjet shtimit të parcelave të reja për familjet e sapokrijuara.

Struktura me kasolle mbi shtroje dërrasash dhe qepena dëshmohet nga afër në palafitin e Donja Dolinës, i cili e nisi jetën në kapërcyellin midis fundit të periudhës së bronxit[22] – fillimit të periudhës së hekurit. Struktura mbajtëse e këtij palafiti i përket kohëve të ndryshme, ndërsa platforma dhe banesat kohëve më të reja. Si të tilla, duke marrë parasysh dhe riparimet, ato do t'i shihnim si të fundit të shek. V p.e.sonë.

Duke u nisur nga materiali drusor i përdorur dhe formulimi i këtyre banesave, mendojmë se planimetri drejtkëndëshe dhe mure të drunjta kanë pasur dhe banesat e palafitëve të neolitit të hershëm (Dunavec I) dhe eneolitit (Maliq II a).

Teknika e ndërtimit. Për nga teknika banesat prehistorike mund të ndahen në 4 grupe kryesore: Në banesa me konstruksione të lehta, me skelet druri, me mure druri dhe me mure guri. Nga ky grupim shkëputen banesat nëntokësore, në të cilat rolin e mureve e luajnë faqet e gropës së banesës.

1) Konstruksionet e lehta janë karakteristike për banesat me planimetri rrethore dhe drejtkëndëshe me skaje të lakuara. Bashkëjetesa e kësaj teknike në banesat e Badhrës me muret solide prej guri të kalasë, e tregon atë një remineshencë të formave primitive. Rrjedhimisht, ndonëse gjurmët e gjetura i përkasin një periudhe relativisht më të vonë, asaj të bronxit, këtë teknikë, më të lehtë në zbatim, e mendojmë me origjinë më të hershme. Në Badhër (fig. 1), konturi i banesave përvizohet prej një xokoli gurësh të papunuar me lartësi rreth 1 m[23], çka tregon se paretet vijonin lart me materiale të lehta. Rikonstruksionin e kësaj strukure na e lejon paralelja me ndërtimet ndihmëse fshatare të ditëve tona.[24] Këto ndërtime me planimetri rrethore ose drejtkëndëshe me qoshe të lakuara, kanë gjithashtu mure prej gurësh të thyer të puqur në të thatë, rreth 1.40 m të lartë.

19) A. Makaroviç, **Sjevorozapadna granica teritorjalne rasprostranjenija starohrvatske rchitekture,** Peristyl, 2, 1957, f. 93.

20) Rifniku, i cili sipas A. Stipçeviçit (vep.cit., f. 113) i takon epokës së vjetër të hekurit, paraqet një varg trikthinësh.

21) W. Schmied, **Die ringwalle des Bacherngebietes,** Mitteilungen der Prahistorischen ommision, I, bd, 2, 3, 1915, f. 278, 284, 276, **Vače pred zgodovinska naselbina,** glasnik luzejskogo drustva zasloveniju, 1939, f. 114.

22) G. Truhelka, **(vep.cit.)** i rreshton gjetjet, por pa mbajtur ndonjë qëndrim për atimin. Më i plotë është mendimi i A. Benacit **s.v. Donja Dolina.** Enciklopedija Jugoslaje, Zagreb, 1958, III, f. 57-58.

23) M. Korkuti **(Po aty)** ve në dukje se banesat ndodhen në një nivel të veçuar, larg endrave të banuara. Rrjedhimisht gurët e tyre nuk janë grabitur dhe vëllimi i sotëm përgjigjet gjendjes fillestare. Xokoli ka gjerësi 0,70 – 1,20 m dhe lartësi 0,50 – 0,80 m, a i përgjigjet një muri rreth 0,70 m të gjerë dhe 1 m të lartë.

24) K. Zheku, **Të dhëna mbi kasollet fshatare të vendit tonë dhe gjurmët e tyre në shtësi,** Monumentet 5 – 6, 1973, f. 82, 86. M. Krasniqi, **Shtëpia shqiptare në Kosovë.** jurmime albanologjike, seria folklor-etnografi, Prishtinë, 1, 1971, f. 19 v.

DOKTORSKY

DO NOT COPY



Fig. 6

Mbulesa e çatisë së tyre përbëhet prej purtekash që mblidhen dhe lidhen të përkulura në majë, duke formuar kupolën ose qemerin. Ky skelet dhe mbulesa mbështeten drejtëpërsëdrejti në muret perimetrale. Rrjedhimisht, faqe e brendshme ishte pareti i çatisë, i cili vijonte mbi lartësinë e xokolit të gurtë, çka e shkëpuste çatinë nga toka, duke e ruajtur nga lagështia.

2) Struktura me skelet druri, kapet që në neolitin e mesëm (Kolshi II)[25] (fig. 2). Në të, gropat për trarët vertikalë (∅ 0,20 – 0,30m), gjenden rreth 1 m larg njëra – tjetrës. Midis tyre vijonin traversat (∅ 5 – 10cm) që shërbenin dhe për krijimin e qemerit të çatisë. Gjurmët në baltën e suvasë së banesës të neolitit të hershëm në Vashtëmi tregojnë edhe për një skuadrim, qoftë primitiv, të traversave. Skeleti i mësipërm thurrej në formë trine, me kallama në vendbanimet buzujore (Maliq I, II b), ose me thupra në vendbanimet e tjera. Për mbrojtjen nga era dhe lagështia këto trina suvatoheshin nga brenda dhe jashtë me llaç balte, i cili për mënjanimin e plasjes nga tharja, përzihej detyrimisht me byk ose kashtë. Kjo teknologji që dëshmohet në banesat e neolitit të hershëm (Vashtëmi), vazhdon në neolitin e mesëm (Kolshi), në eneolit (Maliq II b) dhe në periudhën e hekurit (Labovë). Gjurmët e purtekave tregojnë se ato qëndronin një diametër, rreth 1,5 cm, larg njëra-tjetrës, për të lejuar lidhjen e drejtpërdrejtë të shtresës së jashtme dhe të brendshme të suvasë.[26]

3) Platforma e palafitit të Donja Dolinës e përbërë prej strukturës mbajtëse me trarë horizontalë dhe shtrojes me trarë të çarë, ngrihej mbi pilastra druri të vendosura dendur, çdo 1 m^2. Nën banesa dendësia e tyre ishte 3 herë më e madhe, rreth 110 pilota për secilën (fig. 6).[27]

Deri në lartësinë e ruajtur 1.60 m, muret vijonin me trarë druri, të cilët në faqet tërthor platformës shkelnin mirë mbi njëri-tjetrin, pa lënë hapësira boshe.[28] Dy faqet e tjera qenë dy paretëshe me mesin të mbushur me argjilë.[29] Muret e tërthor-



Fig. 7

25) M. Korkuti, **Vendbanimi neolitik i Kolshit...**

26) Mendimi i përhapur se balta e suvatimit piqej për ta bërë atë më të qëndrueshme mendojmë se është i gabuar, pasi një pjekje eventuale do ta shkatërronte skeletin e drunjtë. Ruajtja e gjurmëve në formë balte të pjekur duhet të jetë pasojë e zjarreve që i kanë shkatërruar banesat e mësipërme.

27) Pilotat me diametër 0,10 – 0,45 m, gjatësi 1,5 – 4 m, dhe majë të mprehtë deri 1 m, janë futur më se 1 m në tokë, duke u rrahur me tokmak të rëndë. Pilotat i përkasin kohëve të ndryshme, ndërsa dyshemeja kohës më të re.

28) Lidhja e strukturave sigurohej vetëm nëpërmjet kllapëzimit dhe efektit të peshës. Me gozhdë, për më tepër të drunjta, janë bashkuar vetëm dërrasat e shkallëve.

29) Përjashtim bën vetëm njëra nga banesat (III), faqja lindore dhe veriore e së cilës ka dy rreshta trarësh.

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

ta që ndanin mjediset janë punuar pjesërisht me trarë e pjesërisht me pilota të thurura me trinë e të lyera me suva balte (fig. 7).

4) Në banesat e hershme nëntokësore, pjesërisht nëntokësore dhe ato me konstruksion të lehtë, muratura me gurë ka lartësi të vogël, rreth 1 m. Si e tillë ajo është vetëm plotësuese. Mungesa e muraturës së gurtë shpjegohet me kërkesën për një konstruksion të qëndrueshëm, i cili mund të arrihej vetëm nëpërmjet përpunimit të tij. Në të kundërt, në periudhën e hekurit, kjo muraturë bëhet e rëndomtë. Muret e banesave të kësaj kohe, rreth 0.70 m të gjera (Karo, Vica, Radovinë etj), janë me gurë të përpunuar ashpër, të lidhur me llaç balte (Vashtëmi, Kolsh, Cakran, Dunavec II, Kamnik, Maliq I, Maliq II a, Karo).

Dyshemeja e banesave është prej një shtrese dheu. Gjetja në këtë shtresë e hirit, coprave të suvasë (Vashtëmi) dhe e thëngjijve (Kamnik), tregon se dheu i baltës së dyshemesë nxirrej në vend. Mendojmë se kjo shpjegon dhe praninë e gropave me përmasa të mëdha në qendër të banesave (Cakran, Kolsh II, 3,9 x 2,25 m) (fig. 2), të mbushura me thëngjill, hi, enë të thyera dhe kocka kafshësh. Në tokë të fortë shtresa e argjilës vijon drejt e mbi taban, ndërsa në tokë të butë, mbi një shtresë kalldrëmi (Vashtëmi, Karro). Për të mënjanuar lagështinë në terrenet buzëujore, ajo shtrohej mbi një dysheme trarësh (Dunavec II, Maliq I)[30]. Po e tillë ishte dhe dyshemeja e banesave palafite (Donja Dolina).

Vatra për gatim dhe ngrohje ndodhej në mes ose në skajin e largët nga hyrja (Vica). Në neolitin e hershëm e të mesëm hasen si vatrat e mirëfillta (Kolsh, Cakran) (fig. 8), ashtu dhe vendet për ndezje zjarri (Vashtëmi), ende të pafiksuara në një vend të caktuar. Në periudhat e mëvonshme hasen vetëm vatrat e mirëfillta.[31] (Maliq, I, II, Vica) (fig. 4), të cilat me kohë kthehen edhe në simbole kulti.[32] Këto vatra kanë formën e një kuadrati me skaje të lakuara, të përvizuar prej një buzine të ulët (Kolsh, II, Maliq II b) (fig. 9).

BANESA E PERIUDHËS QYTETARE

Ndonëse periudha qytetare shtrihet në një hark kohor mjaft më të shkurtër se periudha prehistorike, banesa e saj, falë zhvillimit të përshpejtuar, paraqitet me një larmi tipash e variantesh. Kjo ecuri, brenda kuadrit të zhvillimit të përgjithshëm ekonomiko-

30) Pjekja e dyshemesë, siç mendon për Maliqin I F. Prendi (**La civilisation...**, f. 256) nuk na duket bindëse. Ashtu si dhe për suvanë prej balte vlen arsyetimi se zjarri për pjekje do shkatërronte strukturën e drunjtë të skeletit.

31) Krahas vatrave, në disa mjedise (Donja Dolina dhe Kamnik) gjenden dhe furrat e pjekjes me diametër 2 m. C. Truhelka, **vep.cit;** S. Aliu, **vep.cit.**

32) Č. Truhelka, **Vep.cit.**



DO NOT COPY

Fig. 10

-shoqëror, lidhet me kërkesat e reja të shoqërisë së polarizuar në klasa. Arritjet teknike dhe akumulimi në rritje lejuan vënien në jetë të këtyre kërkesave.

Banesat e kësaj periudhe mund të ndahen në dy grupe: banesa që lindën në sajë të zhvillimit të brendshëm, me pasojë shtimin gradual të mjediseve përreth bërthamave të prototipave prehistorike, dhe banesa të huazuara nga repertori bashkëkohës i banesës mesdhetare, helenistike. Karakteristika të grupit të parë janë racionalizmi, përshtatja ndaj terrenit dhe zbatimi krijues i programit. Tipat e banesave të huazuara u morën prej shtresave të kamura qytetare, më kozmopolite. Duke qenë banesa të të njëjtit brez klimaterik me kushte të njëjta ekonomiko-shoqërore, ato nuk u kthyen në trupa të huaj, por u aklimatizuan mirë duke fituar disa veçori, qoftë edhe të vogla.

Banesa me shtëpi zjarri

Banesa me shtëpi zjarri lidhet drejtpërsëdrejti me arketipin prehistorik, me banesën një kthinëshe me vatër, e cila përbën dhe bërthamën qendrore të këtij tipi. Ky është dhe mjedisi diktues për përcaktimin e tipit. Emërtimi i tij në shekullin tonë «shtëpi zjarri», tregon qartë se ky mjedis në origjinë ishte vetë shtëpia[33]. Me kohë kësaj bërthame shumëfunksionale, për gatim, ngrënie, qëndrim dhe fjetje, iu shtuan mjedise të tjera të cilat morën mbi vete disa prej funksioneve origjinare, pjesërisht fjetjen dhe qëndrimin. Por, nëse shtëpia e zjarrit, në rastet e shtimit tej masës së pjesëtarëve të familjes ose ardhjes së miqve të shumtë, mund t'i merrte përsipër funksionet e mjediseve të tjera, këto mjedise, për shkak të përmasave të vogla dhe mungesës së vatrës, nuk mund t'i plotësonin, qoftë edhe në grup, funksionet jetike të shtëpisë së zjarrit, gatimin dhe ndejtjen e familjes në kohë të ftohtë.

Fillesat e këtij tipi kapen që në Radovinë, ku nga mjedisi me vatër veçohet në një farë mase mjedisi për fjetje (fig. 4). Por strukturë të kristalizuar ai fiton në banesën e Donja Dolinës. Rrugën e zhvillimit të tij të mëtejshëm e ndjekim në Kasope, Çukën e Ajtoit, Oraion dhe me një rishfaqje të vonë në banesën tiranase. Në funksion të terrenit kjo banesë krijon dhe variante, përkatësisht banesën e shpatit me shtëpi zjarri në Çukën e Ajtoit.

Banesat e palafitit të Donja Dolinës (fig. 6,7,10, 11)[34] kanë sipërfaqe 35 – 45 m^2. Nga banesat e ruajtura më mirë kuptohet se ato kishin planimetri drejtkëndëshe, me një raport gjatësi – gjerësi 7 : 4, të ndarë në tri kthina. Kthina e parë (20 – 22,5 m^2), shtëpia e zjarrit, thuajse katrore, zinte tërë ballin[35]. Përmasat dhe vatra në mes ose në skajin e largët nga hyrja, e tregojnë atë mjedisin kryesor, për gatim, ngrënie, ndenjje dhe fjetjen e anëtarëve të pamartuar të familjes. Shtëpia e zjarrit, nuk kishte tavan, në mënyrë që tymi të dilte nëpërmjet pullazit. Një mur i tërthortë në shpinën e saj veçonte dy kthina të tjera të vogla, të ndara po me mur nga njëra-



Fig. 11

33) E. Riza, **Shtëpia e zjarrit në banesën qytetare shqiptare,** Etnografia shqiptare, 14, 1985, f. 77. Po kështu – W. Hoepfner – E. L. Schwandner, **(Wohnung in der klassischen Polis, Haus und Stadt- im Klassischen Grichenland,** München, 1986. f. 269) e shkëpusin këtë tip nga banesat klasike greke duke e quajtur banesë me mjedis me vatër (Herdraumhaus).

34) Ç. Truhelka, **vep.cit.**

35) Përmasat e saj janë: në banesën III: 4,2 x 4,9 m, IV: 4,6 x 4,9 m, VI: 4,5 x 4,5 m. Nga kthinat e tjera (IV, VI, X) kapet gjerësia: 5.8, 5.2 dhe 5.3 m.

DO NOT COPY

-tjetra.[36] Kalimi për në këto kthina 2 – 2,5 m të larta të pajisura me tavan anjesh, i cili i mbronte nga e ftohta dhe lagështira, kryhej nëpërmjet shtëpisë së zjarrit. Tavani dhe përmasat i tregojnë ato dhoma fjetje. Hapësira midis çatisë prej trarësh të mbuluar me kashtë dhe tavanit shërbente si depo për veglat e punës dhe drithin që ruhej në kosha ose arka. Në njërën nga banesat (III) si depo shërbente dhe hapësira një metërshe ndërmjet dyshemesë dhe platformës së vjetër. Në këtë depo kalohej nga shtëpia e zjarrit me anë shkallësh të brendshme. Gjurmët e një tavani të dytë tregojnë se njëra prej banesave ishte dykatëshe. Kjo dëshmon për zhvillimin e brendshëm të këtij tipi dhe kalimin nga skema e thjeshtë njëkatëshe në skemën me dy kate.

Në njërën prej banesave shtëpia e zjarrit kishte dy vatra. Trajtimi dhe forma tregojnë se vatra në mesin e dhomës shërbente vetëm për ngrohje, ndërsa vatra tjetër, që i mbështetej murit anësor, për gatim. Ky diferencim përveç anës praktike, gatimit në një vatër teknologjikisht më të arritur, tregon se vatra qëndrore kishte fituar funksione kulti (fig. 12). Zbukurimi i bordurave të vatrave me svastika, meandra, kryqe elikë, i dëshmon ato altarë të kultit të lashtë ilir të diellit, zjarrit dhe ngrohtësisë së vatrës familjare[37]. Në krahasim me banesat e përparme, tepër të thjeshta, banesa e Donja Dolinës shënjon një hop cilësor për nga programi dhe zgjidhja arkitekturore. Kushtet ekonomiko-shoqërore dhe pozita e veçuar i tregon këto banesa evolutive dhe jo të transplatuara. Hopin e mëtejshëm në zhvillimin e këtij tipi e shënjojnë banesat e Kasopesë.



Fig. 12

Banesat e Kasopesë epirote[38] shtrihen në një pllajë me skaje të thepisura, të përshtatur për endjen e rrjetit urbanistik ortogonal. Insulat e tija të përzgjatura «per strigas» (100 x 420 këmbë – 30 x x 126 m). Karakteristike për rrjetet e hershme urbanistike në Magnia Graecia, ndahen në mes prej rrugënës së ngushtë për kullimin e ujërave. Në këto gjysmë insula, të orientuara nga jugu në veri, vargëzohen kryesisht 8 banesa me planimetri thuajse katrore (14,40 x 15,60 m, 225 m²)[39] (tab. 1).

Shembujt e ruajtur më mirë (fig. 13, 14), tregojnë se në fazën origjinare ata kishin program të njëjtë dhe trajtim thuajse uniform. Hyrja, afër mesit të faqes nga rruga të çonte në oborrin që shërbente për qëndrimin e familjes në kohë të mirë dhe si nyje e parë organizuese dhe ndërlidhëse. Njëra anë e tij komunikonte me andronin, tjetra me bllokun e depove dhe dyqaneve, ndërsa balli me bllokun e shtëpisë së zjarrit dhe mjediseve të banesës. Ky bllok me planimetri drejtkëndëshe, me raportin 7 : 4, ripërsërit i zmadhuar banesën e Donja Dolinës (102 m²/ 33,2 m²). Si të tillë atë e kemi emërtuar «shtëpi të mirfilltë». Banesa e Kasopesë diferencohet në lartësi, me kufi murin e tërthortë në fund të oborrit. Pjesa e pasme, shtëpia e mirëfilltë, dhe sipas nesh edhe trakti përkatës i dyqaneve dhe depove, zhvillohej në dy kate lartësi[40]. Trakti tjetër, pjesa e përparme, ishte njëkatësh (fig. 15).

36) Kthina e parë është II: 2,4 x 3,7. IV: 1,8 x 2,3. V: 1,8 x 2,8 m, ndërsa kthina e dytë II: 3,5 x 3.7. IV: 2,8 x 2.3. V: 3.2 x 2,8 m. Në banesat e tjera kapet vetëm gjerësia dhe gjatësia e përbashkët (I: 2 x 5,8. III: 2 x 5.6. VI: 2,3 x 4,5. X: 2 x 5.3 m).

37) A. Baçe, **Vështrim...**, f. 5-8. Për prejardhjen dhe domethënien e këtyre simboleve A. Stipçeviç, **Kukasti kriz svastika-crux gramata kod starih ilira,** Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1970, f. 1-2.

38) Përmendja në listën e therodokëve të Epidaurit (IG IV² 95) në v. 360 – 355 dhe prerja e monedhës në v. 343/2 p.e.sonë (P. Franke **Die antiken Munzen von Epirus,** 1961, f. 55 – 69) e tregojnë Kasopenë qytet të kristalizuar në gjysmën e parë të shek. IV.

39) Për banesën e Kasopesë W. Hoepfner – E. L. Schwandner, **vep.cit.** 75 v.

40) W. Hoepfner – E. L. Schwandner, **vep.cit,** fig. 10, f. 112 e rikonstruktojnë tërë bllokun e dyqaneve me një kat. Por kjo bashkësjell një strukturë të komplikuar dhe humbje sipërfaqeje banimi. Supozojmë se të paktën në disa banesa kati i II shtrihej edhe mbi dyqanet. Kështu, në banesën 14, shkalla të shpie fillimisht në zonën mbi këtë bllok, çka do të ishte pa kuptim nëse ai do të qe njëkatësh.

POZITIV



DO NOT COPY

ig. 13

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15



Fig. 16

Bërthamën e shtëpisë së mirëfilltë e përbënte shtëpia e zjarrit, me planimetri kryesisht katrore (49 m^2)[41]. Shtëpia e zjarrit që lartësohej në të dy katet nuk kishte tavan, në mënyrë që tymi i vatrës të dilte nëpërmjet plasave të çatisë. Vetë vatra (fig. 16) i shmangej boshtit të hyrjes për mënjanimin e rrymave të ajrit. Nga ana e pasme, shtëpisë së zjarrit, i mbështeteshin mjediset e banimit, nga dy për çdo kat. Në dy kthinat e katit të I kalohej drejtpërdrejt, ndërsa në dhomat e katit të II nëpërmjet një shkalle në formë ballkoni – korridor, si mafili i banesës tiranase. Në katin e dytë ka mjaft gjasë të kishte dhe dy dhoma mbi bllokun e dyqaneve. Rrjedhimisht, shtëpia e mirëfilltë kishte 7 ose të paktën 5 mjedise. Duke u nisur nga krahasimi tipologjik, në kthinat e katit të dytë duhen kërkuar dhomat e fjetjes dhe ajo e grave-gynaikonitisi. Blloku i dyqaneve ose magazinave zakonisht ndahej në 3 kthina, në të cilat kalimi kryhej i dyfishtë, nga oborri dhe rruga. Në një rast, në këtë bllok bënte pjesë dhe stalla.

Banesa e Oraonit[42] (Amotopos) zë skajin e njërës nga gjysmëinsulat e përzgjatura të këtij qyteti mollos. Banesa që ruhet e plotë në dy kate lartësi,

41) Sipërfaqet e sjella i korrespondojnë mesatares aritmetike.

42) S. Dakaris, W. Hoepfner, E. L. Schwandner, N. Gravani, **(Anaskafi ston Ammotopo,** Dodoni, 5, 1976, f. 431-43o), shkruajmë se ndërtesa ka dy faza, nga të cilat, perëndimorja, pas dhembëzimit, i takon fazës së dytë. Kjo ndarje bie ndeshas me sistemin e insulave pasi gjerësia e plotë 14,80 m përkon me gjerësinë e një gjysmë insule. Në librin e tyre, W. Hoepfner, E. L. Schwandner **(vep.cit, f. 269)** flasin për një rikonstruksion, por në planimetritë përcjellëse **(vep.cit,** fig. 266) nuk shihet fazifikimi përkatës.



Fig. 17

ka sipërfaqe 285 m² dhe formë thuajse drejtkëndëshe (fig. 17). Hyrja që ndodhet në skaj të çon nëpërmjet korridorit në një oborr të vogël, i cili shërbente si nyje e parë shpërndarëse. Në njërën anë të oborrit ndodhej androni, në anën e përkundrejtë depoja e përzgjatur, ndërsa nga balli shtëpia e mirëfilltë. Në ndryshim nga banesa e Kasopesë kalimi në të kryhej nëpërmjet një hajati, i cili veç rolit të amburit për shmangien e rrymave të ftohta, kryente dhe funksionin e nyjes së dytë shpërndarëse. Shtëpia e zjarrit lidhej me magazinën e ushqimeve dhe me dy kthina të vogla duke krijuar një bllok, i cili ripërsërit me besnikëri shtëpinë e mirëfilltë të Kasopesë dhe banesën e Donja Dolinës. Shtëpia e zjarrit (45 m²), (fig. 18), e cila në mesin e saj ka një vatër të madhe, ndërsa në skaj shkallën në formë ballkon-korridori, vijonte në lartësinë e dy kateve, për 5,9 m, duke siguruar kështu tërheqjen e mirë të zjarrit të vatrës dhe shpërndarjen në kthinat e shtëpisë. Planimetria e katit të dytë ripërsërit planimetrinë e katit të parë duke dubluar çdo mjedis përjashtuar këtu vetëm shtëpinë dykatëshe të zjarrit.

Tepër e ngjashme me banesën e Oraonit, për nga programi, përmasat dhe formulimi, është banesa tiranase e cila në shembujt e ruajtur i përket fundit të shek. të kaluar. (fig. 19). Shtëpia e zjarrit (51 m²),



Fig. 18

DO NOT COPY

DO NOT COPY

e vendosur në qendër të banesës, është e rrethuar në të katër faqet me mjedise të tjera banimi. Këto të fundit zhvillohen në dy kate, ndryshe nga shtëpia e zjarrit, e cila ngrihet në lartësi sa të dy katet e mjediseve rrethuese.[43]

Banesa e shpatit me shtëpi zjarri haset në qytetin e Çukës së Ajtoit, qytet tipik shpati.[44] Ndonëse skema urbanistike e qytetit nuk është e rregullt, në të shihet synimi për renditjen e banesave gjatë së njëjtës vijë rrushkulluese, në vargje të lakuara në përshtatje me terrenin. Këtij lakimi i përmbahen dhe rrugët që vijojnë mes tyre, mbi tarraca 2,80 m të gjera. Në shpatin jugor, 30 m më në brendi të murit rrethues, shihen rrënojat e tri banesave me skemë të njëjtë kompozicionale. Dy prej tyre vijojnë në varg pas njëra-tjetrës, ndërsa e treta ndodhet pak më larg. (fig. 20). Banesat, të orientuara mirë ndaj diellit të jugut, kanë në planimetri formën e shkronjës «L». Për shkak të pjerrësisë 45° të terrenit dhe planimetrisë asimetrike, banesat kanë një zhvillim volumor të diferencuar (fig. 21). Ndërsa blloku kryesor zhvillohet me 2 kate, krahu i dalë, i lidhur organikisht me të, është 3 katësh, duke arritur në banesën e ruajtur më mirë, një lartësi prej 11,10 m nga kulmi i çatisë. Në katin e parë të kësaj banese ndodhet një kthinë e vetme, që ndërthuret organikisht me bllokun kryesor[45]. Në katin e dytë dhe të tretë, përreth bërthamës së saj kompozicionale, shtëpisë së zjarrit, grupohen 7 kthina. Kjo tregon se banesa zhvillohej praktikisht me një plan të vetëm horizontal, të shtrirë përgjatë vijave rrushkulluese (fig. 21, 22).

Në kthinën e madhe 28,70 m dhe të lartë 4,45 m të katit të parë kalohej nga rruga, nëpërmjet një hyrjeje, në ballin e dalë. Dyshemeja e saj, një rampë shkallë dhe faqja e pasme janë gdhendur në shkëmb. Kjo faqe dhëmbëzohet në 1,50 m lartësi për të krijuar një bordurë të gjerë; në mesin e saj ndodhej çezma e ushqyer prej një burimi, ndërsa anash ndodhej vazhdimi i shkallës për në katin e dytë. Duke u nisur nga fragmentet e dinosave dhe burimi i sistemuar i ujit këtë kthinë e shohim si punishte ose depo të veglave të punës dhe re-



Fig. 19

zervave ushqimore. Prej saj shkalla të çonte në bërthamën e banesës, në shtëpinë e zjarrit, me planimetri thuajse katrore (49 m²). Foletë e trarëve të çatisë (fig. 23, 24) dhe mungesa e foleve të trarëve të dyshemesë ndarëse tregojnë se shtëpia e zjarrit vijonte për 5,65 m, në lartësinë e dy kateve, pa u mbuluar me tavan. Në shtëpinë e zjarrit kalohej nga jashtë nëpërmjet një hyrjeje anësore dhe një kthinë – tambur, ose nëpërmjet shkallës nga kati i

43) E. Riza, **Vep.cit,** f. 77.

44) S. Islami, Në vitin 1979 kryen gërmime në Çukën e Ajtoit. Gjatë tyre, përveç sistemit fortifikues, ai shpie deri në fund gërmimet e filluara nga L.M. Ugolini tek banesa e trajtuar në artikull. Por, përveç lajmit të shkurtër se «në brendi të rrethimit ruhen gjurmët e 40 banesave, shumica prej të cilave në anën perëndimore», (S. Islami, **Qyteza në Çukën e Ajtoit,** Saranda, almanak, 2, 1982, f. 51) ai nuk boton ndonjë material tjetër.

45) Skicat e kësaj banese dhe banesave të tjera të Çukës së Ajtoit janë nxjerrë në terren nga A. Baçe, S. Terezi, ndërsa rilevimi i kompleksit të poshtëm nga M. Bezhani, A. Baçe.

parë. Një mulli për bluajtje drithi në skajin e pasëm (fig. 25) dhe fragmentet e mokrave, pythosave dhe amforave, tregojnë se shtëpia e zjarrit krahas ndenjjes shërbente si vend për përgatitjen dhe mbajtjen e rezervave ushqimore. Shpina e saj, pjesërisht muret anësore dhe pjesa më e madhe e dyshemesë, janë gdhendur në shkëmb (fig. 20). Pjesa tjetër e dyshemesë ngrihet mbi mbushjen e mbajtur prej një xokoli me blloqe të latuara. Nga fundi i tabanit shkëmbor dyshemeja dhëmbëzohet, ndoshta për të krijuar folenë e një dyshemeje dërrase. Duke u nisur nga shembujt e ruajtur (Oraion, Banesa Tiranase) dhe nga llogjika konstruktive, ky mjedis ka qenë i errët, i ndriçuar paksa nga balli nëpërmjet dritaresh frëngji.

Shtëpia e zjarrit komunikonte me tërë mjediset e tjera, duke shërbyer si nyje ndërlidhëse – organizuese. Nga e majta kalohej në një kthinë të gdhendur në shkëmb. Në shpinën e saj, në 2 m lartësi shihen foletë e trarëve masivë të dyshemesë (rreth 30 x 40 cm), që e ndanin këtë mjedis në dy kate (fig. 26). Në katin e sipërm kalohej me shkallë, po nga shtëpia e zjarrit, nëpërmjet një porte prej së cilës ruhen gjurmët e pragut. Lartësia e këtij kati lëviz nga 3,25 m në fund, në 1,85 m në ballë, në funksion të pjerrësisë së çatisë. Trarët e fuqishëm tregojnë se dyshemeja e tij shërbente për mbajtjen e ngarkesave të rënda, pra si depo. Kati i poshtëm vijonte detyrimisht mbi katin e I, duke krijuar një kthinë që mund të ndriçohej nga balli ose anët me dritare.

Nga e majta shtëpia e zjarrit ndërlidhej nëpërmjet një korridori me një kthinë të vogël, të ndarë po në dy kate (fig. 27). Kthina e katit të poshtëm, si pozicion afër hyrjes dhe sipërfaqe, do t'i përgjigjej andronit. Nga ana tjetër ajo është e errët, e ndri-



Fig. 20

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 21



Fig. 22

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 23



Fig. 24



Fig. 25



Fig. 26



Fig. 27



Fig. 28

çuar tërthorazi vetëm nëpërmjet hapësirës së derës. Si andron vjen në konsideratë dhe kthina përballë saj, me mundësi mjaft më të mira ndriçimi, por me sipërfaqe të vogël. Solenët e shumtë tregojnë se banesa mbulohej me tjegulla (fig. 28).

Zhvillimi i banesës me shtëpi zjarri (tab. 1) nis fillimisht me Donja Dolinën, ku me shpenzime minimale, nëpërmjet shtimit nga shpina e shtëpisë së zjarrit të kthinave për fjetje dhe depove, kristalizohet një banesë mjaft racionale (fig. 10). Kjo banesë i përgjigjet një stadi ende në fermentim, kalimit nga shoqëria paraurbane në atë urbane, çka kuptohet nga numri ende i kufizuar i mjediseve. Në to vërehet dhe një hop i ri cilësor, shkëputja e qartë e shtëpisë së zjarrit nga dhomat e fjetjes dhe depot. Krahas kësaj, në banesat e Donja Dolinës vihet re



Fig. 29

DO NOT COPY

synimi, qoftë embrional, ndaj konfortit, i shprehur përveç veçimit të mjediseve të fjetjes, në pajisjen e tyre me tavan. Gjurmët e zhvillimit të mëtejshëm të kësaj banese hasen po në Donja Dolina, ku shembujt e vonë zhvillohen në dy kate lartësi. Njësia e mësipërme, shtëpi zjarri me dy kthina të vogla për fjetje dhe depot në shpinë, paraqet një grup të kristalizuar mirë, i cili e ndjek zhvillimin e këtij tipi, në rolin e bërthamës qendrore, edhe në shembujt më të zhvilluar.

Në banesat e Kasopesë (fig. 13), ky grup, që veçohet qartë nga mjediset e tjera, ripërsërit me të njëjtin raport (7 : 4), por me përmasa më të mëdha, banesën e Donja Dolinës. Në Kasope, në përkim me shembujt e zhvilluar të Donja Dolinës, Shtëpia e zjarrit zhvillohet në lartësinë e dy kateve, ndërsa dhomat e fjetjes ripërsëriten në katin e dytë. Në përputhje me kërkesat e reja, kësaj bërthame i bashkëngjitet oborri, blloku i dyqaneve e depove dhe androni. Në banesën e Oraionit, (fig. 17), më të vonë në kohë, bërthamës së mësipërme i bashkëngjitet një numër edhe më i madh mjedisesh (13) dhe një hajat. Ashtu si në Kasope këtu kemi të bëjmë vetëm me shtime mekanike, të cilat nuk e prekin tiparin bazë të kësaj banese, mbizotërimin e Shtëpisë së zjarrit ndaj mjediseve të tjera.

Në qytetin e vogël në Çukën e Ajtoit (fig. 21, 22), me stad më të ulët zhvillimi, sipërfaqja e banesës është më e vogël se në Kasope dhe Oraion, ndërsa sipërfaqja e Shtëpisë së zjarrit përkon plotësisht. Rrjedhimisht përqindja që zë Shtëpia e zjarrit në raport me tërë banesën është më e lartë. Mungesa e sipërfaqeve të lira, oborrit dhe hajatit, e tregojnë atë një banesë utilitare me skemë kompakte, të përshtatur mirë ndaj terrenit. Por edhe ajo nuk shkëputet nga tipi i banesës me Shtëpi zjarri, duke paraqitur vetëm një variant të tijin, banesën e shpatit me Shtëpi zjarri.

Shtëpia e zjarrit në raport me vëllimin e përgjithshëm të banesës shënjon një ulje relative në kohë nga 68% në Donja Dolina, në 56% në Çukën e Ajtoit, në 28,6% në Kasope dhe 17% në Oraion (tab. I, fig. 29). Kjo ulje relative, pasojë e shtimit të mjediseve në përshtatje me kërkesat e kohës, e tregon këtë tip banese dinamik dhe evolutiv. Në të kundërt, në madhësi absolute, Shtëpia e zjarrit rritet në sipërfaqe dhe ca më tepër në vëllim, përkatësisht nga 21,2 m^2 dhe 45 m^3 në Donja Dolina, në 49 m^2 dhe 220 m^3 në Kasope, 49 m^2 dhe 273 m^3 në Çukën e Ajtoit, dhe 45 m^2 dhe 280 m^3 në Oraion. Ecuria e mëtejshme mund të arrihet duke interpretuar banesën tiranase, ku Shtëpia e zjarrit, që zë vetëm 12% të vëllimit të përgjithshëm të banesës,



Fig. 30

ka sipërfaqe 52 m^2 dhe vëllim 300 m^3. Këto të dhëna tregojnë se ndryshimet sasiore, në përshtatje me kërkesat e kohës, nuk sollën elemente të reja cilësorë, që do të diktonin formimin e një tipi të ri (tab. II).

Banesa me shtëpi zjarri është specifike për Ilirinë dhe Epirin. Në të vërtetë shtëpia e zjarrit, dhoma me vatër, haset edhe në banesat greke (oikosi). (tab. II, fig. 29). Por vendi i saj në skemën kompozicionale dhe sipërfaqja relativisht e vogël e tregojnë atë njësi të nënrenduar dhe jo element diktues për përcaktimin e tipit. Kjo kuptohet mjaft mirë nga krahasimi i skemave kompozicionale dhe sipërfaqes së mjediseve korresponduese të banesave të shqyrtuara më sipër me banesat e njohura të qyteteve greke të shek. V – gjysmës së parë të shek. IV p.e.sonë (Kolofon, Olynth Abdera, Pire, Prienë). Prej tyre sipërfaqja e banesës së Kasopesë (225 m^2) afron tepër me sipërfaqen mesatare të banesave të këtyre qyteteve (231 m^2). Por ndërsa sipërfaqja e mjediseve të banimit mbetet e njëjtë (30/30 m^2) dhe ajo e andronit e përafërt (23/16 m^2) sipërfaqet e tri mjediseve të tjera kryesore, shtëpisë së zjarrit, oborrit, dhe hajatit, ndryshojnë ndjeshëm.

Shtëpia e zjarrit në Kasope është më se dy herë

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 31

më e madhe se në qytetet e mësipërme (49/23 m²), ndërsa oborri zë një sipërfaqe afro tri herë më të vogël (27/70 m²). Kjo e tregon atë kryesisht nyje ndërlidhëse dhe më pak vend qëndrimi në kohë të mirë, si në banesat e qyteteve greke. Sipërfaqja e tepërt në këtë rast i kalon depove dhe stallave (52/31 m²), çka tregon për një lidhje më të fortë me ekonominë fshatare. Së fundi, hajati, element përcaktues i tipit prostas dhe pastas të banesave greke, këtu mungon krejtësisht. Në Oraion dhe Çukën e Ajtoit vazhdon të ruhet raporti i mëparshëm, me shtëpi të madhe zjarri (45/24 m²; 49/23 m²) dhe oborr të vogël (33/60 m²). Ky i fundit në Çukën e Ajtoit mungon fare. Ndonëse në Oraion shfaqet hajati ai vazhdon të mbetet i vogël (11/22 m²), në rolin e një nyje ndërlidhëse dhe tamburi për shmangjen e rrymave të ftohta. Sipërfaqja e përafërt e banesave të Kasopesë dhe Oraionit me banesat e Olynthit, Kolofonit, Abderës, Pireut e Prienës tregon për njësi të baraspeshta, për familje numerikisht të barabartë. Këtë e dëshmon më qartë sipërfaqja krejt e njëjtë (Kasope) ose e përafërt (Oraion) e mjediseve të banimit. Rrjedhimisht, sipërfaqja më se dy herë më e madhe e shtëpisë së zjarrit shpjegohet vetëm me strukturën e ndryshme familjare. Si e tillë ajo shërbente si një bërthamë bashkimi. Përqëndrimi në një mjedis të vetëm i tërë pjesëtarëve të familjes, jep të kuptohet për një jetë familjare kompakte dhe një formë më demokratike të jetës së brendshme. Njëkohësisht kjo tregon se jeta e përditshme e meshkujve në qytetet ilire dhe epirote, ndryshe nga qytetet helene, zhvillohej sipas traditës, më tepër në shtëpi se në agora[46].

Prania e banesës me shtëpi zjarri në mjaft pika, në territoret e dalmatëve, kasopëve, mollosëve, kaonëve dhe jashtë harkut kohor në shqyrtim, në Shqipërinë e Mesme, tregon për një unitet arkitekturor. Datimi i këtyre banesave nga prehistoria, në kohët tona, ndonëse me një hiatus në mes, ndoshta duhet parë si vazhdimësi e këtij tipi në kohë.



Fig. 32

46) P. Caban, **Shoqëria dhe institucionet në Epir dhe Maqedoni në epokën klasike dhe helenistike,** Iliria, 2; 1981, **Vendi i gruas në Epirin antik,** Iliria, 1983, 2.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Banesa me hajat

Një banesë e tillë ka gjasë të jetë ajo e Selcës (fig. 30), por më mirë hajati kapet në ansamblin ndërtimor në Çukën e Ajtoit. Ky ansambël i qarkuar me mur ndodhet në perëndim të fortifikimit, 75 m larg dhe rreth 50 m poshtë tij (fig. 31). Përmasat, numri i ndërtesave e mjediseve, si dhe pozita e shkëpusin atë cilësisht nga banesat e tjera të Çukës së Ajtoit. Terreni ku shtrihet ansambli, është mjaft më i qetë se ai i shpateve të fortifikimit ku ngrihen banesat e tjera, por prapëseprapë ai ruan një pjerrësi prej 20° të këmbyer me rënie shkëmbore. Terreni, i rrethuar me mure me blloqe guri të latuar, ka një sipërfaqe prej 1150 m^2 dhe një trajtë pak a shumë të rregullt, gjeometrike, atë të dy katrorëve të bashkëngjitur (fig. 18). Në këtë ansambël veçohen dy grupe banesash. Grupi i parë, prej dy ndërtesash paralele, ndodhet në gjysmën perëndimore. I dyti, që ndodhet në pjesën lindore përbëhet prej dy ndërtesash të bashkuara në formën e shkronjës L.

Në brendinë e rrethimit të fut hyrja kryesore, e cila ndodhet në skajin jugperëndimor. Pas saj vijon një oborr në formën e një korridori, i cili përfundon në sheshin ndërmjet dy ndërtesave. E para, në skajin veriperëndimor të rrethimit, ruhet në gjurmë të zbehta. Prej tyre kuptojmë se kjo ndërtesë drejtkëndëshe ndahej në kthina prej muresh të tërthorta. Trajtimi i thjeshtë dhe pozicioni e tregojnë atë një ndërtim ndihmës, në funksion të ndërtesës së parë. Ndërtesa tjetër, për shkak të rënies së terrenit, ka një zhvillim të ndryshëm volumor. Bllokut të saj qendror, drejtkëndësh në plan, i bashkangjitet nga para një hajat[47], ndërsa nga pas një kthinë katrore që mbyll kalimin nga oborri. Kati i parë i pararendur nga hajati është i gdhendur në shkëmb. Në këtë kat të ndarë logjikisht me mure të tërthorta në kthina ndodhet dhe shkalla për në katin e dytë. Ky kat zhvillohej pjesërisht mbi taban dhe pjesërisht mbi katin e parë. Në këtë mënyrë e tërë ndërtesa arrinte një sipërfaqe prej 485 m^2 (112 m^2 kati i I, 373 m^2 i II). Në pjesën e pasme të katit të II duket se vijonte një hajat tjetër qendror, pas të cilit, nga balli dhe në anët e ngushta zhvilloheshin kthinat. Në këtë mënyrë numri i kthinave arrinte në 10. Në paralele me Kasopenë këtë ndërtim do ta supozonim katagogion, bujtinë për mysafirët e qytetit.[48] Në



Fig. 33

47) Prej këtij hajati 2,50 m të gjerë ruhen dy antet, ndërsa nga pas kthinën katrore mund ta justifikojë vetëm hajati i hapur.

48) Katagogioni i Kasopesë ka 38 mjedise dhe një sipërfaqe 1120 m^2 (S. Dakaris, **Cassopaia and the Elean Colonies,** Ancient Greek Citiis 4, 1971, f. 121, 475 v). Kundërshtimi nga ana e W. Hoepfner E. L. Schwandner **(vep.cit,** f. 88 v), që e mendojnë treg, nuk na duket i argumentuar.

DO NOT COPY

të mirë të këtij mendimi është ndërtimi në një terren vërtet më të përshtatshëm dhe komod, por jashtë mureve mbrojtës të qytetit.

Grupi lindor i ndërtesave veçohej nga i tërë mjedisi prej një muri të brendshëm. Ai zhvillohet në dy rrafshe të diferencuara në lartësi, përkatësisht me dy oborre. Në rrafshin verior ndodhet oborri i përparmë, ndërsa në rrafshin jugor oborri i pasmë. Në oborrin e pasëm ndodhet dhe stera cilindrike e ujit, e suvatuar me llaç me pluhur tulle[49]. Blloku qendror ngrihet, ashtu si dhe ndërtesa e grupit jugor, mbi rënien shkëmbore, cak ky që parapëlqehej për shkak të shfrytëzimit të shkëmbit për mjedise nëpërmjet gdhendjes. Blloku kryesor ka planimetri drejtkëndëshe dhe zhvillim të diferencuar volumetrik. Përkundrejt rrafshit të poshtëm ai është dykatësh, ndërsa ndaj rrafshit të sipërm njëkatësh. Në ballin e përparmë të punuar me blloqe poligonale, në tërë lartësinë e katit, ndodhet një hyrje e mbuluar me hark të rremë trekëndësh. Kjo hyrje të çonte drejt korridorit të pasëm, të ngushtë dhe të gjatë, i cili komunikonte me shpinat e kthinave. Në fundin e tij niste shkalla për në katin e dytë, që ndodhej në një nivel me rrafshin e pasëm. Ky kat nga pas vazhdonte në tabanin e këtij rrafshi, gjasisht të pararendur prej një hajati, ndërsa përpara shtrihej mbi mjediset e katit të I. Në këtë mënyrë sipërfaqja e tërë ndërtesës arrinte në rreth 300 m^2. (110 m^2 kati i I, 190 m^2 kati i II). Së bashku me mjediset ndihmëse sipërfaqja e grupit lindor është rreth 500 m^2, ndërsa së bashku me oborret ajo arrin në 1050 m^2. Këto përmasa, pesë herë më të mëdha se të banesave të tjera qytetare, dhe veçimi nga qyteti dhe territori tjetër i rrethuar, ndoshta e tregojnë këtë ansambël prytaneum. I tërë ky ansambël datohet nga gërmimet në shek. e III p.e.s.

Ndërtesat e tij zhvillohen me dy fytyra, në përshtatje me terrenin i cili i detyron banesat që vëllimin më të madh ta drejtojnë nga veriu. Rrethimi i banesave me mur jepte mundësinë për një formulim të brendshëm të lirë e të hapur. Trajtimi disi i ashpër arkitektonik, pa elemente dekorative, tregon se banesat e qendrave të vogla, qofshin dhe të shtresave më të pasura, ishin më pak të prirura ndaj estetikës e luksit, se sa banesat e një rangu më të ulët shoqëror të qëndravë të mëdha.



Fig. 34

Banesat me oborr

Banesat qytetare të fundit të shek. IV – fillimit të shek. III p.e.sonë i përmbahen kryesisht dy tipave, me oborr të qarkuar me kolona (peristil) dhe me oborr – korridor, ku rolin e bërthamës organizuese dhe ndërlidhëse e luan oborri. Banesa me peristil përfaqësohet me pesë shembuj të ruajtur mirë (Apoloni, Antigone, Bylis, Oraion, Kasope), ndërsa ajo

49) Stera me diametër 2,5 m është minimumi 2,7 m e thellë, si e tillë ajo kish një vëllim të paktën 14 m^3.

me oborr – korridor me tri (Apoloni, Antigone, Nikae)[50]. Por gjurmët, tregojnë për një shumicë banesash me oborr-korridor, veçanërisht në Antigone, ku ajo ishte dhe banesa e rëndomtë. Ndonëse banesa me peristil ka sipërfaqe më të madhe dhe dekor më të përkujdesur e të kushtueshëm, të dy këta tipa i gjejmë në të njëjtin insul, disa herë shpinë më shpinë (Apoloni fig. 32 Kasope). Si të tilla mendojmë se ato i përkasin së njëjtës shtresë shoqërore, por caqeve të ndryshëm. Prej tyre, më e standartizuar është banesa me peristil, ndërsa ajo me oborr-korridor ka një shpërndarje më të lirë të mjediseve.



Fig. 35

Banesat me oborr-korridor paraqesin një ndërthurje të lirë të banesës klasike të tipit pastas dhe prostas me skemën e thjeshtë kompozicionale të banesës tradicionale. Element i ri në to është oborri, i cili luan rolin e nyjes ndërlidhëse dhe kompozicionale. Kjo banesë shquan për një zgjidhje të lirë, pa ju nënshtruar kanonizimit, si banesa me peristil, çka sjell një shumëllojshmëri variantesh. Banesat më të thjeshta dhe më të hershme të këtij tipi janë ato në Çukën e Ajtoit, ndërsa banesat në Antigone dhe Apoloni janë më të vonshme të shek. III p.e.sonë.

Banesat e Çukës së Ajtoit (fig. 33) ndodhen në afërsi të hyrjes veriperëndimore, brenda mureve rrethuese. Sipërfaqja, thuajse e barabartë (124 – – 131 m^2) dhe numri i njëjtë i mjediseve (5) tregon se ato i përkisnin së njëjtës shtresë qytetare. Orientimi i këtyre banesave le për të dëshiruar, pasi balli i drejtuar nga veriperëndimi rrihej nga dielli vetëm në orët e vona të pasdites. Kjo dhe sipërfaqja 40% më e vogël se e banesave jugore tregon se ato i përkisnin një shtrese më të vobektë. Ky grupim tregon dhe për veçimin në lagje sipas shtresëzimit ekonomik. Por skema kompozicionale e këtyre banesave ka mjaft ngjashmëri me skemën kompozicionale të banesave jugore me një kthinë qëndrore, në amfiladë me kthinat anësore dhe një kthinë tjetër të shkëptur para tyre. Element i ri është oborri i

50) Banesat e Apolonisë, me peristil dhe oborr-korridor tek L. Rej **(Fouilles de la Mission Français a Apolloni d'Illyrie et a Durrazo,** (1923-24) Albanie 1, 1925, f. 25 v). anesat e Antigonesë jepen nga Dh. Budina, **Antigonea,** Iliria, 2, 1972, Banesa e Bylisit epet shkurtimisht nga N. Ceka **(Legjenda e një qyteti,** Shkenca dhe jeta, 1981, 1, f. 7). Për banesën e Oraionit S. Dakaris, W. Hopfner, E. L. Schwandner, N. Gravani, **vep.cit,),** banesa e Kasopesë tek W. Hopfner-E. L. Schwandner **(vep.cit,).** Banesa e Nikaes k L. Papajani, **(Disa monumente të arkitekturës në qytetin antik në Klos,** Monumentet, 976, 11).

DO NOT COPY

vogël, praninë e të cilit e lejonte terreni më pak i pjerrët, ndonëse jo shkëmbor dhe i aksidentuar. Në funksion të tij trajta planimetrike e banesave është e çrregullt. Nga tri banesat më të lexueshme, njëra ka planimetri katrore, tjetra në formën e shkronjës L, kurse e fundit ka planimetri të çrregullt.

1) Banesa e parë ka formën e shkronjës L (fig. 34). Në brendi të oborrit të vogël të fut një portë e vogël e pajisur me shkallë. Oborri komunikon drejtpërsëdrejti me një kthinë drejtkëndëshe, e cila ndodhet në një plan me të. Kthinat e tjera vijojnë në ballë, rrëzë shkëmbit. Disa këmbë shkallë dhe një hyrje të çojnë nga rrafshi i oborrit në kthinën qendrore. Dy kthinat e tjera të vendosura në amfiladë, anash saj, e tregojnë atë si nyjen e dytë kompozicionale dhe ndërlidhëse. Hyrja e kthinës qëndrore është më e madhe se ajo e oborrit, ndonëse gabaritet e sendeve që hynin në banesë kalibroheshin që në portën e oborrit me përmasa më të vogla. Kjo çrregullsi shpjegohet vetëm me synimin që kthina e mesit dhe nëpërmjet saj, dy kthinat e tjera, të përfitonin sa më tepër dritë dhe ngrohje nga dielli. Tërthorazi kjo tregon se ndriçimi i banesës kryhej vetëm nëpërmjet derës. Shkallët dhe ngushtësia e portës së oborrit tregojnë gjithaq se bagëtia e mundshme në shtëpi ishte e imtë.



Fig. 36

2) Banesa e dytë ka një zgjidhje mjaft racionale (fig. 35). Planimetria e saj katrore ndahet kryqas në katër pjesë thuajse të barabarta. Një mur tjetër e ndan sërishmi më dysh njërën nga këto pjesë. Në këtë mënyrë krijohen pesë kthina, numër ky i njëjtë me atë të banesës së përparme. E njëjtë duket se është dhe skema e lëvizjes. Nga oborri i banesës, katror e më i madh, kalohej drejtpërsëdrejti në kthinën përbri dhe gjasisht, me shkallë, në kthinën nga balli. Kjo e fundit në rolin e nyjes së dytë ndërlidhëse me dy kthinat e tjera.[51]

3) Banesa e tretë ka planimetri të çrregullt (fig. 36). Nga oborri i saj i vogël, drejtkëndësh në formë, kalohej në kthinën e madhe përbri, që komunikonte me shkallë me një kthinë të përzgjatur. Në fundin e saj ndodhet dhe një mjedis fare i vogël. Nga oborri kaldohej drejtpërsëdrejti në një kthinë të punuar në shkëmb, në një lartësi 2,70 m nga rrafshi i oborrit. Ndonëse zgjidhja volumetrike e kësaj banese është e paqartë, mundësia më e madhe është që ajo të zhvillohej në dy plane të diferencuara në lartësi, pa kaluar në kate.

Oborri i këtyre banesave dallohet qartë nga punimi më i dobët i mureve dhe pozicioni. Sipërfaqja tepër e vogël tregon se ky

51) Mungesa e gjurmëve të shkallëve e bën këtë skemë hipotetike. Në të kundërt lëvizja do të ishte 1 – 2 – 3 – 4 – 5.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 37



Fig. 39

oborr thjesht utilitar shërbente si nyje ndërlidhëse dhe ndoshta si vend për lënien e veglave të punës dhe mbajtjen e ndonjë bagëtie të imtë. Në të kundërt, shtëpia e zjarrit nuk diferencohet qartë, për shkak të sipërfaqes thuajse të barabartë të mjediseve. Në dy banesat e para si të tillë do supozonim kthinën e sipërme, nga e majta, me përmasa pak më të mëdha dhe me izolim termik më të mirë se mjediset e tjera: pa komunikim të drejtpërdrejtë me mjedisin e jashtëm dhe vetëm me një faqe të lirë. Në banesën e tretë këtë rol mund ta luante kthina katrore përbri oborrit, i vetmi mjedis me sipërfaqe të madhe. Për nga sipërfaqja shtëpia e zjarrit e këtyre banesave mbetet mjaft prapa shtëpive të zjarrit në Kasope, Oraion dhe banesat jugore të Çukës së Ajtoit, duke ju afruar oikosit të banesave greke. Megjithëkëtë raporti i saj ndaj sipërfaqes së banesës (16 – 26%) i largohet mjaft raportit të banesave greke, duke hyrë në normën e zakonshme të banesave ilire me shtëpi zjarri. Programi më i varfër, teknika më e zbehtë dhe orientimi i pafavorshëm tregon se këto banesa i përkisnin një shtrese më të ulët se ajo e pronarëve të banesave jugore. Sipërfaqja e banesës (pa oborrin) dhe e shtëpisë së zjarrit të grupit verior është përkatësisht 40 dhe 49% më e vogël se e grupit verior, gjë që tregon për familje numerikisht më të vogla. Duke qenë familjet e mirëfillta brenda së njëjtës qendër të barabarta për nga numri, kjo do tregonte dhe për mungesën



Fig. 38

DO NOT COPY



Fig. 40



Fig. 41

e personelit të shërbimit në banesën veriore dhe praninë e tij në banesën jugore.

Banesat e Nikaes (fig. 37, 38), Antigonesë (fig. 39), Apollonisë (fig. 32) kanë një formulim të ndryshëm. Në to dallohen tri grupe kryesore: oborri, dyqanet – punishte dhe mjediset e banimit. Nyje organizuese përreth së cilës zhvillohet banesa është oborri – korridor, i cili i shkëput grupet kryesore nga njëri-tjetri, siguron ndërlidhjen dhe ndriçon e ajros mjediset. Sipërfaqja e tij (36 – 60 m^2), e afërt me oborret e banesave klasike ose prostas (50 – 60 m^2), e tregon atë vend kryesor qëndrimi në kohë të ngrohtë.

Trajtimi i oborrit është i ndryshëm. Në Antigone ai ka formë drejtkëndëshe. Në Nikae oborri – korridor merr përsipër çrregullsinë e banesës, duke i lënë dhomat të rregullta, por duke u deformuar vetë. Në Apoloni ai ka formën e shkronjës L. Shtaga e tij e gjatë, siç e tregojnë gjurmët e afreskut, ka qenë e mbuluar. Shtaga e shkurtër diferenconte dy grupet e banesës, grupin e shërbimit dhe shtëpinë e mirëfilltë. Në të mund të kalohej dhe drejt nga rrugica që e ndante nga banesa tjetër. Në disa prej oborreve (Nikae fig. 40 Margëlliç) ruhen dhe sterat cilindrike (rreth 2500 l). Përveç oborrit – – korridor këto banesa kanë pasur dhe një oborr të pasëm (Nikae, Margëlliç, Apolloni). Dyqani – punishte me depon në shpinë dëshmohet qartë në Autigone. Në të, pronari i punishtes – dyqan për regje lëkure[52] kalonte nga oborri, ndërsa klientët nga rruga.

Androni i këtyre banesave nuk ka një vend të caktuar vetëm në fillim të banesës (Nikae, Antigone), por shtyhet edhe në thellësi (Apolloni). Dyshemeja me mozaikë tregon se në Apolloni androni ndërfutet mirë në qendër të banesës. Këtu, një portëzë e vogël përbri tij lejonte daljen e drejtpërdrejtë në rruginën e vogël, duke shmangur kalimin përbri kthinave të tjera. Në Antigone gjetjet arkeologjike dhe porta e gjerë dy flegërshe tregojnë se androni kryesor nuk ishte mjedisi i parë pas hyrjes. Ai pararendej prej një kthine tjetër më të vogël, gjetjet dhe pozita e së cilës mund ta justifikojnë veten si një androni të dytë.



Fig. 42

52) Këtë e dëshmojnë veglat e ndryshme të punës dhe 5 pytosa të ngulur në tokë (Dh. Budina, **Vep. cit,**).

DO NOT COPY

Karakteristikë e banesës me oborr – korridor është shkëputja e kuzhinës si njësi më vete, çka sjell zhvleftësimin e shtëpisë së zjarrit. Kuzhina, në sajë të gjetjeve dhe vatrës, kapet mirë në Nikae dhe më zbehtë në Margëlliç, ku pranë hyrjes së saj ndodhej dhe stera e ujit. Banesat e këtij tipi, ndryshe nga banesa me peristil që kërkon një truall krejt të rrafshët, mund të shkallëzohen në rrafshe me lartësi të ndryshme, kalimi tek të cilët kryhej me anë shkallësh të brendshme (Antigone). Së fundi, duke u nisur nga krahasimi tipologjik, mund të supozojmë se pjesët e pasme të banesës në Antigone dhe në Apolloni, ku ajo shkëputet qartë nga pjesa tjetër, ishin dykatëshe, ndërsa pjesët e përparme njëkatëshe. Në këtë rast numri i kthinave të tyre ishte rreth 11.

Banesat me oborr peristil

Këto banesa i përkasin shek. III p.e.sonë. Banesat e këtij tipi në Prienë, Delos, Pergam etj.[53], janë të shek. III dhe rrallë herë të gjysmës së parë të shek. IV p.e.sonë. Rrjedhimisht trajtimi i rregullt arkitekturor, me forma të kristalizuara dhe të kanonizuara, dekori i pasur i banesave në Antigone, Apolloni, Bylis,[54] tregon për një ecje sinkrone me arkitekturën bashkëkohore. Banesat me oborr peristil në Apolloni (fig. 32, 41, 42), Antigone (fig. 43-46) dhe Bylis kanë skema të ngjashme planimetrike e sipërfaqe të përafërta (615, 734 dhe 720m²). Prej tyre, dy të parat, thuajse përsërisin njëra-tjetrën.[55]. Ndryshe nga këto banesa të ndërtuara «ex novo», banesa me oborr



Fig. 43

53) P. Wiegand – Schraeder, **Priene,** Berlin, 1910, f. 285; P. Lavedan, **Histoire de l'urbanisme,** Paris, 1906, 1; B.G. Rider, **The greek House,** Combridge, 1916.

54) N. Ceka, Legjenda e një qyteti, Bylis, Shkenca dhe jeta, 1981, 1, f. 46-48.

DO NOT COPY



Fig. 44

peristil në Kasope paraqet thjesht një zgjerim dhe riadaptim të banesës së vjetër me shtëpi – zjarri (fig. 47).

Në Apolloni dhe Antigone (fig. 45, 46) anët e ngushta të banesave kufizohen prej rrugësh paralele, formuluese të sistemit urbanistik ortogonal. Në këto dy raste gjerësia e banesave është e barabartë me gjerësinë e tërë kuartallit. Banesa e Bylisit ndodhet në një terren të pjerrët, të kufizuar në anët e gjera nga një shkëmb dhe rrëzim i terrenit. Një mur tarracimi, i pajisur me kontraforte e nivelon, këtë rrëzim, duke krijuar një plan të rrafshët horizontal, mbi të

55) Banesa e Antigonesë është 22 m e gjatë. Gjerësia e saj kapet deri në mbarim të hajatit, për 21 m, ndërsa më tej ajo është lënë e pagërmuar. Shtrirja e saj është padyshim në një insul, çka tregon për një gjerësi 30 m, sa në Apolloni.

DO NOT COPY



Fig. 45

cilin zhvillohet banesa. Në Antigone terreni i pjerrët nivelohet po nëpërmjet dy tarracimeve (fig. 45, 46). Në të kundërt, në Apolloni ai paraqitet krejt i sheshtë. Siç shihet ky tip banese nuk e duronte pjerrësinë dhe mund të zhvillohej vetëm në terrene të sheshta e të niveluara mirë. Kjo kuptohet qartë në Antigone, ku paralel me banesën me peristil ndodhet një banesë me oborr – korridor, (fig. 43), e shkallëzuar nga dhoma në dhomë, plan mbas plani. Si tërë banesat e tjera të këtij tipi, banesat e mësipërme janë të verbëra. E vetmja e çarë në murin e jashtëm, të rrafshët dhe monoton, është ajo e korridorit të hyrjes. Para tij, në Apolloni, ndodhej një urë e vogël me blloqe të harkuara, për të hedhur kanalin e ujërave që vijonte anash rrugës (fig. 32). Porta dy fle-gërshe, masive, e zbukuruar dhe e përforcuar me gozhdë bronxi[56], ndodhej 1,95 – 2,8 m e tërhequr në brendi. Në këtë mënyrë krijohej një strehë e mbuluar, që shpëtonte ata që vinin e trokisnin në derë, si nga shiu, ashtu dhe nga dielli i fortë. Në se kthinat anash saj qenë dyqane (Apolloni Antigone) në to mund të kalohej drejtpërsëdrejti nga kjo strehë.[57] Gjerësia e madhe e korridorit (2,5 m Antigone) lejonte dhe kalimin në brendi të banesës të karrove të rënda.

Korridori në asnjë nga këto banesa nuk përkon me aksin e banesës, mesin e oborrit, si në Prienë ose Delos[58], por me zgjatimin e njërit nga krahët e hajatit. Kjo zgjidhje është më racionale pasi shmang



Fig. 46

56) Në Apolloni janë gjetur 6 nga gozhdët e kësaj porte (L. Rej **vep.cit.**).
57) Në se kthinat anash saj në Apolloni e Antigone kanë qenë dyqane, nga ky parakorridor mund të kalohej drejt e në dyqan.
58) B. Rider, **vep.cit,** f. 241-253.

DO NOT COPY



Fig. 47



Fig. 48



Fig .49

kthesat e kota që do të sillte një korridor i vendosur simetrikisht.

Bërthama qendrore, rreth së cilës shtjellohej e tërë banesa, ishte oborri i hapur (impluviumi) ndaj të cilit kthehej e tërë fytyra e saj. Ky oborr, së pari shërbente si një pus drite dhe ajrimi për tërë kthinat e banesës (fig. 44). Në të qëndrohej në kohë të mirë, kurse në kohë shiu derdheshin tërë ujërat e pullazeve. Këto ujëra mblidheshin në një sterë nëntokësore, në skaj të oborrit (Bylis) ose përcilleshin me kanale jashtë banesës (Apolloni). Nga prania e ujit në taban, oborri ndodhej pak më ulët se syprina tjetër e banesës. Oborri katror (75 – 96 m) përkufizohej prej një xokoli (euthynterisë) me blloqe të latuara[59] (fig. 45, 46). Gjurmët dhe përmasat tregojnë se ky xokol mbante 12 kolona të orderit Jonik me diametër 0,43 – 0,46 m (Antigone fig. 45, Apolloni)[60]. Duke marrë parasysh raportin diametër – lartësi në kolonat e andronit të banesës së Antigonesë 1: 8,3[61], lartësia e tyre rezulton rreth 3,70 m.

59) Përmasat e oborrit, të matura në anën e jashtme të xokolit janë në Apolloni 8,5 x 8,8 m.

60) Në Apolloni, kolonë me këto përmasa, është gjetur në murin e jashtëm, ndërsa në Antigone në brendi të oborrit.

61) Kolonat e andronit në Antigone kanë diametër 0,32 m dhe lartësi të plotë, përfshirë bazën dhe kapitelin, 2,86 m.

Oborri qarkohej nga të katër anët prej një hajati (portiku) me tabanin me dhé të ngjeshur (Antigone) ose të shtruar me tulla (Apolloni). Gjerësia e portikut luhatet sipas dendësisë së lëvizjes, nga 2,5 – 3,5 m. Ai shërbente për ndërlidhjen e mjediseve të banesës dhe si vend pushimi në kohë të nxehtë dhe me diell ose dhe në kohë shiu. Në të njëjtën kohë portiku luante dhe rolin e thyerësit të rrezeve të diellit, duke lejuar të kalonin drejtpërdrejt në dhoma vetëm rrezet e hershme të mëngjesit ose rrezet e vona të mbasdites, e duke i pritur me pullaz rrezet përvëluese të mesditës së verës, kur dielli ngjitej në Zenit. Por në mesditën e dimrit rrezet e diellit i cili qëndronte ulët kapnin një hapësirë të gjerë pas kolonave të peristilit, duke krijuar rezervuarë nxehtësie. Çatia e portikut (kompluviumi), katërflegërshe, e pjerrur në drejtim të oborrit, në ballë mbështetej mbi arkitraun e kollonadës së oborrit, kurse nga ana pas në murin e brendshëm të kthinave, duke arritur në kulm një lartësi rreth 5 – 5,5 m (fig. 44).

Shkallëzimi i terrenit prej 3,20 m në shpinën e andronit të banesës së Antigonesë kërkon nga kjo anë një ndërtesë dykatëshe. Kjo dëshmohet dhe nga bazamentet e kolonave të drunjta në meset e mjediseve të andronit, që shërbenin për mbajtjen e dyshemesë së katit të sipërm. Por, në Antigone, ashtu si dhe në Apoloni, njëri krah i portikut zhvillohej i lirë, pa mjedise pas vetes. Ky zhvillim planimetrik kërkon dhe një zhvillim të diferencuar vëllimor, me traktin mbi andronin dykatësh dhe krahun e lirë njëkatësh, në rolin e një galerie të thjeshtë. Rrjedhimisht kolonada e oborrit dhe kompluviumi kanë qenë njëkatëshe (fig. 44). Dy krahët e tjerë mund të zhvilloheshin si një ashtu dhe dykatëshe. Duke u nisur nga trajtimi i banesës fqinje me oborr – korridor në Apoloni, me bllok të pasëm dykatësh, mendojmë se dhe banesat me peristil në Apolloni dhe Antigone, gjasisht dhe në Bylis, një ose dy krahë i kishin dykatësh, ndërsa dy të tjerët njëkatësh.

Në vazhdim të korridorit të hyrjes ndodhej androni me sallën e gostisë (sympozionin) (49 – 52 m) në mes dhe dhomat e miqve, po kaq të mëdha (Antigone, Bylis) a më të vogla (Apolloni) anash (Antigone), ose në varg (Apolloni).

Në Apolloni, salla e gostisë me dyshemenë e mbuluar me pllaka tulle, hapet drejt hajatit me një hapësirë 3,5 metërshe. Kjo hapësirë e gjerë kufizohet anash nga kthesat e lehta të mureve, parastadet të kurorëzuara lart me kapitele me figura njerëzish dhe lulesh (fig. 48). Në Antigone i tërë balli i sallës mbetej i hapur. Dy kolona dhe dy pilastra, me kapitele jonikë të një tipi të veçantë (fig. 49), e hijeshohin atë dhe mbartnin arkitraun. Në Bylis dyshemeja e sallës, gjasisht në një kohë më të vonë, u mbulua me mozaik shumëngjyrësh, ndërsa muret u pikturuan me afresk.[62]

Mjediset e banimit të kateve të parë ndodhen në krahun e largët të portikut, për të mos interferuar me lëvizjen e miqve.[63]. Këto mjedise kanë përmasa të mëdha.

Së fundi, grupi i mjediseve të shërbimit në Apolloni dhe Antigone ndodhet në krah të korridorit të hyrjes, i shmangur nga lëvizja për në andron, por njëkohësisht afër me sallën e gostisë. Lëvizja brenda përbrenda kthinave të këtij grupi e kthente atë në një njësi të mbyllur. Në Antigone kjo është zgjidhur me anë të komunikimit të njëpasnjëshëm të dhomave, ndërsa në Apolloni, si nyje organizuese për lëvizjen e brendshme, shërbente një korridor i vogël, që i ndërlidhte me njëra-tjetrën të tri kthinat, kuzhinën, depon dhe dhomën e fjetjes së personelit.

Shembujt e mësipërm, veçanërisht Apollonia e Antigonea, tregojnë se në fillim të shek. III p.e.sonë, banesa me oborr me kolona, me peristil, u kristalizua mirë, si një banesë racionale, me program krejt të qartë e standart ndërtimor. Kjo banesë, ndryshe nga mjaft banesa të tjera të këtij tipi, ka një formë rigorozisht drejtkëndëshe, që tregon për një sistem të rregullt, urbanistik, hyrje asimetrike dhe një shtrirje në varg të dhomave të burrave. Kjo sjell dhe një ndriçim e ajrim më të mirë të dhomave. Me futjen e korridorit në mjediset e shërbimit në Apolloni, ky grup, kthehet në një njësi më vete, që s'komunikon drejtpërdrejt me nyjen ndërlidhëse të tërë banesës. Vendosja e tyre jo larg qendrës, programi, si dhe dekori arkitektonik, tregon se kjo banesë i përkiste shtresave të kamura.

62) Gjurmët e suvasë së pikturuar gjenden në Antigone dhe Bylis. Ka gjasë që në këtë rast ajo të jetë e vonë.

63) Në Antigone kjo pjesë nuk është gërmuar, por hapësira që i lihet asaj është e njëjtë me atë të Apollonisë. Në Bylis këto dhoma duhet të kenë qenë në krahun djathtas hyrjes 4 m të gjerë.

FOTOKOPY

Nr.	Qyteti, Numri i banesës La ville, le numéro de l'habitation	Sipërfaqe banesës Kati i I m²	E përgjithshme m²	Shtëpia zjarrit m² La maison du feu m²	Mjediset e banimit dhe ndihmëse Kati i m²	E përgjithshme m² Les piéces d'habitation et les annexes Le premier étage m²	La totale m²	Qborr m² La cour m²	Blloku i punishteve, dyqaneve dhe depove m² Le bloc des boutiques et des dépôts m²	Androni m² L'andron m²	Hajati Kati I m²	Përgjith. m² La porche Le premier étage m²	La totale m²	Përqindja që shtëpia e zjarrit Në Sip. % Le pourcentage En supérficie %	Në vëll % En volume %
1	Donja Dolina II	.	.	.	21,8	21.8	—	—	—	—	—	—	.	.	
2	» » III	.	.	20.6	.	.	—	—	—	—	—	—	.	.	
3	» » IV	33.2	33,2	22.6	10,6	10,6	—	—	—	—	—	—	68	68	
4	» » V	.	.	.	14	14	—	—	—	—	—	—	.	.	
5	» » VI	.	.	20.3	.	.	—	—	—	—	—	—	.	.	
	mesatarja (La moyenne)	33,2	33,2	21,2	15,5	15.5	—	—	—	—	—	—	68	68	
6	Çuka e Ajtoit	123,8	185.	49	36	97	—	28.7	10.2	—	—		40	53	
7	Kasopea 1	225	355	49	22	70	27	60	32	—	—		22	30	
8	» 3	225	370	50	24	84	20	68	20	—	—		22	29	
9	» 5	225	377	42.5	33	98	22	50	18	—	—		19	24	
10	» 6	225	353	48	35	84	37	42	24	—	—		21	30	
11	» 14	225	370	52	35	94	31	39	20	—	—		23	30	
	mesatarja	225	365	49	30	86	27	52	23	—	—		21,4	28,6	
12	Oraioni	295	557	45	40	100	33	20	25	11	22		15	17	
13	Banesa tiranase	500	1000	52	365	730	.	—	24	52	52		12	12	
14	Kolofoni (mesatarja)	220	330	22.5	40	80	65	10	10	14	28		10	15	
15	Olynthi t »	272	421	21	35	110	49	45	25	39	78		8	11	
16	Abdera »	190	290	27.5	.	36	42	35	15	17	34		14	22	
17	Pireu »	235	340	27.5	33	66	66	22	18	20	40		12	20	
18	Priena »	195	259	22	12	35	58	48	11,2	14,5	29		11	22	
	Mesatarja e qyteteve greke La moyenne des villes grecques	231	332	23	30	73	60	31	16	22	44		10.2	17	

DO NOT COPY

APOLLON BAÇE
VERA BUSHATI

DO NOT COPY

APPERÇU SUR L'HABITATION PREHISTORIQUE ET ANTIQUE EN ILLYRIE ET EN EPIRE.

L'évolution de l'habitation en Illyrie a connu une longue voie de plusieurs millénaires qui se poursuit depuis les plus simples et les plus anciens chaînons. Cette évolution intérieure, dûe au progrès économique, ne connut pas d'accélération uniforme dans l'espace et dans le temps. Dans l'espace, la différence du niveau économique d'une région à l'autre se reflète aux différents stades et rythmes d'évolution de l'habitation. Dans le temps, pendant la période en question, on distingue, du point de vue qualité, deux périodes, la période préhistorique depuis le néolithique jusqu'au VIe sc. av.n.è., et celle antique ou urbaine jusqu'à la période qui est à cheval sur les premières années du Ier sc. de n.è et le Ier sc. av.n.è. La fin de la période préhistorique depuis les VIIIe-VIIe sc. av.n.è., jusqu'aux VIe-Ve sc. av.n.è. peut être vue comme le prélude de l'habitation urbaine pendant lequel les rassemblements quantitatifs formèrent l'embryon des premiers types. Pendant la première période, malgré son étendu dans le temps, l'évolution de l'habitation se poursuivit assez lentement. Au cours de la deuxième période, au contraire, grâce à l'élan économique et social elle connut une évolution rapide. Dans la solution planimétrique-stéréométrique des habitations de pair au développement économique – social, influèrent, bien que sans s'intervenir au programme, le climat, les matériaux et le terrain.

L'HABITATON PREHISTORIQUE

Bien que l'habitation préhistorique appartienne à un espace temporel de 5500 ans, depuis le néolitique ancien (6000 av.n.è,) jusqu'aux VIe-Ve sc.av.n.è son évolution quant au programme et à la technique de construction, fut minime. Cela s'explique par le fait que l'habitation en question appartenait à une société sans différenciation de classe, par conséquent, sans exigences pour une vie économique-sociale élevée. Cette habitation à caractère simplement utilitaire, fut construite conformément aux conditions climatériques et au terrain et en fonction des matériaux disponibles gardant le même programme simple à une ou deux pièces, sans parvenir à créer des types.

Le rapport avec le terrain *définit deux groupes principaux: sur le sol et au sous-sol. Le premier groupe comprend les habitations construites au-dessus du sol, sur un terrain plat et les habitations aménagées sur des plateformes élevées sur poutres au-dessus ou au bord de l'eau. Les habitations construites sur des terrains en pente, ne sont pas témoins de cette période. Cette absence s'explique par les difficultés statiques et le programme, plus riche et plus coûteux auquel elles s'en tenaient; un programme qui ne leur est pas demandé à cette époque.*

Afin de mieux faire ressortir le choix entre l'une et l'autre façon de l'adaptation au terrain, nous donnons un tableau sur le rapport quantitatif dans le temps. Le nombre des habitations mises au jour étant insignifiant les conclusions auront un caractère hypothétique.

Période	Habitation au dessus du sol	Habitation au sous-sol	Habitation partiellement au sous-sol	Habitation Palafittes
Néolithique ancien	2(Vashtëm Kolsh)	—	—	1(Donavec)
» moyen	1(Dunavec II)	2(Kolsh, Cakran)	2(Cakran I,II)	—
» récent	2(Kamnik, Maliqi I)	—	—	—
énéolithique	1(Maliq IIb)	—	—	1 Maliq II a
Bronze	1(Badhër)	—	—	2(Ripaç, Otok)
Fer I	7(Karo, Vica, Nin, Rovinjë, Cres, Loshinj, Susak)	3(Gadimje, Gomolavë, Stari, Slankamen		1(Donja Dolina)

Au néolithique ancien deux des habitations mises au jour sont construites au-dessus du sol sur terre et la troisième sur une plateforme de poutres au-dessus du l'eau. Au néolithique moyen ce rapport change en faveur des habitations situées au sous-sol. On en compte trois alors que l'habitation au-dessus du sol est représentée par un exemple unique

DO NOT COPY

qui est plutôt le dérivé d'une habitation palafitte. Cette apparence s'explique peut-être par un abaissement éventuel de la température et par la perfection des outils de travail qui permettaient de creuser. Au néolithique récent, ce rapport changea de nouveau en faveur des habitations aménagées au-dessus du sol, peut-être après un adoucissement du climat. Cette conclusion vaut seulement pour les zones au climat chaud, puisque dans les régions reculées au climat froid continental, ce type se rencontra sans interruption jusqu'à la fin de la période en question, alors qu'en Albanie du Nord il demeure jusqu'au XIXe sc.

Pendant la période néolithique et celle de Bronze, le rapport tourne 4 à 1 en faveur des palafittes. La croissance ultérieure du nombre des habitations au-dessus du sol par le convertissement de l'habitat à palafittes à Maliq, en habitat amménagé au-dessus du sol, vise le retour au rapport initial. Les palafittes, continuent à survivre même pendant la période du Fer, à Donja Dolina ou au bord du lac Prasias.

La prédominance des habitats palafittes pendant la période énéolithique et celle du Bronze pourrait s'expliquer par l'avantage qu'apporta la pêche à hameçon métallique, le poisson devenant la principale nourriture, et par le but de réaliser une défense élémentaire dans les conditions de l'apparition de la propriété privée et des incursions de pillage.

L'habitation souterraine la plus ancienne, remonte au néolithique moyen (Cakran région de Fier). Le niveau du plancher, 2,20 m au-dessous du sol, démontre que cette habitation se développait entièrement sous terre. Plus tard, à cause du dépôt de la couche culturelle à l'intérieur, elle devint une habitation partiellement sous terre partiellement sur terre.

Un fragment de Strabon (VII-5,7) montre que l'habitation souterraine prédominait à Dardanie, connu par son climat froid même aux premiers siècles de n.è. De pareilles habitations remontant à cette époque, sont mises au jour à Dardanie (Gadimje Supérieure) et aux territoires des Skordisques (Gomalave, Stari Slankamen). Pour la reconstruction de cette habitation on peut se baser sur l'architecture de quelques constructions auxilliaires de notre siècle et sur une description de l'année 1637. D'après ces données, elle avait une planimétrie rectangulaire dont les faces longitudinales s'élevaient un peu au-dessus du sol. Sur les faces les plus étroites, traitées en forme de fronton, s'appuyait le toit à deux versant couvert de paille ou de fumier. La couverture en fumier, dont les qualités thermo-isolantes sont évidentes, est mentionnée même au fragment écrit par Strabon.

D'après la forme planimétrique, les habitations au-dessus du sol se divisent en habitations à planimétrie circulaire et quadrangulaire. Les habitations à planimétrie rectangulaire à coins arqués représentent des formes passagères. L'habitation à planimétrie circulaire, plus facile à construire, doit être la plus ancienne. Les plus anciennes habitations à planimétrie circulaire connues appartiennent au néolithique moyen (Kolsh). A l'habitat datant de la période du Bronze tardif à Badhër (région de Sarandë) des 15 habitations situées au versant nord-ouest d'une colline littorale au dehors des murs de fortification, trois représentent une planimétrie circulaire alors que les autres ont une planimétrie rectangulaire aux coins arqués. (fig. 1). Leur position distante l'une de l'autre (de 6 à 20 m), la différence jusqu'à quatre fois de la superficie, (de 8 à 32 m^{2}), la division en deux pièces et enfin le passage de la forme circulaire, la plus simple forme réalisée avec des matériaux légers à celle rectangulaire, témoignent de l'apparition des nouvelles expériences de construction. Le plancher de terre, sans aucun dépôt de ces habitations montre qu'elles servaient à coucher alors qu'un faisait le feu à l'extérieur.

L'arrangement en lignes droites des poutres de la charpente d'une habitation du néolithique moyen (Kolsh) (fig. 2,3) témoigne d'une planimétrie quadrangulaire. Cette forme, qui apparaît mieux aux habitations du néolithique récent à Komnik et Maliq, apparaît évidente dans les habitations à pièce unique de la période du Fer. Les plus typiques parmi elles sont les habitations archaïques molosses à Vica Jannina), (fig. 4), à pièce unique avec foyer au milieu.

Vers la fin de la période du Fer, on remarque un enchainement d'habitations à planimétrie rectangulaire: A l'habitat Liburn à Rodovine du VIIIe-VIe sc.av.n.è. elles forment une chaîne à six pièces (fig. 5). Dans l'une d'elles, la pièce du feu se détache de la pièce qui servait de chambre à coucher, formant ainsi l'embryon de l'habitation avec «maison de feu». Ces habitations caractérisées par une juxtaposition infinie de pièces, apparaît même à d'autres habitats liburns à Crés, Loshinj, Susak, Ritnik. Vers la fin de la période du Fer, aux habitations iapodes à pièce unique, fut ajoutée une pièce et un porche ouvert, leur donnant ainsi la forme de Megaron. Les autres habitations iapodes (Turishka, Vasa, Ptuj, et Vaçe) dès le début furent construites avec un porche dans la partie frontale.

Les polafittes. La propagation des polafittes en Illyrie est témoignée par les traces de 7 habitats et par les sources écrites. (Dunavec, Maliq, Lin, Ripaç, Otok, Donja Dolina, le lac de Prasias). Ces traces font preuve d'un large étendu dans l'espace et dans le temps depuis le néolithique ancien (Dunavec) jusqu'aux premières années de notre ère (Ripaç). La description du palafitte du lac de Prasias par Hérodote au Ve sc av. n. è. en demeure la plus complète description. Il en ressort que les débuts du palafitte doivent être cherchés à une période située bien avant le Ve sc. av. n. è, quand il existait encore le mariage en groupe, et son élargissement se poursuivait par l'adjonction des nouvelles parcelles pour les nouvelles familles.

La technique de construction des habitations préhistoriques peut être classifiée en 4 groupes principaux. De cette classification se détachent les habitations souterraines dans lesquelles les parois des trous jouent la fonction des murs de l'habitation.

1) Les constructions légères sont caractéristiques pour les

habitations à planimétrie circulaire et quadrangulaire aux coins arqués. Nous pensons que cette technique, plus facile à être appliquée, remonte à une plus ancienne époque. A Badhër (fig. 1), le contour des habitations est représenté par un soubassement de pierres brutes à une hauteur d'1 m., ce qui montre que les parois qui s'y posaient étaient réalisés, en matériaux légers. La parallèle avec les constructions auxilliaires ruralés de nos jours, nous permet de reconstituer cette structure. L'appareil de ces constructions à planimétrie circulaire ou rectanguiaire aux coins arqués d'une hauteur d'environ 40cm se fait avec des pierres cassées, placées à joints vifs: Leur toit est formé de perches de bois qui s'unissent et se rattachent courbés au sommet, formant ainsi la coupole ou la voûte. Cette charpente et la couverture s'appuient directement aux murs périmétraux; Par conséquent, comme face intérieure du mur servait le parois du toit, qui s'élevait au-dessus de la hauteur des assises en pierres, et détachait le toit de la terre en le protégeant ainsi de l'humidité.

2. La structure en charpente de bois remonte au néolithique moyen (Kolshi II) (fig. 2). Les poutres verticales (Ø 0,20--0,30 m) s'élèvent à 1m de distance les unes des autres. Parmi elles, se trouvaient les traverses (Ø 5-10 cm) qui servaient à créer la voûte du toit. Les traces du pisé du crépi (l'habitation néolithique à Vashtëmi) prouvent un équerrage, bien que primitif, des traverses. La charpente mentionnée, avait la forme d'une haie et se réalisait avec des roseaux dans les habitats situés au bord de l'eau et avec des perches dans les autres habitats. Pour la protéger du vent et de l'humidité, on procédait à un revêtement intérieur et extérieur avec crépi de pisé mélangé de balle ou de paille (néolithique ancien Vashtëm-jusqu'à la période du Fer Labovë). Les traces des perches attestent qu'elles étaient posées à une distance de 1,5 cm loin l'une de l'autre permettant-ainsi une liaison directe des couches intérieures et extérieures du crépi en pisé.

3. Au palaffite de Donja Dolina, les murs étaient réalisés en poutres de bois. Les faces disposées transversalement à la plate-forme, s'unissaient bien, sans laisser des espaces vides. Le deux faces sont à deux parements entre lesquels est coulé un blocage en argile. Les murs qui séparent les pièces sont aménagés partiellement en poutres, partiellèment en pilots enchevétrés en herse et enduits de crépi de pisé (fig. 7).

4. Dans les anciennes habitations souterraines, partiellement souterraines et celles à charpente légère, le mur en pierre est d'une hauteur d'environ 1 m. Tel quel il ne sert qu'à compléter les parois. Au contraire, pendant la période du Fer, l'appareil en pierres occupe toute la hauteur du mur. Le plancher de ces habitations est formé de terre battue. Sur un terrain compact la couche d'argile suit directement le sol, alors que sur une terre légère, elle est étalée sur une couche pavée. Afin d'éviter l'humidité, sur les terrains au bord de l'eau, elle s'étalait sur un plancher de poutres (Dunavec II, Maliq I) comme dans les palafittes (Donja-Dolina).

Le foyer qui servait à faire la cuisine et à rechauffer, se trouvait au milieu ou au coin le plus éloigné par rapport à l'éntrée. Au néolithique ancien et moyen on rencontre les foyers proprement dits (Kolsh, Cakran) (fig. 8), ainsi que les endroits où l'on faisait du feu (Vashtëm) qui n'étaient pas encore fixés à une position précise. Au cours des périodes ultérieures, on ne rencontre que les foyers proprement dits (Maliq I, II, Vica) qui avec le temps remplissent même la fonction des symboles de culte. Ces foyers ont la forme d'un quadrangulaire aux coins arqués contourné d'une basse bordure (Kolsh II, Maliq II b) (fig. 9).

L'HABITATION DE LA PÉRIODE URBAINE

Les habitations de cette époque peuvent être divisées en deux groupes: en habitations qui naquirent grâce à l'évolution ultérieure, en conséquence de la croissance graduelle du nombre des pièces autours des noyaux des prototypes préhistoriques et en habitations empruntées du répertoire contemporain de l'habitation méditerranéenne hellénistique. Le premier groupe se caractérise par le rationalisme, l'adaptation au terrain et l'application créatrice du programme.

Les types des habitations empruntées furent prises aux couches riches plus cosmopolites des villes. Etant des habitations de la même zone climatérique avec les mêmes conditions économiques-sociales, elles ne devinrent pas des corps étrangers mais s'acclimatèrent bien, regagnant des particularités même insignifiantes.

L'habitation à maison de feu

L'habitation «à maison de feu» se rattache directement au foyer, qui constitue le noyau central de ce type. C'est cet élément qui dicta la définition du type. De la nomination de cette pièce dans les habitations de notre siècle «maison du feu» il ressort qu'elle était à l'origine, la maison même. Avec le temps, à ce noyau multifonctionnel furent ajoutées d'autre pièces assumant quelques-unes de ces fonctions. Si la «maison du feu»' dans le cas d'une famillle nombreuse ou lors d'un séjour de quelques amis peut accomplir mêmes les fonctions des autres pièces, au contraire, ces pièces, ne peuvent satisfaire, même en groupe, aux fonctions vitales de la maison du feu, telle la préparation des mets et le logement de la famille pendant l'hiver, tout cela à cause des petites dimensions et l'absence du foyer. Avec l'habitation de Donja Dolina, ce type acquiert une structure cristallisée. On peut suivre les voies de son évolution ultérieure à Kassopé, Çuka e Ajtoit et à Oraion, ainsi qu'avec une réapparition récente, à l'habitation de Tirana.

Les palafittes de Donja Dolina (fig. 6,7,10,11). Par les meilleures habitations conservées on comprend qu'elles avaient une planimétrie quadrangulaire, dans le rapport longueur-largeur de

DO NOT COPY

DO NOT COPY

7 à 4, divisée en trois pièces. La première, la «maison du feu» presque carréé, occupait toute la partie frontale. Les dimensions et le foyer au milieu ou au coin le plus eloigné montrent qu'elle constituait la principale pièce qui servait à faire la cuisine, à manger, à se reposer et à dormir pour les membres non mariés de la famille. La «maison du feu», était sans plafond, pour que la fumée puisse s'échapper du toit. Un mur disposé tranversalement à son derrière, détachait deux autres pièces, plus petites couvertes d'un plafond de bois qui les protégait du froid et de l'humidité. Le passage à ces deux pièces se réalisait par la maison du feu. Il parait que ces deux petites servaient de chambres à coucher.

L'espace entre le toit en poutres couvertes de paille et le plafond, servait de dépôt pour les outils de travail et pour les céréales conservées dans des paniers. Les traces d'un deuxième plafond démontrent que l'une des habitations a été à deux étages. Cela témoigne de l'évolution ultérieure de ce type et du passage du schéma à un étage au schéma à deux étages.

La décoration des bordures des foyers en svastika, méandres, croix hélices, les témoigne des autels de l'ancien culte illyrien du soleil et du feu (fig. 12). En comparaison avec les habitations précédantes, trop simples, l'habitation de Donja Dolina, marque un pas qualitatif quant au programme et la solution architecturale. Par les conditions économiques-sociales et la position écartée, ces habitations apparaissent évolutives et non transplantées. Ce sont les habitations de Kassopé qui marquent un bond ultérieur dans l'évolution de ce type.

Les habitations de Kassopé (fig. 13, 14). Des exemples les mieux conservés, il ressort que dans la phase originale elles présentaient le même programme et un traitement presque uniforme. L'entrée presqu'au milieu de la face qui donnait sur la rue, amenait à une cour qui servait de lieu de repos à la famille pendant l'été, et d'un premier noyau d'organisation et de communication. L'un de ses côtés communiquait avec l'andron, l'autre avec l'ensemble des dépôts et des magasins, alors que la partie frontale précédait le bloc de la «maison du feu» et des autres pièces de l'habitation. Ce bloc à planimétrie quadrangulaire, dans le rapport de 7 à 4, répète par de plus grandes dimensions, l'habitation de Donja Dolina. (102m^2/33m^2). L'habitation de Kassopé était différenciée en hauteur. La partie frontale était à un étage alors que celle dernière se developpait à deux étages (fig. 15). La maison du feu à une planimétrie principalement carrée (49 m^2) constituait le noyau de l'habitation. La maison du feu, qui en hauteur occupait le premier et le deuxième étage, était sans plafond, pour que la fumée de la cheminée puisse sortir par les fentes du toit (fig. 16). Au dos de la maison du feu s'appuyaient les autres pièces de l'habitation. Un escalier en forme de balcon menait aux pièces du deuxième étage tandis dans les deux pièces du premier étage on passait directement.

Le bloc des boutiques et des dépôts était généralement divisé en trois pièces à double accès, l'un donnant sur la cour, l'autre sur la rue.

L'habitation de Oraon (Amotopos) (fig. 9, 10) conservée à la hauteur complète de deux étages à une forme presque quadrangulaire, occupe une superficie de 285 m^2. (fig. 7). L'entrée, située à son extrémité, au moyen d'un corridor donnait accès à une petite cour qui servait de premier noeud de communication. La cour était limitée d'un côté de l'andron de l'autre du dépôt allongé et en face, de l'habitation. A la différence de l'habitation de Kassopé, dans cette habitation le passage est assuré au moyen d'un porche qui à part la fonction du tambour pour éviter les courants froids, jouait la fonction d'un deuxième noeud de communication. La «maison du feu» communiquait avec le dépôt des provisions et deux petites pièces, créant ainsi un bloc qui répète fidèlement l'habitation authéntique de Kassopé et l'habitation de Donja Dolina. La planimétrie du deuxième étage respecte celle du premier étage doublant ainsi chacune de ses pièces, à part la maison du feu qui occupe en hauteur les deux niveaux (fig. 18).

Assez proche à l'habitation d'Oraon, se présente quant au programme, aux dimensions et à la formulation, l'habitation de Tirana, qui par les exemples conservés, remonte à la fin du dernier siècle (fig. 19). La maison du feu (51 m^2) située au centre de l'habitation est entourée de tous les côtés par les pièces d'habitation. Comme à Kassopé à Oraon celles-ci se développent au premier et au deuxième étage à la différence de la «maison du feu» qui occupe en hauteur les deux étages.

L'habitation du versant avec «maison de feu», se rencontre dans la ville de Çuka e Ajtoit, une ville typique du versant (fig. 20-28). Bien que le schéma urbanistique de la ville n'est pas régulier, on y remarque la tendence d'aménager les habitations sur la même courbe de niveau. Au versant sud se trouvent les ruines de trois habitations avec le même schéma compositionnel. La planimétrie de ces habitations orientées vers le sud, a la forme de la lettre «L». Une pente de 45° du terrain et la planimétrie assimétrique, ont dicté aux habitations un développement de volume differencié: Quant'à lui, le bloc principal, a deux étages. L'aile qui fait saillie liée organiquement à lui se développe à trois étages atteignant ainsi une hauteur de 11,10 m jusqu'au faite de la toiture.

Au premier étage de cette habitation, il y a une seule pièce. Au deuxième et au troisième autour du noyau compositionnel, la maison de feu, sont groupées 7 pièces. Cela montre que l'habitation se développait pratiquement selon un plan horizontal, étendu le long des courbes de niveau. La face postérieure, les murs latéraux en partie et le plancher, sont gravés sur le roc.

D'après les fragments des pythos et de la fontaine cette pièce du premier étage a dû servir d'atelier. De là, un escalier menait au noyau de l'habitation, à la «maison du feu» à planimétrie presque carrée (49 m^2). La maison du feu communiquait aussi avec l'extérieur au moyen d'une porte latérale. Un moulin à céréales à l'extrémité postérieure et les débris

des pythos et amphores montrent que la «maison du feu» à part sa fonction de pièce de séjour servait également à faire la cuisine et à conserver des provisions.

La maison du feu communiquait avec toutes les autres pièces servant ainsi de noeud de communication et d'organisation. A sa gauche, on accédait à une pièce divisée en deux niveaux par une rangée de poutres massives. La maison du feu au moyen d'un corridor communique avec une petite pièce divisée en deux niveaux.

Le développement de l'habitation avec «maison de feu» (tab. I). commence avec celle de Donja Dolina, où à peu de frais, par l'adjonction des autres pièces et des dépôts derrière la maison du feu se cristallise une habitation très rationnelle (fig. 10). Cette habitation correspond encore à un stade en fermentation, celui du passage de la société préurbaine à celle urbaine, se qui se reflète au nombre encore limité des pièces. Entre temps on y remarque un noveau band qualitatif: le net écartement de la «maison du feu» des autres pièces servant à coucher ou à emmagasiner. De pair à cela, dans les habitations de Donja Dolina, se reflète bien que embryonnaire, la tendence vers le confort qui s'exprime par l'aménagement à part des pièces à coucher et par la présence du plafond.

Cet unité, la «maison du feu» avec deux pièces à coucher et des dépôts, représente un groupe bien cristallisé, qui, au rôle du noyau central suit l'évolution de ce type dans les exemples plus développés. Les traces d'un développement ultérieur de cette habitation se rencontrent de nouveau à Donja Dolina où les exemples les plus récents sont à deux étages.

Dans les habitations de Kassopé (fig. 13), ce groupe qui se détache nettement des autres pièces répète le rapport de l'habitation de Donja Dolina (7:4) mais avec de plus grandes dimensions. A. Kassopé, comme dans les exemples développés de Donja Dolina, la maison du feu s'élève à la hauteur de deux niveaux, alors que les pièces à coucher du premier étage sont reprises au deuxième étage. Afin de satisfaire aux nouvelles exigences on ajoute à ce noyau la cour, le bloc de dépôts et des boutiques et l'andron. Au noyau de l'habitation de Oraion (fig. 17), fut ajouté un nombre de pièces (13) et un porche. Tout comme à Kassopé, nous avons à faire ici à des adjonctions mécaniques, qui ne touchent pas aux traits fondamentaux de cette habitation: la prédominance de la maison du feu envers les autres pièces.

Dans la petite ville de Çuka e Ajtoit (fig. 21, 22) moins développée du point de vue économique, la superficie totale de l'habitation est plus petite, alors que la superficie de la maison du feu est la même. Par conséquent, le pourcentage qu'elle occupe par rapport à toute l'habitation, est plus élevé. L'obsence des surfaces libres, de la cour et du porche montre qu'elle n'est qu'une habitation utilitaire avec un schéma compact, bien adaptée au terrain. Même cette habitation ne se détache pas du type de l'habitation avec «maison du feu», représentant seulement une de ses variantes, l'habitation du versant avec «maison du feu».

«La maison du feu» par rapport à tout le volume de l'habitation marque une baisse relative dans le temps, (tab. 1 fig. 29) de 68% à Donja Dolina à 56% à Çuka e Ajtoit, à 28,6% a Kassopé et à 17% à Oraion. Cette baisse relative, conséquence de l'adjonction des pièces conforme aux exigences de l'époque, montre qu'il s'agit d'un type d'habitation dynamique et evolutif. Au contraire, en grandeur absolue, la «maison du feu» augmente de superficie et de volume, notamment de 21,2 m^2/43 m^3 à Donja Dolina à 49 m^2/220 m^3 à Kassopé à 49 m^2/273 m^3 à Çuka e Ajtoit et à 45 m^2/280 m^3 à Oraion. L'évolution ultérieure peut être suivie dans l'habitation de Tirana où la maison du feu qui représente 12% du volume total de l'habitation, occupe un superficie de 52 m^2 et un volume de 500 m^3. De ces données il ressort que les changements quantitatifs conforme aux exigences de l'époque, n'apportèrent pas de nouveaux éléments qualitatifs qui dicteraient la formation d'un nouveau type.

L'habitation à «maison de feu» est spécifique pour l'Illyrie et l'Epire. En effet, la pièce à foyer «Oikos» se rencontre même a l'habitation grecque (tab I, fig. 29) mais la place qu'elle occupe au schéma compositionnel et la superficie relativement petite indiquent qu'elle n'est pas un élément subordoné qui ne dicte pas la définition du type. Cela se comprend bien par une comparaison établie entre les schémas compositionnels et la superficie des pièces correspondantes des habitations en question avec les habitations connues des villes grecques du Ve sc.av.n.è. et de la première moitié du IVe sc.av.n.è. (Kolofon, Olyntne, Abdere, Pirée, Prièné) (tab. 1). Alors que la superficie des pièces d'habitation demeure la même (30/30 m^2) et celle de l'andron, approché (23/16 m^2), la superficie des trois autres pièces principales, celle de la «maison du feu» de la cour et du «hayat» diffèrent sensiblement.

La «maison du feu» à Kassopé «Oikos» se présent deux fois plus grande que celle dans les villes déjà mentionnées (49,23 m^3) tandis que celle de la cour occupe une superficie deux fois plus petite (27,60 m^2). Cela montre qu'elle servait plutôt de noeud de communication que de lieu de séjour comme dans les habitations des villes grecques. L'excès de superficie dans ce cas passe aux dépôts et aux écuries (52,31 m^2) ce qui demontre une plus étroite liaison avec l'économie rurale. Enfin, le porche, élément qui définit le type «prostas» et «pastas» de l'habitation grecque, y manque totalement. A Oraion et à Çuka e Ajtoit on conserve l'ancien rapport avec une grande «maison de feu» (45,23 m^2; 49/23 m^2). A Oraion la cour est petite (33,60 m^2) alors qu'à Çuka e Ajtoit elle fait défaut. Le porche qui apparait à Oraion, demeure très petit (11/22 m^2). La superficie approchée des habitations de Kassopé et Oraion avec celle des habitations d'Olunthe, Kolofon, Abder, Pirée et Prièné, révèle des unités équivalentes, des familles numériquement égales. Cela est mieux indiqué par la superficie égale (Kassopé) ou approchée (Oraion) des pièces

DO NOT COPY

DO NOT COPY

d'habitation. Par conséquent, la superficie plus que deux fois plus grande de la «maison du feu» s'explique seulement par la différente structure familiale. En tant que telle elle servait de noyau de réunion. Le rassemblement de tous les membres de la famille en une seule pièce, révèle une vie familiale compacte et une forme plus démocratique de la vie en famille. Cela indique que la vie quotidienne des hommes, à la différence de celle dans les villes héllènes, se déroulait selon la tradition, plutôt à la maison qu'agora.

L'existence de l'habitation avec «maison de feu» sur plusieur endroits des térritoires des Dalmatiens, Kassopéens, Kaoniens, et en dehors de l'espace temporel en question, en Albanie centrale, fait preuve d'une unité architecturale.

L'habitation à porche.

Il paraît que l'habitation de Selca (fig. 30) est une habitation à porche. Le porche se distingue mieux à l'ensemble d'habitations de «Çuka e Ajtoit». Cet ensemble entouré de mur se situe 75 m à ouest de la fortification hors de l'enceinte de la ville (fig. 31). Les dimensions, le nombre des bâtiments et des pièces ainsi que la position, l'encartent du point de vue qualité, des autres habitations de Çuka e Ajtoit. Le terrain sur lequel s'élève cet ensemble est plus calme que celui des versants où se situe la fortification et les autres habitations. Il est entouré de mur de grand appareil. Dans cet ensemble on distingue deux groupes d'habitations. Le premier groupe, représenté par deux constructions parallèles, se situe à la moitié occidentale. Le premier bâtiment de ce groupe au moyen d'un mur disposé transversalement est divisé en pièces. Le simple traitement fonctionnel et la position révèlent une construction annexe en fonction de l'autre construction. L'autre à cause de l'affaissement du terrain présente un développement de volume différencié. Le premier étage précédé du porche est-gravé en rocher. Dans cet étage logiquement divisé en pièces par des murs disposés tranversalement, se trouve l'ascalier qui mène au deuxième étage. Cet étage s'appuyait partiellement au sol, partiellement au premier étage. Il paraît que dans la partie derrière le deuxième étage se trouvait un autre porche central derrière lequel, dans la partie frontale, étaient aménagées dix pièces. La parallèle à Kassopé nous induit à penser à un «Katagagion» une auberge pour les hôtes de la ville.

Le groupe oriental des constructions se détachait de l'autre partie par un mur intérieur. Il se développe sur deux niveaux différenciés en hauteur, entre deux cours. Dans la cour du derrière se trouve la citerne cylindrique (14 m^3). Le bloc central s'élève, tout comme la construction du groupe méridional, sur une pente rocheuse qu'on creusait pour aménager les pièces.

Le bloc principal présente une planimétrie quadrangulaire au développement volumétrique differencié. Dans la partie frontale est percée une entrée qui menait au corridor postérieur, long et étroit qui communiquait avec les pièces. A son extrémité, commençait un escalier étroit qui menait au deuxième étage. La partie frontale de «cet étage se développait au-dessus du premier étage alors que l'autre partie continuait au-dessus du sol plat et se terminait par un «hayat». De cette façon, toute l'habitation occupait une superficie de 300 m^2. Ces dimensions cinq fois plus grandes que celles des autres habitations de ce centre, sa position à l'écart du territoire de la ville entourée d'enceinte, prouvent que cet ensemble peut-être a été un prytané. D'après les fouilles, il remonte au IIIe sc. av.n.è. L'entourage des habitations en mur, permettait une formulation intérieure libre. Le traitement architectonique un peu rude, sans éléments décoratifs, démontre que les habitations des petits centres, soient celles des couches riches, tentaient moins vers l'esthétique et le luxe que dans les grands contres.

L'habitation avec cour

Les habitations urbaines de la fin du IVe sc et du début du IIIe sc.av.n.è. se divisent principalement en deux types: celui avec cour entourée de colonnes (péristyle) et celui avec cour corridor où la cour joue le rôle du noyau d'organisation et de communication. L'habitation à peristyle est représentée par cinq exemples (Apollonie, Antigone, Bylis, Oraion. Kassopé) tandis que celle à cour-corridor par trois exemples. (Apollonie, Antigone, Nikae). Les traces révèlent la présence d'un grand nombre de ce type d'habitation, surtout à Antigone. Bien que l'habitation à peristyle ait une plus grande superficie et une décoration plus soigneuse et coûteuse, on retrouve les deux types au même îlot, quelques fois dos à dos. (Apollonie fig. 32 Kassopé). Il en résulte qu'elles appartiennent à la même couche sociale mais à de différentes cathégories. Des deux types, celui à péristyle est plus standardisé alors que celui à cour corridor connaît un plus libre aménagement des pièces.

Les habitations avec cour-corridor représentent un libre mélange de l'habitation classique du type pastas et prostas avec le simple schéma compositionnel de l'habitation traditionnelle. Son nouveau élément est la cour qui joue le rôle du noeud de communication et de composition. Cette habitation se distingue pour une solution libre comme l'habitation à péristyle, ce qui apporte une diversité de variantes. Les plus simples et les plus anciennes habitations de ce type sont celles de Çuka e Ajtoit. Les habitations d'Apollonie et d'Antigone sont plus récentes. Elles datent du IIIe sc.av.n.è.

Les habitations de Çuka e Ajtoit (fig. 33-36) se trouvent aux approches de l'entrée nord-ouest, à l'intérieur de l'enceinte. La superficie presque égale (124-131) et le même nombre des pièces (5) démontrent qu'elles appartenaient à la même couche urbaine. L'orientation de ces habitations laisse à désirer parce que la partie frontale disposée vers le nord-ouest ne recevait le soleil que pendant les heures de l'après-midi. Cela et la superficie qui est 40% plus petite que celle

des habitations méridionales prouvent qu'elles appartenaient à une plus pauvre couche. Ce groupement montre aussi la division en quartiers selon la cathégorie économique. Le schéma compositionnel de ces habitations ressemble beaucoup au schéma compositionnel des habitations méridionales: une pièce centrale en enfilade avec les pièces latérales et une autre pièce détachée au devant. La petite cour est un nouveau élément dont la présence se justifie par le terrain moins en pente qui n'est pas rocheux et accidenté. En fonction du terrain, la forme planimétrique de l'habitation se présente irrégulière. Des trois habitations mieux conservées l'une indique une planimétrie carrée, l'autre en forme de la lettre «L», la dernière une planimétrie irrégulière.

La cour de ces habitations se distingue nettement par un traitement moins soigné des murs ainsi que par la position. La petite superficie montre que cette cour simplement utilitaire servait de noeud de communication et peut-être comme un endroit où l'on gardait les outils ou quelque menu bétail. La «maison du feu» ne se différencie pas nettement à cause de la superficie presque égale des pièces. Pour les deux premières habitations on supposerait que la «maison du feu» est la pièce superieure, à gauche avec des dimensions plus grandes et un meilleur thermo-isolement que les autres pièces sans communication directe avec l'extérieur et avec une seule face libre. Dans la troisième habitation ce rôle pourrait être assumé par la pièce carrée en face de la cour, la seule pièce à grande superficie. Quant à la superficie, la «maison du feu», de ces habitations est plus petite que celle des habitations de Kassopé, d'Oraion et des habitations méridionales de Çuka e Ajtoit, s'approchant ainsi aux «oikos» des habitations grecques. Malgré cela, son rapport envers la superficie de l'habitation (16-26%) s'éloigne beaucoup de celui de l'habitation grecque respectant ainsi la norme habituelle des habitations illyriennes et épirotes à «maison de feu». Le programme moins riche, la technique, l'orientation infavorable montrent que ces habitations appartenaient à une plus pauvre couche que celle des propriétaires des habitations méridionales. La superficie totale de l'habitation (sans la cour) et de la maison du feu du groupe au nord est 40-50% plus petite que celle du groupe au sud. Il en ressort que numériquement les familles sont plus petites.

Les habitations de Nikae (fig. 37, 38) Antigone (fig. 39) Apollonie (fig. 32) présentent une formalation différenciée. On y distingue trois groupes principaux, la cour, les boutiques-ateliers et les pièces d'habitation. Le noeud d'organisation, autours duquel se développe l'habitation est la cour-corridor, qui détache les groupes principaux les uns des autres, assure la communication et éclaire les pièces. La superficie (36-60 m²) proche à celle des cours des habitations classiques ou «prostas» (50-60 m²) la révèle un principal lieu de séjour pendant les mois chauds. La cour est traitée différement. A Antigoné elle se présente carrée, à Nikae, la cour-corridor assure une forme régulière aux pièces en se déformant elle-même. A Apollonie elle a la forme de la lettre «L». Son aile longue comme le démontrent les traces de la fresque a été couverte alors que celle courte, différenciait les deux groupes de l'habitation, le groupe des communs à celui de l'habitation. On pouvait y acceder même directement par la ruelle qui la séparait de l'autre habitation.

Dans quelques-unes des cours (Nikae fig. 40 Margëlliç) on conserve les citernes cylindriques à une capacité de 2500 l d'eau. A part cette cour-corridor, derrière ces habitations il y a eu une autre cour. (Nikae, Margëlliç, Apolloni). La boutique-atelier, avec le dépôt à son dos, se distingue nettement à Antigoné (40 m²). Le propriétaire de la maison y accédait par la cour tandis que les clients, par la rue. La position de l'andron de ces habitations n'est pas définie, il peut se déplacer du début (Nikae, Antigone) à l'intérieur (Apollonie). Le plancher en mosaïque démontre qu'à Apollonie, l'andron (37 m²) se trouvait au centre de l'habitation.

L'écartement de la cuisine comme une unité à part, est une caractéristique de l'habitation avec cour-corridor, qui apporte une perte des valeurs de la «maison du feu». Les habitations de ce type, à la différence de celle à peristyle qui exigent un terrain plat, peuvent être échelonnées sur des niveaux de différentes hauteurs. Le passage d'un niveau à l'autre se réalisait par un escalier intérieur (Antigoné). Enfin, selon une comparaison typologique, on peut supposer que les parties postérieures des habitations à Apollonie, et à Antigoné avaient deux étages tandis que les parties frontales un étage.

Les habitations à péristyle. Ces habitations remontent au IIIe sc.av.n.è. Les habitations de ce type à Priène, Délos, Pergame, etc, appartiennent au IIIe sc. av.n.è. et rarement à la première moitié du IVe sc. av.n.è. Par conséquent, le traitement architectonique régulier, avec des formes cristallisées et la riche décoration font preuve d'un marche synchrone avec l'architecture contemporaine. Les schémas planimétriques des habitations avec péristyle d'Apollonie (fig. 32, 41, 42), Antigoné (fig. 43-46) et Bylis, se ressemblent et occupent presque la même superficie (615, 734 et 720 m²). A la différence de ces habitations construites «ex-novo», l'habitation à peristyle à Kassopé, représente tout simplement un élargissement et une adaptation de l'ancienne habitation avec «maison de feu».

L'habitation de Bylis se trouve sur un terrain en pente. Un mur de terrassement doté de contreforts nivelle le terrain créant un plan horizontal plat sur lequel s'élève l'habitation. Avec deux murs de terrassement on a nivelé aussi le terrain incliné d'Antigoné. A Apollonie, le terrain se présente plat. Comme on le voit, ce type d'habitation ne supportait pas la pente du terrain, il pouvait se développer seulement sur des terrains plats, bien nivelés. Cela se voit nettement à Antigoné, où, parallèlement à l'habitation à péristyle, se trouve une habitation avec cour-corridor, dont les pièces sont disposées de façon échelonnée. Comme toutes les autres habitations de ce type, les habitations déjà mentionnées sont aveugles: C'est seulement l'entrée du corridor qui perce le mur extérieur, plat et monotone. A Apollonie elle était précédée d'un petit pont en blocs

DOWNLOADED

arqués qui servait à franchir un petit ruisseau au bord de la rue. La porte massive à deux vanteaux, decorée et renforcée de clous de bronze, se trouve un peu retiré à l'intérieur. Il se créait de cette façon un certain abri couvert qui protégeait de la pluie ou du soleil fort, les gens qui venaient frapper à la porte. Si les pièces qui se trouvaient à ses deux côtés servaient de boutique (Apollonie, Antigoné) alors on y accédait directement. La grande largeur du corridor permettait le passage des grandes charrettes à l'intérieur de la maison.

Dans ces habitations, le corridor ne correspond jamais à l'axe de l'habitation, au milieu de la cour, comme à Priène, à Délos, mais à l'allongement de l'une des ailes du portique. Cette solution est plus rationnelle parce qu'elle évite les tournants inutiles que dicterait un corridor disposé symétriquement.

Le noyau central, autour duquel était aménagé toute l'habitation était la cour ouverte (l'impluvium). Il servait premièrement de source de lumière et d'aération pour toutes les pièces de l'habitation. Quand il faisait beau, il servait de lieu de repos, et quand il pleuvait, il recueillait les eaux des toits. On collectait ces eaux dans une citérne souterraine au coin de la cour (Bylis) ou on s'en débarrassait au moyen de canaux (Apollonia). La cour carrée (75-96 m) était limitée d'un socle qui d'apprès les traces conservées, supportait 12 colonnes d'ordre ionique à une hauteur de 3,70 m environ. La cour était entourée de quatre côtés d'un portique dont le plancher était en terre battue (Antigoné) ou pavé de brique (Apollonie). Le toit du portique, à quatre versants, incliné en face vers la cour, s'appuyait d'un côté sur l'architrave de la colonnade de la cour et de l'autre côté, sur le mur de refend des pièces. Selon la fréquence des mouvements, la largeur du portique varie de 2,5 à 3,5 m. Il assurait la communication des pièces de l'habitation et en même temps servait de lieu de repos. Le portique brisait les rayons du soleil et laissait pénétrer dans les pièces seulement les rayons matinaux et ceux de l'après-midi évitant ainsi l'effet brûlant des rayons du midi. Au midi d'un jour hivernal, les rayons de soleil embrassent une large espace dérrière les colonnes du péristyle, créant ainsi un réservoir de chaleur.

Le gradin du terrain à une hauteur de 3,20 m derrière l'andron de l'habitation d'Antigoné, exige de ce côté une construction à deux étages, Cela est témoigné également par les soubassements des colonnes en bois au milieu des pièces de l'andron qui servaient à soutenir le plancher du deuxième étage. A Antigoné, comme à Apollonie, l'une des ailes du portiques se présente libre, sans pièces. Ce développement planimétrique exige un développement de volume différencié avec la partie à deux étages au-dessus de l'andron et l'aile libre à un étage qui joue le rôle d'une galerie simple. Par conséquent, la colonnade de la cour et l'impluvium ont dû être à un étage. Les deux autres ailes pouvaient avoir un ou deux étages. Ayant en vue le traitement de l'habitation voisine avec cour-corridor à Apollonie dont le bloc de derrière est à deux étages nous pensons que les habitations à péristyle d'Apollonie et d'Antigoné et peut-être celles de Bylis ont eu une ou deux ailes à deux étages et les deux autres à un seul étage.

Le corridor de l'entrée était suivi de l'andron avec la salle des banquets (symposion) flanquée des deux chambres d'amis. A Apollonie, la salle des banquets dont le plancher est pavé de briques, s'ouvre à un espace de 3,5 m vers le porche. Cette large ouverture est limitée des deux côtés par de légers tournant des murs, des parastades couronnés d'images d'homme et de fleurs. Les pièces d'habitation des premiers étages se trouvent à l'aile située loin du portique, afin de ne pas intérférer au va-et-vient des amis. Ces pièces ont de grandes dimensions. Enfin le groupe des pièces de service à Apollonia et Antigoné, se trouve à côté du corridor d'entrée, près de la salle de banquet. Réalisant une communication intérieure entre les pièces ce groupe se présente comme une unité fermée.

Les exemples déjà mentionnés, surtout ceux de Apollonie et Antigoné, démontrent qu'au début du IIIe sc. av.n.è. l'habitation avec cour à colonnes et à peristyle, fut bien cristallisée comme une habitation rationnelle, avec un programme bien net et un standart de construction. Cette habitation, à la différence des autres habitations de ce type, présente une forme rigoureusement rectangulaire qui révèle un système urbanistique régulier, bien contrôlé, une entrée assymétrique bien rationnelle et un aménagement en chaîne des chambres des hommes. Cela apporte un meilleur éclairage et aération des chambres. Avec l'aménagement du corridor dans les pièces de service à Apollonie, ce groupe devient une unité à part qui ne communique pas directement avec le noeud de communication de toute l'habitation, le «hayat» porche.

La disposition non loin du centre, le programme ainsi que le décor architectonique prouvent que cette habitation appartenait aux couches riches de la population.

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

KËSHTJELLA MESJETARE NË SHQIPËRINË JUGPERËNDIMORE+

Në këtë shkrim janë bërë objekt studimi katër kështjella mesjetare, në zonën bregdetare të Shqipërisë Jugperëndimore. Prej tyre, Lëkurësi, ndodhet drejtpërdrejt mbi bregun e detit Jon, ndërsa të tjerat, të vendosura pak më në thellësi të tokës, prapa vargmaleve që ndajnë bregun me prapatokën, kontrollonin rrugë apo vendkalime të rëndësishme, të cilat lidhnin bregun me thellësinë e vendit. Në trajtimin e përbashkët të tyre të shtyn jo vetëm lidhja territoriale e karakterit strategjik por dhe rrethanat e përbashkëta historike, lidhur me kohën e ndërtimit, apo me ndonjërën nga periudhat e rëndësishme ndërtimore të tyre. Studimi është bazuar mbi vrojtimin dhe rilevimin e mbetjeve arkitektonike të këtyre monumenteve, pa ndihmën e gërmimeve ose sondazheve arkeologjike. Tri nga fortifikimet e lartpërmendura jepen për herë të parë nga një organ shkencor, ndërsa për Delvinën[1], studiuar më parë nga A. Baçe, jepen disa të dhëna të reja, dalë nga vrojtimi i monumentit, lidhur me fazat e ndërtimit dhe datimin e tyre.

Kështjella e Kalasës

Rrënojat e kësaj kështjelle (fig. 1) ndodhen në fshatin Kalasë, në rrjedhën e sipërme të lumit me të njëjtin emër, i cili përshkon një zonë të pasur arkeologjike, dëshmi e popullimit të këtij territori qysh në kohë të lashta. Rruga nga Delvina në Kalasë, duke përshkuar një terren fushor, kthen në Stihar e ndjek luginën e lumit të Kalasës. Kalasa lidhet me bregun e detit me anën e Borshit (Sopotit) duke ndjekur rrugën nëpër qafën e Frashërit, e cila mban rreth tri orë e gjysmë në këmbë. Ajo lidhet edhe me luginën e Drinosit nëpërmjet rrugës që të çon në Zhulat e Kardhiq. Në Zhulat dhe Kardhiq ruhen rrënoja kështjellash, të cilat i përshkruan Çelebiu. Dendësia e fortifikimeve gjatë kësaj rruge tregon se ajo ishte një arter i rëndësishëm për të lidhur brendësinë me breg-



Fig. 1

+) Rilevimi topografik i Kështjellës së Kalasë dhe Delvinës është kryer nga M. Bezhani nën drejtimin e autorit. Fotot janë nga N. Kasapi, fotot (fig. 6, 8) janë të A. Baçes, botuar në «Monumentet» 13. Rilevimi i Lëkurësit nga autori L. Suli dhe A. Qoshka. Skicat për botim janë përgatitur nga F. Guralumi dhe A. Qyshka.

1) A. Baçe, **Kështjellat e Kardhiqit dhe Delvinës,** «Monumentet», 13, 1977 f. 62 – 66.

DO NOT COPY

detin, nëpërmjet qafës së Frashërit, grykës së Borshit, si dhe pellgut të Delvinës.

Kalasa, si kështjellë, përmendet për herë të parë në v. 1581 me emrin Kasteli, që s'është gjë tjetër veçse një variant latin i Kalasës,[2] ndërsa si qendër e banuar me 74 shtëpi, del dy vjet më vonë, në v. 1583, në defterin e Delvinës[3]. Kalasa përshkruhet nga Çelebiu, i cili e vizitoi atë gjatë udhëtimit të dytë në Shqipëri në v. 1670. Ai e quan me emrin Galatas, por nga përshkrimi i vendit kuptohet se bëhet fjalë për Kalasën. Kështjella, sipas Çelebiut, ka qenë nën sundimin venedikas dhe u pushtua nga Gjedik Ahmet Pasha në kohën e Bajazitit II. Kalasa varej nga Delvina, dhe ishte qendra e nënprefekturës së Kurveleshit. Fortifikimi në formën e një pesëkëndëshi ishte ndërtuar krejtësisht me mure guri në një perimetër prej 600 hapash. Brenda saj kishte vetëm 7 shtëpi, një faltore dhe një depo ushqimi. Nga lindja kishte një portë hekuri. Në kështjellë qëndronte Dizdari (komandant i kështjellës) me 100 ushtarë[4].

Kështjella është ndërtuar mbi një kodër të ulët, në të majtë të rrjedhës së lumit, shtrati i të cilit pranë saj kapërcehet nga ura të vjetra me nga një hark të madh, të cilat Çelebiu nuk i përmend. Urat lidhnin lagjet e qytetit në dy anët e lumit dhe njëkohësisht rrugën e cila vinte nga Delvina me atë që kalonte nëpër qafën e Frashërit.

Muret e fortifikimit i përshtaten formës së terrenit, veçse gjithnjë me linja të drejta, duke tentuar të krijojnë një figurë të rregullt gjeometrike, e cila i afrohet katërkëndëshit (fig. 2). Ato kanë perimetër prej 270 m duke përfshirë një sipërfaqe më pak se 1/2 ha. Vende-vende muret ruhen në 4-6 m lartësi (fig. 3), por në pjesën më të madhe janë të rrafshuara me tokën. Tre nga këndet e pesëkëndëshit kanë qenë pajisur me kulla. Kulla e I është e vetmja kullë rrethore në këtë kala. Prej saj ruhen gjurmët e mureve anësore 1,5 m të gjerë, si dhe një pjesë e murit të brendshëm, të harkuar, prej të cilit del se kulla ka patur një diametër të brendshëm 2,5 m (fig. 4). Nga kulla e II ruhet vetëm muri ballor me gjatësi 3,70 m, në lartësi rreth 1 m. Kjo e fundit, ndërtuar në pjesën më të lartë të kodrës, me një fushëpamje të mirë, kontrollon krejt territorin e kështjellës. Kulla e III gjithashtu drejtkëndore, ndodhet në këndin verilindor. Ajo projektohet vetëm kundrejt murit verior të kështjellës, kështu, një nga muret e kullës, është vazhdim i murit rrethues. Ky i fundit kontrollohej nga kulla II, ndërsa pjesa që mbetej nga muret e kështjellës prej kullës I dhe III.



Fig. 2

2) Kasteli përmendet në një letër që i dërgojnë Papës kryengritësit himariotë. Ai shënohet në radhë pas Nivicës, që ndodhet pranë, dhe nuk ka të bëjë me rrënojat prehistorike në afërsi të Borshit të njohura me emrin Kasteli. Shih. N. Borgia, **I monaci basiliani d'Italia in Albania,** Appunti di Storia missionaria sec. XVI-XVIII, Roma 1935, f. 83.

3) Defteri Ieva-i Delvina në Tapuve Kadastra unum mudurlunguten Arsivi, Ankara Defteri 91.

4) S. Vuçiterni, Shqipëria para dy shekujsh, Tiranë 1930, f. 24-26, F. Babinger, Tschelebis Reisewegen in Albanien, Berlin 1938, f. 10.

POSTCOPI

Muret janë ndërtuar me gurë pllocakë të lidhur me llaç, të vendosur në rreshta thuajse horizontalë. Më tepër kujdes është treguar në muraturën e kullave, sidomos tek kulla II, në të cilën kemi një vendosje krejt të rregullt të gurëve (fig. 5). Gjerësia e mureve të kurtinave është 1,5-1,7 m dhe po aq është dhe trashësia e mureve të kullave. Në mure nuk janë përdorur copra tullash apo tjegullash, gjë që vështirëson datimin nëpërmjet teknikës së muraturës, si dhe hetimin e fazave të ndryshme të ndërtimit.

Pranë kullës III, në murin lindor, ndodhej hyrja. Rikonstruksioni i saj nuk mund të arrihet, pasi ajo ka mbërritur mjaft e dëmtuar.

Në pjesën më të lartë të kodrës hetohen gjurmët e një ndërtimi drejtkëndësh, me përmasa të brendshme 10 x 11 m me gjerësi muresh 1,5 m. Teknika e ndërtimit ndryshon nga ajo e mureve të tjera. Në pjesën më të madhe ato janë ndërtuar me gurë lumi dhe vetëm në disa vende me gurë kave. Muri i kështjellës nga ana lindore duket se mbështetet mbi këtë ndërtim. Muret e gjerë dëshmojnë për një ndërtim me qëllime mbrojtëse. Ka shumë mundësi të kemi të bëjmë me një fazë më të hershme të kështjellës, që mund të ketë qenë një kullë e veçuar e ndërtuar në pjesën më të lartë të kodrës. Nuk dimë gjithashtu se në ç'raport qëndron edhe kulla II lidhur me periudhën kryesore të ndërtimit, sepse prej saj ruhet vetëm faqja ballore dhe një fugë e shkëput murin që shkon në drejtim të kullës II nga ai që vjen prej kullës III. Mospërdorimi i tullave dhe tjegullave në përbërje të mureve, përdorimi i formave të ndryshme të kullave, kryesisht kombinimi i kullave me kurtinat, përmasat e tyre modeste etj, të kujtojnë ndërtime fortifikuese të një periudhe relativisht të vonë, të bëra nga feudalë vendas me porosi të Portës së Lartë, siç ndodhi me Kështjellën e Ishmit, ndërtuar në vitin 1572 – 74, me të cilën Kështjella e Kalasës ka mjaft tipare të përbashkëta[5]. Kjo përforcohet edhe nga mospërmendja e fshatit Kalasë në regjistrat osmanë të shek. XV e të fillimit të shek. XVI, si dhe nga emërtimi i këtij fshati nga Kalaja (Kala – Kalasë), me sa duket pas ndërtimit të kësaj të fundit. Zakonisht turqit i ndërtonin kështjellat e tyre për garnizone pranë qendrave të banuara, por ndodhte që ato të ngriheshin dhe mbi gërmadha më të vjetra ndërtimesh mbrojtëse, të braktisura prej kohësh. Në rastin tonë këto ndërtime të vjetra përfaqësoheshin nga kulla e rrënuar që përshkruam më sipër. Një veçori tjetër, karakteristike për ndërtimet ushtarake të kësaj



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5

5) Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Ishmit,** Monumentet, 15-16, 1978, f. 243-248.

DO NOT COPY

periudhe, është se kështjella ngrihet mbi një terren mjaft të ulët, për të mos thënë fushor, gjë që nuk është karakteristike për kështjellat mesjetare para turke. Së fundi, mund të vemë në dukje tendencën për të krijuar një planimetri drejtkëndëshe me gjithë pengesat e terrenit.

Po t'u drejtohemi ndodhive historike që favorizuan ndërtime ushtarake të këtij lloji do të na shkonte mendja tek ekspedita e Sulltan Sulejmanit në vitin 1537 në këto anë, e cila u shoqërua edhe me ndërtime në gjininë e fortifikimeve.

Me synim për të realizuar ëndrrën e vjetër të paraardhësve të tij, pushtimin e Italisë, Sulejman Kanuni u ndërtoi Kalanë e Vlorës, që do të shërbente si baza kryesore ushtarakodetare me zbarkimin në Pulje.

Në kushte të tilla, atij do t'i duhej një prapavijë e sigurtë, sidomos në një kohë kur krahina e Himarës ishte hedhur në kryengritje të përgjithshme dhe sulmonte e shkatërronte kampet e karvanet turke[6].



Fig. 6

Ndërtimi i një sistemi kështjellash për qëllimin e mësipërm dëshmohet edhe nga një dokument i v. 1583, në të cilin thuhet se banorët myslimanë të Gjirokastrës, ishin të ngarkuar me detyrimin për të mirëmbajtur kalatë e ndërtuara rishtas në Kurvelesh dhe për të ndihmuar në shtypjen e kryengritjeve të banorëve të kësaj krahine.[7] Në krahinën e Kurveleshit bënte pjesë edhe Kalasa. Në qoftë se cilësimi «të ndërtuara rishtas» nuk i referohet një periudhe më se 40 vjeçare, kështjella duhet të jetë ndërtuar rreth viteve 1570, kur u krijua një situatë e ngjashme me atë të v. 1537, lufta veneto-turke dhe kryengritja e shqiptarëve të krahinës së Bregut të Detit. Sidoqoftë periudha më e mundshme e ndërtimit të saj është ajo nga viti 1537 – 1570.

KËSHTJELLA E DELVINËS

Kështjella e Delvinës është studiuar më parë nga A. Baçe[8]. Por gjurmimi i mbetjeve të këtij fortifikimi na çoi në përfitimin e disa të dhënave të reja, lidhur me periudhat e ndërtimit, datimin e tyre e për pasojë në një pamje të re të zhvillimit tipologjik të kështjellës.

Muret mbrojtëse rrethojnë konturet e platformës së një kodre shkëmbore rreth 60 m të gjatë dhe 30 m të gjerë. Edhe ky territor thyhet vende-vende nga shkëmbenj që dalin mbi sipërfaqe. Vendi i kufizuar për ndërtime të çon në përfundimin se në origjinë kemi të bëjmë me një kështjellë të vogël, me një rol më tepër strategjik, që bënte mbylljen e kalimit nga pellgu i Delvinës e zona tjetër bregdetare, për në luginën e Drinosit, të cilat lidheshin nëpërmjet qafës

6) Historia e Shqipërisë, Vëll.I (bot. II) Tiranë 1967, f. 351.
7) S. Pulaha, **Qytetet shqiptare nën regjimin feudal ushtarak osman gjatë shek. XV-XVI**, Monumentet 1/1984 (27) f. 19.
8) A. Baçe, **Vep.cit,** Monumentet 1977, f. 62-66.

DO NOT COPY

së Muzinës. Kështjella, me një formë të përzgjatur në drejtimin perëndim-lindje, është pajisur në tri kulla dhe me një hyrje në anën veriore (fig. 6). Ana lindore e kështjellës, më pak e dëmtuar, mbrohet nga dy radhë muresh. Muri jugor, perëndimor dhe pjesërisht ai verior, është ndërtuar mbi shkëmbinj të thepisur.

Të para nga brenda kështjellës muret duken të rrafshuara me tokën, por ato veshin shpatet e pjerrëta të kodrës duke u ruajtur në një lartësi 2-7 m, ndërsa njera nga kullat (2) nga jashtë fortifikimit arrin lartësinë 10 m (fig. 7).

Kështjella ka kaluar disa periudha të rëndësishme ndërtimi, përveç riparimeve të vogla të herpashershme. Përsa i përket periudhave të ndërtimit dhe datimit të tyre, A. Baçe, shprehet se fazat e ndërtimit janë tri, por veçimi i qartë i tyre dhe përcaktimi i kronologjisë relative është i mundshëm vetëm për pikën E, ku shihet qartë seksioni tërthor i kurtinës dhe është e pamundur të ndiqet në tërë konturin e rrethimit[9]. Nga trajtimi i mëtejshëm i këtij problemi përcaktohet si e fazës së parë kulla 2, e fazës së dytë kulla 1 dhe e fazës së tretë kulla 3, si dhe një kontrafortë pranë kullës 2[10].

Në mbyllje thuhet se ndërtimi fillestar i kështjellës i përket shek. XI-XII, ndërsa fizionominë e plotë ajo e merr në shek. XIII-XIV[11].

Meqë fillimisht, kështjella, ka qenë ndërtuar me mure mjaft të holla, periudhat e mëvonshme të ndërtimit kanë synuar dhe në drejtim të rritjes së trashësisë së tyre. Siç ka vënë në dukje dhe A. Baçe, rritja e trashësisë së mureve është bërë nga pjesa e brendshme e kështjellës, pasi muret më të vjetëra kishin zënë buzën shkëmbore të terrenit (fig. 8). Kjo mënyrë ndërtimi na e bën të lehtë të dallojmë periudhën e parë të ndërtimit, e cila ndodhet në lindje të kullës 3, pranë pikës E. Kjo periudhë përfaqësohet nga një trakt muri me gjatësi rreth 10 m dhe lartësi 3 m, që mund të shihet vetëm nga ana e jashtme e kështjellës.



Fig. 7



Fig. 8

9) A. Baçe, **Vep.cit,** f. 64.
10) **Po aty,** f. 64.
11) **Po aty,** f. 66.

PO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

Teknika e ndërtimit me gurë të vendosur në rreshta horizontalë, që nuk takohet në asnjë vend tjetër në muret e kështjellës, të kujton periudhën e parë të Kalasë së Elbasanit (shek. IV p.e.s). Ky mur nuk është marrë në konsideratë kur kështjella u rindërtua në mesjetë, gjë që tregon se ajo ka qenë mjaft e degraduar. Në fazën e parë kështjella ka patur një formë eliptike pa kulla dhe ndiqte me linjën e mureve konturin e terrenit. Por, ajo, nga ana veriore nuk arrinte deri tek rrethimi i dytë, pasi disa shkallë të gdhendura në shkëmb nga kjo anë e që shkelen nga muri i sotëm, tregojnë gjithashtu se në këtë anë duhet të kishte një hyrje (fig. 6). Sidoqoftë, do të ishte e nevojshme kryerja e disa sondazheve arkeologjike për të qenë të bindur mbi praninë e një periudhe kaq të hershme.

Në periudhën e dytë të ndërtimit kështjella kishte përsëri një formë eliptike dhe përfshinte një sipërfaqe më të madhe, duke u zgjeruar në drejtim të verilindjes (fig. 9). Të njëjtës kohë i përket dhe formulimi i hyrjes, një trakt prej 12 m, pranë kullës 3, si dhe muri veriore «parapritës». Muret e kësaj periudhe, ndërtuar me gurë kave të vendosura në formë të çrregullt pa breza druri dhe pa përdorimin e coprave të tjegullave e tullave kanë një gjerësi 70 – 90 cm (fig. 10).

Në një periudhë të mëvonshme (periudha III) që i takon kohës së pushtimit turk, u ndërtuan dy kulla (kulla 2, 3), si dhe një mur rrethues i dytë i brendshëm nga ana lindore, duke e bërë këtë pjesë me terren më pak të thyer të kështjellës me një mbrojtje të dyfishtë (fig. 6). Teknika e ndërtimit të kësaj faze është me gurë kave të vendosur deri diku në rreshta, pa përdorimin e coprave të tjegullave dhe tullave (fig. 7). Në këtë kohë u rindërtua dhe një trakt i rrëzuar i murit të jashtëm në pikat a – b, si dhe krahu verior i hyrjes. Trashësia e murit rrethues është 1,20 m, ndërsa tek kulla 2 muri ka një gjerësi prej 1,65 m. Kulla 2 (fig. 7) është ndërtuar pjesërisht mbi murin e fazës së dytë të ndërtimit, kur ky qe rrënuar deri në nivelin e sheshit të kështjellës, apo është prishur qëllimisht për të lehtësuar ndërtimin e kullës.

Kulla 2 në anën e jashtme të kështjellës ruhet në lartësinë 10 m. Muret e saj bien me pjerrësi të lehtë, për të shtuar qëndrueshmërinë dhe për t'ju përshtatur më mirë formës së terrenit shkëmbor. Në planimetri ajo ka formën e një patkoi. Deri në nivelin e sheshit të kalasë është e mbushur me dhe e gurë. Mbi këtë nivel ngrihej i vetmi kat i kullës, i cili, pjesërisht, ruhen në lartësinë 3 m. Mjedisi i këtij kati mbulohej me një qemer cilindrik me formuese në drejtim gjatësor. Kulla komunikonte me kështjellën nëpërmjet një hyrjeje të mbuluar me qemer, me gjerësi 0,95 m e lartësi 1,35 m. Ajo është pajisur me tre frëngji për topa, që kontrollojnë drejtime të ndryshme. Njëri prej tyre kontrollonte qafën ku shtrihej pjesa kryesore e qytetit mesjetar në kohën e Çelebiut, lagjen e Lakes dhe më poshtë pazarin. Muret e kullës janë përforcuar me breza druri me seksion drejtkëndësh 12 x 14 cm. Brezat gjatësorë i ndan nga faqja e murit vetëm një rreth gurësh, ndërsa ato tërthorë janë vendosur çdo 0,45 m. Kësaj periudhe i ta-



Fig. 11

kon edhe kulla 3 në anën perëndimore të kështjellës, e cila ka formën e një pesëkëndëshi të çrregullt, të kushtëzuar në një masë të madhe nga bazamenti shkëmbor i terrenit.

Periudhës së katërt të ndërtimit i përket kulla 1, si dhe muri që lidhet me të nga ana veriore. Ky i fundit kthen në drejtim të perëndimit, duke krijuar një korridor e duke e bërë hyrjen të përshkojë një rrugë me kthesa, për pasojë më të kontrollueshme. Gjurmë të kësaj periudhe hetohen edhe në murin verior të kështjellës, nga hyrja deri në afërsi të kullës 3. Gjithashtu një pjesë e murit jugor të hyrjes është rindërtuar në këtë kohë bashkë me paturën e portës, e cila është një nga pjesët që dëmtohen më lehtë në krejt fortifikimin, njëkohësisht është ndërtuar një mur kontrafortë, në bazën e kullës 2 (Fig. 7). Ndoshta kësaj periudhe i përket edhe një depo nëntokësore e mbuluar me qemer cilindrik (fig. 11).

Periudha e katërt e ndërtimit paraqitet me një teknikë të veçantë ndërtimi, e cila dallohet nga e gjithë periudha e mëparshme. Në faqet e mureve janë përdorur copra tjegullash të futura në mënyrë të çrregullt midis gurëve (fig. 12). Në disa raste ato tentojnë të rrethojnë gurët duke të krijuar përshtypjen e kluazonazhit. Intensiteti i përdorimit të qeramikës, përsa i përket vendosjes së saj, nuk është kudo i njëllojtë dhe uniformë. Sidoqoftë, kemi të bëjmë me imitimin e një teknike të vjetër tradicionale ose me vazhdimin e pandërprerë të saj, nëpërmjet grupesh të caktuara ndërtuesish. Të njëjtën teknikë e takojmë dhe në tamburin e minaresë së xhamisë, pranë kështjellës, jashtë mureve rrethuese, e cila duhet të këtë shërbyer kryesisht për garnizonin. Po këtë teknikë e gjejmë në Kështjellën e brendshme të Tepelenës, datuar në vitin 1492, si dhe në Manastirin e Kamenosë të 1580 etj. Karakteristikë për këtë teknikë ndërtimi është se ajo nuk vazhdon me të njëjtën intensitet dhe të njëjtën rregullsi në të gjithë sipërfaqen e murit, siç e takojmë për shembull në periudhën e tretë të ndërtimit në murin barrierë në Kalanë e Butrintit, që nuk duhet të jetë më i vonë se shek. XIV.

Kulla 1, në formë drejtkëndëshi, projektohet 6 m nga muri i rrethimit dhe ka një gjerësi ballore prej 7,20 m. Muret e saj kanë një gjerësi prej 1,60 m, me përjashtim të murit të brendshëm me trashësi 1.20 m. Ato janë përforcuar me breza druri me seksion drejtkëndësh rreth 0,15 x 0,15 m, por ndryshe nga kulla 2 brezat janë vendosur në thellësi të trashësisë së murit. Muret e kullës shkelin mbi murin rrethues, i cili vjen nga kulla 2 dhe është i lidhur



Fig. 12

DO NOT COPY

organikisht me këtë të fundit, gjë që të bind për ndërtimin e saj në një periudhë të mëvonshme. Njëkohësisht me kullën është ndërtuar një sterë drejtkëndëshe, e cila ka me të parën një mur të përbashkët. Stera, e mbuluar me qemere cilindrike, mblidhte ujërat e shiut nga çatia e kullës. Muri i brendshëm i sterës, nga ana e kalasë, është përforcuar me dy kontraforte. Në pamje të parë stera të jep përshtypjen e një ndërtimi më të vonë se kulla, sepse është rindërtuar, por po të vëresh me kujdes pjesën e poshtme të mureve, kuptohet, se ajo është projektuar bashkë me të. Një zgjidhje e tillë e sterës, ngjitur me kullën dhe jo brenda saj, është bërë se ndërtuesit nuk i kanë besuar mureve të kullës për presionin që do të krijonte uji i sterës, ose kanë dashur të përdorin katin përdhes të kullës për qëllime të tjera. Arsyeja e parë është më e pranueshme, për faktin e ndërtimit të kontraforteve në murin jugor të sterës, ndërsa nga ana veriore rolin e kontraforteve e luante vetë kulla.

Muri verior i kështjellës ka qenë shumë i dëmtuar në kohën kur u ndërtua kulla 1. Ne gjejmë gjurmë të kësaj periudhe në trakte të shkëputura rrafsh me tokën, ndërsa në anën lindore ai është spostuar më brenda duke u ndërtuar krejtësisht i ri.

Njëkohësisht me kullën 1 është rindërtuar një trakt muri në krahun jugor të hyrjes bashkë me paturën e kësaj ane. Pikërisht në këtë pjesë delikate të fortifikimit, e cila dëmtohet më lehtë, konstatojmë dhe një fazë tjetër ndërtimi, të përfaqësuar nga një teknikë, të cilën nuk e takojmë në vende të tjera, blloqe gurësh të vendosura në formë të çrregullt, por të niveluar në largësi të caktuara nga pllaka guri të holla horizontale, të ngjashme me ato të mureve dhe kullave të Kalasë së Kardhiqit teknikën e së cilës A. Baçe e përgjithëson për gjithë periudhën e dytë të ndërtimit dhe e konsideron si periudhën e fundit të ndërtimeve të kështjellës me formulimin e «barbakanit». Mbetet akoma për t'u përmendur se në bazamentet e kullës 2, përveç kontrafortit, i cili i takonte periudhës së ndërtimit të kullës, 1 dallohen dy periudha të tjera ndërtimi, të përfaqësuara nga dy mure të holla, që i mbështeten njëri-tjetrit. I jashtmi 50 cm dhe i brendshmi 40 cm (fig. 7). Këto dy faza ndërtimi i takojmë dhe në murin «barrier» (fig. 8), ku në të dy rastet i brendshmi është më i vonë. Të dyja këto faza i përkasin periudhës më të hershme mesjetare.

Si përfundim, mund të themi se periudha e parë e ndërtimit të kalasë i takon, me shumë gjasë, antikitetit të vonë, për të cilën të shtyn të mendosh jo vetëm traktit jugor me gjatësi 10 m, me një teknikë karakteristike për shek. IV të e.sonë, por më tepër dhe gjurmët e shkallëve të gdhendura në



Fig. 13

shkëmb të ndërprera nga muri më i hershëm mesjetar, tashmë i vërtetuar si i tillë.

Në periudhën më të hershme mesjetare, kalaja, përbëhej nga një mur i thjeshtë, pa kulla, që rrethonte majën e kodrës dhe një pjesë të shpatit verilindor të saj dhe ishte e pajisur nga një hyrje tangenciale, formuar nga dy skaje paralele të mureve rrethuese (fig. 9). Kjo kala ka patur dy faza ndërtimi, ndoshta me një distancë kohore jo të lar gët midis tyre, që konsiston në rritjen e trashësisë së murit rrethues deri në 1 m. Kjo periudhë ofro të dhëna të pakta dhe jo shumë të sigurta për da tim. Por nuk ka dyshim se ajo i takon periudhës pa ra pushtimit turk, pasi kjo kushtëzohet nga ndërti met e mëvonshme.

Të bën përshtypje trashësia e vogël e mureve të cilën nuk e hasim shpesh në kështjella të tjer mesjetare, si dhe forma eliptike dhe pa kulla e pla nimetrisë, që të kujton, duke përfshirë këtu dhe hyr

DO NOT COPY

jen, ndërtimet prehistorike, si dhe një kategori të caktuar të fortifikimeve të antikitetit të vonë, Përsa i përket trashësisë së mureve në gjejmë paralele në këtë krahinë vetëm në një Kullë të Butrintit (Kulla L), të cilën në bazë të kronologjisë relative dhe nga disa të dhëna të teknikës së ndërtimit e kemi datuar në periudhën e despotatit të Epirit, pra në fillim të shek. XIII[12].

Por, ndryshe nga kulla e lartpërmendur, në mu-

ret e kështjellës së kësaj periudhe nuk gjen përdorim materiali qeramik, karakteristik për periudhën e despotatit të Epirit në krahinat jugore të Shqipërisë. Atëhere do t'u referohemi shembujve territorialë më të largët, siç janë muret rrethuese të qyteteve të hershme mesjetare shqiptare në Shqipërinë Veriore, Sarda, Drishti, etj. Gjerësia e mureve të tyre, të datuara në shek. 9-10[13], luhatet rreth 1 m në një kohë



Fig. 14

12) Gj. Karaiskaj, **Butrinti dhe fortifikimet e tij,** Tiranë 1984, f. 94.
13) Qyteti shqiptar i Sardës, Lindja e qytetit mesjetar në Shqipërinë Veriore (Kumesë në Kongresin e XI të Arkeologjisë Kristiane, Lion Grenobël, Gjenevë, Aosta, ihtator 1986.

DO NOT COPY



Fig. 15

kur muret mbrojtëse të qyteteve apo vendbanimeve nuk ndryshonin tepër nga ato të ndërtesave të zakonshme. Në të njëjtin përfundim të çon forma planimetrike primitive e fortifikimit dhe e hyrjes së tij. Megjithatë, është vështirë të arrihet në një përfundim të prerë, pa të dhëna plotësuese datimi.

Menjëherë pas pushtimit, turqit, e kanë vlerësuar pozitën strategjike të Delvinës. Në vitin 1431 ajo bënte pjesë në Nahijen e Vajonetës dhe numëronte 60 shtëpi kryefamiljarësh. Kështu, ndoshta në kohën e fushatës së Bajazitit II, në këto krahina ata ndërtuan kullën 2 për artileri dhe rifortifikuan kështjellën. Periudha tjetër e rëndësishme, e përfaqësuar nga kulla 1 dhe muret që lidhen me të, krijoi një sistem të dyfishtë portash dhe duhet të jetë përfunduar para vizitës së Çelebiut, i cili e përmend kështjellën me dy porta hekuri. Kështu kjo periudhë datohet nga fundi i shek. XVI deri nga mesi i shek. XVII.

KËSHTJELLA E LËKURËSIT

Kështjella e Lëkurësit ndodhet mbi majën e një kodre të lartë, e cila ngrihet në formën e një piramideje në juglindje të qytetit të Sarandës. Në majë të kodrës mund të ngjitesh nga një rrugë e shtruar me kalldrëm, e cila fillon tek qafa e Gjashtës. Vende-vende rruga arrin gjerësinë 2 m dhe ndjek me pjerrësi të lehtë faqen perëndimore të kodrës. Kalaja ndodhet midis rrënojave të fshatit të Lëkurësit, të braktisur, sipas të dhënave gojore, para një shekulli. Prej saj hapet një pamje e gjerë nga të gjitha pikat e horizontit, por mbi të gjitha vrojtohet rruga nga Delvina për në Sarandë, e cila kalon nëpër qafën e Gjashtës, rrëzë kodrës së kalasë, si dhe rruga që të çon nga Saranda në Butrint. Duke sunduar gjirin dhe skelën e Sarandës, Kështjella e Lëkurësit, zë një pozitë shumë të rëndësishme strategjike.

Kështjella ka planimetri gati katrore, me përmasa 42 x 44 m, me dy kulla të rrumbullakëta, të vendosura në qoshen veriperëndimore dhe juglindore dhe një kullë drejtkëndëshe në murin perëndimor (fig. 13). Në gjendjen e sotme kështjella paraqitet e dëmtuar. Muri perëndimor, lindor dhe verior nuk e kalojnë lartësinë 2-3 m. Vetëm një pjesë e murit jugor ruhet në lartësinë e plotë (fig. 14). Nga jashtë ai ka lartësi 6,70 m. Muret e kështjellës qarkoheshin nga një parapet i përshkruar me frëngji. Frëngjitë në pjesën e sipërme, mbulohen me pllaka guri të vendosura horizontalisht. Muret janë ndërtuar me gurë gëlqerorë të vendosur në rreshta horizontalë e të lidhur me llaç. Po të vrojtosh në brendësi të tyre do të vëresh se gurët e mesit janë vendosur në të thatë dhe vetëm në faqet e murit është përdorur llaçi. Kjo teknikë konstatohet më tepër në pjesët e sipërme të mureve e sidomos në parapet.

Muret janë përforcuar edhe me breza druri. Brezat anësorë ndahen nga faqet e murit vetëm nga trashësia e një guri.

Nga kullat ruhet më mirë kulla e qoshes juglindore (fig. 15). Në gjendjen e sotme ajo ka një lartësi prej 7 m, që arrin në lartësinë e dyshemesë së katit të dytë. Kati i I i kullës, me planimetri rrethore formon, një mjedis të vetëm, me diametër të brendshëm 8 m dhe trashësi muresh 2 m. Ky mjedis mbulohet me një kupolë sferike, ndërtuar me gurë paralelopipedë të vendosur në rrathë koncentrikë, të cilët herë pas here ndërpriten nga gurë tërthorë, për të krijuar një lidhje më të mirë të strukturës. Mjedisi i katit I, nuk është i pajisur me dritare e frëngji dhe nuk komunikon drejtpërdrejt me katin e sipërm, por vetëm me oborrin e kështjellës. Kjo të bën të mendosh se katet e para të kullave rrethore, kanë shërbyer si depo. Mbi platformën e kateve të para, ngrihej, me sa duket, edhe një kat i dytë, i cili duhet të ketë qenë pajisur me frëngji për topa.

DO NOT COPY

Katet e dyta të kullave komunikojnë drejtpërdrejt me shtegun e rojeve që kalonte mbi mure.

Kulla katërkëndëshe në murin perëndimor del 3 m nga ky i fundit dhe ka një gjerësi prej 7 m. Ajo ruhet deri në lartësinë 2 m, për më tepër është e mbushur në anën e brendshme, aq sa nuk mund të matej as gjerësia e mureve. Nga pozicionet e vendosjes së kullave kuptohet se drejtimi i kontrollit të kështjellës ishte deti dhe rruga Sarandë-Butrint. Hyrja e vetme e kështjellës duhet të ketë qenë në murin lindor, sepse vetëm atje muri ndërpritet për një gjatësi rreth 10 m. Brenda murit rrethues, në këtë anë, është përfshirë dhe muri lindor i një kishe, e cila ka qenë pikturuar në teknikën e afreskut, në një kohë relativisht të vonë.

Është vështirë të japësh një mendim të saktë rreth kohës së ndërtimit dhe qëllimit të kësaj kështjelle, pasi asnjë burim historik nuk bën fjalë për të. Në regjistrat turke të viteve 1430-32, fshati Lëkurës përfshihej në vilajetin e Vajonetës dhe kishte 8 shtëpi që paguanin taksë. Kështjella nuk përmendet. Kështu, mbeten për t'u shqyrtuar kryesisht të dhënat e karakterit arkitektonik. Nga forma planimetrike, duket qartë se kemi të bëjmë me një kështjellë garnizoni, që mund të mbante rreth 200 ushtarë. Mospërmendja e kështjellës në regjistrat turke, por edhe një sërë të dhënash të tjera të karakterit teknik, forma shumë e rregullt gjeometrike, kupolat e mëdha sferike, të cilat mbulojnë kullat rrethore e përjashtojnë mundësinë e ndërtimit të saj para pushtimit turk. Zëvendësimi i murit të dhëmbëzuar me bedena nga një parapet i vazhduar me frëngji dhe së fundi pjerrësia e lehtë e mureve të kullave dhe kurtinave, pjerrësi që fillon nga pjesa e sipërme e tyre. Por krahas tipareve të përbashkëta me kështjella të periudhës turke gjatë shek. XV dhe fillimit të shek. XVI, siç janë forma e tyre katërkëndëshe, përmasat e vogla si dhe forma dhe vendosja e kullave, kemi vërejtur se në këto të fundit muret bien vertikalisht mbi terren dhe gjejnë përdorim bedenat qoftë dhe të përshkruara nga frëngjitë.

Po të krahasojmë Kështjellën e Lëkurësit me atë të Peqinit dhe Prezës, ndërtime të fundit të shek. XV ose fillimit të shek. XVI, do të vërejmë në të tri rastet, përveç kullave të rrumbullakëta, të vendosura në qoshe, këto kështjella kanë edhe nga një kullë drejtkëndëshe, me ballë të gjerë në njërin nga muret.

Nga ana tjetër, në Kështjellën e Lëkurësit, kullat e këndeve janë më masive dhe muret e tyre më të trasha se kurtinat, pasi duke qenë, në këtë rast, kullat, pikësynimi kryesor i sulmit apo i goditjes së kundërshtarit, nga që mbi to vendoseshin topat, duhet të ishin më rezistente.

Siç kuptohet nga të dhënat e mësipërme, Kështjella e Lëkurësit na paraqitet në një fazë më të zhvilluar në krahasim me Peqinin dhe Prezën. Një formulim të njëjtë planimetrik me Lëkurësin e takojmë te Kështjella e Gjon Boçarit në rrethin e Vlorës, e cila ka gjithashtu dy kulla në skajet e kundërta të katërkëndëshit. Kështjella e Gjon Boçarit, nga elementet e saj arkitektonike, ngjason me rrethimet mbrojtëse të manastireve të vendit tonë, datuar në gjysmën e dytë të shek. XVII.

Mbetet akoma për t'u shqyrtuar mundësia e ndërtimit të kësaj kështjelle në periudhën e sundimit të Ali Pashë Tepelenës. Por ne nuk gjejmë disa elemente, karakteristike për ndërtimet mbrojtëse të Ali Pashë Tepelenës, siç janë gurët e punuar në forma të rregullta katërkëndëshe, kornizat e gurta, të cilat kufizojnë pjesë të ndryshme arkitektonike, pjerrësia më e madhe e mureve në anën e jashtme, parapëlqimi i kullave poligonale etj.

Edhe frëngjitë që përshkojnë parapetin në mure nuk janë aq tipike për armë zjarri, ato janë më të mëdha se frëngjitë e përdorura në ndërtimet ushtarake të Ali Pashës.

Frëngji me përmasa thuajse të barabarta me ato të Lëkurësit, i ndeshim në disa ndërtime në Butrint, datuar në shek. XVII ose në fillim të shek. XVIII, por ndryshe nga këto të fundit, në Lëkurës mungojnë frëngjitë dyshe, tipike për përdorimin e armëve të zjarrit.

Kemi edhe një shembull për ta krahasuar Kështjellën e Lëkurësit, dhe pikërisht kalanë e quajtur «Zgur» në rrethin e Dibrës, e cila datohet me sak-



Fig. 16

DO NOT COPY



Fig. 17

tësi në mesin e shek. XVI. Ashtu si Lëkurësi ajo është e pajisur me dy kulla të vendosura në skajet e njërës nga diagonalet e drejtkëndëshit të formuar nga muret rrethuese.

Duke u nisur nga gjithë sa u tha më sipër për elementet arkitektonike dhe morfologjike të kësaj kështjelle, do të pranojmë si kohën më të mundshme për ndërtimin e saj periudhën që përfshin fushatën e Sulltan Sulejmanit në vitin 1537, kur turqit sulmuan Korfuzin. Qëllimi kryesor i saj ka qenë kontrolli i skelës së Sarandës, si dhe i rrugës Sarandë--Butrint, përderisa ky i fundit ishte në dorë të Venecianëve.

KALAJA E VRANISHTIT (Hora)

Në luginën e Shushicës, rreth 5 km në veri të fshatit Vranisht, ndodhet kalaja me të njëjtin emër, ky vend njihet dhe me emrin «Qyteti i Hores». Rruga nëpër luginën e Shushicës, duke u nisur nga Vlora ndjek drejtimin juglindje, prapa maleve të bregdetit dhe paralele me rrugën bregdetare. Nëpërmjet saj mund të arrish më shkurt në Borsh e për pasojë në Sarandë, duke evituar në këtë mënyrë qafën e Llogarasë dhe serpentina të tjera të rrugës bregdetare. E vetmja e përpjetë gjatë kësaj rruge ndodhet para hyrjes në Borsh (Sopot), i cili ndodhet rreth 40 km larg Vranishtit. Në vendin ku ndodhet kalaja, lugina e Shushicës, zgjerohet së tepërmi dhe të krijon përshtypjen e një amfiteatri të rrethuar nga male të larta. Nga perëndimi shtrihen malet e bregdetit me vargmalin e Çikës, ndërsa nga lindja mali i Bolenës. Zona është e pasur me gjurmë vendbanimesh të lashta, ndërsa nga mesjeta e vonë ruhen trakte të plota të një ujësjellësi, i cili e kalon përroin mbi një urë. Asnjë nga monumentet e mësipërme nuk



Fig. 18



Fig. 19

DO NOT COPY

përmendet në burimet historike, vetëm fshati Vranisht na del për herë të parë në regjistrin turk të vitit 1431-1432 me emrin Ivranisti.[14]

Kalaja është ndërtuar mbi një terren të sheshtë (fig. 16) dhe në planimetri ka formën e një pesëkëndëshi (fig. 17). Më mirë ruhet muri jugor, i cili nga ana e jashtme arrin lartësinë 1,5 m (fig. 18). Në mesin e këtij muri ruhet një kullë katërkëndëshe, e cila projektohet 3 m nga muri dhe ka një gjerësi prej 6 m. Trashësia e mureve të kullës 1,5 m është e barabartë me atë të mureve. Këndet e tjera janë pa kulla. Prej tyre këndi jugperëndimor përfundon në formë harku (fig. 19). Muri lindor përfshihet brenda ndërtesës së një stalle, ndërsa dyshkajet e këtij jane mjaft të dëmtuara, kështu që nuk mund të arrijmë në një përfundim të saktë për ekzistencën e kullave në këtë anë. Vetëm në këndin juglindor, jashtë ndërtesës së stallës, dallohen gjurmë muresh të harkuara, që mund t'i përaksin ndonjë kulle të rrumbullakët. Një kullë të rrumbullakët duhet të ketë patur dhe në skajin tjetër të këtij muri.

Muret janë ndërtuar me gurë kave të lidhur me llaç gëlqereje, të vendosura në rreshta pak a shumë horizontale (fig. 18). Ato përforcohen me breza druri me prerje drejtkëndëshe, të vendosura gjatësor e tërthor. Brezat me gjerësi prej 15 cm dhe lartësi 10 cm janë vendosur 15 cm larg faqes së jashtme të murit, që i përgjigjet trashësisë së një guri.

Përmasat modeste të kështjellës 48 x 40 m, si dhe ndërtimi i saj mbi një terren fare të sheshtë, pranë rrugës, tregon se kemi të bëjmë me një kështjellë garnizoni, për kontrollin e kësaj rruge me rëndësi strategjike. Mungesa e të dhënave burimore e vështirëson datimin e saktë të kësaj kështjelle, por forma e saj e rregullt, ndërtimi mbi një terren të sheshtë pranë rrugës, teknika e ndërtimit, prania e brezave të drurit, këndet e rrumbullakosura të mureve, përdorimi me kursim i kullave, si dhe kombinimi i kullave drejtkëndëshe në meset e mureve me ato rrethore në këndet, e datojnë këtë kështjellë në periudhën e hershme të pushtimit osman. Vetëm analiza e rrethanave historike mund të na çojë në një përfundim më konkret. Kështjella e Vranishtit lidhet me një sistem të tërë kështjellash, ndërtuar nga turqit në pastokën e Jonit, jo vetëm për të vendosur e konsoliduar sistemin e timareve, por dhe për të mbajtur nën kontroll krahinën e Himarës, zonë kryengritjesh të vazhdueshme dhe ku aërsia me Korfuzin prekte interesat e Venedikut, i cili kërkonte ta mbante në zotërim me çdo kusht. Pra koha më e mundshme e ndërtimit të saj është periudha e fushatës së sulltan Sulejmanit në vitin 1537.

Nga kështjellat e shqyrtuara, në këtë material gjurmët më të vjetra ruhen në Kështjellën e Delvinës, e cila për pasojë ka patur një jetë më të gjatë. Ajo zotëronte jo vetëm pellgun e Delvinës, por kontrollonte edhe rrugën pranë, që lidhte gjirin e Sarandës me luginën e Drinosit dhe nëpërmjet kësaj të fundit lidhej me qendra të tjera mesjetare, të cilat shtriheshin përgjatë kësaj lugine. Nga ana tjetër Delvina ndodhet në qendrën e një zone të pasur e pjellore ku kishin lulëzuar qendra të rëndësishme e qytete qysh në kohën antike, por një pjesë e madhe e tyre nuk kanë patur vazhdimësi në mesjetë nga që nuk plotësonin kushtet e kërkuara për këtë periudhë. Nuk është e rastit që menjëherë pas pushtimit osman pozita strategjike e Delvinës u vlerësua dhe ajo u kthye në qytet dhe qendër administrative e një zone të tërë (më vonë qendër pashallëku), ndërsa edhe fshatra të mëdha si Kamenica që në vitin 1431 numëronte, 267[15] shtëpi, e humbasin gradualisht rëndësinë e mëparshme. Zgjedhja e Delvinës si qendër ushtarake-administrative nga pushtuesit osmanë përputhet edhe me një parim tjetër, që do të vazhdojë edhe gjatë shek. XVI. Në atë që kështjellat e garnizoneve duhet të ishin aq larg nga bregu i detit sa t'i shmangeshin jo vetëm goditjes të drejtpërdrejtë nga artileria e anijeve, por edhe ndonjë sulmi të befasishëm nga deti që mund të vinte kryesisht nga Republika e Venedikut dhe i cili do t'i vinte midis dy zjarreve garnizonet osmane, nga njëra anë prej kryengritësve vendas dhe nga ana tjetër nga fuqitë perëndimore.

Pozita e tërhequr e Delvinës plotësonte si kushtet e karakterit ushtarak, ashtu dhe të administrimit të një krahine pjellore, por që ndahej nga krahinat e tjera nëpërmjet vargmalesh të larta, apo të kalueshme me vështirësi. Ndërtimet e fazës së kullës 2, që mund të datohen nga tipi i frëngjive për topa rreth fundit të shek. XV fillimi i shek. XVI, janë një dëshmi e rëndësishme strategjike e Delvinës, dhe e gjendjes aspak të favorshme të pushtuesit.

14) Fshati Vranisht përfshihej në Vilajetin e Kaninës, Nahija e Pelashit dhe kite 16 shtëpi të regjistruara që paguanin taksë. H. Inalçik Suret-i defter-i sancak-i vanid, Ankara 1954, f. 54.

15) A. Meksi, E. Riza, **Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës,** Monumentet 3, 1974, f. 139.

DO NOT COPY

Kjo gjëndje do t'i përgjigjet më tepër periudhës së fushatës ushtarake të Bajazitit II në 1492.

Kështjellat e tjera të përshkruara në këtë artikull me përjashtim të Kalasës nuk arrijnë rangun e një qendre të rëndësishme administrative-ushtarake. Ato shërbenin më tepër si qendra garnizonesh, të cilat ushtronin kontroll për vendosjen e sistemit të Timareve në krahinën që mbulonin.

Se deri ku është shtrirë veprimtaria ndërtimore e Bajazitit II në këto zona nuk mund të thuhet me siguri. Dihet nga burime të tërthorta, apo të drejtpërdrejta dokumentare, se ai u kujdes për fortifikimin e luginës së Vjosës, me ndërtimin e Kështjellës së Tepelenës dhe të Lopsit dhe me sa duket ka kryer ndërtime edhe në Delvinë, e cila ishte një qendër e rëndësishme administrative-ushtarake e krahinës.

Periudha e dytë e ndërtimeve ushtarake osmane, në këtë krahinë, duhet të lidhet sigurisht me fushatën e Sulltan Sulejmanit, i cili ndërtoi Kalanë e Vlorës, për ta patur si bazë ushtarake detare për zbarkimin në Pulje. Për të arritur qëllimet e mësipërme kërkohej një prapavijë e sigurtë. Pra një sistem kështjellash garnizoni në pastokën e Himarës ishte i nevojshëm jo vetëm për të nënshtruar krahinën e Kurveleshit, por për t'i ardhur në ndihmë garnizoneve osmane në bregdet, që ishin përqëndruar në Lëkurs dhe Borsh, në rast zbarkimi të ndonjë fuqie perëndimore, kryesisht të venecianëve, që shoqëroheshin me kryengritje të shqiptarëve të këtyre zonave kundër sundimit Osman.

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

FORTERESSES MEDIEVALES DE L'ALBANIE SUD-OCCIDENTALE

RESUME

Quatre forteresses médiévales situées sur la côte de l'Albanie Sud-Occidentale font l'objet d'étude du présent article. Celle de Lëkurasi, se trouve directement sur la côte ionienne alors que les autres situées un peu plus à l'intérieur du pays derrière la chaîne côtière, contrôlaient des routes ou des passages importants qui reliaient la côte avec l'intérieur du pays. A part cette liaison territorielle de caractère stratégique, d'autres circonstances historiques communes qui se rattachent à l'époque de la construction ou à l'une des plus importantes périodes de leur construction, nous poussent à les traiter ensemble. L'article est basé sur l'étude et le relèvement des restes architectoniques de ces monuments, sans faire appel aux fouilles ou aux sondages archéologiques. Trois des fortifications déjà mentionnées paraissent pour la première fois dans une édition scientifique, alors que pour la quatrième, celle de Delvine, étudiée déjà par A. Baçe on fournit quelques nouvelles données obtenues par les recherches notamment les phases de construction et leur datation.

Kalasa, comme forteresse, est mentionnée pour la première fois en 1581 sous le nom Kastell qui n'est que la variante latine de Kalasa, tandis que comme centre habité avec 74 habitations elle n'apparait que deux ans plus tard, en 1583, au régistre de Delvina. Tchelebi, qui la visita lors de son deuxième voyage en Albanie en 1670, nous en a laissé une description. Les murs de cette fortification en forme de pentagone d'un périmètre de 600 pas étaient entièrement en pierres. Ils renfermaient 7 habitations, un temple et un dépôt de vivres. Une porte en fer donnait accès à l'Est. Dans la forteresse étaient installés le Dizdar (commandant de la forteresse) avec environ 100 soldats.

La forteresse se situe sur une basse colline, à gauche du courant de la rivière de Kalasa. Les vieux ponts, composés d'un grand arc, qui enjambent cette rivière, ne sont pas mentionnés par Tchelebi. Les ponts reliaient les quartiers de la ville ainsi que la route qui venait de Delvina à celle qui traversait le col de Frashër.

Les murs d'enceinte s'adaptent au terrain toujours en lignes droites, tentant de créer une figure géométrique irrégulière qui s'approche à un quadrilatère (fig. 2) d'un perimètre de 270 m et d'une superficie de 1/2 ha. Par endroits, le mur se conserve à une hauteur de 4 à 6 m (fig. 3), mais dans sa plus grande partie il est rasé.

Trois des angles du pentagone ont été flanqués de tours. La tour I, est la seule tour circulaire de la forteresse. On en conserve les traces des murs latéraux d'une épaisseur de 1,5 m ainsi qu'un fragment du mur intérieur arqué d'où il ressort que le diamètre intérieur de la tour à dû être de 2,5 m (fig. 4). Les murs des courtines et des tours sont épais de 1,5-1,7 m. Pour la construction des murs on n'a pas utilisé de morceaux de briques ou de tuiles, ce qui rend plus difficile la distinction des phases de construction ainsi que la datation d'après l'appareil utilisé.

Près de la tour III, au mur oriental se situe l'entrée. L'état très endommagé dans lequel elle nous est parvenue, ne permet pas sa reconstitution. Au sommet de la colline on remarque les traces d'une construction réctangulaire aux dimensions intérieures 10 x 11 m et aux murs larges de 1.5 m. L'appareil de ces murs diffère de celui des autres constructions. Dans leur plus grande partie ils sont réalisés avec des pierres fluviatiles et seulement par endroits on distingue des pierres de carrière, L'épaisseur des murs démontre leur caractère défensif. Il est fort possible qu'on a à faire à une plus ancienne phase de la forteresse, à une tour isolée construite dans la partie dominante de la colline. On ne connait pas le rapport entre la tour II et la principale phase de la construction parce qu'on n'en conserve que la partie frontale où une jointure détache le mur qui va vers la tour II de celui qui vient de la tour III. L'absence des briques et des tuiles dans l'appareil des murs, les différentes formes des tours et surtout l'arrangement des tours cilyndriques avec celles quadrangulaires, l'épaisseur égale des murs des courtines et des tours, leurs dimensions modestes etc, nous rappellent des constructions fortifiées d'une période relativement récente qu'ont été faites construite par les féodaux du pays selon la commande de la Porte Sublime. La forteresse d'Ishmi construite en 1572-74, qui présente des traits communs à celle de Kalasa en est un exemple. Cela est renforcé aussi par l'absence du village Kalasa dans les régistres fiscaux ottomans du XVe et du début du XVe sc ainsi que par la nomination de ce village Kalaja (la forteresse), parait-il après la construction de celle-ci.

Si l'on se réfère aux événements historiques qui favorisè-

DO NOT COPY

rent des constructions militaires de ce type on pensera à l'expédition de Sultan Sulejman à cette région en 1537 durant laquelle ont été réalisées des constructions du genre des fortifications.

Afin de satisfaire à l'ancien rêve de ces prédécesseurs pour l'occupation de l'Italie, Sulejman Kanuni fit construire la forteresse de Vlora qui servirait de principale base militaire-maritime pour le débarquement à Pouille.

Dans de telles conditions il lui fallait une arrière garde solide, surtout à l'époque où la région de Himara s'était soulevée en insurrection générale en attaquant et ravageant les camps et les caravanes turcs.

La construction de tout un système de constructions dans ce but est témoigné également par un document de 1583 d'après lequel les habitants musulmans de Gjirokastra étaient chargés d'entretenir les forteresses construites récemment pour réprimer les insurrections de cette région. C'est dans cette région que faisait partie la forteresse de Kalasa. Si la qualification «construites récemment» ne se réfère pas à une période de plus de 40 ans, la forteresse a dû être construite vers l'années 1570 quand il fut créé une situation pareille à celle de l'année 1537, la guerre vénéto-turque et l'insurrection des albanais de la région de Bregu i Detit (côte maritime du Sud-Ouest). Quand même la période entre les années 1537-1570 fut la meilleure période possible de sa construction.

La forteresse de Delvina

La forteresse de Delvina é été étudiée par A. Baçe mais les recherches sur les restes de cette fortification apportèrent un nouveau panorama de l'évolution typologique de la forteresse et de nouvelles données quant aux périodes de construction et à leur datation.

Les murs d'enceinte contournent la plateforme d'une colline rocheuse longue de 60 m et large de 30 m. Même sur ce territoire plat se découpent par endroits quelques rochers. Le terrain limité nous amène à la conclusion qu'à l'origine il n'y avait qu'une petite forteresse qui jouait plutôt un rôle stratégique empêchant le passage qui reliait la région de Delvina et l'autre zone côtière à la vallée de Drinos. La forteresse en forme allongée orientée O-E, est flanquée de trois tours et d'une entrée donnant accès au nord (fig. 6). Le côté oriental de la forteresse, moins accidenté, est protégé de deux rangées de murs. Les murs méridional, occidental et partiellement celui septentrional, s'élèvent sur des rochers obrupts.

Vus de l'intérieur de la forteresse, les murs paraissent au ras de terre, mais ils revêtent les versants en pente de la colline en la protégeant à une hauteur de 2 à 7 m, alors que l'une des tours (2), à l'extérieur de la fortification atteind une hauteur de 10 m (fig. 7).

A part les petites réparations effectuées de temps en temps, la forteresse a connu quelques importantes périodes de construction. A. Baçe pense qu'il y a trois phases de construction et que leur nette précision et la définition de la chronologie relative ne sont possibles qu'au point K, où l'on distingue bien la section de la courtine qu'on ne peut pas suivre tout au long de l'enceinte. Du traitement ultérieur de ce problème il ressort que la tour II appartient à la première phase, la tour I à la deuxième phase et la tour III ainsi qu'un contrefort situé près de la tour II, à la troisième phase.

On dit que les débuts de la construction de la forteresse remontent aux XIe-XIIe sc, alors qu'elle conçoit sa complète physionomie aux XIIIe-XIVe sc.

Puisqu'au début les murs de la forteresse étaient assez minces, les périodes ultérieures ont visé à leur épaississement. Comme l'a déjà accentué A. Baçe, l'épaississement des murs s'effectua à l'intérieur de la forteresse, parce que les anciens murs s'élevaient à l'extrêmité rocheuse du terrain (fig. 8). Ce mode de construction nous rend facile la distinction de la première période de construction, à l'Est de la tour III près du point E. Cette période est réprésentée par un fragment de mur long de 10 m et haut de 3 m que l'on peut voir seulement de l'extérieur.

L'appareil de ce fragment de mur avec des pierres disposées en rangées horizontales, qu'on ne rencontre en aucune autre part de la forteresse, nous rappelle la première période de la forteresse d'Elbasan (IVe sc.a-.n.e.). Ce mur n'est pas pris en considération lors de la reconstruction de la forteresse au Moyen Age, ce qui montre qu'il se présentait assez endommagé. Pendant la première phase, la forteresse avait une forme elliptique sans tours, qui par la ligne des murs suivait le contour du terrain. Au nord, elle n'arrivait pas jusqu'à la deuxième enceinte. Quelques marches d'escalier gravées sur le rocher, coupés par le mur actuel, prouvent qu'autrefois il existait de ce côté une entrée (fig. 6). Tout de même il serait nécessaire d'effectuer quelques sondages archéologiques pour être convaincu de la présence d'une période si ancienne.

Pendant la deuxième période de construction, la forteresse gardait toujours une forme elliptique occupant une plus grande superficie et s'élargissant vers le Nord-Est (fig. 9). C'est à cette période qu'appartiennent l'entrée et un fragment de 12 m près de la tour III.

Les murs de cette période, d'une largeur de 70-90 cm sont d'un appareil en pierres de carrière empilées sans ordre et sans bandes de bois (fig. 10).

Plus tard (IIIe période) pendant l'occupation turque, furent construites deux tours (les tours II et III) ainsi qu'une deuxième enceinte intérieure à l'Est, dotant ce côté moins accidenté de la forteresse, d'une double défense (fig. 6). L'appareil de cette phase, en pierres de carrière disposées plus ou moins en assises n'utilise pas de morceaux de briques ou de tuiles (fig. 7). A cette époque furent reconstruits un fragment du mur extérieur aux points a-b et le côté septentrional de l'entrée. La largeur du mur d'enceinte est 1,20 m tandis que celle du mur de la tour II est 1,65 m. La tour II (fig. 7) est construite

DOI 10.2307/...

partiellement sur le mur de la deuxième phase de construction. Peut-être il était ruiné jusqu'au ras du niveau du terrain, ou on l'avait détruit à dessein pour faciliter la construction de la tour.

De l'extérieur, la tour se conserve à la hauteur de 10 m. La planimétrie a la forme d'un fer à cheval. Un blocage de pierres et de terre est utilisé pour l'élever au niveau de la place de la forteresse. Au-dessus de ce niveau s'élève le seul étage de la tour qui se conserve partiellement à une hauteur de 3 m. La pièce de cet étage était couverte d'une voûte cylindrique. Elle est munie de trois canonnières qui contrôlent de différentes directions. A cette période remonte également la tour III à l'Ouest de la forteresse, dont la forme de pentagone est en partie conditionnée par le soubassement rocheux du terrain.

La tour I ainsi que le mur qui y est lié au Nord correspondent à la quatrième période de construction. Le mur tourne vers l'Ouest créant un corridor, qui parcourt un chemin sinueux étant ainsi mieux contrôlé. Au mur septentrional de la forteresse, depuis l'entrée jusqu'au voisinage de la tour III, on distingue des traces de cette période. A cette époque furent reconstruits également une partie du mur méridional de l'entrée, l'embrasure de la porte et fut construit un contrefort, au soubassement de la tour II (fig. 7). On pense qu'à cette époque appartient aussi un dépôt souterrain couvert de voûte cylindrique (fig. 11).

L'appareil particulier de la quatrième période se distingue de celui de toute la période précédente. Au parement des murs sont utilisés des débris de tuiles introduits sans ordre parmi les pierres (fig. 12). On rencontre la même technique au tambour du minaret de la mosquée située tout près de la forteresse, en dehors de l'enceinte, qui a dû sevir à la garnison.

L'étude des différentes phases de construction nous amène à la conclusion que la première phase de la construction de la forteresse remonte à la basse Antiquité. Cela est témoigné par le fragment du mur, méridional conservé à une longueur de 10 m, dont l'appareil est caractéristique au IVe sc, ainsi que par les traces de l'escalier gravé sur le rocher qui sont traversées par le plus ancien mur médiéval, vérifié déjà comme tel.

Lors de la plus ancienne période médiévale la forteresse était composée d'un simple mur sans tours qui entourait le sommet de la colline et une partie de son versant N-E et elle était munie d'une entrée tangentielle formée des deux extrémités parallèles des enceintes. (fig. 9). Cette forteresse a connu deux phases de construction peut-être proches du point de vue temporel, qui consistaient à l'épaississement des murs d'enceinte jusqu'à 1 m. Cette période offre peu de données qui ne sont pas très sûres pour une datation. D'après les constructions ultérieures, elle remonte sans doute à l'époque avant l'occupation turque.

Tout de suite après l'occupation, les turcs apprécièrent la position stratégique de Delvina qui en 1431 faisait partie au «nahije» de Vajonet et comptait 60 maisons. Ainsi, peut être à l'époque de la campagne de Bayazid II, dans ces régions, ils construisirent pour l'artillerie la tour II que A. Baçe considère de la première période de construction en la datant du XIIe sc, et fortifièrent de nouveau la forteresse. Lors de l'autre période importante qui est représentée par la tour I et les murs qui s'y attachent, fut créé un double système de portes qui à dû être terminé avant la visite de Tchelebi qui mentionne une forteresse à deux portes en fer. Il s'agit donc de la période entre la fin du XVIe sc et le milieu du XVIIe sc.

La forteresse de Lëkurësi

La forteresse de Lëkuresi se situe au sommet d'une haute colline qui s'érige en pyramide au S-E de la ville de Saranda.

C'est une forteresse à planimétrie presque carrée aux dimensions 42x44 m, flanquée de deux tours circulaires aux coins N-O et S-E et une tour quadrangulaire au mur occidental (fig. 13). A l'heure actuelle, la forteresse se conserve assez endommagée. Les murs orintal, occidental et septentrional, ne dépassent pas la hauteur de 2 ou 3 m. Il n'y a qu'un fragment du mur méridional qui garde sa complète hauteur (fig. 14). (à l'extériur 6,70 m). Les murs de la forteresse sont entourés d'un parapet muni de meurtrières. L'entrée unique de la forteresse a dû percer le mur oriental puisqu'on y remarque une coupure du mur sur une longueur de 10 m. A l'intérieur de l'enceinte de ce côté est compris le mur oriental d'une église peinte à fresque pendant une période relativement récente.

Il est difficile d'avancer une juste opinion sur le but et l'époque de la construction de cette forteresse puisqu'on ne dispose d'aucune source historique. Selon les registres turcs des années 1430-32, le village Lëkurës qui était compris au vilajet de Vajonet avait 8 maison qui payaient les impôts. Ainsi, il ne reste à consulter que les données de caractère architectonique. La forme planimétrique nous induit à penser qu'il s'agit d'une forteresse de garnison qui pouvait abriter environ 200 soldats. Le fait que cette forteresse n'est pas mentionnée dans les registres turcs ainsi qu'une série d'autres données techniques, telles la forme géométrique irrégulière, les grandes coupoles sphériques qui surmontent les tours circulaires le mur en talus des tours et des courtines etc., excluent la possibilité de sa construction avant l'occupation turque. De pair aux traits communs de cette forteresse avec celle de la période turque au cours du XVe sc et au début du XVIe sc tels leur forme quadrangulaire, leurs petites dimensions ainsi que la forme et la disposition des tours on remarque que dans celle dernière, les murs tombent verticalement sur le terrain et les crénaux demeurent toujours utiles bien que quelques fois soient percés de meurtrières.

Si l'on compare la forteresse de Lëkurësi à celles de Peqin et de Preza, constructions de la fin du XVe sc et du début du XVIe sc, on remarquera qu'elle se présente à une phase plus avancée. On retrouve sa planimétrie dans la région de

DO NOT COPY

Vlora à la forteresse de Gjon Boçari dont les deux coins opposés du quadrangulaire sont flanqués de tours. La forteresse de Gjon Boçari, ressemble par ses éléments architectoniques aux encientes des monastères de notre pays qui datent de la deuxième moitié du XVIIe sc.

Il reste encore à étudier la possibilité de la construction de cette forteresse à l'époque d'Ali Pacha de Tepelena. On n'y trouve pas d'éléments caractéristiques aux constructions défensives d'Ali Pacha tels les pierres quadrangulaires bien équarries, les corniches en pierres qui contournent de différentes parties architectoniques, le talus accentué des murs à l'xetérieur, la préférence pour les tours polygonales etc. Même les meurtrières qui percent le parapet ne sont pas très typiques aux armes à feu, elles sont plus grandes que les meurtrières utilisées aux constructions militaires d'Ali Pacha.

On rencontre des meurtrières avec les dimension de celles de Lëkurës, aux constructions vénétiennes à Butrint, qui remontent au XVIIe sc. ou au début du XVIIIIe sc mais à la différence de celles-ci, à Lëkurës il n'y a pas de meurtrières double, si typique à l'utilisation des armes à feu.

On peut établir une comparaison entre la forteresse de Lëkurës et celle de la région de Dibra appelée «Zgur». D'après les sources historiques, celles-ci remonte au XVI-sc et comme la forteresse de Lëkurës est doté de deux tours qui flanquent les extrémités de l'une des diagonales du rectangle formé par les murs d'enceinte.

D'après ce qu'on a déjà dit sur les éléments architectoniques et morphologiques de cette forteresse, on doit accepter comme période possible de sa construction celle qui correspond à la campagne de Sultan Sulejman en 1537, quand les turcs attaquèrent Corfou. Par sa construction on a voulu mettre sous contrôle le quai de Saranda et la route qui reliait Saranda à Butrint puisque la ville de Butrint était aux mains des vénétiens.

La forteresse de Vranisht (Hora)

Dans la vallée de Shushica, à 5 km au nord du village Vranisht, se trouve la forteresse qui porte le même nom. On connait cet endroit aussi par le nom «la ville de Hore». La route le long de la vallée de Shushica, partant de Vlora, suit la direction S-E, derrière les montagnes, parallèlement à la route cotière. Elle amène plus vite à Borsh et par conséquent à Saranda, évitant de la sorte le col de Llogara et d'autres serpentines de la route côtière.

La forteresse à planimétrie en forme de pentagone s'érige sur un terrain plat (fig. 16). Le mur le mieux conservé est celui méridional, qui à l'extérieur atteind la hauteur de 1,5 m. Au milieu de ce mur se trouve une tour quadrangulaire large de 6 m qui se projette 3 m du mur (fig. 17). L'épaisseur de 1,5 m des murs de la tour est pareille à celle des autres murs. Les autres angles ne sont pas flanqués de tours et celui sud-occidental se termine en forme d'un arc. Le mur oriental s'introduit à une écurie tandis que ses deux extrémités étant très endommagées ne permettent pas une conclusion exacte sur l'existance des tours à ce côté. Seulement au coin S-E, en dehors de l'écurie se distinguent des traces de murs arqués qui ont dû apartenir à quelques tours circulaires. Même l'autre extrémité de ce mur a dû être flanqué d'une tour circulaire.

Les dimensions modestes de la forteresse 48x40 m, ainsi que sa position sur un terrain plat tout près de la rue, indiquent qu'il s'agit d'une forteresse de garnison qui servait à contrôler cette route d'importance stratégique. L'absence des données historiques rend difficile la datation précise de cette forteresse mais sa forme géométrique régulière, sa position sur un terrain plat tout près de la rue, l'appareil des murs, la présence des bandes de bois, les coins arqués des murs, l'utilisation épargnée des tours ainsi que la combinaison des tours rectangulaires au milieu des murs avec celles circulaires aux coins, remontent cette forteresse à l'ancienne période de l'occupation ottomane. Seulement l'analyse des circonstances historiques peut nous amener à une conclusion plus concrète. La forteresse de Vranisht est liée à tout un système de forteresses construites par les turcs dans la zone ionienne dans le but de consolider le système des timars et de tenir sous contrôle la région de Himara qui était une zone d'insurrections continuelles et où le voisinage au Corfou touchait aux intérêts de Venise qui tenait fort à avoir sous possession cette île. Donc la période la plus possible de sa construction est la période de la campagne de Sultan Sulejman, en 1537.

* * *

Des forteresses traitées dans ce matériel, les plus anciennes traces se conservent à celle de Delvina, qui par conséquent a connu une plus longue vie. Elle dominait la zone de Delvina et contrôlait la route qui passant tout près reliait le golfe de Saranda à la vallée de Drinos et par celle-ci communiquait avec d'autres centres médiévaux situés le long de cette vallée. D'autre part, Delvina se trouve au centre d'une zone riche et fertile où avaient fleuri d'importants centres et villes depuis l'époque antique mais ne répondant pas aux conditions exigées par cette époque, ils ont cessé d'exister au Moyen-Age. Ce n'est pas par hasard que tout de suite après l'occupation ottomane fut appréciée la position stratégique de Delvina. Elle dévint une ville et le centre administratif de toute une zone (plus tard le centre du pachalik) alors que les grands villages tel Kamenica qui comptait 1431 maisons, perdait graduellement la première importance. Le choix de Delvina au rôle du centre militaire et administratif par les occupants ottomans repose aussi sur un autre principe qu'on rencontrera même au cours du XVIe sc, celui que les forteresses des garnisons doivent se trouver si loin de la côte qu'elles puissent

éviter non seulement les tirs directs d'artillerie partant des navires mais également l'attaque éventuelle par la République de Venise qui mettrait entre deux feux les garnisons ottomanes, celui des insurgés du pays d'une part et celui des puissances occidentales de l'autre.

La poisition retirée de Delvina répondait bien tant aux conditions à caractère militaire qu'à celles à caractère administratif d'une région fertile séparée des autres régions par des chaines de hautes montagnes. Les constructions de la phase de la tour III qui d'après le type de canonnières remontent à la fin du XVIe sc sont un témoignage de l'importance stratégique de Delvina.

Les autres forteresses mentionnées dans cet article n'atteignent pas le rang d'un important centre administratif et militaire, même si dans quelques-unes sont conservées des traces de constructions avant-turques. Elles servaient plutôt de centres de garnison qui contrôlaient l'établissement du système des timars dans toute la région qu'elles dominaient.

On n'est pas sûr jusqu'où s'étend l'activité constructrice de Bayazid II dans ces zones. D'après les sources documentaires il prit soin de la fortification de la vallée de Vjosa, en y faisant construire la forteresse de Tepelena et de Sopes. Il parait qu'il a effectué des constructions même à Delvina en tant que centre administratif et militaire de la région à cette époque.

La deuxième période des constructions militaires ottomanes de cette région doit se rapporter certainement à la campagne de Sultan Sulejman qui fit construire la forteresse de Vlora laquelle lui servirait de base militaire maritime pour le débarquement à Pouille. Afin d'atteindre les dessins déjà mentionnés il lui fallait une arrière garde sûre. Donc, un système de forteresses de garnisons dans la région de Himara était utile non seulement pour soumettre la région de Kurvelesh mais aussi pour venir en aide aux garnisons ottomanes de la côte disloquées à Lëkuras et Borsh, en cas d'un débarquement éventuel d'une puissance occidentale, surtout venant de Venise, qui s'accompagnerait d'une insurrection des albanais de ces régions contre le joug ottoman.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Ylli DRISHTI
Adrian DEVOLLI

TEQEJA E DOLLMËS, PIKTURA MURORE DHE RESTAURIMI I SAJ

Qyteti i Krujës gjatë shek. të XIX dallohet në mënyrë të veçantë për përhapjen e sektit bektashi. Sipas një vlerësimi të ekzagjeruar lokal numri i këtyre teqeve dhe tyrbeve thuhet se ishte 366.[1]

Në ditët tona e plotë ruhet Teqeja e Dollmës, që ndodhet pranë skajit jugperëndimor të kalasë së Krujës. Ajo bie në sy nga çdo pikë e qytetit dhe njihet nga vendasit me emrin «Tabja e Dollmës»[2].

Në gjininë e faltoreve islamike ajo përfshihet në tipin e vogël monumental me kupolë. Mbi katër faqe muri të gurtë, nëpërmjet trompave kalohet në tamburin oktogonal, mbi të cilën ngrihet kupola e mbuluar me tjegulla vendi. (Fig. 1).

Teknika e ndërtimit është ajo me gurë të rrumbullakët, të lidhur me llaç gëlqere. Fasada kryesore, nga veriperëndimi, është ndërtuar me gurë të skuadruar, të vendosur në rreshta jo të rregullt. Dera e hyrjes dhe dy dritaret anash saj kornizohen nga bordura vertikale prej guri në formë konkave, të trajtuara në harmoni me konceptimin monumental të teqesë.

Interieri ndriçohet nga dymbëdhjetë dritare. Tri prej tyre, ato të faqes juglindore, janë të murosura. Në ballë ndodhet mihrabi dhe anash tij dy nike. Pjesa më e madhe e interierit është e pikturuar.

Datën e saktë të ndërtimit të Teqesë nuk e njohim, por nga një fragment mbishkrimi, pranë mihrabit lexohet data 1193 H (1779), pra ajo duhet t'i takojë gjysmës së parë të shek. XVIII (fig. 2). Në faqen jugperëndimore gjendet dhe një mbishkrim tje-



Fig. 1

1) Th. A. Ippen «Skutari und die nordalbanis che kunstenebene» Sarajevo, 1907, f. 70.
2) Stilian Adhami, «Monumentet» 1971/1, f. 88.

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

tër (fig. 3), prej të cilit mësohet se një mirëbërës, Adem Aga[3], ka kryer meremetime në kupolë, pasi ajo kishte qenë shembur. I biri, me rindërtimin e saj në vitin 1222 H, (1807)[4] ka financuar pikturimin. Kësaj periudhe rindërtimesh duket se i takon dhe murosja e tri dritareve, të cilat nga brenda janë të mbuluara me pikturë si kupola.

Piktura murore

Në pikturën e teqesë së Dollmës kemi të bëjmë me dy faza pikturimi. E para i takon vitit 1193 H (1179). Prej saj ka mbetur e pikturuar mihrabi, niket anësore dhe sipërfaqet midis tyre. E dyta, që i përket vitit 1222 H (1807), shtrihet në kupolë, në trompe, në pjesën e sipërme të mihrabit e nikeve, në faqet jugperëndimore, verilindore dhe veriperëndimore.

Piktura e fazës së parë paraqet stilizime floreale, ku çdo motiv del në pah i kornizuar me linjë të zezë. Koloriti është i përmbajtur, ngjyrat e përdorura, kryesisht janë: e kuqja, grija, e zeza dhe okra e artë.

Mihrabi kornizohet me shirita vertikalë të pikturuar. Dy prej tyre imitojnë pilastra me kapitele. Motivet përsëriten brenda çdo shiriti. Shiriti i parë është vetëm me ngjyrë, i dyti me motiv ornamental, kurse i treti ka motivin e gjethes së palmës së stilizuar. Shiriti i kaltërt, i pikturuar me ngjyrë okër të artë, në pjesën e sipërme zgjerohet sipas profilit të mihrabit. Ai është i zbukuruar me gonxhe karafilash bisht shkurtër, të vendosura në mënyrë të lirë, që kontrastojnë motivet e shiritave të tjera anësorë të pikturuar, simetrikisht. (fig. 4). Mihrabi, në pjesën e brendisë së nikes, është pikturuar me breza në gjerësi të ndryshme. Brezi i parë (duke filluar nga sipër), që është më i gjeri, ka motiv floreal, të ndarë me linjë dyshe të zezë në tri skena. Pas tij është një shirit ndarës. Brezi i dytë dhe i tretë kanë të pikturuar tufa të vogla lulesh në skena të veçanta. Brezi i katërt paraqet një bordurë ornamentale nëpërmjet përsëritjes së një motivi floreal të stilizuar. Më poshtë ruhet një fragment lutjeje fetare (fig. 5). Në të dy niket anësore, po këto motive, janë të vendosura në tri breza horizontale.

Piktura me kompozim simetrik shquhet për rea-

3) Adem Aga është i varrosur pranë teqesë, në anën e pasme të saj. Sipas gurit të varrit (fig. 5) teksti i plotë i tij është si më poshtë:

Viti 1198(1783-1784)/Ai është fajfalësi i mëshirshëm/Ky është viti i vdekjes/së Adem Agës/Toptanit, – që e ka vendin në parajsë, bir/ i Ibrahim Agait, bir/i Ali Bej Krutanit/Qoftë mbi ata mëshirë e zotit/«Mbishkrime të Monumenteve turko-arabë».

Përkthim: V. Buharaja. Dosja A. III 435. – Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë.

4) V. Buharaja, **Po aty.**

lizim grafik koloristik. Motivet anësore të shiritave kornizues, kalojnë gradualisht në tone më të buta në sfondin ngjyrë okër të artë, të ngacmuar lehtë me pikturimin e lirshëm të gonxheve të karafilave. Në sfondin e artë ato errësohen mjaft dhe duken si të zeza.

Në pikturën e fazës së dytë, motivet e stilizuara në pikturën e kupolës, të trajtuara me forma të mëdha, rrinë në harmoni plastike me vetë zgjidhjen e saj. Në të ndërmjet hapësirave të motiveve të vendosura në mënyrë asimetrikë, vërejmë natyra të qeta; vazo me lule, tufa lulesh e hurma arabie (fig. 6).

Trajtimi i natyrave të qeta ka tendencë drejt një imazhi realist, megjithatë ato duken pjesë e pandarë e kornizimeve të mëdha ornamentale të stilizuara. Për të rritur përshtypjen e lartësisë dhe për të krijuar një dallim ndërmjet sallës dhe kupolës është pikturuar një brez dekorativ floreal me motivin e gjethes së palmës së stilizuar, që përsëritet ritmikisht.

Në përgjithësi koloriti i kësaj pikture është i kursyer. Në paletën e saj, të përbërë kryesisht nga e kuqja e pjekur dhe e zeza, që kornizon motivet e pikturuar në sfondin e bardhë, bën pjesë edhe grija, si ngjyrë ndërmjetëse. Me anë të saj pikturohen motive të ndryshme, të cilat në raportet koloristike me ngjyrat bazë japin nuancat e jeshiles së përmbajtur, me tingull origjinal. Piktura, vendosur mbi një sfond të bardhë në të thyer, i jep interierit mjaft dritë në imazhin e një tantelle. Sipër mihrabit, në trompat, mbi shiritat kornizues të nikeve, motivet ornamentale shoqërohen me tufa lulesh të pikturuara gjithmonë në tonalitetet e shumta të ngjyrës gri (fig. 4). Në veçanti, spikat në skenën qendrore mbi kornizën e mihrabit, një draperi e shpalosur, e cila nxjerr në pah motivin floreal në qendër. Piktura murore e faqes juglindore, që shtrihet në dy nike me harqe të verbëra, përmban një mbishkrim arab me sipërfaqe 2 m². Edhe këtu dallohet motivi floreal, i shoqëruar me natyra të qeta me fruta (fig. 7).



Fig. 4

Natyrat e qeta kornizohen, si tek mihrabi, nga një perde e pikturuar me ngjyrë të kuqe. Në faqen veriperëndimore motivet floreale shtrihen sipër derës dhe dritareve (fig. 8). Shiritat kornizuese të dritareve dhe derës, në pjesën e sipërme, nuk mbarojnë më me tufa lulesh si në faqet e tjera, por pikturohen me gjethe të stilizuara. Sipër derës, i rrethuar nga këto motive, është pikturuar, peisazhi i vetëm. Ai paraqet një xhami me pesë kupola dhe dy minare (fig. 9).

Faqja verilindore është më e varfër në pikturë. Ajo ka të pikturuar vetëm pjesët anësore dhe të

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5

sipërmes të nikes së pjesës së poshtme (fig. 10).

Piktura e teqesë së Dollmës, vepër e dy autorëve të ndryshëm, ruan një unitet kompozicional dhe një kolorit të ngrohtë në të kuqërremtë, ku bie në sy ngjyra e kuqe e pjekur. Piktori i dytë, i cili realizoi pikturën në vitin 1222 H (1807), ka ruajtur harmoninë plastike dhe koloristike të piktorit paraardhës, duke u mbështetur në stilin e tij. Megjithatë, ai operon me një siguri dhe elegancë, duke na dhënë sidomos për kupolën, përshtypjen e një pikture të krijuar me një frymë.

GJENDJA E PIKTURËS PARA RESTAURIMIT

Pas studimit historiko-teknik të monumentit dëmtimet e pikturës murore u diferencuan në tri grupe të veçanta.

1) Prishje të shkaktuara nga lagështia (faqja juglindore i ekspozohet rreshjeve të shoqëruara me erë).

2) Prishje të shkaktuara nga dëmtimet e strukturës së monumentit (tërmete, cedime etj).

3) Prishje të shkaktuara nga materialet e përdorura në ndërhyrjet e mëparshme konservuese.

1 – Lagështia ka depërtuar në monument prej çarjeve në kupolë dhe ekspozimit të murit juglindor ndaj shirave. Ajo kishte krijuar dëmtime të shtratit piktural, kripëra në formë velature dhe kristalore. Në kupolë (fig. 11), në faqen juglindore (fig. 12) dhe jugperëndimore (fig. 13), ishin krijuar edhe xhepa ajri e rënie të pelikulit të ngjyrës.

Në faqen juglindore kemi shtegtimin e kripërave të tretshme në ujë dhe rikristalizimin e tyre, duke shkaktuar zgavrime të intonakos. Ky dëmtim është ndihmuar dhe nga kondensimi në stinën e verës. Si rezultat janë gërryer në formë zgavrash shiritat anësore të mihrabit, pjesa e sipërme e tij dhe niket anësore (fig. 14,1)[5]. Të kësaj natyre janë dëmtimi i shtratit pikturor nën harqet e faqes jugperëndimore. Në disa raste është shkëputur dhe ka rënë piktura



Fig. 6

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 14

te të dyja niket, në dritaret e faqes veriperëndimore dhe në niken e faqes verilindore.

2. Në kupolë vërejmë tri çarje kryesore të mëdha. Çarjet vazhdojnë në faqen juglindore duke përshkuar qendrën e mihrabit. Një çarje tjetër zbret në faqen jugperëndimore deri tek harqet e piktu-

ruara. Gjerësia dhe thellësia e këtyre çarjeve ishte më e madhe në pjesën e kupolës, që varionte nga 4 – 8 cm gjerësi dhe thellësi sa gjithë gjerësia e murit (çarja e nikes në anën e djathtë të mihrabit) (fig. 16).

3. I kësaj natyre ishte mbulimi i pikturës mu-

DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 16



Fig. 17



Fig. 18

rore, anash çarjeve të kupolës, shkaktuar nga pllombimet e restaurime të mëparshme.[5] (fig. 17, 18). Në rrethana të panjohura është dëmtuar nga lyerjet me llaç – çimento piktura në faqen jugperëndimore

5) Këto pllombime janë kryer para krijimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, dmth para vitit 1965.

dhe juglindore. Gjithashtu, lyerjet me sherbet gëlqereje kishin mbuluar gjithë patinën origjinale dhe në ndonjë rast edhe pikturën murore. Nga tymi i qirinjve dhe pluhurat e depërtuara nga dritaret e dëmtuara ishte krijuar një velo e lehtë gri mbi të gjithë sipërfaqen.

Nga dritaret origjinale ruheshin disa fragmente fare të vogla të xhamave me ngjyrë të kuqe, blu dhe të verdhë.

Për të stabilizuar gjendjen e pikturës murore u morën këto masa konservimi – restaurimi:

1. Konsolidimi i pikturës së shkëputur nga suporti.
2. Çlirimi i pikturës nga pllombimet e vjetra të kryera me gëlqere, nga mbulimet me llaç çimento, si dhe pastrimi nga lyerjet me sherbet gëlqere.
3. Pllombime të reja në çarjet dhe pjesët munguese të pikturës.
4. Trajtimi i pikturës nga kripërat dhe pastrimi i pikturës.
5. Fiksimi përfundimtar i pikturës.

1. Konsolidimi i pjesëve të pikturës së shkëputur nga suporti. – Shkëputja e pikturës është kryesisht në formë xhepash të mbushura me ajër. Në vendet ku ato takonin çarjet e murit u përdor injektimi i drejtpërdrejtë i kazeatit të gëlqeres (10%) të përmirësuar me acetat polivinili (10%) dhe fenol (3-5 pika). (Në vendet ku nuk përdorej injekme shpime në pjesën e sipërme të xhepit. Mbushja timi i drejtpërdrejtë u ndoq procedura e injektimit me preparatin e sipërm u krye me shiringë dhe dardhë llastiku me presion (foto 18).

2. Çlirimi i pikturës nga pllombimet e vjetra të kryera me gëlqere dhe me llaç çimento, si dhe pastrimi nga lyerjet me shërbet gëlqere.

– Pllombimet e vjetra prej llaç gëlqereje, kryesisht në kupolë, kishin mbuluar sipërfaqe të mëdha pikture, por megjithatë nuk kishin krijuar lidhje të forta me patinën e pikturuar. Prandaj u vendos çlirimi me mjete mekanike (bisturi e shpatulla). Nga heqja e llaçit të gëlqeres u vu re se piktura ruhej në gjendje të mirë, veçse kishte nevojë për pastrim. Procesi i pastrimit u krye në fund të punimeve.

Pllombimet me llaç çimentoje ishin bërë në faqen jugperëndimore. Edhe aty u përdor heqja e ngadaltë me bisturi[6], duke i holluar në mënyrë progresive shtresat e mbivëna. Procesi u ndërpre në shtre-



Fig. 19



Fig. 20

6) Për heqjen e çimentos u eksperimentua freza elektrike, e cila nuk dha rezultatin e dëshiruar. Ajo largonte vetëm shtresat me pak çimento dhe shumë gëlqere,por edhe këto të pakontrolluara.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 21



Fig. 23

sën e fundit të çimentos, pasi vazhdimi më tej shkaktonte heqjen e pikturës (fig. 19).

Një ndërhyrje masive, për krejt brendinë, ishte largimi i shtresës së gëlqeres, dhënë në formë sherbeti. Vende-vende ai kish mbuluar edhe dekoracionin në faqen veriperëndimore. Largimi i tij u realizua me njomje të sipërfaqes me ujë të pijshëm dhe pas saj me kruarje mekanike, deri në daljen e patinës origjinale.

3. Pllombime të reja në çarjet dhe pjesët munguese të pikturës. Këto punime paraqiteshin të nevojshme në aspektin konstruktiv dhe estetik, prandaj u vendos kryerja e tyre me një material lidhës, i cili duhej të kishte aftësi ngjitëse, mbushëse dhe ngjyrë të afrueshme me pikturën. Për këtë qëllim u eksperimentua dhe u përdor përzierja e gëlqeres karbonate me pluhur guri nga zona përreth, i cili realizonte fortësinë dhe ngjyrën e kërkuar. Pllombimet u kryen në thellësi të çarjeve, duke patur ndaj



Fig. 22



Fig. 24



Fig. 25



Fig. 27

sipërfaqes së pikturës një disnivel prej 2-3 mm (fig. 20, 21).

4. Trajtimi i pikturës nga kripëzimet

Eleminimi i kripërave paraqitej problemi më delikat i ndërhyrjes konservuese e pastruese, pasi ato shfaqeshin në formë velature dhe kristalore (fig. 22). Në të dy rastet, nga analizat[7] rezultoi se përmbajtja e tyre ishte me bazë kalciumi. Për heqjen e kripërave në formë velature u përdorën kompresa të njomura me pastë (brumë letre), të vendosura mbi sipërfaqen e kripëzuar. Sipas rastit, kur ishte përfunduar njomja e kërkuar, me spatula druri, hiqej pasta së bashku me kripërat. Sipërfaqja e pastruar terrej me kompresa të thata.

Për eleminimin e kriprave kristalore, që nuk ishte e mundur të treteshin u përdor largimi me



Fig. 26



Fig. 28

7) Analizat kimike u kryen nga M. Beçin me metodën e Floureshencës së rrezeve X në laboratorin e Institutit të Fizikës Bërthamore në Tiranë. Rezultatet e analizave janë paraqitur në pasqyrën përkatëse. (fig. 23).

DO NOT COPY



Fig. 29

bisturi i kombinuar, sipas rastit, me njomje uji të distiluar, siç rekomandohej nga literatura[8]. Me përfundimin e këtyre punimeve monumenti u la 2 vjet pa ndërhyrje. Mbi të s'pati kripëzime të reja, prandaj u vendos trajtimi përfundimtar i pikturës.

Fillimisht u vendos të kryhej pastrimi i krejt brendisë së pikturuar. Për të ishte i nevojshëm përcaktimi i metodës dhe preparateve të pastrimit. U identifikua përbërja kimike e ngjyrave dhe teknika e pikturimit (afresk + aseko) (fig. 24,25,26). Piktura është realizuar me dy shtresa nga të cilat arriçio me trashësi 2 – 2,5 cm dhe intonakoja tepër e hollë por e lidhur me të. Në kompozimet e së zezës ngjyra qëndronte sipër intonakos. Në këtë mënyrë preparati më i përdorshëm mbetej përzierja e alkoolit me amoniak në raportin 1 : 1. Pas provave në disa pjesë të pikturave (në kupolë në faqen juglindore, në mbishkrimin e fazës së parë dhe të dytë) rezultoi që tretësira ishte e përshtatshme (Fig. 27). Me të u trajtua e gjithë sipërfaqja me tampone të vegjël pambuku hidrofil duke lënë pa prekur vetëm ngjyrën e zezë. Gjatë trajtimit në faqen juglindore, u vu re delikatesa e ngjyrës së kuqe, e cila si dhe e zeza u fiksua me paraloid B-72. Së fundi, me paraloib B-72 u fiksua krejt sipërfaqja e pikturës.

Përveç këtyre punimeve u pa i nevojshëm edhe plotësimi i brendisë, me dritare ornamentale, sipas një modeli të rikompozuar stilistikisht. (fig. 28).

Në përfundim themi se punimet konservuese dhe restauruese në brendinë e teqesë së Dollmës kanë bërë të mundur një rivlerësim të plotë të monumentit. Ato kanë lejuar pamjen e pikturës në tërësinë e saj kompozicionale dhe në vlerat e plota piktorike, duke e kthyer ndërtesën në objekt të vizitueshëm të qytetit të Krujës[9].

DO NOT COPY

8) Paolo et Lama Mora et Paul Philippot «La conservation des Peintures murales» f. 342

9) Skicat grafike janë nga A. Drazhi, fotot nga Zamir Marika, Naim Kasapi dhe nga autorët.

DO NOT COPY

Ylli DRISHTI
Adrian DEVOLLI

LE TEKKE DE DOLLMA, LA PEINTURE MURALE ET SA RESTAURATION

RESUME

La ville de Kruja au cours du XIXe sc se distingue de façon particulière pour la propagation de la secte «bektachi». Selon une donnée locale exagérée, les «tekkes» et les «turbes» étaient au nombre de 366.

Le tekke de Dollma, situé au coin sud-occidental de la forteresse, est parvenu à nos jours entièrement conservé.

Dans le genre des temples, il est compris aux petites constructions du type monumental avec coupole couverte de tuiles.

Les murs sont en pierres rondes, liées au mortier de chaux. La façade principale, celle à N-O, est construite en pierres équarries, disposées en rangées irrégulières.

L'éclairage est assuré par douze fenêtres dont trois, celles de la face sud-orientale, sont murées. En face se trouve le mirhab flanqué de deux niches. La plus grande partie de l'intérieur est peinte.

On ne connaît pas la date exacte de la construction du tekke mais un fragment d'inscription près du mihrab indique la plus ancienne date, l'année 1193 H (1779), donc il doit dater du XVIIIe sc. Sur la face sud-occidentale se distingue une autre inscription indiquant les noms de ceux qui ont investi pour la reconstruction et la peinture en 1222 H (1807).

Il paraît qu'à cette époque de reconstruction appartienne aussi le murage des trois fenêtres dont la face intérieure est peinte.

Il s'agit de deux phases de peinture dont la première remonte à 1193 H (1779). Il en reste la peinture du mihrab, des niches latérales et du fragment du mur qu'elles limitent. Les peintures de la coupole, des trompes dans la partie supérieure du mihrab et des niches, des faces S-O, N-E et N-O, appartiennent à la deuxième période qui remonte à l'année 1222 H. (1807).

La peinture de la première phase présente des stylisations florales où chaque motif est corniché d'une ligne noire. Les couleurs utilisées sont: le rouge, le gris, le noir et l'ocre doré. Le mihrab est corniché de bandes de pinture verticales. Il se distingue par une composition symétrique et une réalisation graphique colorée.

Les motifs stylisés de la peinture de la coupole, appartenant à la deuxième phase de la peinture, sont traités en grandes dimensions. La peinture appliquée sur un fond blanc cassé donne assez de lumière à l'intérieur. Au-dessus du mihrab, aux trompes, aux corniches des niches etc, les motifs ornamentaux sont accompagnés de bouquets de fleurs peints en de différentes tonalités du gris. Au-dessus de la porte, entouré de motifs ornamentaux se distingue l'unique paysage de l'édifice qui représente une mosquée avec cinq coupoles et deux minarets. Dans la face N-E la plus pauvre en peinture, sont peintes seulement les parties latérales et supérieure de la niche.

La peinture du tekke de Dollma, l'oeuvre de deux auteurs anonymes présente une unité compositionnelle et un coloris où se distingue le rouge. Le deuxième peintre (1222 H – 1807) qui a su garder l'harmonie plastique et le coloris du peintre précédent en s'appuyant sur son style a opéré avec assurance et élégance.

Les dégâts qu'ont subis les peintures murales, sont différenciés en trois groupes et sont dûs:

1) à l'humidité

2) à l'endommagement de la structure du monument (tremblement de terre etc).

3) aux matériaux utilisés lors des précédentes interventions de conservation.

Afin de conserver la peinture, furent prises les mesures suivantes:

1) L'enlèvement des anciens plombages et badigeons à la chaux et au ciment.

2) Les nouveaux plombages effectués aux lézardes et aux lacunes de la peinture.

3) L'enlèvement des sels.

4) Le nettoyage de toute la peinture et son fixage définitif.

En conclusion, nous pouvons dire que les travaux de conservation et de restauration ont permis une lecture complète de la peinture du point de vue compositionnel et pictural et ont rendu le monument accessible.

DO NOT COPY

Leonard SULI

BANESA POPULLORE E ZONËS SË VURGUT DHE MURSISË+

Ky artikull ka për qëllim kryesor paraqitjen e tipologjisë dhe të arkitekturës së banesës populloré të zonave të Vurgut dhe Mursisë, si dhe vënien në dukje të disa ndërtimeve të gjinive të tjera, të cilat mund të shërbejnë për studime të mëtejshme. Materiali është mbledhur, kryesisht, gjatë katër ekspeditave të kryera nga Instituti i Monumenteve të Kulturës[1]. Dhënia e arkitekturës së trashëguar, të dy zonave njëherësh, është e mundur se banesat populloré afrojnë me njëra – tjetrën për faktin se marrëdhëniet ekonomike shoqërore, si faktori kryesor në zhvillimin e arkitekturës, kanë qenë pothuajse të barabarta.

Zona e Vurgut kufizohet nga veriu me Rrëzomën e Delvinës, nga verilindja me zonën e Theollogos (Partizani), nga perëndimi me detin Jon, kurse nga jugu me zonën e Konispolit dhe të Mursisë, e cila në pjesën jugore të saj kufizohet me Greqinë (fig. 1). Zonat që po studiojmë shtrihen në territorin e quajtur pellgu i Delvinës. Kjo pjesë e pellgut është rrethuar nga ana veriperëndimore me Malin e Kostarit, të Koqinolitharit të Kazanjes, pjesërisht nga jugu me Malin e Saraqinit dhe të Milesë. Në veri të fushës së Vurgut ndodhet fusha e Nivicë – Bubarit dhe e Rrëzomës. Nga ana jugperëndimore, është e hapur dhe përfundon në liqenin e Butrintit. Malet e mbrojnë këtë territor nga erërat. Ndonëse kjo pjesë e pellgut është fushore, kryesisht në mesin e tij, lartësohen disa kodra të grupuara, mbi të cilat ngrihen fshatrat e zonave në studim. Zona e Mursisë ka marrë emrin nga vetë fshati Mursi. Në administratë e kudo Vurgu njihet me emrin «Vurgu i Delvinës». Emri Vurg rrjedh nga greqishtja e re «vurgos» që do të thotë moçalishte, vend i ulët, i mbushur me mushkonja. Në ndarjen krahinore të vendit tonë zona e Vurgut dhe e Mursisë bëjnë pjesë në njësinë etnografike të Labërisë.[2] Territori i tyre ka qenë i banuar qysh në lashtësi, për faktin se ai ndodhet në mesin e trekëndëshit që formohet po të bashkohen tri qytetet e Ilirisë së Jugut, Buthrot (Butrinti), Foinik (Finiq) dhe Onhezmin (Saranda). Gjetjet arkeologjike[3] dhe të dhënat e shumta historike vërtetojnë zhvillimin e jetës në mënyrë të vazhdueshme, nga lashtësia e deri më sot. Në mesjetë përmendet qyteti i Mesopotamit[4],

+ Rilevimet janë të S. Terezit, F. Zarshatit, H. Savës, A. Drazhit, K. Qatipit, fotot të autorit, vizatimet të S. Terezit.

1) Fshatrat Mursi, Xarë, Vrinë, Vagalat, Kallogjer, Sopik (të zonës së Mursisë) dhe fshatrat Metoq, Gjashtë, Vrion, Vromera (Bregas), Shijon (Blerimas), Karahaxh (Pemas), Finiq, Mesopotam, Velshovë, Krane, Livini, Allrasave, Imerefende (Fitore), Memoraq, Rumanxa, Navaricë, Kulluricë, Pllakë, Qenari, Jermë, Tremul, Çaush, Çukë, Aliko, Hajderaga (Lefter Talo), Karalibej, (Fanor) dhe Rahullë të zonës së Vurgut u gjurmuan kryesisht gjatë ekspeditave të kryera në vitet 1977-1978, por materiali u pasurua me të dhëna të marra edhe gjatë viteve 1981 – 1983.

2) Rr. Zojzi, **Ndarja krahinore e popullit shqiptar,** Etnografia Shqiptare, Nr. 1, Tiranë 1968, f. 64.

3) Dh. Budina, **Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe e Pellgut të Delvinës,** Iliria 1, Tiranë 1971, f. 275 – 328.

4) Burime të zgjedhura të Historisë së Shqipërisë, Vol. II, Tiranë 1962, f. 163.

DO NOT COPY



Fig. 1

që lë të kuptosh se përreth tij ka pasur fshatra, të cilat furnizonin qytetin me prodhime bujqësore dhe blektorale. Regjistrat osmanë të shekujve XV, XVI, XVII, si dhe burimet e tjera historike të periudhave të mëvonshme, japin të dhëna në lidhje me qënijen e fshatrave, numrin e banesave etj.

Nga burimet historike osmane të shek. XV Vurgu njihet me emërin «Vurgos Ovasi»[5] (fusha e Vurgut), me këtë emër fusha njihet edhe sot, si nga vendasit, ashtu dhe nga banorët e rrethinave fqinje. Duke pasur parasysh pasqyrën[6] (fig. 2) e mësipërme si dhe të dhënat e marra kryesisht në terren, numri i banesave ka ardhur duke u shtuar, por kjo shtesë është e vogël për zona me një numër relativisht të madh fshatrash, si p.sh. zona e Vurgut. Në këtë zonë mjaft fshatra janë ndërtuar në shek. XVIII, XIX dhe në fillim të shek. XX[7] Popullsia e dy zonave është marrë me bujqësi dhe blektori. Bujqësia ishte dega kryesore e ekonomisë, ndërsa brektoria degë ndihmëse. Kryesisht këtu mbaheshin qe, lopë, kuaj dhe më pak dhenë ose dhi. Përgjithësisht, fshatrat e dy zonave, kanë qenë fshatra çifçinjsh (ku bujqit e merrnin tokën me qira nga feudalët, bejlerët, apo agallarët duke u dhënë atyre një të tretën e prodhimit), por më të shumtën e rasteve i jepnin gjysmën e prodhimit. Edhe banesa përdhese ndërtuar me material të dobët ishte pronë e feudalëve. Në fshatrat çifçinjë kishte dhe shtresa të popullsisë që kishin tokën dhe shtëpinë e tyre, të

5) Halil Inalçik, Suret-i defter-i, Arvanid, Ankara, 1952, f. 3.

6) Për hartimin e pasqyrës së mësipërme janë shfrytëzuar disa burime. Për numrin e banesave të regjistruara në vitin 1432-33 është shfrytëzuar vepra, **Burime të zgjedhura të historisë së Shqipërisë,** Vep. cit, f. 240-243. Për të dhënat e tjera ka shërbyer studimi i S. Shkurtit, **Vurgu, vështrim etnografik** (Monografi), Tiranë 1987 (I cili ka shfrytëzuar Livi defter-i Delvinë «Tabu e kadastra» (për vitet 1506-1520, 1583) i ndodhur në Institutin e Historisë, Aravantinou, P.: **«Kronografia tis Epirou»,** Athinë 1856, f. 356-362, (për vitin 1852) L. Mile: **«Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit** f. 156-163, (Për vitin 1878) 1978, f. 157 – 160, nga T. Selenica Shqipëria më 1923 (për vitin 1923).

7) Të moshuar tregojnë se fshati Vrion ka qenë pronë e Omer Bej Vrionit, i cili jo vetëm e krijoi (duke sjellë familjet e para), por i dha dhe emrin e tij. Fshati Çukë është krijuar në vitin 1879, mbas prishjes së Lëkurësit. Fshati Metoq dhe Rahullë janë krijuar në çerekun e parë të shek. XX.

ndërtuar me gurë. Zakonisht këta banorë përfaqësonin shtresën e pasur dhe të mesme të popullsisë. Fshatra si Navarica, Ardhosova, Livina, Sopiku, Vagalati, etj. ishin fshatra të lirë. Bujku kishte tokën dhe shtëpinë e tij. Në fshatrat çifçinjë pazari bëhej në natyrë në qendër të fshatit. Nuk mungonin rastet kur banorët e Vurgut dhe të Mursisë merrnin pjesë në tregtimin dhe shkëmbimin e produkteve në pazaret e Konispolit dhe të Delvinës, e cila është qendër e rëndësishme zejtaro-tregtare e gjithë sanxhakut të saj,[8] në të cilën bënin pjesë zona e Gjirokastrës dhe krahina e Çamërisë[9]. Ndërsa në çerekun e dytë të shek. XVIII Delvina ishte pashallëk[10]. Rregullimi i marrëdhënjeve midis familjeve ose fiseve për çështje të ndryshme bëhej nga kryepleqësia. Në fshatrat e Vurgut dhe të Mursisë të drejtat zakonore zhvilloheshin duke u bazuar në shatrin e Idriz Sulit.

Gjatë ekspeditave gjurmuese u vërejt se kasollja, e cila përdorej përpara Çlirimit të vendit për banim nga bujku çifçi, pothuajse, ishte zhdukur. Megjithatë, u gjetën disa shembuj, të cilët përdoreshin për futjen e bagëtive dhe veglave bujqësore. Ato me disa ndryshime të vogla (si mungesa e suvatimit etj) ruanin formën dhe teknikën e kasolleve, që përpara çlirimit përdoreshin për banim. Gjithashtu dhe mjaft banesa të ndërtuara me gurë kishin pësuar transformime për shkaqet e njohura të ndryshimit të mënyrës së jetesës nga rendi socialist. Megjithatë nga trashëgimia ndërtimore e këtyre zonave, nga materiali i grumbulluar në terren, është e mundur të krijohet një kuadër i kënaqshëm i mënyrës së vendosjes së vendbanimeve, organizimit të tyre, tipologjisë dhe arkitekturës së banesave popullore. Vendosja e vendbanimeve dhe organizimi i tyre nuk është i njëjtë për të gjithë fshatrat. Fshatrat janë ndërtuar në pjerrësitë e kodrave ose në lartësitë e tyre, jo vetëm për të kursyer tokën bujqësore, por edhe për t'iu shmangur sadopak rrezikut të infektimit nga malarja, që karakterizonte zonën e Vurgut në të kaluarën. Përgjithësisht fshatrat e zonës së Vurgut janë orientuar nga ana e fushës së Vurgut, kurse ato të Mursisë nga ana e fushës së Mursisë. Para Çlirimit ekzistonin dy mënyra të organizimit të lagjeve të fshatit, të orientimit të vetë banesave, si dhe të llojit të rrugëve. Mënyra e parë i përkiste kryesisht fshatrave çifçinje të Vurgut, të cilat janë ngritur kryesisht mbi kodra të ulëta dhe niveli i organizimit të fshatit është shumë

Nr	Fshati	Viti 1431-Banesa	1432 Familje	1506 Familje	1520 Familje	1583 Familje	1852 Banesa	1878 Banesa	1923 Banesa
1	Finiq	56	48	168	134	359	20		44
2	Mesopotam	24							
3	Jermë	17	16				16		
4	Livinë	14							
5	Kranë		22	13	19	4	15		38
6	Sopik	I braktisur							
7	Arllasovë	II							
8	Karahaxh						8		20
9	Ymerefende						16		20
10	Çukë							10	58
11	Aliko						32		46
12	Tremul						10		7
13	Çaush						13		30
14	Vrion						24	25	36
15	Vromero						5		7
16	Qenurjo						13		12
17	Hajderaga						4	20	19
18	Karalibej						7	5	34
19	Kalive Pasha						20		

Fig. 2

8) Z. Shkodra, **Esnafet Shqiptarë,** Tiranë 1973, f. 295
9) Historia e Shqipërisë, Vol. I, Tiranë 1959, f. 337.
10) Historia e Shqipërisë, **Vep.cit,** f. 422.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

më i ulët se ai i fshatrave të lirë. Si shembull të vendosjes së ndërtimeve të fshatit çifçi kemi marrë fshatin Vrion (fig. 3). Fshati përbëhej nga disa lagje të quajtura nga vendasit mëhalla. Ato mbanin emërin e beut që zotëronte lagjen (banesat ishin pronë e beut). Pranë banesave me orientim nga fusha e Vurgut ngrihej kasollja. Në oborr gjendej zakonisht furra e pjekjes, një mullar bari, një koçek misri, si dhe nyja sanitare. Këto ndërtime qarkoheshin me gardh (Tab. II). Pjesën e përparme e zinte oborri, kurse në pjesën mbrapa banesës ishte kopshti i perimeve. Banesat lidheshin me njëra-tjetrën me rrugë të ngushta këmbësorësh. Rrugët që lidhnin lagjet ishin pak më të gjera. Në mes të fshatit kalonte një rrugë jo e drejtë, e pasistemuar, ku përveç stinës së verës, kalimi i këmbësorëve vështirësohej shumë nga balta e madhe. Në qendër të fshatit ngrihej kulla e beut (i cili rrinte në fshat kryesisht në stinën e verës), banesa e qehajait, e kryeplakut, priftit dhe e banorëve të tjerë, që i përkisnin shtresës së pasur dhe të mesme. Jo shumë larg qendrës ngrihej kisha e Shën Mamandies, ndërtuar në vitin 1888 (fig. 4). Kisha e tipit bazilikë një nefshe, është realizuar me dy hyrje, një nga faqja e ngushtë dhe tjetra nga faqja e gjerë. Pranë kishës gjendej shkolla fetare (fig. 5). Shumë fshatra të Vurgut kishin kishën e tyre. Në Kulluricë gjendej kisha e Shën Mërisë, kishë një nefshe e paraprirë nga hajati dhe e



Fig. 5



Fig. 6

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

pajisur me këmbanore, ndërtuar në vitin 1780 (fig. 6). Në ndërtimet popullore të fshatrave çifçinjë bënin pjesë dhe çezmat. Njërën prej këtyre ndërtimeve përfaqëson dhe çesmja e ndërtuar në fshatin Pllakë, në vitin 1903 (fig. 7), e cila quhej nga vendasit «Çesmja e Memush Beut». Në fshatrat e Vurgut ka pasur disa ura të ndërtuara në periudhën e Ali pashë Tepelenës. Njëra prej tyre, e përbërë nga një hark i vetëm (fig. 8), gjindet afër fshatit Hajderaga (Lefter Talo). Mënyrën e dytë, më të avancuar, përsa i përket organizimit të ndërtimeve në fshat, vendosjes së lagjeve, orientimit të banesave dhe llojit të rrugëve e vërejmë në fshatrat e lira si Livina, Navarica, Arllasova, Sopiku, Vagalati etj. Si shembull të këtij organizimi po marrim fshatin Vagalat. Lagjet janë të formuara nga banesa të ndërtuara me gurë, përgjithësisht dykatëshe. Në sipërfaqet e pjerrëta është praktikuar ndërtimi i banesës me gjysmëkat. Banesat ndërtuar jo shumë larg njëra-tjetrës qarkohen me mure rrethuese jo shumë të larta dhe janë të pajisura me portë oborri dyflegërshe, të mbuluar me hark prej guri (fig. 9). Pamja kryesore e banesës është vendosur paralel me rrugën. Lagjet, që mbajnë emërin e fiseve, lidhen me rrugë të shtruara me kalldrëm (fig. 10). Në qendër të fshatit gjendej kisha e vjetër njënefshe e Ajllonatos. Sot ajo është në gjendje



Fig. 9



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

rrënojë, por mund të dallohet konturi i planimetrisë, si dhe pamja nga ana e absidës (fig. 11). Meqenëse kisha e vjetër nuk është rindërtuar më, në fillim të shek. XX u ngrit kisha e re e Ajllonatos. Kisha e tipit bazilikë njënefshe u ndërtua me përmasa më të mëdha se e vjetra (fig. 12). Ashtu si tek fshatrat çifçinjë dhe në fshatrat e lira ngriheshin çesma. E tillë është çesma e Korvunit (fig. 13), në fshatin Velahovë. Në këto fshatra nuk mungojnë dhe mullinjtë e drithit, siç është ai i ndërtuar në fshatin Navaricë, i quajtur nga banorët mulliri i Koxhavos (fig. 14). Shkëmbimi i produkteve bujqësore e blektorale bëhej kryesisht në pazaret e fshatrave, por duke qenë se fshatarët e lirë ishin shumë më në gjendje se bujqit çifçinjë, në shumë raste pazarin e bënin dhe në qendrat tregtare siç është pazari i Delvinës dhe ai i Konispolit.

Klasifikimi tipologjik dhe trajtimi arkitektonik i banesave të trashëguara

Ashtu si në rrethinat e tjera të rrethit të Sarandës dhe në rrethinën e Vurgut dhe të Mursisë, kushtet ekonomike dhe diferencimi klasor i popullsisë ka ndikuar shumë në veprimtarinë ndërtimore të trashëguar. Diferencimi klasor pasqyrohet qartë në kompozimin e banesës popullore. Banesa e dy zonave në studim paraqitet në variante të shumëllojshme, që është banesa përdhese njëkthinëshe, banesa përdhese dykthinëshe, banesa me gjysmëkat, banesa me kat. Varianti më i zhvilluar i gjetur në këto zona është ai me zhvillim në një krah. Nuk mungojnë rastet e shembujve të banesave të mbyllura me tipare qytetare.

Banesa përdhese njëkthinëshe

Banesa përdhese njëkthinëshe nuk pati përhapje të gjerë. Atë e gjejmë kryesisht në fshatrat çif-



Fig. 13

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 16

çinje të Vurgut[11]. Kjo banesë e ndërtuar me material të dobët, i cili nuk rezistonte më shumë se plesëmbëdhjetë vjetë, quhej nga vendasit kasolle. Mbas Çlirimit të vendit nuk u përdor më për banim, por shërbeu vetëm për futjen e bagëtive. Ky variant është paraqitur në tab. I (varianti i parë). Banesa kishte një derë në faqen e ngushtë dhe vatrën në pjesën ballore të mjedisit. (fig. 15). Në këtë fshat gjetëm dhe një shembull të banesës një kthinëshe, të ndërtuar me gurë në vitin 1910 (fig. 16). Elementi më kryesor i mjedisit është oxhaku, që ka formën e katërkëndëshit këndrejtë. Mjedisi nuk ka tavan dhe si dysheme shërben trualli natyror.



Fig. 15



Fig. 17

11) Nga të dhënat e më të moshuarve mësuan se për të banuar në kasolle fshatari ose trashëgimtarët e tij duhet t'i jepnin beut qera të përvjetshme, një sasi të konsiderueshme drithi. Këto bënin që në kasolle të banonin shumë persona në mënyrë që të mos bëhej e domosdoshme ngritja e një kasolle të dytë. Këto banesa ishin me lagështirë, që nuk largohej asnjëherë dhe kushtet higjenike ishin të këqia. Pajisjet dhe orenditë ishin të thjeshta. Përdhe shtroheshin 1 – 3 rrogoza. Kishte 2 ose 3 velenxa për t'u mbuluar, një ose dy syndyqe, ku vinin rrobat nuset. Çdo banesë kishte sofrën, dhe dybekun e qumështit dhe atë të «zhveshjes së orizit». Familjarët, të mëdhenj e të vegjël hanin së bashku, ulur këmbëkryq rreth sofrës.



Fig. 18

Banesa përdhese dykthinëshe

Përhapja e kësaj banese ka qenë më e madhe meqë ndërtohej nga shtresat e varfëra. Edhe banesa përdhese dykthinëshe ndërtohej me material të dobët. Njëra prej kthinave shërbente për banim, ndërsa tjetra për futjen e bagëtive dhe veglave bujqësore. (tab. I, varianti i dytë). Shembull i ngjashëm me këtë lloj banese përfaqëson kasollja për bagëtitë, gjetur në fshatin Karahaxh (fig. 17). Më tej, kjo banesë evoluon në drejtim të zhvillimit planimetrik e të dy kthinat ndahen me një korridor të ngushtë (tab. II, varianti i tretë). Banesa e bujkut çifçi ndriçohej dhe ajrosej nga një ose dy dritare të ndërtuara në brinjën e gjatë. Ushqimet mbaheshin mbi lesa druri të ngritura nga toka, kurse misri kalli vendosej në lesa druri ndën çatinë e banesës. Në rastin kur familja e bujkut çifçi shtohej shumë, pranë banesës, ngrihej kasollja për kafshët (Tab. II). Banesa përdhese dykthinëshe me gurë u përhap gjerësisht sidomos në fillim të shek. XX. Ajo ndërtohej nga shtresat e varfra, të mesme dhe nga fshatarë të varfër, por të lirë. Mbas Çlirimit të vendit ajo nuk parapëlqehej shumë. Variantin më të zhvilluar të kësaj banese, ndërtuar në vitin 1935, e gjetëm në fshatin Karahaxh (pemës) (fig. 18, Tab. IV). Banesa ngrihet me tre këmbë shkallë, ndërtuar në mesin e pamjes kryesore. Parahyrja në këtë shembull është pjesërisht e mbuluar. Në shembujt e tjerë çatia zgjatet dhe mbahet mbi 4 shtylla. Kjo mbulesë quhet nga vendasit podhe. Nga parahyrja, nëpërmjet hyrjes dy kanatëshe, kalohet te korridori me funksion ndërlidhës për odën e zjarrit dhe për odën e miqve. Në vazhdim të tij ndodhet një kthinë e vogël e quajtur «Kamar», e cila përdorej për gatim (në këtë rast dhoma më e mirë përdorej vetëm për pritjen e miqve), ose si dhomë e vogël për të fjetur çifti i ri. Jeta familjare zhvillohet kryesisht në odën e zjarrit. Në këtë mjedis gatuhej, hahej dhe flinin pleqtë e fëmijët e rritur. Në mesin e faqes së ngushtë, përkundrejtë hyrjes, ndodhet oxhaku me vatrën. Tamburi i tij prej guri, ka formën e katërkëndëshit këndrejtë. Në mure ka dollapë muri për mbajtjen e enëve. Të dy mjedisët të shtruara me dërrasa janë të suvatuara dhe të pajisura me tavane dërrase. Tavani i odës së miqve, në mes, ka një rozetë të thjeshtë. Ndriçimi i mjedisit të miqve është i bollshëm. Pamja kryesore është e orientuar nga juglindja. Këtë pamje, në të dy anët e hyrjes, në mënyrë simetrike, e thyejnë hapësirat e një çifti dritaresh. Pjesa e sipërme e muraturës, kufizohet nga një kornizë prej guri të punuar. Pranë banesës ndodhej kasollja e bagëtive, e cila ka pothuajse po atë formë të banesave të bujkut çifçi. Nyja sanitare ndodhet në oborrin e banesës, në pjesën fundore të tij.

Banesa me gjysmëkat

Si në mbarë vendin dhe në fshatrat e zonës së Vurgut dhe të Mursisë gjendet banesa me gjysmëkat. Ndërtuar kryesisht në terrene të pjerrëta të fshatrave kodrinore, banesa me gjysmëkat, bëhet një strehë e sigurtë, si për njerëzit, që tashmë banojnë në katin e sipërm, ashtu dhe për kafshët, që futen



Fig. 19

DO NOT COPY

në brendësi, në pjesën e poshtme të saj. Magjëria (mjedisi i gatimit) dhe sidomos vatra mbështetej mbi truallin natyror. Në këtë mënyrë banesa siguronej përgjithësisht nga rreziku i djegjes që mund të vinte nga magjëria. Në disa raste trualli i padjeçëm është krijuar artificialisht. (banesa në Vrion, ab. XIV). Këtë mënyrë sigurimi nga zjarri e kemi akuar dhe në disa fshatra të Rrëzomës së Delvinës[12]. Një prej shembujve të banesës me gjysmëkat gjindet në fshatin Vromero (Bregas). Banesa është ndërtuar mbi një terren të pjerrët, që lartësohet nga ana verilindore (Tab. V). Katin përdhes e zë një mjedis i vetëm, katoi për futjen e kafshëve. Hyrja për në katua realizohet nëpërmjet derës së vendosur në pamjen kryesore të orientuar nga lindja. Përmbi katua ngrihet oda e miqve. Në vazhdim të odës së miqve ndodhet magjëria. Secili mjedis i katit të sipërm ka hyrje të veçantë nga jashtë. Në murin tërthor është ndërtuar dera, që lejon ndërlidhjen e brendshme në mes dy mjediseve. Në faqen ballore të magjërisë ndodhet vatra dhe oxhaku me tambur prej guri, me formën e një katërkëndëshi këndrejtë. Dyshemeja e këtij mjedisi formohet nga shtresa natyrore e dheut. Oda e miqve, ose siç thirret nga vetë banorët oda, është mjedisi më paraqitës i banesës. Në faqen ballore ka të ndërtuar oxhakun, kamaret për vendosjen e pajisjeve të kafesë dhe dritaret, që i japin ndriçim dhe ajrim të mjaftueshëm. Dyshemeja është prej dërrase të punuar, dhe muret janë të suvatuar. Mjedisi ka tavan dërrase të formës së thjeshtë, në mesin e të cilit ndodhet një rozetë. Ndër pamjet e banesës më e arrira nga ana arkitektonike është pamja lindore.

Shembull tjetër i banesës me gjysmëkat gjendet në fshatin Sopik, mbi një terren të pjerrët shkëmbor, i cili lartësohet nga veriperëndimi (fig. 19, Tab. VI). Banesa është ndërtuar në dy periudha. Fazës së parë i përket pjesa me gjysmëkat, që përmban katoin në katin përdhes dhe odanë dhe magjërinë në katin e parë. Kjo pjesë e banesës është ndërtuar rreth vitit 1870. Rreth vitit 1900 është ndërtuar volumi dykatësh nga ana e pamjes kryesore të banesës së vjetër. Në këtë mënyrë u krijua një ndërtim në të cilin bashkëjetojnë pjesa e vjetër me pjesën e re. Planimetria e ndërtimit në katin e parë ka formën e shkronjës T. Ndërtimi i ri, në katin përdhes, ka dy katoj për vendosjen e kafshëve. Ndërlidhja e banesës së vjetër me katoin bëhet duke kaluar fillimisht nga katoi i pjesës shtesë, pastaj kalohet ndën qemerin e shkallëve të banesës së vjetër. Shkallët e banesës dyrampëshe prej guri, të çojnë në korridorin e katit të parë, i cili ka funksion ndërlidhës për të tri mjediset, duke përfshirë këtu dhe divanin e pjesës shtesë. Ndryshime kanë pësuar dhe mjediset e banesës së vjetër. Fillimisht ato ishin pa tavan, por me ndryshimet e bëra në mënyrën e re të jetesës lindi nevoja për ndërtimin e tyre. Ndërtimi i ri ndikoi pozitivisht në drejtim të anës funksionale të katit të parë, u shtua divani, parahyrja e shkallëve, u mbyll dhe u rrit ndjeshëm vlera e pamjeve të banesës, sidomos e pamjes kryesore, ku shihen lëvizje të harmonishme volumesh.



Fig. 20



Fig. 21

12) L. Suli, **Arkitektura e banesës popullore në Rrëzomën e Delvinës,** Monumentet, Tiranë 1986, f. 132.

PHOTOCOPY

DO NOT COPY

Banesa me kat

Në fshatrat e dy zonave është shumë e përhapur banesa me kat. Atë e gjejmë nga varianti më i thjeshtë, me një mjedis për secilin kat, deri tek banesa me zhvillim në një krah. Shembujt më të arrirë të banesës me kat, përsa i përket kompozimit planimetriko-volumor dhe trajtimit të elementeve të veçanta konstruktivo-arkitektonike gjenden të datuara. Në fshatin Mursi gjetëm një banesë me kat, ndërtuar në fund të shek. XIX. Banesa prej guri, trikatëshe, e quajtur nga vendasit kulla e beut, përdorej kryesisht në stinën e verës. Në planimetri banesa ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë (fig. 20, Tab. VII). Katin përdhe e zë katoi, në të cilin gjindeshin fillimisht shkallët që të lidhnin me manxaton e katit të dytë me lartësi të vogël. Në këtë kat viheshin zahiretë e dimrit. Në katin e dytë, në faqen e ngushtë, orientuar nga jugu, në një periudhë të dytë, është krijuar një parahyrje. Ngjitja në të bëhej, me shkallë të brendshme prej druri. Në katin e sipërm, që është më i paraqitshmi i banesës, pritej miku. Oxhaku ndërtohej në faqen e gjerë. Mjedisi ndriçohej nga dritare të vogla. Në të katër qoshet gjenden frëngji për qitje me pushkë. Nga kjo kullë kontrollohej pothuajse më tepër se gjysma e fshatit.

Në fshatin Rumanxa, në vitin 1915, në një terren thuajse të sheshtë, është ndërtuar një banesë dykatëshe. Secili kat përbëhet nga një mjedis (fig. 21, Tab. VIII). Kati përdhes ka shërbyer për gatim, sepse në faqen e ngushtë, kundrejtë derës së hyrjes, ndodhet oxhaku. E veçantë në këtë mjedis është kompozimi i elementeve në mënyrë simetrike kundrejtë aksit gjatësor, që kalon në mes të oxhakut. Muret janë të suvatuara. Oda në lartësinë 1,8 m, qarkohej me sergjen dërrase, në të cilin vendoseshin pajisje shtëpiake. Në krahasim me banesën e mësipërme, niveli i teknikës së ndërtimit dhe aftësia mbrojtëse këtu është shumë më e ulët.

Shembull tjetër i banesës me një mjedis për çdo kat, është një banesë në Vagalat, ndërtuar në fund të shek. XIX (fig. 22. Tab. IX). Edhe kjo banesë njihet me emrin kulla e beut. Ajo ngrihet në krye të fshatit, në një terren të pjerrët shkëmbor, i cili lartësohet kryesisht nga ana jugore. Në këtë anë ndodhet dhe hyrja për në katin e sipërm të kullës. Kati përdhes shtruar me rrasa guri, ka shërbyer si katua. Kulla e beut të Vagalatit është më e fortifikuar përsa i përket pasjes së shumë frëngjive pothuajse në katër anët e mureve perimetrale. Kati përdhes



Fig. 22

është i mbuluar me qemer cilindrik me hark gjysmë rrethor. Në këtë kat ndodhet dhe një derë e murosur në faqen e ngushtë, nga e cila kalohej tek një strehim nëntokësor i fshehtë. Mjedisi i katit të sipërmë është i ndriçuar mirë, i suvatuar dhe i pajisur me tavan dërrase, ka dysheme të shtruar me pllaka guri.

Ashtu si në krahina të tjera të vendit, zgjidhja e mënyrës së strehimit në rastin e shtimit të familjes, bëhet kryesisht në dy mënyra. Mënyra e parë: ndërtimit të vjetër i bashkangjitej një ndërtim i ri. Mënyra e dytë: njëri prej mjediseve të katit përdhe përshtatej për banim. Mënyra e parë të çon në krijimin e skemave më të zhvilluara, siç është rasti i banesës me zhvillim në një krah, apo asaj me zhvillim në dy krahë. Këtë e kemi hasur dhe në krahinën e Rrëzomës, në veri të zonës së Vurgut.[13] Banesa e ndërtuar në fshatin Finiq është një shembull i mënyrës së parë të ndërtimit, e problemit me rastin e shtimit të familjes (Tab. X). Shembulli në shqyrtim përbëhet nga dy faza ndërtimi. Fazës së parë i përket banesa e vjetër, ndërtuar në fillim të shek. XX, me dy kthina për secilin kat. Qënja e oxhakut në kthinën e parë të katit përdhes të le të kuptosh se ky mjedis në raste të veçanta është përdorur dhe për

13) L. Suli, **Artikull i cituar,** f. 119.

DO NOT COPY



Fig. 23



Fig. 24

gatim. Nëpërmjet mjedisit të parë kalohet tek katoi i katit përdhes, i cili është krejtësisht i errët. Në katin e sipërm të çojnë një palë shkallë prej guri. Nga korridori kalohet dhe tek një odë me përmasa të vogla, që shërbente për fjetjen e çiftit të ri. Nga ana lindore bllokut të vjetër i është mbështetur një volum dykatësh. Kjo shtesë është bërë në vitin 1925. Komunikimi me secilin kat të ndërtimit të ri bëhet i veçantë, nga jashtë. Të dy ndërtimet së bashku na japin një konfiguracion planimetrik me formën e shkronjës L. Një banesë dykatëshe me vlera nga ana kompozicionale ndodhet në fshatin Mursi (Tab. XI). Banesa e datuar, i përket vitit 1891. Duke e krahasuar me banesën e vjetër të shembullit në Finiq, banesa në shqyrtim përsa i përket kompozimit, përgjithësisht është më e arritur. Kati përdhes gjatë kohës ka pësuar disa ndryshime. Fillimisht, kati përdhes përbëhej nga një mjedis i vetëm, por gjatë kohës ai është ndarë. Në mjedisin e majtë janë hapur dritare, dera e hyrjes dhe oxhaku, duke e kthyer më vonë këtë pjesë të katit përdhes, në një mjedis banimi. Tek parahyrja e katit të banuar të çojnë shkallët njërampëshe prej guri. Dyshemeja prej rrasash guri e parahyrjes mbështetet mbi qemerin cilindrik me hark gjysmë rrethor. Magjëria dhe oda e miqve në vazhdim kanë hyrje të veçanta nga jashtë, por nuk mungon dhe ndërlidhja e brendshme në mes dy mjediseve. Magjëria ka pasur dhe furrë pjekje. Me kohë furra është dëmtuar. Ndër pamjet, më e arritura në drejtim të trajtimit të elementeve konstruktivo-arkitektonike është pamja kryesore, e orientuar nga ana jugore.

Një shembull tjetër i banesës dykatëshe me dy kthina për secilin kat ndërtuar në vitin 1894, gjendet në fshatin Vagalat (fig. 23. Tab. XII). Ndërtimi ngrihet mbi terren të pjerrët, i cili lartësohet kryesisht nga ana jugperëndimore. Kjo banesë në krahasim me shembujt e tjerë të banesës dykatëshe, me dy kthina banimi në katin e banuar, ka ndryshim në kompozim. Ky ndryshim vihet re në krijimin e hyrjeve për në të dy katet në të dy pamjet e banesës. Nëpërmjet hyrjeve të ndërtuara në pamjen perëndimore komunikohet me katin përdhes dhe dy mjediset e banimit. Kurse hyrjet në pamjen lindore komunikojnë me katoin dhe magjërinë e ndërtuar sipër tij. Në këtë shembull shtesa është bërë në vazhdim të magjërisë dhe jo përpendikular me të. Shtesa prej një mjedisi është ndërtuar në çerekun e dytë të shek. XX. Shtesa dhe elementet përbërëse të saj janë punuar në mënyrë të tillë, që vështirësojnë mjaft dallimin e dy ndërtimeve. Dallimi bëhet i qartë kryesisht nga fugatura vertikale, e dallueshme në pamjen lindore dhe perëndimore.

Shembulli i ndërtuar në fshatin Livinë paraqet interes kryesisht në drejtim të katit të banuar. (Tab. XIII). Banesa sipas të dhënave të banorëve është ndërtuar në çerekun e tretë të shek. XIX. Në vitin 1908 banesa pësoi disa ndryshime, rritet sipërfaqja e parahyrjes deri në fund të pamjes duke krijuar kështu një qilar për vendosjen e zahireve, gjë që se kemi hasur tek shembujt e tjerë.

Në mjaft fshatra të dy zonave në studim vihet re se banesa me kat, dhe pikërisht ajo me dy mjedise në katin e banuar ka pësuar një evoluim në drejtim të zhvillimit planimetrik të katit të sipërm. Në mjaft shembuj vihet re qenja e një korridori në mes të katit, i cili ka funksion ndërlidhës për magjërinë (mjedisi i gatimit) dhe odën (odën e miqve). Një shembull të kësaj banese e gjetën në fshatin Vrion,

ndërtuar rreth vitit 1870. (Tab. XIV). Kati përdhes ka të shfrytëzuar vetëm një mjedis. Mjedisi tjetër është mbushur me dhe me qëllim që dyshemeja e magjërisë të jetë e padjegshme. Magjëria ka dhe një qilar me dërrasa në pjesën fundore të mjedisit, i cili shërbente për fjetjen e çiftit të ri. Oda e miqve është e shtruar me dërrasa dhe ka tavan. Muret janë të suvatuara. Pjesa ballore e mjedisit përmban oxhakun me tambur katërkëndësh këndrejtë dhe dy çifte dritaresh të ndërtuara në mënyrë simetrike.

Një shembull me interes i banesës me dy kthina në katin e banuar është ai i ndërtuar në fshatin (Lefter Talo), në vitin 1908 (fig. 24. Tab. XV). Kati përdhes përmban dy mjedise, ku njëri, ai në krahun e djathtë të vrojtuesit, ka shërbyer si mjedis ndihmës, për gatim, kurse mjedisi në të majtë shërbente si katua. Ndërlidhja me katin e banuar realizohej me anën e shkallëve të jashtme prej guri. Secili prej dy mjediseve të katit të banuar paraprihet nga një korridor relativisht i ngushtë,[14] me hyrje të veçantë nga jashtë. Dhe në këtë shembull vihet re një simetri e plotë përsa i përket kompozimit, elementeve të brendësisë. Me shtimin e familjes ka lindur nevoja që banesës së vjetër t'i shtohet nga ana jugore një volum një katësh. Volumi shtesë është ndërtuar në vitin 1950. Me shumë interes, përsa i përket evoluimit nga një formë më e thjeshtë, në një skemë më të zhvilluar është banesa në lagjen e vjetër (fig. 25, Tab. XVI), në fshatin Mursi.[15] Ndërtimi i saj i përket vitit 1888. Kati përdhes përbëhet nga dy katoj të lartë. Në brendësi të tyre janë ndërtuar dy manxata, të cilat së bashku me manxatan e tretë, që mbështetet mbi truallin natyror, formojnë katin e ndërmjetmë. Në manxatat vendoseshin zahiretë dhe shpesh, në stinën e verës përdoreshin për të fjetur. Si zakonisht, kati i sipërm është kati më i paraqitshëm i banesës. Në shembullin në shqyrtim ai përbëhet nga tri mjedise. Magjëria për gatim, në vazhdim të së cilës ndodhet oda për ndenjje ku hanin dhe flinin zakonisht njerëzit e shtëpisë. Kjo odë është e vendosur paralel me shkallët e jashtme prej guri. Odaja ose oda e miqve është vendosur përpendikular me magjërinë. Të tri mjediset kanë lidhje të brendshme në mes tyre.

Një nga shembujt më të vjetër të banesës me zhvillim në një krah është dhe banesa dykatëshe e ndërtuar nga fisi i Kaloit në vitin 1842 (Tab. XVII). Kati përdhes u gjend mjaft i transformuar, prandaj u bë e mundur të jepet vetëm zhvillimi planimetrik i katit të sipërm. Ky kat, përmban si zakonisht, tri mjedise: magjërinë, një mjedis thuajse i errët, që përdoret për gatim, odën për ndenjje, ku hanin dhe flinin zakonisht njerëzit e shtëpisë dhe odën e miqve, të ndërtuar normal me magjërinë. Nga jashtë ndërlidhja realizohet nëpërmjet parahyrjes, me formën e një korridori të vogël. Këtë korridor vendasit ashtu si banorët e zonës së Konispolit e quajnë mesua.[16]

Në zonën e Vurgut dhe të Mursisë shfaqet dhe varianti i banesës së mbyllur me kat. Kjo formë banese së bashku me banesën në zhvillim në një krah



Fig. 25

DO NOT COPY

14) Në periudhën që është ndërtuar volumi shtesë i cili ka shërbyer kryesisht për gatim. Janë bërë disa ndërtime të tjera si komunikimi i brendshëm i pjesës shtesë me banesën e vjetër, si dhe ndërtimi i çatmasë në katin e banuar, e cila e ka ndarë korridorin e gjerë në dy pjesë, duke krijuar kështu një komunikim krejt më vete në mes dy familjeve.

15) Gjatë gjurmimit për evidentimin e banesave të trashëguara në fshatin Mursi, banesa e ndërtuar në vitin 1888 u gjend e transformuar, duke qenë se një pjesë e saj është e djegur. Megjithatë e pamë të arsyeshme të qëndrojmë tek ky shembull me interes nga ana tipologjike dhe arkitektonike. Duke u bazuar në gjurmët e nxjerra mbas sondazheve dhe nga plotësimi me të dhënat e banorëve të moshuar, nuk e patëm shumë të vështirë për të bërë një rikonstruksion të pjesës së dëmtuar. Kështu u bë e mundur paraqitja e zhvillimi planimetriko-volumor të këtij shembulli.

16) L. Suli, **Banesa e vjetër tipike e zonës së Konispolit,** «Monumentet historike në vendin tonë», Tiranë 1978, f. 84 – 92.

DO NOT COPY



Fig. 26



Fig. 27

mbartnin karakteristikat e banesës qytetare. Një prej shembujve të banesës së mbyllur me kat, ndodhet në fshatin Sopik ndërtuar në vitin 1910.[17] (Tab. XVIII). Kati përdhes përbëhet nga dy mjedise të ndara nga një korridor i gjerë. Mjediset janë përdorur për banim. Në faqen e gjerë të secilës prej tyre gjendet oxhaku, tamburi prej guri i të cilit ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë. Ndonëse dritaret e dy mjediseve kanë përmasa më të vogla se ato të katit të sipërm, ndriçimi i mjediseve të katit përdhes është i mjaftueshëm. Në korridor ndodhen shkallët prej druri, të cilat të çojnë tek divani i katit të sipërm, i cili ka kryesisht funksion ndërlidhës për dy mjediset e ndodhura anash tij. Oxhaku është ndërtuar në faqen e ngushtë të mjedisit. Ndriçimi i mjediseve të katit të sipërm është më i bollshëm. Divani komunikon me ballkonin e dalë në pamjen kryesore të banesës. Pamja kryesore, e orientuar nga perëndimi,-është më e arrituara në drejtim të trajtimit të elementeve të veçanta konstruktive-arkitektonike. Duke filluar nga pjesa e pamjes që i takon katit përdhes, ku është ndërtuar dera e hyrjes dhe nga një çift dritaresh të harkuara, fillon e thyhet monotonia e masës së ftohtë prej guri, e cila zmadhohet në pjesën e katit të banuar, ku dritaret janë më të shumta e të baraslarguara nga ballkoni i ndërtuar në pjesën qëndrore. Në pjesën e sipërme pamja kufizohet nga streha e punuar prej guri. Çatia e mbuluar pjesërisht me rrasa guri edhe tjegulla, ku gërshetohen ngjyra gri me të kuqen e mbyllur rrit efektin e pamjes kryesore dhe të gjitha pamjeve të tjera të banesës në këtë aspekt.

Teknika e ndërtimit dhe mjeshtrit që ndërtuan banesat popullore

Materiali kryesor për ndërtimin e banesës së bujkut çifçi (kasolleve) ishte druri, balta dhe kashta. Puna për ndërtimin e banesës fillonte me rrafshimin e truallit, pastaj hapjen e gropave rreth 30-40 cm, çdo 1-1,5 në të katër anët e konturit katërkëndësh këndrejtë. Në këto gropa vendoseshin hunj vertikalë 10-12 cm, që dilnin 2-2,5 m nga sipërfaqja e tokës. Hunjtë e vendosur në mes të hapësirës, në drejtim gjatësor ishin 3,5 të lartë. Mbi ta vendosej trau horizontal, që formonte kulmin e çatisë së banesës. Trarët horizontalë vendoseshin dhe mbi hunjtë vertikalë të pjesëve anësore. Në këtë mënyrë formohej skeleti i banesës. Nga kulmi në drejtim të traut horizontal të mureve anësore lëshoheshin mahitë, të cilat ishin rreth 1 m larg njëra-tjetrës. Mahitë dilnin 0,3 m nga sipërfaqja e jashtme e murit të kasolles, për të formuar strehën e saj. Muret me skelet druri të banesës visheshin me lesa të përgatitura më parë. Ato ishin prej shelgu ose rrapi. Muret e kasolles suvatoheshin me baltë të përzier me byk gruri ose orizi. Në përzierje të baltës nga ndonjë herë vendosej dhe lesh dhie i prerë. Zakonisht suvatohej faqja e brendshme, por nuk mungonin rastet kur suvatoheshin të dy faqet e muraturës. Çatia mbulohej me fier ose kashtë. Kjo mbulesë lidhej me mahitë me thupra shelgu. Çatia e banesës bëhej gjithnjë dyujëse. Banesa e bujkut çifçi (kasollja) ngri-

17) Banesa gjatë kohës ka pësuar disa ndryshime, të cilat kanë ardhur si rezultat i ndarjeve të kurorave. Në vizatim është paraqitur gjendja fillestare.

hej brenda një kohe të shkurtër. Ato i ndërtonte vetë bujku çifiç, meqenëse mënyra e ndërtimit të tyre ishte e thjeshtë. Banesat më të thjeshta, sidomos ato përdhese, janë ndërtuar kryesisht nga shtresat e varfëra të popullsisë. Ndërtimi i tyre bëhej me gurë të lidhur me llaç balte. Muratura qarkohej me breza druri të dukshëm në të dy faqet e muraturës. Por, në fshatrat e zonave në studim, kishte dhe banesa përdhese, me muraturë me llaç gëlqere pa breza druri (Tab. III). Rrallë herë, për banesat me kat, përdorej teknika e ndërtimit të muraturës me llaç balte e breza druri (Tab. VIII, Tab. X). Përgjithësisht, muratura e banesave me kat lidhej me llaç gëlqere. Qoshet e muraturës ndërtoheshin me një përkujdesje të veçantë. Suvatimet e brendshme në banesat e thjeshta, sidomos ato përdhese dhe rrallë herë në ato me kat, bëheshin me llaç balte. Llaçi për suvatim forcohej vetëm në banesat e mbyllura. Ne i hasim tek banesat e Mursisë. Muratura ngushtohet nga ana e brendshme nga kati në kat. Trashësia minimale e murit është 60 cm, kurse trashësia maksimale shkon deri 80 cm. Dyshemeja bëhej me dërrasa treshe të afruara. Në disa shembuj, kur hapësira e dritës në drejtim tërthor ishte relativisht e madhe, ata përforcoheshin në mes nga një tra. Trau mbështetej në drejtimin gjatësor mbi kolona prej guri. Tek banesat e Mursisë trau gjatësor mbështetej mbi pjesën e sipërme të harkadave (Tab. XVI). Zakonisht për dyshemenë e magjërisë përdorej shtresa natyrore e terrenit, por siç e kemi vënë re dhe në zonat e tjera kjo shtresë formohej artificialisht (Tab. XIV). Nuk mungojnë rastet kur trualli i padjekshëm për magjërinë, ose për raste të veçanta, për ndonjë mjedis tjetër, i cili ndërtohej me qemere cilindrike prej guri (Tab. IX, Tab. XVI, etj). Në këto dy zona nuk mungonin shembujt e banesave ku kati përdhes shtrohej me rrasa guri, si për shembull banesat me zhvillim në një krah të Mursisë. Teknika e ndërtimit të dritareve dhe dyerve është e realizuar në disa mënyra. Mbulesa e hapësirës së dritareve dhe dyerve realizohej, si në anën e jashtme ashtu dhe të brendshme, me arkitra druri. Mënyrë tjetër e mbulimit të dritareve është me arkitra guri nga ana e jashtme dhe me qemer guri nga ana e brendshme. Tek dritaret nga ana e jashtme vërejmë dhe mbulesën e kombinuar, e cila realizohet duke vendosur mbi arkitraun prej guri një hark guri (fig. 27, Tab. VI, Tab. XI, Tab. XVIII). Gjithashtu hasim mbulesën e dritareve pjesërisht me konsola guri, mbi të cilat mbështetet arkitrau prej guri (Tab. IX). Përveç mënyrës së përmendur më sipër dyert janë të mbuluara me arkitra guri nga ana e jashtme dhe arkitra druri nga ana e brendshme. Në banesat me konfiguracion të thjeshtë, konstruksioni i çatisë është i tipit stropil. Zakonisht këto lloj banesa mbulohen me tjegulla, por siç u vërejt gjatë studimit vihen re dhe banesa, të cilat janë mbuluar përgjithësisht me tjegulla, ndërsa tek pjesa e strehëve janë të mbuluara me rrasa guri në mënyrë që era të mos dëmtojë mbulesën e strehës. Gjatë gjurmimit kemi hasur dhe shembuj banesash të mbuluara krejtësisht me rrasa guri. Në këtë rast dimensionet e konstruksionit të trashë të çatisë rriten. Në banesat me konfiguracion planimetrik të zhvilluar siç është rasti i banesave me zhvillim në një krahë, skema e çatisë është më e ndërlikuar. Këtu pesha e babaliekëve lehtësohet me anën e pajantave, sidomos kur kulmi nuk bie mbi mur. Këtë e kemi vërejtur dhe në banesat e zhvilluara në zonën e Rrëzomës dhe në atë të Konispolit. Lënda që përdorej ka qenë kryesisht prej gështenje, rrapi dhe bredhi. Strehët e çative realizoheshin me pllaka guri të punuar. Strehët prej guri formohen zakonisht nga një rresht pllakash, por në disa raste dhe nga dy rreshta. Kjo strehë del nga faqja e jashtme e muraturës 12-18 cm, kurse streha prej druri varion nga 30-70 cm. Ornamentika e këtyre banesave përgjithësisht është e thjeshtë, por nuk mungojnë shembujt ku dollapët e murit, sergjenet, musandrat dhe tavanet, janë trajtuar me një përkujdesje të veçantë. Tavanet prej dërrase në shumicën e banesave janë bërë më vonë. Kjo vihet re sidomos në shembujt jo të zhvilluar, të ndërtuar kryesisht në fund të shek. XIX. Një prej këtyre formave të tavaneve të thjeshta është tavani me formën e katërkëndëshit këndrejtë, qarkuar nga një fashaturë e profiluar. Fusha e tavanit është realizuar me dërrasa të afruara. Bashkimi i tyre mbulohet me çibukë të ngushtë të pro-



Fig. 28

DO NOT COPY

filuar. Në mes të fushës zakonisht vendoset një rozetë nëntëkëndore në mesin e së cilës gdhendeshin gjethe (fig. 28). Nuk mungojnë dhe rozetat e zbukuruara në mes me një shqiponjë ose me yll. Mjeshtat popullorë, të cilët ndërtuan banesat me gurë, kanë qenë kryesisht nga Opari i Korçës dhe nga Përmeti. Kishte dhe ustallarë nga Sopiku, Leshnica, në raste të rralla dhe nga Konica. Ustallarët nga Opari i Korçës dhe ato të Sopikut, zakonisht merreshin me ndërtimin e muraturës dhe të çatisë, kurse përmetarët kryenin punimet e drurit dhe suvatimet. Grupi i muratorëve përbëhej deri në 12 veta, ndër të cilët bënin pjesë 3-4 të rinj, që mësonin zanatin. Muratorët, në mjaft raste, ashtu si dhe në zona të tjera, transportimin e bënin me kafshët e tyre.

Në qoftë se në zonën e Vurgut dhe pjesërisht në atë të Mursisë banesa e bujkut çifçi (kasollja) ka patur një përhapje relativisht të gjerë, në zonat e tjera të rrethit, me përjashtim të rasteve të veçanta, nuk ka gjetur përdorim. Banesa përdhese, e këtyre dy zonave, e ndërtuar me gurë është e ngjashme nga kompozimi me atë të zonave të tjera të rrethit. Këtë ngjashmëri e shohim dhe me banesat e tjera siç janë ato me gjysmëkat e ato me kat. Në banesën me kat më e përhapur është ajo me nga dy mjedise për secilin kat, duke u bërë kështu banesa tipike e këtyre zonave. Banesa me zhvillim në një krah, përveç fshatit Mursi, në fshatrat e tjerë gjendet e ndërtuar rrallë. Banesa me zhvillim në një krah e Mursisë ka tipare të ngjashme me banesën me zhvillim në një krah të zonës së Konispolit. Kjo ngjashmëri vihet re sidomos në zhvillimin planimetriko-volumor, në kompozimin e elementeve të veçanta konstruktivo-arkitektonike, si dhe në drejtim të teknikës së ndërtimit (suvatuar nga jashtë). Banesat e formave të tjera të përmendura më sipër qëndrojnë në unitet me banesat brenda rrethit dhe me ato të krahinave fqinje. Ky unitet vihet re në numrin e barabartë të mjediseve, në trajtimin e elementeve të brendshme dhe të jashtme, në teknikën e ndërtimit etj. Kushtet ekonomiko shoqërore s'e kanë favorizuar përhapjen e banesës me zhvillim në dy krahë si në zonën e Konispolit dhe pak më rrallë në atë të Rëzomës. Në zonat në studim komplekset ndërtimore ishin një fenomen shumë i rrallë. Megjithatë, trashëgimia ndërtimore e këtyre dy zonave zë një vend të kënaqshëm në fondin e përgjithshëm të banesës popullore të trashëguar nga të parët tanë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. I

KASOLLE



VARIANTI I DYTE



0 2 4m



PRERIE I I

VARIANTI I PARE



0 15 3m.

0 2 4m

DO NOT COPY

TAB. II

KASOLLE



KOMPLEKS



VARIANTI III

0 2 4



VARIANTI III

DO NOT COPY

TAB IV

BANESE NE FSHATIN KARAHAXH



KATI PERDHE

0 2 4m



TAB III

BANESE NE FSHATIN RRAHULLE





KATI PERDHE

0 2 4m



PRERIA I I

0 1 2m

DO NOT COPY

TAB. V

BANESE NE FSHATIN VROMERO



PAMJE KRYESORE

0 1 2m



KATI I PARE



KATI PERDHE

0 2 4m

TAB. VI



FAZA E PARE FAZA E DYTE



0 2 4m

BANESA NE FSHATIN SOFIK



DO NOT COPY

TAB. VIII

BANESE NE FSHATIN RUMANXA





KATI I PARE



KATI PERDHE

0 2 4m

TAB. VII



BANESE NE FSHATIN MURSI

KATI I SIPERM



KATI I NDERMIETEM



KATI PERDHE

0 2 4m

TAB. IX

BANESE NE FSHATIN VAGALAT





KATI I PARE



KATI PERDHE

0 2 4m

DO NOT COPY

TAB X

BANESE NE FSHATIN FINIQ





KATI I PARE

FAZA E PARE FAZA E DYTE



KATI PERDHE

0 2 4m

TAB. XI



KATI I PARE



KATI PERDHE

0 2 4m

BANESE NE FSHATIN MURSI



DO NOT COPY

TAB. XII



PAMJE KRYESORE

BANESE NE FSHATIN VAGALAT

0 1 2



KATI I PARE



KATI PERDHE

0 2 4m

TAB. XIII

BANESE NE FSHATIN LIVINE



KATI I PARE

FAZA E PARE FAZA E DYTE



KATI PERDHE



0 2 4m

DO NOT COPY

TAB XIV



PAMJE KRYESORE

BANESE NE FSHATIN VRION









TAB XV

BANESE NE FSHATIN LEFTER TALO



PAMJE KRYESORE



DO NOT COPY

Tab. XVI

RIKONSTRUKSION

Banesë në Murrsi



Tab. XVII

RIKONSTRUKSION



Banesë në Murrsi

Tab. XVIII

Banesë në Sopik





Pamje Kryesore

0 1 2 3 4 M

Lenoard SULI

DO NOT COPY

L'HABITATION POPULAIRE DE LA REGION DE VURGU ET DE MURSIA.

Cet article a pour objet de représenter la typologie et l'architecture des habitations populaires dans les zones de Vurgu et de Mursia, ainsi que de mettre en évidence quelques constructions appartenant à d'autres genres (constructions de culte, ponts, moulins etc). La zone de Vurgu et de Mursia se trouve dans la partie sud-occidentale de la région de Saranda (fig. 1). Selon la division régionale de notre pays en deux zones, elle fait partie à la grande unité ethnographique de Labëria. Sa position au milieu du triangle formé par l'union des trois villes de l'Illyrie du Sud Buthrotos (Butrint), Foinike (Finiq) et Onhezmos (Saranda) prouve qu'elle a été peuplée depuis l'Antiquité. Les multiples trouvailles archéologiques, en sont un autre témoin. Partant de la période de construction des habitations populaires en question, les données des régistres ottomans du XVe, XVIe, XVIIe sc ainsi que les sources historiques ultérieures représentées au tableau (fig. 2) apportent un intérêt particulier. Dans les sources historiques ottomanes du XVe sc, Vurgu apparait avec le nom «Vurgos Ovasi» (la plaine de Vurgu). C'est par ce nom qu'elle est connue même à l'heure actuelle par les gens du pays et ceux des régions avoisinantes. Nombre de villages des deux zones, surtout ceux de Vurgu, sont créés au cours des XVIIe, XIXe sc et au début du XXe sc.

La population de ces deux zones s'occupait essentiellement d'agriculture et d'élevage. La plupart des villages de ces zones étaient des villages de métayeurs. L'habitation du métayeur, qui était généralement à simple rez-de-chaussée et construite avec du matériel faible, appartenait à l'agha et au bey. Dans ces zones il y avait également des villages libres où la terre et l'habitation appartenaient au laboureur, citons: Navarica, Ardhasava, Livina, Vagalat, Sopik etc. Les grands propriétaires fonciers habitaient généralement à Delvina et à Konispol. Dans la plupart des cas on faisait le marché au centre du village, en plein air, mais on le faisait également à Konispol ou à Delvina qui étaient de grands centres d'artisanat et de commerce. Au cours des expéditions de recherche on constata que l'habitation à simple rez-de-chaussée du métayeur, n'existait plus.

On remarque deux manières d'organisation et de disposition des constructions. Celle la plus arriérée, se rencontre aux villages des métayeurs de Vurgu. On donnera comme exemple, l'organisation et la disposition des constructions du village Vrion (fig. 3). Le village était composé de quelques quartiers nommés «mëhalla» qui portaient le nom propre du bey. Les habitations qui formaient les quartiers, étaient orientées vers la plaine de Vurgu. Près de l'habitation se trouvaient la chaumière, le four, les W.C. (tab. II). Les habitations et les «mëhalla» se reliaient par d'étroits chemins, une rue non pavée passait au milieu du village. Au centre du village s'élevait la «Kulla» du bey entourée des habitations des couches riche et moyenne. Au centre se trouve également l'église à une nef construite en 1888 (fig. 4). Dans la plupart des villages des métayeurs il y a une église. Ainsi, au village Kulluricë on trouve l'église de la Sainte Marie (fig. 6) à une nef, construite en 1780. Dans ces villages il y a eu aussi des fontaines, des ponts tels: la fontaine de «Memush Bey» au village Pllakë (1903) (fig. 7), le pont à un arc de «Lefter Talo» (fig. 8) construit à l'époque d'Ali Pacha de Tepelena etc.

Le deuxième mode d'organisation et de disposition des constructions se rencontre aux villages libres comme Vagalat. Les habitations y sont généralement à un étage, disposées l'une près de l'autre et entourées d'un parapet (ifg. 9). Les quartiers se relient par des rues pavées (fig. 10) et au centre du village s'élève l'ancienne église d'Ajnollato (fig. 1). Au début du XX sc fut construite l'église à une nef du type basilique (fig. 12). L'habitation à simple rez-de-chaussée et à pièce unique ne connut pas une large propagation. Elle a été construite principalement par les métayeurs. Après la libération Nationale du pays, ce type d'habitation ne s'utilisa plus à cette fin. On en trouva un exemple au village Rahullë (fig. 15), qui servait déjà à abriter le bétail. C'était une pièce sans plafond et où le sol servait de plancher, construite en 1910. Le principal élément de la pièce était la cheminée en pierre. L'habitation à deux pièces du métayeur, construite en matériel faible, connut un large emploi parmi les couches pauvres de la population. L'une des pièces servait aux gens l'autre aux animaux (tab. I, IIe variante). La variante la plus avancée de cette habitation, construite toujours en matériel faible, est celle où les deux pièces sont séparées d'un étroit couloir (tab. II, III variante). Quand la famille devenait plus nombreuse, en ajoutait une chaumière à part pour les animaux (tab. II).

L'habitation en pierres à deux pièces, construite par le paysan libre s'utilisa beaucoup au premier quart du XXe sc. L'une de ses variantes avec un couloir au milieu, construite en

1935 se conserve au village Karahaxh (fig. 18, tab. V). L'habitation à demi-étage est utilisé surtout pour le terrain en pente des villages situés au versant des collines. Le rez-de-chaussée servait d'étable tandis qu'au premier étage se trouvaient la «chambre d'amis» suivie de «magjësia» (pièce ou l'on préparait à manger dont le plancher était hors du danger du feu de foyer). On en trouve un exemple au village Vromer (Bregas) (tab. V) et au village Sopik (fig. 19, tab. VI). En 1900 est réalisée la deuxième phase qui représente le volume à un étage ajouté à la face principale. Dans les villages des deux zones s'est propagée l'habitation à étage, depuis la variante la plus simple celle à pièce unique à chaque étage, jusqu'à celle plus avancée, représentée par l'habitation à deux étages, développée sur une seule aile. On rencontre l'un des plus simples exemples, au village Mursi (fig. 20, tab. VII). L'ancienne habitation date de la fin du XIX sc tandis que la partie ajoutée, appartient au début du XXe sc. Au village Rumanxa, on trouve une habitation à un étage, construite en 1915 (fig. 21, tab. VIII). Une habitation construite à la fin du XIXe sc au village Vagalar, représente un autre exemple de l'habitation à étage (fig. 22, tab. IX). Comme dans les autres régions du pays, même dans ces deux zones, on rencontre deux solutions répondant aux besoins de logement; la première, on ajoute une nouvelle pièce à l'ancienne construction et la deuxième, on adopte l'une des pièces annexes déjà existantes. La première solution apparait nettement à une habitation de Finiq où au premier volume construit au début du XXe sc, est ajouté un autre, construit en 1925 (tab. X), tandis que la deuxième solution nous est prouvée par une habitation à Mursi (tab. XI).

Une habitation avec une composition intéressante est construite en 1894 à Vagalat (fig. 23, tab. XII). L'adjonction appartient au deuxième quart du XXe sc. Au village Vrion se conserve une habitation à un étage avec un couloir au milieu des deux pièces, datant de l'année 1870. (tab. XIV). Une habitation construite en 1908 au village Lefter Talo, représente de l'intérêt quant à sa composition. En 1950, à cette habitation fut ajoutée une pièce où l'on préparait à manger (fig. 24, tab. XV). Au village Mursi, se trouve une habitation à deux étages, à un développent sur une seule aile (fig. 25, tab. XVI). L'habitation, construite en 1888, se présente assez modifiée mais les sondages effectués rendirent possible sa réconstitution hypothétique. L'habitation fermée, avec des traits urbains se heurte plutôt dans la zone de Mursia. L'un de ses exemples fut construit en 1910 à Sopik (tab. XVIII). Les principaux matériaux dont on se servait pour la construction de l'habitation en pierres à simple rez-de-chaussée, étaient réalisées en mortier de pisé ou de chaux (tab. III). On rencontre parfois l'appareil en mortier de pisé et en bandes de bois (tab. VIII, tab. X). L'épaisseur des murs varie de 0,6 m à 0,80 m.

Dans quelques cas, afin de créer un sol pour la cuisine, au-dessous de cette pièce on aménageait des voûtes en plein cintre. (tab. IX, tab. XVII, etc). Au-dessus des portes et des fenêtres on utilise des architraves en bois des deux côtés ou en pierres à l'extérieur et en bois à l'intérieur ou quelquefois des architraves en arc de pierres (fig. 27). Le toit est couvert de dalles de pierres ou quelquefois d'une combinaison des tuiles et des dalles. Au milieu des plafonds réalisés généralement en bois, se trouve une rosace ornée de feuilles gravées (fig. 28). Il ne manque pas les plafonds avec des rosaces ornées d'étoiles et d'aigles gravés. Les maîtres étaient originaires de Korça, Përmet, Leshica, mais dans quelques cas venaient même de Konica. Alors que dans les deux zones en question, les habitations populaires héritées remontent au XIXe sc et au début du XXe sc, dans la zone de Rëzome, cet héritage appartient au XIVe, XVIIe sc (vestiges de Komenica) tandis que dans la zone de Konispol, cet héritage était encore plus ancien, si l'on a en vue les vestiges de Qafa e Ktismave au voisinage de Konispol. L'habitation du métayeur qui dans ces deux zones trouve une large propagation, ne connut pas un large emploi à Rezome, Muzine, Theollogo, Konispol et à la région de Vlora. De même, les variantes avancées des habitations dans ces deux zones, n'apparaissent qu'au village Mursi, tandis qu'à Rëzone et Konispol, on les trouve partout. Tout de même, les variantes simples de ces zones demeurent en unité avec les variantes respectives des zones voisines tant par le nombre des pièces et la formation des éléments de l'intérieur que par la technique de construction.

DO NOT COPY

Nr. 1 1989

monumentet

DO NOT COPY

Latif LAZIMI

ODA E MIRË DHE ELEMENTET ARKITEKTONIKE TË SAJ NË BANESËN QYTETARE GJIROKASTRITE DHE BERATASE

Në këtë studim do të trajtojmë elementet arkitektonike të odës së mirë të banesës gjirokastrite e beratase, të cilat shfaqin karakteristika në mbarë tipologjinë e banesës qytetare shqiptare. Synimi ynë është të japim në mënyrë kronologjike, morfologjinë, vlerat dhe veçoritë e këtyre elementeve. U mbështetëm në banesat e Gjirokastrës e të Beratit sepse ato ruajnë material autentik, që i takon kryesisht shek. të XIX. Siç është vënë në dukje nga studimet bashkëkohore, banesën gjirokastrite e gjejmë të ndërtuar në tri variante kryesore në variantin përpendikular, variantin me një krah dhe variantin me dy krahë[1]. Edhe banesa në qytetin e Beratit ndahen në tri grupe[2], banesa me çardak, banesa e mbyllur me gjysmëkat dhe me kat, si dhe grupi i banesave të rindërtuara rreth mesit të shek. XIX, apo të ndërtuara pas kësaj kohe.

Si banesa gjirokastrite, e cila shquhet për kompozimin e saj vertikal me dy, tri kate, me zgjidhje planimetrike me një krah dhe dy krahë, ashtu dhe banesa në qytetin e Beratit, me një theksim horizontal, me 2-3 kate, janë të pajisura me një numër dhomash (njësi) ku zhvilloheshin aktivitete të ndryshme familjare. Çdo dhomë është një mjedis që shërben për aktivitete të caktuara si ndenjje, pune, ngrënie, fjetje, gatim etj. Prej tyre spikat dhoma e mirë ose oda e miqve, e cila duke qenë njësia ku pritet dhe nderohet miku, shfaqet kudo e trajtuar me një përkujdesje të veçantë arkitektonike dhe artistike. Në banesën gjirokastrite dhe beratase tradita ka preferuar ndërtimin e odës së mirë në katin më të lartë, madje të orientuar gjithmonë nga pamja kryesore dhe të vendosur në krahët, volumi i të cilave i del akoma më përpara rrafshit të banesës. Me këto cilësi kompozicionale, odës së mirë, i jepet një theks i ndjeshëm në arkitekturën e eksterierit të banesës dhe reciprokisht, ajo fiton parametrat më të mirë (në krahasim me njësitë e tjera të banimit), për soditjen dhe komunikimin me elementet urbane përreth banesës.

Duke trajtuar odën e mirë, në aspektin funksional vërejmë këto hapësira volumore (Fig. 1).

I. Hapësira e aktivitetit jetësor (ndenjtje, fjetje, soditje) e cila ndahet në:

1) Hapësirë tranzitore (aktive) (H.A.)[3].
2) Hapësirë të qetë (për qëndrim dhe soditje) (H.Q)
3) Sipërfaqe të ndriçimit (dritaret e poshtme dhe të sipërme) (S.D).
4) Hapësira e ngrohjes (H.N).
5) Tavanin dekorativ (T.D).

II. Hapësira për shërbimet në odën e mirë, përbëhet nga:

6) Hapësira ndërlidhëse (korridori) (H.Sh).
7) Një hapësirë me tavan të ulët (T.U).
8) Nyja sanitare (N.S).
9) Hapësirë e përdorshme e hapur dhe e mbyllur (Dyshja musandër dhipato (H.P).
10) Hyrja.

Në banesën gjirokastrite oda e miqve është më e tipizuar dhe ka një formë të përzgjatur planimetrike me raporte të brinjëve 1 : 2,2, ndërsa lartësia është relativisht e madhe dhe shkon nga 3,5-4 m.

1) E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë, 1981, f. 59.
2) E. Riza, **Banesa popullore në qytetin muze të Beratit,** Monumentet, 1981, f. 11.
3) L. Lazimi, Çardaku në banesën beratase, Monumentet 1976, 11, f. 175.

DO NOT COPY



Fig. 1

Ndërsa në banesën e Beratit ka një theksim arejtë formës katërkëndëshe me raport të brinjëve 1 : 1,1, 1 : 1,2 dhe lartësi 3-3,5 m.

Në përshtatje me marrëdhëniet-variante të elementeve hapësinore të klasifikuar më sipër, në odën e mirë gjirokastrite, kemi vërejtur 6 zgjidhje kompozicionale. (Fig. 2).

Në zgjidhjen e parë hapësira aktive (H.A) është në disnivel me hapësirën e shërbimit H. Sh, e cila në këtë rast merr funksion të mirëfilltë lëvizjeje Fig. 2/a). Hyrja zë vend në krah të kompleksit musandër – dhipato dhe nga ana kompozicionale është pjesë përbërëse e tij. Në zgjidhjen e dytë hapësira aktive (H.A) është në disnivel me hapësirën e qetë (H.Q), e cila duke qenë dhe pranë dritareve, që trajtohen shumë afër dyshemesë, nga ku hapet një panoramë e gjerë përpara, merr funksione ndenjtje dhe soditjeje (Fig. 2, b). Në këtë rast merr përparësi vendi për çlodhje dhe soditje duke zënë 1/3 e sipërfaqes së odës. Në zgjidhjen e tretë hapësira aktive (H.A) ka kuotë të njëjtë në të gjithë sipërfaqen e odës (fig. 2, c) duke e veçuar hapësirën e qetë (H.Q), që shtrihet përqark tri faqeve të saj. Në zgjidhjen e katërt kemi një kompozim me interes, të cilin nuk e takojmë shpesh në banesën gjirokastrite (Fig. 2, d). Ajo ka po atë trajtim të hapësirës së odës, si në zgjidhjen e tretë, por ndryshon konfiguracioni në lidhje me vendin e vendosjes të sipërfaqes së ndriçimit dhe të hapësirës së ngrohjes. Në zgjidhjen e pestë (Fig. 2, e), e cila i takon fundit të shek. XIX, hapësira aktive (H.A. zë pjesën më të madhe të odës, ndërsa hapësira e qetë (H.Q) është kufizuar vetëm pranë dritareve. Hyrja për në odë në këtë rast është vendosur në qendër të kompleksit. Fillimi i shek. XX sjell ndryshime të reja, të cilat në zgjidhjen e gjashtë (Fig. 2, f) lidhen me kthimin e kompleksit në një element formal dhe hyrja për në odë bëhet në krah të kompleksit.

DO NOT COPY



Fig. 2

Në odën e mirë të banesave të Beratit dallojmë 7 zgjidhje kompozicionale (Fig. 2). Në zgjidhjen e parë bëhet një kombinim i dy zgjidhjeve të para të odës së mirë gjirokastrite, ku hapësira aktive (H.A) është në disnivel me hapësirën e shërbimit (H.Sh) dhe hapësirën e qetë (H.Q) (Fig. 2, g). Hyrja është kompozuar në krah të kompleksit musandër mafil. Zgjidhja e dytë ka të veçantë, nga zgjidhja e parë e odës gjirokastrite, futjen e hapësirës së shërbimit (H.Sh) në volumin e kompleksit (Fig. 2, h). Në zgjidhjen e tretë (Fig. 2, i), në konfiguracionin e odës, ndryshon vendi i vendosjes së hapësirës së ngrohjes (H.N) dhe të ndriçimit (H.D). Në zgjidhjen e katërt hapësira e qetë (H.Q) zvogëlohet dhe kufizohet pranë dritareve (Fig. 2, j). Hyrja për në odë është e shkëputur nga kompleksi dhe bëhet në faqen e saj anësore. Këtë mënyrë vendosje nuk e gjejmë në odën e mirë gjirokastrite. Zgjidhja e pestë është e njëjtë për të dy qytetet (Fig. 2, k). Në zgjidhjen e gjashtë hapësira e qetë (H.Q) zë dy faqe të odës, ndërsa hyrja është anësore (Fig. 2, l). Zgjidhja e shtatë përputhet me zgjidhjen e fundit të odës gjirokastrite. (Fig. 2, m).

Në odën e mirë të dy qyteteve-muze, në tipet më të zhvilluara të banesave, hapësira e odës ndahet në tri pjesë kryesore; hapësira e shërbimit, hapësira aktive dhe hapësira e qetë, për ndenjje dhe soditje. Duke lëvizur në odën e mirë sipas një aksi gjatësor, që shkon nga hapësira e shërbimit drejt hapësirës së qetë, arrijmë pranë dritareve, në pikën e rëndësishme të interesit vizual, prej nga soditet pa u penguar, jo vetëm mjedisi i jashtëm urban, por dhe kompozimet tërësore ose të pjesshme të elementeve arkitektonike që zënë vend në hapësirën e odës së mirë.

Kompozimi dhe trajtimi i saj nuk mund të konceptohet pa praninë e elementeve arkitektonike. Krahas tipologjisë së banesës, në rrjedhën e kohës dhe elementet e saja pësojnë evoluim. Elementet arkitektonike kryesore, të cilat marrin pjesë në formulimin arkitektonik të brendësisë së odës së mirë gjirokastrite dhe beratase, janë: I) kompleksi musandër – dhipato, II) dollapët, III) dyert, IV) oxhaku dekorativ, V) tavani dekorativ, VI) dritaret, VII) fashaturat dhe sergjenet, VIII) nimet, etj. Elementet përbërëse të odës së mirës, që po trajtojmë kanë evoluar duke u mbështetur në kërkesat e kohës dhe kushtet ekonomiko-shoqërore në periudhën prej fundit të shek. XVIII dhe gjatë shek. XIX.

I. **Kompleksi musandër – dhipato,** në banesën gjirokastrite është një dukuri e pandarë nga oda e miqve. Përgjithësisht, ky kompleks ndërtohet në faqen fundore të odave të mira, ose në raste të veçanta në faqen anësore, por gjithmonë në atë më të ngushtën. Si kompozim arkitektonik ai formohet nga dy volume të mbivëna. Volumi i poshtëm përbëhet nga dy parahyrjet anësore, që lidhin odën me çardakun dhe me mjedisin sanitar, ndërsa pjesën qendrore e zë musandra, e cila është sipas rasteve një dollap me përmasa të mëdha, anash të cilit vendosen kamare simetrike ose jo. Kamaret shoqërojnë dollapët në të gjithë rastet. Lartësia e këtij volumi arrin 2-2,2 m. Pjesa e mbivënë përbën një volum të vetëm, të mbyllur ose të hapur nga ana e odës. Lartësia e saj është 1,40 – 1,60 m. Ndriçimi realizohet nga dritare që shohin në odë ose në çardak. Nga volumi i parë, me shkallë të brendshme druri, ngjitesh në hapësirën e sipërme. Ky kompleks është një element arkitektonik, i cili kryhen disa funksione. Së pari, duke qenë një perde ndarëse, e odës në pjesën fundore, nëpërmjet tij sigurohet qarkullimi me mjediset e tjera të banesës, pa dalë në mjediset ndërlidhëse. Ndërlidhja me nyjen sanitare bëhet nga pjesa e prapme ose drejtpërdrejtë nga pjesa ballore. Volumi i poshtëm i tij është i ndarë në hapësira të vogla, të cilat kryejnë funksionin e vendit të ruajtjes së shtresave, pajisjeve dhe sendeve të tjera të banesës, me anë të të cilave oda përshtatet më së miri, duke marrë funksionin e mjedisit të fjetjes. Volumi i sipërm (dhipatoja) është një vend i mirë për ruajtjen e sendeve të ndryshme, që i nevojiten banesës, por mund të këtë shërbyer dhe si vend qëndrimi për gratë. Në aspektin estetik ky kompleks, mund të themi se është më prezantuesi, si nga përmasat ashtu dhe nga trajtimi dekorativ. Zbukurimorja e këtij kompleksi është e pasur me dekoracione të ndryshme, në dyert, flegrat e dollapit, kamaret, parmakët, harkadat e kolonave etj. Këto elemente janë punuar me shije artistike. Njësinë e motivit dekorativ e përbëjnë figura të ndryshme gjeometrike, ose simbole bimore të kombinuara dhe me elemente ornamentale prej hekuri. Në aspektin konstruktiv ky kompleks nuk merr pjesë në zgjidhjen statike të odës. Nga pikëpamja e trajtimit ballor dhe funksional të elementit musandër – dhipato, në përshtatje me evoluimin e odës gjirokastrite, dallojmë pesë variante[4] kryesore, të cilat

4) E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë 1981, f. 244-333 bëhet përshkrimi i banesave dhe jepen datimet e tyre. Elementet arkitektonike që do të përshkruajmë janë marrë nga banesat Nr. 27, 29, 38, 15, 19, 36, 12, 17, 34.

DOKTORATURA

përputhen me disa ndryshime të vogla, me përfundimet e një studimi të mëparshëm.[5]

Variantin e parë të kompleksit musandër – dhipato e përbëjnë ato me dhipato të mbyllur dhe me një trajtim të thjeshtë të pamjes në tërësi (Fig. 3). Mbyllja është realizuar me një perde dërrase, të ndarë në 5 ose 6 panele të futura, të konturuara me korniza të profiluara dhe me dekoracione të daltuara. Ndriçimin, ky mjedis, e merr nga dritare që shohin në çardak ose në faqen anësore. Pjesa e poshtme ka dy trajtime. E para, që është më e hershme (Fig. 3, a) dhe i takon fundit të shek. XVIII, mbarte elemente funksionale duke u pajisur me musandrën në qendër dhe anash saj ka një ose dy kolona vertikale të trajtuara me kamare të hapura dhe dy dyert respektivisht për parahyrjen dhe mjedisin sanitar, me një trajtim jo simetrik. Në këtë rast kufiri ndarës i dy volumeve është më poshtë brezit horizontal të fashaturave të odës. Pamja ballore është e thjeshtë, dekoracioni me daltime është i varfër, ndërsa ngjyrosja e elementeve prej druri ka një rol parësor dhe kjo më e dallueshme në elementet që krijojnë zemrat e paneleve dhe figurave gjeometrike këndrejtë. Shembulli i dytë (Fig. 3, b) i takon fillimit të shek. XIX, viteve 1811-1812, dhe nuk përmban elemente funksionale si shembulli i parë, por kryen vetëm funksionin e një perdeje ndarëse, ku brezi horizontal, i cili ndan dy volumet ka të njëjtën kuotë me atë të odës.

Në pamjen ballore, shumë të thjeshtëzuar, theksin kryesor e luajnë elementet vertikale të fashaturave, në të dy volumet, duke krijuar një vizion më të lartë të kompleksit. Këtë variant e gjejmë deri në vitet 20 të shek. XIX, më tej fillon të ndërtohet varianti i dytë[6], i cili vazhdoi deri në vitet 50 (fig. 4). Ky variant ka



Fig. 3

5) E. Riza, **Vep.cit,** f. 104-109, ku autori dallon 3 tipe me nënvariantet përkatëse.
6) Kalimi nga një variant në tjetrin, është bërë gradualisht.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4

si tipar dallues dhipatonë e hapur, të trajtuar me një kolonadë druri, e cila në pjesën e sipërme ka një harkadë ose një element dantellë të gdhendur në thellësi me motive të ndryshme. Në këtë zgjidhje dhipatoja ka pamje transparente, duke dhënë qartë vazhdimësinë e odës në pjesën e sipërme. Në zgjidhjen planimetriko-funksionale ne dallojmë dy nënvariante. Në të parën pamja ballore e kompleksit trajtohet me thyerje (Fig. 4, a), ku pjesa e musandrës me lartësi 2 m është më e futur, ndërsa dy kolonat vertikale me nike të thelluara kanë një vendosje me kënd 45°, për të krijuar një lidhje sa më estetike me dy dyert anësore, që janë në një plan më të dalur. Dhipatoja është trajtuar me 6 kolona me seksion L, të cilat shoqërojnë në lartësi konfiguracionin e thyer planimetrik të pjesës së poshtme dhe kanë një lartësi 1,5 m. Ato bashkohen me parmakë druri me lartësi relativisht të ulët, 35 cm (Fig. 4,b). Në trajtimin arkitektonik të pamjes ballore ky element ka një transparencë në pjesën e sipërme, e cila krijon një perceptim më të qartë të volumit hapësinor të odës dhe e lidh më organikisht pjesën e poshtme të këtij elementi me elementet e tjera arkitektonikë të odës. Në volumin e poshtëm, musandra dy flegërshe është e trajtuar me motive të drejta gjeometrike nga kombinimi i fashaturave të profiluara. Dy kolonat vertikale me kamare të futura janë trajtuar me dekoracion, me daltime me teknikën e tejshpimit. Në pjesën e sipërme të hapësirave kanë azhure të lakuara me thurje të lidhura me fije të drunjta. Dera e hyrjes për në odë është gjithmonë njëflegërshe. Njësia që përbën motivin dekorativ të derës përbëhet nga një kombinim këndrejtë i fashaturave të profiluara, të cilat në qendër krijojnë një zemër katrore dhe përqark zemra katërkëndëshe këndrejta[7]. Ky motiv është përdorur edhe në kanatat e musandrës, por elementet kanë dimensione më të vogla. Pjesa e sipërme, e hapur, është trajtuar me kolona druri me proporcione elegante, të lidhura me parmak me forma të stilizua-



Fig. 5

DO NOT COPY

7) F. Shkupi, Zbukurimorja e disa banesave gjirokastrite, Monumentet 2, 1986, f. 107.

POZITCOPY

ra gjeometrike, që përfundojnë sipër me një harkadë të valëzuar me azhure të daltuara tej për tej.

Në të dytën, pamja ballore e kompleksit trajtohet e diferencuar dhe i takon viteve 1850. Dhipatoja është në një plan të thyer, ndërsa volumi i poshtëm është në plan të rrafshtë. Pamja ballore e tij ka një kompozim asimetrik (Fig. 4, c). Në qendër musandra me dy flegra dhe anash saj dy kolonat me kamare, me ballin të dekoruar me azhure me motive të lakuara, me thurje të lidhura me fije druri. Dera njëflegërshe përmban tri panele të ndara njëra nga tjetra me fashatura të profiluara horizontale. Në qendër, njësia që përbën motivin dekorativ, përbëhet nga një svastikë rombike. Dy pjesët e tjera janë trajtuar me zemra dhe fashatura vertikale.

Të bie në sy në këtë trajtim, numri i pullalijeve, të cilat me formën, ngjyrën dhe numrin e madh të tyre, duke thyer disi monotoninë e ngjyrës së drunjtë të tij, ndikojnë estetikisht në pamjen e kompleksit. Pjesa e sipërme e dhipatos ka një trajtim të përafërt me atë që përshkruam. Takojmë dhe shembuj ku pamja ballore e kompleksit në tërësi është e rrafshët (Fig. 4, b). Në variantin e tretë, që i takon viteve 1870, musandra nuk ndryshon shumë si zgjidhje nga e dyta, ndërsa dhipatoja trajtohet e mbyllur, por në këtë rast ajo është realizuar me suvatim (skelet druri, çatma). Në këtë zgjidhje takojmë dy nënvariante (Fig. 5, a,b). Në të dy shembujt, kompleksi trajtohet me thyerjen karakteristike në qendër, e cila vazhdon në lartësinë e dhipatosë me gjerësinë e musandrës me dy harqe që takohen në qendër. Në të dy anët e tij vendosen dritare, nga të cilat merr dritë mjedisi i dhipatosë. Këto dritare kanë formë të rrumbullakët ose katërkëndësh këndrejtë dhe kanë shpesh një perde të krijuar nga kryqëzimi i listelave të holla. Pjesa e poshtme e kompleksit ka zgjidhje të përafërt me të dytën. Musandra, poshtë, vazhdon me një xokol të trajtuar me panele të ngushta vertikale, të cilat në pjesën e sipërme kanë sipërfaqe të lakuar në një plan me të dalë se musandra. Kjo është një karakteristikë e variantit të tretë, që shoqëron të gjithë shembujt që kemi takuar. Ndryshimi i dy rasteve të këtij varianti qëndron pikërisht në trajtimin e pjesës së poshtme të kompleksit, në të cilën dera e djathtë eleminohet dhe bëhet me suva si dhipatoja. Në këtë shembull ndërtuar në vitet 70-80 duken shenjat e fillimit të humbjes së funksionit të këtij kompleksi (Fig. 5, b). Në trajtimin arkitektonik të pamjes ballore, kjo zgjidhje është më e përafërt me trajtimin e odës dhe lidhet më organikisht me të. Elementet arkitektonike përbërës të kompleksit, flegrat e musandrës, dyert, kanë si njësi bazë të motivit dekorativ zemrat katërkëndëshe këndrejtë me panele e me përmasa më të mëdha. Në kamaret



Fig. 6

DO NOT COPY



Fig. 7

dekoracioni është më i thjeshtëzuar. Në këtë zgjidhje vërehet se dy volumet e kompleksit nuk lidhen më estetikisht si në dy variantet e para dhe kanë kontrast në trajtim dhe në ngjyrë, ndërmjet volumit të poshtëm, i tërë në dru dhe të sipërmit, me suva në ngjyrë të bardhë.

Gjatë 20 vjetëve të fundit të shek. XIX, ndërtohet varianti i katërt (Fig. 6), në të cilën kompleksi ndryshon trajtimin arkitektonik të pamjes dhe fillon të humbasë disi funksionin fillestar. Pamja ballore nuk përshtatet me odën në përgjithësi dhe merr një trajtim formal në lidhje me funksionin që kryen. Pjesa e prapme e volumit zvogëlohet gradualisht, megjithatë ruan po atë mënyrë funksionale si variantet e mëparshme. Pamja ndahet në tri nike të suvatuara me theksim vertikal, të trajtuara përqark me një kornizë të profiluar, të cilat mbyllen lart me dy harqe të takuar në qendër. Hyrja për në odë bëhet në mesin e saj, ndërsa në dy anët brenda hapësirës së nikeve, vendosen dolapë me flegra xhami ose të kombinuara me dërrasa, mbi të cilat ka ose jo dritare të vogla për ndriçimin e mjedisit të dhipatosë. Pjesa e poshtme është e veshur me dërrasa vertikale të profiluara, me konfiguracion të lakuar, të cilat mbyllen me një sheshore.

Korniza ndarëse e volumeve nuk ekziston më, po ashtu dhe ndërlidhja e odës me mjedisin sanitar. Trajtimi arkitektonik i pamjes, me motive të harkuara, me suvatim, tregon influencën e rrymave të arkitekturës bashkëkohore në brendësinë e mjediseve, gjë që reflektohet dhe në trajtimin e dollapëve, me kanata xhami. Motivi që është përdorur për dyer njëflegërshe është i stilizuar dhe në shembullin e parë përbëhet nga dy figura rombi (Fig. 6, a). Mbas viteve 90, në kompleksin e mafilit, ndodhin ndryshime të mëtejme, të cilat bëhen duke zvogëluar më tej volumin e tij, që shkon drejt eliminimit, pa patur ndryshime në pamjen ballore (Fig. 6, b). Në lidhje me ornamentikën vërehet një tendencë për pasurimin e saj dhe ngarkimin e elementeve me shumë motive. Njësia e motivit të derës ka elemente të përafërta me katrorin, që zënë gjithë sipërfaqen e saj, të ndarë nga fashatura. Nëpërmjet teknikës së inçizimit janë krijuar figura të stilizuara me motive bimore dhe gjeometrike. Fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX shënon fundin e këtij kompleksi. Varianti i pestë dallohet për një trajtim formal, tashmë ai e ka humbur funksionin[8] dhe dekorin, duke mbetur kështu më tepër si një element i traditës (Fig. 7). Ai ze vend në perden ndarëse me mjedisin ngjitur dhe në trajtimin e pamjes ballore ruan në qendër një nike me theksim vertikal me kornizë të profiluar, e cila zbret deri poshtë në dysheme. Në të dy anët e saj janë vendosur dy dollapë muri me flegrat me xham dhe zemra dërrase, sipër të cilave janë dy dritare formale me xham. Në pamjen ballore dekoracioni është shumë i varfër dhe kufizohet vetëm në krijimin e profileve me suvatim dhe prej druri.

Po të shikojmë trajtimin e kompleksit në të gji-

8) E. Riza, **Oda e miqve në banesën qytetare shqiptare,** Etnografia shqiptare, 1983, Nr. 13, f. 268.

tha zgjidhjet në aspektin teknik do të shikojmë se elementi bazë i ndërtimit të tij, është druri. Gjithë sistemi strukturor përbëhet prej kolonave vertikale dhe trarëve horizontalë, të cilët vishen me dërrasa. Pamja ballore e kompleksit, në zgjidhjen e parë, të dytë dhe pjesërisht të tretë, trajtohet me dërrasa të profiluara, ndërsa në dy zgjidhjet e fundit realizohet me suvatim mbi paretkat e drurit (teknika e çatmasë). Edhe profilet e krijuara në suvatim këtë teknikë përmbajnë. Përveç drurit një material tjetër, i cili kryen funksionin, jo vetëm për lidhjen e elementeve prej druri, por mbart dhe vlera dekorative, janë gozhdët dhe elementet e tjera prej hekuri, si bravat, llullat dhe menteshat. Deri në vitet 80 janë përdorur gozhdët e kovaçit, me përmasa nga 1 – 12 cm, sipas funksionit që kryente elementi i drurit, të cilat kanë formën e pykës, për të siguruar një mbërthim më të qëndrueshëm. Në pamjen ballore të kompleksit zënë vend dhe pullalijet (gozhdët me kokë të madhe), të vendosura në flegrat e dyerve dhe të musandrës. Pas viteve 80 u futën gozhdët e industrializuara.

Edhe në banesën e Beratit kompleksi musandër – dhipato (mafil) është i pandarë nga oda e miqve dhe zë po atë vend, në zgjidhjet e ndryshme të banesave, si dhe në odën gjirokastrite.

Kompozimi arkitektonik i tij është disi i ndryshëm nga i Gjirokastrës, por edhe ai përbëhet nga dy volume të mbivëna. Volumi i poshtëm ka një trajtim dhe funksion të përafërt me atë të Gjirokastrës, veçse duke qenë me përmasa më të vogla, në pjesën e prapme të tij nuk bëhet ndërlidhja me mjedisin sanitar. Volumi i sipërm (mafili) në shumicën e zgjidhjeve del 60-80 cm më tej ballit të musandrës dhe qëndron mbi dy kolona druri anësore, duke lënë të lirë pjesën qendrore. Ai ka një lartësi 130 – 160 cm, e cila në shumë shembuj është më e ulët se dhipatoja në Gjirokastër, për arsye se oda e mirë beratase trajtohet më e ulët, si rezultat i zgjidhjes së banesave me përmasa volumore më të vogla se banesa gjirokastrite. Pikërisht trajtimi i volumit të sipërm, dallon kompleksin e odës gjirokastrite me atë të odës së Beratit, por ka dhe zgjidhje, sidomos ato të fundit të shek. XIX dhe fillimi i shek. XX, të ngjashme. Volumi i mbivënë të parit, në shumicën e zgjidhjeve, është i mbyllur, me çatma të suvatuar dhe ka trajtim ballor të përafërt, me zgjidhjen e tretë të Gjirokastrës. Në shumicën e zgjidhjeve kufiri ndarës i dy volumeve është vazhdim i brezit të ser-



Fig. 8

gjeneve të odës. Funksioni që kryen ky volum përputhet me atë të Gjirokastrës, pamvarësisht nga trajtimi i ballit dhe përmasat e tij.

Dekoracioni në musandrën, kamaret, kolonat, kapitelet, dyert, është i pasur në përbërësit e tij, por në krahasim me atë të Gjirokastrës, në zgjidhjet e para, është më pak i përpunuar. Në trajtimin e pamjes ballore, duke u mbështetur në zgjidhjet e ndryshme, në Berat nuk takojmë rastin e mafilit të hapur si në Gjirokastër, i cili ka një trajtim transparent. Ky përbërës arkitektonik ka ndryshuar vazhdimisht në kohë, por në dallim me Gjirokastrën, në Berat, nuk vërehet një tendencë tipizimi, por ka zgjidhje të larmishme dhe të shumëllojshme. Në rrugën e zhvillimit të tij, ky kompleks, mendojmë se ka kaluar nëpër

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 9

katër variante kryesore.[9] Si kriter bazë është marrë trajtimi i pamjes ballore, mënyra e sasia e dekoracionit, si dhe aspekti funksional.

Variantin e parë të kompleksit musandër – mafil e përbën shembulli me mafil të mbyllur me suvatim (pjesa e sipërme) dhe me pamje ballore të thjeshtësuar (Fig. 8). Në qendër musandra dy flegërshe, në anë kolona me kamaret dhe në krahët dy dyert e skemës së zakonshme. Pamja ballore e kompleksit është trajtuar në një plan. Ndriçimin, volumi i sipërm, e merr nga dritaret që dalin në çardak. Në krahasim me variantin e parë të mbyllur të Gjirokastrës trajtimi dhe zhvillimi hapësinor mbetet më prapa, megjithëse është më i hershëm dhe i takon çerekut të fundit të shek. XVIII, variantit të banesës me çardak në gjithë ballin. Në trajtimin ballor musandra dhe dyert kanë një punim dekorativ pa motive, por konturohen nga fashatura të profiluara. Hapësirat e kamareve përmbajnë në formë motivin e stilizuar të derës me buzët të profiluara.

Varianti i dytë, i cili përfshin një diapazon kohor të gjerë, nga fundi i shek. XVIII deri në gjysmën e parë të shek. XIX (Fig. 9), ka si tipar dallues trajtimin në dy volume të kompleksit në të cilën volumi i sipërm i mbyllur, del përtej të parit 60-80 cm dhe mbështet në dy kolona druri të latuara në buzë, ndërsa kufiri ndarës i tyre është vazhdim i brezit të sergjenëve të odës dhe si zgjidhje planimetrike është skema e njohur. Shembujt që do të përshkruajmë, kanë të njëjtin konceptim funksional, dhe trajtim arkitektonik, por specifika dalluese mbetet në mënyrën dhe sasinë e dekoracionit dhe në kompozimin

9) E. Riza, **Banesa popullore në qytetin-muze të Beratit,** Monumentet, 1981, 1, ku autori përshkruan banesat dhe jep datimin e përafërt të tyre. Elementet arkitektonik janë marë kryesisht nga këto banesa f. 11-20.

e volumit të sipërm, i cili merr forma të larmishme ballore. Në shembullin e parë, i cili i takon fundit të shek. XVIII[10], volumi i mafilit ndahet në tri nike të pajisura me dritare. Ato janë vazhdim i pjesës së poshtme të kolonave dhe mbyllen sipër me hark gjysmë rrethor, sipas madhësisë së hapësirave, të cilat shoqërojnë me konfiguracionin planimetrik thyerjen e kufirit ndarës (Fig. 9,a). Dekoracioni i daltuar në këtë kompleks dallohet vetëm në hapësirat e kamareve, të ciiat janë trajtuar me motive të ndryshme të stilizuara me buzët e profiluara. Në elementet e tij vendin e dekoracionit të daltuar e mbulon ngjyrosja, si në variantin e parë të Gjirokastrës, por me ndryshimin që ngjyrosja e përbërësve të kompleksit të Beratit bëhet me gjithë fushën, ndërsa në Gjirokastër ngjyrosin zemrat e paneleve. Fushat e dyerve dhe flegrat e musandrës janë të dekoruara me figura të ngjyrosura trekëndore, katrore dhe rombi, ndërsa sfondi i tyre me vizatime vijash të përdredhura me motive floreale. Në shembullin e dytë dhe të tretë[11] volumi i sipërm i mafilit kompozohet pa thyerje dhe nike si në shembullin e mëparshëm (Fig. 9, b,c). Pamja ballore është e rrafshët, me trajtim, të përafërt, por ndryshon konfiguracioni i dritareve. Volumi i poshtëm ka kompozim tradicional me pamje simetrike ose jo. Në aspektin e trajtimit dekorativ, në shembullin e dytë, tonin ia jep ngjyrosja e elementeve të drunjta, siç janë dyert dhe musandrat. Në këtë rast motivi i ngjyrosur përbëhet nga figurat e kombinuara të rombit dhe katërkëndëshit, ndërsa hapësirat e







Fig. 10

Fig 11











Fig. 11

DO NOT COPY

kamareve kanë motivin e stilizuar të derës. Kolonat kanë trajtim të hollë, punuar me inçizim në lartësi. Në shembullin e tretë, fundi i shek. XVIII dhe fillim të shek. XIX, dekoracioni fillon të pasurohet në drejtim të gdhendjeve duke zënë vendin e ngjyrosjes. Flegrat e musandrës dhe dyert konturohen me fashatura të profiluara. Kolonat punohen me daltime dhe kurorëzohen me kapitele të punuara me motive të harkuara. Xokolatura poshtë musandrës trajtohet e harkuar dhe mbyllet sipër me një sheshore, e cila ndjek po atë konfiguracion. Shembulli i katërt (Fig. 9,d) ngjason në vizionin e përgjithshëm me shembullin e parë, por ndryshon mënyra e përpunimit kompozicional dhe dekorativ, duke arritur një stad më të zhvilluar në sensin artistik. Volumi i sipërm është trajtuar me një nike të thelluar në qendër, e cila konturohet nga një fashaturë dërrase e dhëmbëzuar. Pamja e volumit të poshtëm është simetrike me kompozimin tradicional, ku pjesa qendrore është e futur më brenda. Në aspektin dekorativ flegrat e musandrës ndahen në dy katërkëndësha, të cilët formohen nga konturimi me fashatura të profiluara dhe të dhëmbëzuara. Edhe dyert kanë po atë motiv, por me përmasa më të mëdha. Hapësirat e kamerave në këtë shembull trajtohen me gdhendje me teknikën e tejshpimit dhe ngjasojnë me ato të variantit të dytë të Gjirokastrës. Ky shembull qëndron më i arrirë si kompozim dhe dekoracion në krahasim me shembujt e mësipërm. Shembulli i pestë (Fig. 9,e) është i një stadi më të zhvilluar në kuadrin e evoluimit të kompleksit në drejtim të kompozimit volumor dhe trajtimit arkitektonik dhe i takon gjysmës së dytë të shek. XIX. Karakteristikë është se volumi i sipërm del përtej ballit të musandrës 1.40 m dhe peshon mbi dy kolona druri. Ky volum ka në qendër një nike të thelluar, e cila anash ndjek drejtimin e kolonave, pastaj mbyllet nga gjysma harku të kryqëzuara në qendër. Lartësia e tij arrin 2 m dhe mafili ze një sipërfaqe prej 10 m^2, veçori të cilën nuk e takojmë në shembujt e tjerë të Beratit dhe Gjirokastrës. Dekoracioni i kamareve është i thjeshtë, me motive të lakuara gjeometrike, pa daltime të imëta. Musandra dhe dyert kanë të njëjtin trajtim dhe dekoracion si në shembullin e katërt. Ky kompleks me përmasa të mëdha në të tri dimensionet, reflekton arkitekturën e banesës, e cila shquhet për përmasat dhe trajtimin arkitektonik.[12]

Në variantin e tretë (Fig. 10), i cili mendojmë se i takon viteve 1850-1875, duken shenjat e humbjes së funksionit të kompleksit, por në anën tjetër dekoracioni ze vend të rëndësishëm dhe arrin realizime më të skajme në të gjitha elementet arkitektonike të odës. Në këtë shembull tashmë nuk kemi trajtimin tradicional të zgjidhjeve të para, por i tërë kompleksi zhvillohet në një plan vertikal, pa daljen karakteristike të volumit të sipërm. Pamja ballore është kompozuar me tri nike të futura, të cilat mbyllen me harqe gjysmë rrethore duke formuar një kornizë konkave të suvatuar. Kompleksit i mungon musandra në qendër, ndërsa dyert anësore funksionojnë për ndërlidhje. Dyert në këtë shembull ndahen në dy pjesë, në secilën kemi nga një zvastikë rombike, sipas motivit të përdorur në variantin e katërt të Gjirokastrës.

Varianti i katërtë (Fig. 11, a,b) përmban shembuj të shumtë. Koha e ndërtimit të tij ze 30 vjeçarin e fundit të shek. XIX. Në të gjithë shembujt e fundit shihet një mënyrë e përbashkët trajtimi. Tani kompleksi e ka humbur funksionin dhe mbetet vetëm si një element i traditës, me të njëjtin konceptim si varianti i fundit i Gjirokastrës. Nga këta shembuj, spikat kompleksi në të cilën duken në mënyrë të qartë futja e dukurive të reja[13] në arkitekturë e kombinuar me influencat e rrymave bashkohore, me një sistem të tërë formash të lakuara, jo vetëm në elementet e suvatuara, por edhe të drurit (Fig. 11,b). Në aspektin e realizimit teknik, kompleksi i Beratit ngjason me atë të Gjirokastrës, sepse në të dy rastet ai mbetet një element ndarës dhe nuk merr pjesë si element mbajtës. Problem përbën vetëm mbajtja dhe qëndrueshmëria e peshës së tij, së bashku me sendet që depozitohen në të. Në variantin e dytë, problemi vështirësohet, për natyrën e kompozimit të mafilit, i cili del më tej planit të musandrës prandaj vendosja e dy kolonave simetrike e lehtëson zgjidhjen. Mafili suvatohet gjithmonë mbi skeletin e drurit të veshur me paretka; ndërsa musandra vishet me dërrasa të profiluara dhe të daltuara.

Një dallim me rëndësi qëndron në teknikën e ndërtimit të flegrave të musandrës dhe dyerve të kompleksit. Në Berat aplikohet teknika e ndërtimit të flegrave me dërrasa ngjitur njëra me tjetrën, ndërsa në Gjirokastër ajo e kllaposjes me shumë zemra të kombinuara. Problemet e tjera teknike mbeten të njëjta me ato të Gjirokastrës.

Duke krahasuar komplekset në dy qendrat, mund

10) B. Strazimiri, **Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Bizbiqëve,** «Monumentet», 9, 1975, f. 133.
11) E. Riza, **Vep.cit,** f. 11.
12) E. Riza, **Vep.cit,** f. 13.
13) E. Riza, **Vep.cit,** f. 18.

DOKTORATURA

DO NOT COPY



Fig. 12

të themi që dallimi kryesor qëndron në trajtimin e volumit të sipërm në dy variantet e para, ndërsa volumi i poshtëm, pavarësisht nga ndryshimet në teknikën e ndërtimit, ka afëri në trajtimin kompozicional-funksional të elementeve, si në lidhje me vendin që zenë, ashtu dhe me funksionin që kryejnë. Në zgjidhjet e fundit shihet një ngjashmëri në trajtimin ballor, gjë e cila përputhet me futjen e dukurive të reja në arkitekturë.

II. Në vijim të elementeve arkitektonike, po përshkruajmë **dollapët e murit.** Këto elemente, gjatë periudhës një shekullore, zenë vend të rëndësishëm në odën e mirë gjirokastrite dhe së bashku me oxhakun krijojnë një kompleks dekorativ. Ky është vendi tradicional i dollapëve të murit, jo vetëm për Gjirokastrën, por në mbarë banesën qytetare shqiptare. Ata vendosen edhe në faqet e tjera të odës së mirë, por gjithmonë nën nivelin e sergjeneve. Kompozimi arkitektonik i dollapit përbëhet prej tri pjesëve kryesore: kornizës së fashaturave, dy flegrave, dhe sipas varianteve një ose dy kamareve. Ato zënë sipërfaqe jo të vogla të brendësisë së odës. Dollapi mbart vlera estetike si në aspektin e proporcioneve, të formës, ashtu dhe në drejtimin dekorativ. Edhe ai, si element arkitektonik, ka evoluar në kohë në raport të ngushtë me elementet e tjera. Evoluimi i tij kalon nëpër 4 variante[14]. Varianti i parë përfshin fundin e shek. XVIII deri në vitet 20 të shek. XIX (fig. 12 a).

14) E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë 1981, f. 244-335, banesat Nr. 38, 17, 15, 36, 31, 19, 33, 12.

Dollapët ndërtuar me mënyrën e kllaposjes në qendër kanë të daltuar një zemër katërkëndësh këndrejtë, dhe lart e poshtë dy katrorë të vegjël. Fashaturat e kornizës dhe flegrave në buzë kanë një profilim të imët. Elemente që bien në sy janë dhe gozhdët e kovaçit. Më pas nga vitet 20 deri 50 të shek. XIX (Fig. 12, b,c,d) dekoracioni vjen dhe rritet në elementet e kornizës dhe kamareve, ndërsa flegrat trajtohen me shumë zemra katrore dhe katërkëndësh këndrejtë, me skema të kombinuara me kënd të drejtë. Përparësi merr trajtimi i kornizës me trajta dhe profile të dalura, të gdhendura me motivet e gërshetit, të dhëmbit të sharrës, të cilat kurorëzohen me kapitele të gdhendura me motive bimore. Kamarja e pandarë nga dollapët, trajtohet me një ose dy hapësira sipër e poshtë. Të sipërmet kanë gjithmonë azhure me gardhime të rombuara, të luhatura, të cilat lidhen me fije të drunjta gjatësore. Poshtë flegrave, kamaret, kanë forma të valëzuara me lulëzime ose drethka dy krerëshe me hapje baroke. Këta dollapë dallohen për një punim të pasur artistik të elementeve përqark flegrave, të cilat vetëpunohen me zemra svastike kënddrejta.

Pas viteve 50, deri në vitet 80 ,(Fig. 12,f,g,h) dekoracioni thjeshtëzohet në të tre përbërësit e dollapëve. Kornizat e fashaturave punohen me motive të qeta, ndërsa flegrat trajtohen me pak zemra, me përmasa më të mëdha, me motive të thjeshta gjeometrike, ose dy zemërshe ku dekorin e përbëjnë disa vijëzime në formë kanelurash ose me motive bimore. Kamaret zënë vend në pjesën e poshtme dhe mbyllen me flegra pa dekoracion, me hapje sipas aksit horizontal. Në dy dekadat e fun-



Fig. 13

DO NOT COPY

dit të shek. XIX (fig. 12,i,j) ekziston një pririe tjetër, ajo e ngarkesës dekorative në të tre përbërësit. Në korniza përsëriten motivi i dhëmbit të sharës dhe i gjetheve të bashkuara, të punuara me profile të dalura dhe me shumë artikulime. Flegrat trajtohen me pano të vogla katërkëndëshe, me një dimension, të kombinuara dhe të gdhendura me motive bimore dhe me inçizime. Kamaret e sipërme janë transparente, me gdhendje, me motive të lakuara bimore, ndërsa e poshtmja, një flegërshe, është e punuar me inçizime të lehta. Në fillim të shek. XX vendin e dollapit të murit filluan ta plotësojnë mobiljet e lëvizshme.

Edhe në odën e mirë të Beratit, dollapët e murit janë një përbërës i pandarë dhe në variantet e ndryshme pozicioni që zënë dhe mënyra e kompozimit ngjason me atë të Gjirokastrës. Karakteristikë e tij është se dollapi, gjithmonë trajtohet me kamare, lart e poshtë. Gjatë periudhës nga fundi i shek. XIII deri në fund të shek. XIX ne dallojmë në Berat 5 variante. Varianti i parë, çereku i fundit të shek. XVIII (Fig. 13,a), përbëhet nga pjesa qëndrore me dy flegra, kamaret sipër e poshtë dhe korniza përqark. Trajtimi dallohet për thjeshtësinë kompozicionale të flegrave, në të cilat me teknikën e inçizimit janë vizatuar figura të stilizuara, të lakuara gjeometrike, ndërsa kamaret dallohen për një përpunim të pasur dekorativ. Varianti i dytë, fundi i shek. XVIII (Fig. 13,b,c), ka po atë trajtim të dollapit, por përmasat e kamareve rriten. Në aspektin dekorativ shihet një dukuri e re, vendin e gdhendjeve e zë ngjyrosja e flegrave, në të cilat imitohen figura gjeometrike dhe bëhen inçizime të lehta. Fillimi i shek. XIX shënon pririen për ndërtimin e flegrave me një teknikë të re, me zemra, të cilën në Gjirokastër e takojmë më vonë. Në këtë variant kemi pesë shembuj ku shihet si evuluon ky trajtim. Shembulli i parë është më dekoracion të pakët (Fig. 13,d). Flegrat kompozohen me nga dy zemra katrore, ndërsa kamaret trajtohen me gdhendje sipërfaqësore. Shembulli i dytë është më i përparuar në drejtim të dekoracionit (Fig. 13,e). Kompozimi i flegrave është i njëjtë, ndërsa dy kamaret përpunohen më tej në drejtimin estetik. Kamarja e sipërme ka një azhur transparent me motive të rrumbullakosura, të punuara me fije të drunjta dhe e poshtmja një dekoracion të stilizuar, figurash gjeometrike. Në shembullin e tretë (Fig. 13,f), ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XIX, shihet një pririe e re drejt një trajtimi të flegrave prej një cope, njëzemërshe, dhe me një përpunim më të arrirë në aspektin kompozicionalo-estetik. Flegra njëzemërshe ka po ato proporcione dhe qarkohet nga korniza e gdhendur me motive trekëndore, ndërsa kamarja e poshtme punuar me teknikën e tejshpimit ka një trajtim transparent të dekoruar. Korniza që qarkon dollapin punohet me shumë profile. Në gjysmën e dytë të shek. XIX (Fig. 13,g) dekoracioni arrin ngarkesën maksimale duke veshur sipërfaqen e flegrave dhe dy panelet.

Motivi kryesor i këtij shembulli është një vazo dekorative nga e cila shpërndahen lulet që mbushin flegrat e dollapit. Kamarja dhe paneli janë të trajtuara me lule të gdhendura, me forma të përdredhura. Kjo mënyrë punimi në thellësi arrin teknikën më të lartë dhe dekoracioni lexohet në të tri përmasat. Në Berat proporcionet e dollapit arrijnë parametra më të lartë në krahasim me zgjidhjen e fundit të Gjirokastrës. Po ashtu dekoracioni i flegrave dhe kamareve është i një stadi më të përparuar. Shembulli i pestë, fundi i shek. XIX, përbëhet nga një trajtim këndrejtë, me dy flegra, secila e ndarë nga tri katërkëndësha, që kanë të brendashkruar nga një romb. Shihet pririja për një thjeshtësim të dekoracionit dhe për një trajtim të kombinuar me forma gjeometrike të drejta dhe të lakuara, motiv të cilin nuk e gjejmë në Gjirokastër.

Krahasimi i dollapëve të odave të mira të dy qyteteve nxjerr në pah disa ndryshime. P.sh, në Berat kemi trajtimin e flegrave me përmasa më të vogla dhe të hapësirave të kamareve me përmasa më të mëdha. Ndërsa ndërtimi i flegrave, në Berat, bëhet me telajo të formuara nga puthitja e dërrasave në drejtimin vertikal dhe me zemra të mëdha, në Gjirokastër mbizotëron teknika me kllaposje dhe kompozimi me zemra të vogla.

III. **Dera** është një përbërës i rëndësishëm i odës së mirë gjirokastrite. Ajo zë vend në faqen perimetrale të saj, në pjesën fundore, nga ana e mjedisit të ndërlidhjes. Në formulimin arkitektonik të saj tregohet një përkujdesje e veçantë, si në formë dhe në dekoracion. Ajo përbëhet nga dy pjesë kryesore, nga fashatura së bashku me kornizën dhe nga kanati, përgjithësisht njëflegërsh. Duke qenë përbërësi i parë me të cilin biem në kontakt, për të është treguar përkujdesje edhe në aspektin estetiko-dekorativ, gjë e cila pasqyrohet në harkun e valëzuar dekorativ, dhe elementet prej hekuri të rrahur. Flegra e dyerve përbëhet nga një telajo e formuar nga elemente katërkëndsh këndrejtë, të lidhur me teknikën e kllaposjes. Duhet të theksojmë se evolucioni i dyerve ndjek në vija të përgjithshme atë të dollapëve. Gjatë periudhës që analizojmë, tri janë variantet kryesore. Deri në vitet 20 të shek. XIX, formulimi i tyre bëhet nga kombinimi i zemrave katërkëndëshe dhe katrore me përmasa të mëdha (Fig. 14,a). Harku mbi derë, trajtuar me shumë valëzime dhe thyerje pa dekoracion, vetëm buzët i ka të profilua-

DOKTORE

DO NOT COPY





Fig. 14

ra. Nga vitet 20-80 kjo teknikë përpunohet më tej nëpërmjet trajtimit të sipërfaqes së derës me shumë zemra, me përmasa të vogla, me një motiv me pamje të ndërlikuar, i cili kërkon një realizim shumë të saktë. Me këtë zgjidhje takojmë shembuj që ndryshojnë nga këndi i vendosjes së zemrave në raport



Fig. 14b



Fig. 14c

me kornizat anësore, paralel ose me një kënd 45° (Fig. 14,b,c), ndërsa shembulli i tretë është një kombinim i tyre. Pas viteve 80, siç shihet, në dy shembujt e mëposhtëm, shkëputemi nga kjo teknikë. Shembulli i parë është trajtuar me dy rombe me fashatura të profiluara pa dekoracion, por me një pamje të qetë (Fig. 14,d), i dyti me pano të mbushura me dekoracion të shumëllojshëm, ka një trajtim të përafërt me dollapët e murit (Fig. 14, e).

Dyert e odave të mira në tipin e banesave me çardak janë të vendosura në të njëjtin pozicion, si në Berat dhe në Gjirokastër. Në dy grupet e tjera të banesave zënë vend, gjithmonë, në mjediset e ndërlidhjes, por jo në pjesën fundore. Në krahasim me Gjirokastrën, trajtimi arkitektonik i tyre dallohet nga një përkujdesje jo e veçantë në zgjidhjet e para dhe vjen duke u rritur në zgjidhjet e fundit. Edhe në dyert, si tek dollapët, ruhet e njëjta frymë kompozimi arkitektonik, por dekoracioni është i paket. Pjesët përbërëse, funksioni që kryejnë, ngjasojnë me të Gjirokastrës, por ndryshon realizimi teknik, meqenëse në Berat flegrat formulohen po me atë mënyrë si dhe dollapët. Në periudhën që analizojmë dallojmë tri variante kryesore. Varianti i parë, i çerekut të fundit të shek. XVIII, ka një trajtim të thjeshtë të flegrës (Fig. 14, f), e cila përbëhet nga një telajo me dërrasa të bashkëngjitura, e konturuar me fashatura të profiluara. Harku mbi derë është gjysmë rrethor, ndërsa mbështetjet i ka me profil të gdhendur. Dallohen gozhdët e shumta të kovaçit dhe elementet e tjera me hekur të rrahur. Në variantin e dytë, gjatë fundit të shek. XVIII (Fig. 14,g), trajtimi i saj thjeshtëzohet dhe vendin e dekoracionit e zë ngjyrosja e flegrës me motive të lakuara dhe figura gjeometrike. Harku mbi derë është gjysmë rrethor dhe mbështetja vjen duke u shtrirë me lakime të vogla. Gjatë shek. të XIX kemi një larmi formash me trajtime të ndryshme brenda një diapazoni kohor të gjerë. Shembulli i parë, fillimi i shek. XIX, ka një trajtim të përafërt me variantin e parë, por është më i përpunuar dhe ruan harkun gjysmë rrethor mbi derë, i cili nuk përdoret në shembujt e tjerë. Shembulli i dytë është dy flegërsh dhe përbën deri tani rastin e vetëm për të dy qytetet. Çdo flegër ndahet në tre katërkëndësha të konturuara me fashatura të profiluara, por pa dekoracion. Shembulli i tretë bën një hap përpara drejt një trajtimi, të cilin nuk para e takojmë në Berat, por që në Gjirokastër është mbizotërues. Dera është një flegërshe dhe trajtohet me teknikën e kllaposjes me zemra me përmasa të vogla, me motivin e svastikës që përsëritet disa herë. Shembulli i katërt është po njëflegërsh dhe ndahet në katrore dhe katërkëndësha kënddrejtë të përzgjatur, të formuar nga konturimi me fashatura të profiluara nga të dy anët. Shembulli i pestë është i trajtuar me dy svastika rombike lart e poshtë (Fig. 14,h), motiv të cilin e takojmë me një trajtim më të thjeshtëzuar.

Shembulli i fundit (Fig. 14,i) përbëhet nga dy svastika, kënddrejtë dhe rombike. Fundi i shek. XIX sjell një thjeshtësim në trajtimin e dyerve.

DO NOT COPY



Fig. 15



IV) **Oxhaku,** në odën e mirë gjirokastrite, ndërtohet në muret perimetrale anësore, përbri kompleksit musandër-dhipato, duke lënë të lirë faqen ballore, në të cilën vendoset grupi i dritareve. Në shembuj të pakët, oxhakun e gjejmë të vendosur edhe përballë kompleksit, në faqen e ngushtë, por në këtë rast oda ka një shtrirje gjatësore me truallin dhe dritaret janë të vendosura në brinjën më të gjatë të saj. Trajtimi arkitektonik i oxhakut ka një theksim vertikal. Ai përbëhet prej vatrës, tamburit dhe tymtarit, i cili përbëhet nga kanali i lëvizjes së tymit dhe volumit mbi çati. Oxhakët e odave të mira, ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XIX, janë funksionalë, ndërsa pas kësaj periudhe shërbejnë si oxhak dekorativ, pa tymarë, shpesh herë dhe pa vatrën, por në të dy rastet në to vendosej prush zjarri. Në aspektin estetik, të dy llojet e oxhaqeve, trajtohen me përkujdesje të veçantë dhe të harmonizuar me përbërësit e tjerë të odës. Theksimi vertikal i tyre, i cili thyen monotoninë e brezit të sergjenëve që qarkon odën, ngjyra e bardhë, ose ngjyrosja e tyre me nuanca të ndryshme, në kontraste me ngjyrën e drunjtë, të të gjithë përbërësve të tjerë, trajtimi me forma e dekoracione në stuko-reliev, kurora qarkuese e valëzuar, e bëjnë oxhakun një nga përbërësit më të vlerësueshëm të odës. Në periudhën që analizojmë dallojmë dy drejtime kryesore në ndërtimin e tij[15]. Në variantin e parë kemi tre shembuj (Fig. 15,a, b,c), të cilët i takojnë gjysmës së parë të shek XIX dhe në pamjen e parë kanë ngjashmëri në formë. Ata përbëhen nga baza gjysmëcilindrike ose prizmatike, të cilat me një rakordim të lehtë përfundojnë në një trajtë të përafërt me gjysmësferën. Në shembullin e parë, të vitit 1811 – 1812 dhe të tretë të vitit 1850 (Fig. 15,a,c), kemi një ngjashmëri më të përafërt në aspektin dekorativ, ndërsa shembulli i dytë, që i takon vitit 1823 (Fig. 15,b), ka një trajtim më të stilizuar.

Tamburi zbukurohet me pemë të plazmuara e të pikturuara. Trajtimi dekorativ i tamburit dhe i kurorës së valëzuar mbi të, bëhet me



Fig. 16

15) E. Riza, **Vep.cit.,** f. 163.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

teknikën e stuko-relievit, dhe me ngjyra që paraqesin motive bimore. Nga vitet 40-50, deri në vitet 80, varianti i dytë i oxhakëve pavarësisht nga ndryshimet e vogla, ka një konceptim të përbashkët në trajtimin e volumit të tamburit me dy vëllime të mbivëna (Fig. 16). Vëllimi i poshtëm ka formë gjysmë cilindrike, me hapje ballore karakteristike, me buzë me trajta të luhatura rrethore ose valëzore. Vëllimi i sipërm ka formë shatore gjysmë konike, mbuluar me bisqe, të përkulura në majë dhe të përhapura në të dy anët me bisqe, me forma gjethesh të lakuara. Korniza ndarëse e dy vëllimeve ruan një vijë të qetë, me luhatje të formuara nga rakordimi i tri harqeve. Dekoracioni dhe në variantin e dytë është realizuar me stuko reliev, por me motive më të thjeshtësuara.

Oxhaku në odën e mirë beratase, përsa i përket pjesëve përbërëse dhe kompozimit arkitektoniko-volumor ka përputhje me të Gjirokastrës, por në qoftëse në Berat variantet e para, kanë një trajtim të thjeshtë, pavarësisht se janë pak më të hershëm, në shembujt e fundit përsosen në formë, ndërsa në Gjirokastër ndodh e kundërta.



Fig. 17

Gjatë fundit të shek. XVIII varianti më i hershëm dhe më i thjeshtë (Fig. 17,a), i cili lidhet me tipin e banesës[16], ka një trajtim arkitektonik të veçantë, të përbërë nga tre volume të mbivëna. Dy paralelpipede kënddrejta njëra mbi tjetrën, që ndahen nga një kornizë katërkëndësh këndrejtë, mbi të cilët vendoset një piramidë jo barabrinjëse. Dekoracioni është i pakët, gjë që pasqyrohet edhe në elementet e tjera që përshkruam. Në vazhdim të kësaj periudhe,

16) E. Riza, **Vep.cit,** f. 12.

DO NOT COPY



Fig. 18

varianti i dytë (Fig. 17,b) paraqitet me një oxhak të trajtuar me dy vëllime të mbivëna (që të kujton variantin e parë të Gjirokastrës). Baza është prizmatike, me hapjen ballore karakteristike, me buzët me trajta të luhatura, e mbi të shatorja gjysmë konike. Ky tambur ka qenë i ngjyrosur (gjurmë të tij ruhen në të dy anët e pjesës konike). Korniza ndarëse horizontale më e dalë, me konfiguracionin e saj shoqëron bazën prizmatike. Dekoracioni i thjeshtë trajtohet me teknikën stuko-relief. Shatorja është konike, ndërsa pjesa e sipërme e bazës me kanelura vertikale. Gjatë shek. XIX, shembujt që do të analizojmë ndjekin një vazhdimësi kronologjike dhe ngjasojnë në aspektin e trajtimit volumor (Fig. 17, c,d,e,f). Baza është prizmatike, ose cilindrike, ndërsa shatorja është formuar nga një ose dy trungje koni të mbivëna mbi të cilat vendoset gjysma e konit që përfundon, në afërsi të tavanit, me një pano të lulëzuar në stuko-relief. Ngarkesa dekorative vjen duke u shtuar nga shembulli i parë deri tek i katërti, ndërsa në të pestin mbizotëron forma e lakuar në trajtimin hapësinor të tymarit dhe dekoracioni pakësohet.

V) **Tavani,** në odën e mirë gjirokastrite, mbyll hapësirën e sipërme të saj dhe ka gjithmonë formën e katërkëndëshit kënddrejtë të përzgjatur. Trajtimi i tij arkitektonik i përmbahet një fryme përpunimi të njëjtë me përbërësit e tjerë, kompleksin musandër-dhipato, dollapëve të murit, dyerve, oxhakëve, duke krijuar së bashku me to një unitet stilistik. Përbërësit kryesorë janë: korniza konturuese katërkëndëshe kënddrejtë, trekëndëshat e qosheve, bordura konturuese, që formon konfiguracionin e katërkëndëshit jo barabrinjës (trajtim i cili dallohet në tavanet e Gjirokastrës), fusha e tavanit dhe rozeta në qendër. Elementet më të ndryshueshme në kohë janë rozeta dhe bordura tetëkëndore. Problemet konstruktive janë zgjidhur nga mjeshtrat popullorë duke krijuar në tavan, sipas konfiguracionit të tij, një rrjet me listela, të kapura në trarët, mbi të cilat mbërthehen elementet përbërëse të tij. Gjatë periudhës prej një shekulli mund të ndjekim ecurinë e tij dhe të dallojmë tri variantet kryesore. Në variantin e parë në të cilën dallojmë dy shembuj kemi tavane me një trajtim të thjeshtë, pa zbukurime. Shembulli i parë i vitit 1791



Fig. 18c

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 19

përbëhet nga një fushë e mbushur me një rrjet katrorësh, me në qendër rozetën katrore, trajtuar me figura të çrregullta gjeometrike, të punuara me incizim. Shembulli i dytë fundi i shek. XVIII (Fig. 18,a) ka një trajtim edhe më të thjeshtëzuar. Fusha është e mbushur me po atë rrjet katrorësh, ndërsa në qoshe ka nga një trekëndësh të formuar nga fashaturat e profiluara, të cilat ruajnë gjurmë të lehta ngjyrosje. Varianti i dytë, që i takon gjysmës së parë të shek. XIX, ka një trajtim të qartë kompozicional. Korniza katërkëndore thyhet në skaje duke formuar trekëndëshat. Bordura e dytë, 8 këndësh jo bara-

brinjës, është në një plan më të futur se e para. Në qendër të saj është rozeta tetëkëndësh i rregullt me një zemër rrethore plot dekoracion.

Rozeta rrethohet me një ose dy bordura tetëkëndore në një plan ose jo me fushën e tavanit.

Shembulli i parë i vitit 1811 – 1812, i dyti i vitit 1823 dhe i katërti i vitit 1850, me zgjidhje të njëjtë kompozicionale (Fig. 18,b,c,e) sipas konfiguracionit planimetrik ndahen në dy pjesë. Pjesa ballore pranë dritareve ka një trajtim të veçantë të tavanit, i cili shkëputet nga tavani qendror me një kornizë të dekoruar me azhure. Tavani i qoshkut, në shembullin e parë (Fig. 18,b), përsërit në miniaturë tavanin qendror, por është i ngjyrosur, i dyti përbëhet nga dy pjesë me nga një rozetë të rrumbullaktë në qendër (Fig. 18,c), i treti është trajtuar me një rozetë të madhe tetëkëndore, e cila ka anash dy fusha të qeta. Tavanet qendrore të tre shembujve kanë të njëjtin trajtim, me një rozetë tetëkëndore në qendër në një plan me fushën, ose të futura më brenda. Ata, shquhen nga punimi me dekoracion, me gdhendje ose inçizim, me figura të ndryshme gjeometrike ose bimore. Shembulli i tretë, i vitit 1827 (Fig. 18, d), ka po atë zgjidhje kompozicionale, me përjashtim të rozetës, e cila është në formën e yllit me 8 cepa dhe formohet nga dy katrorë të mbivënë. Tavanet e këtij varianti, në aspektin kompozicional, janë më të arrira. Varianti i tretë, periudha nga vitet 50 deri 90, karakterizohet nga një shumëllojshmëri tavanesh, me trajtim të përafërt. Pjesët përbërëse të tavanit kompozohen në një plan, ndërsa të katër skajet e bordurës pranë trekëndëshave lakohen së bashku. Fusha e tavanit është e mbushur me listela të profiluara me motivin e gjethes me një vendosje 45° me planet e mureve. Rozeta që në shembullin e parë (Fig. 18,f) është në formën e yllit me 8 cepa, tek shembulli i dytë nuk ekziston, ndërsa në shembullin e tretë (Fig. 18, g) është trajtuar me perimetra të përbërë nga tetë gjysmë rrathë të jashtëshkruar një tetëkëndëshi dhe në shembullin e katërt rozeta në qendër me formën e yllit me tetë cepa (Fig. 18,h) e ka fushën të trajtuar me listela gjatësore të gdhendura. Ndryshimi i tavanit të odës së mirë beratase nga ai gjirokastrit qëndron në radhë të parë në konfiguracion, i cili në Berat, në shumicën e zgjidhjeve, ka formë të përafërt me katrorin dhe trajtim të përsosur dekorativ në shembujt e fundit, që arrijnë realizime të skajme. Përbërësit kryesor të tavanit të Beratit, përngjajnë me të Gjirokastrës, por ndryshon sipas zgjidhjeve gjerësia e kornizave katërkëndëshe kënddrejtë ose katrore, bordura tetëkëndore barabrinjëse dhe rozeta, të cilat janë me përmasa më të vogla, gjë që reflektohet dhe nga siperfaqja më e vogël e odës së mirë beratase. Në periudhën që analizojmë dallojmë pesë variante kryesore. Varianti i parë i fundit të shek. XVIII (Fig. 18,i), ka një trajtim të thjeshtë dhe përbëhet nga dy tavane, sipas konfiguracionit planimetrik dhe përputhet me variantin e dytë të Gjirokastrës në aspektin e trajtimit volumor të hapësirës së odës. Tavani kryesor është konturuar nga korniza katërkëndëshe kënddrejta. Fusha është mbushur me një rrjetë katrorësh paralel me të katër faqet dhe në qendër ka rozetën tetëkëndore me një trajtim të thjeshtë dekorativ. Korniza e gjerë e saj dhe qendra rrethore, punuar me teknikën e inçizimit, është e rrethuar nga gjashtë sektorë rrethorë ku ruhen gjurmët e ngjyrosjes. Tavani i qoshkut është trajtuar po me atë mënyrë me një rozetë më të thjeshtëzuar në qendër. Varianti i dytë, fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX (Fig. 18,j), paraqet një trajtim më të përpunuar dhe më të kompletuar në të gjithë përbërësit. Fusha është e mbushur me katrorë dhe në qendër ka rozetën tetëkëndore të përbërë nga tri rrathë tetëkëndëshash. Qendra në formë kazani, e futur më brenda, është trajtuar me gdhendje sipërfaqësore, po ashtu dhe trekëndëshat. Në kompozimin e përgjithshëm ngjason me variantin e dytë të Gjirokastrës, por ndryshon trajtimi i elementeve në plane të ndryshme, forma e tavanit dhe dekoracioni është më i pakët. Në variantin e tretë, gjysma e parë e shek. XIX (Fig. 18, k) ruhet po ai kompozim arkitektonik, por fusha është më brenda dhe rozeta tetëkëndore në qendër me sipërfaqen anësore të gdhendur me motive të lulëzuara futet më në thellësi.

Varianti i katërt paraqet nivelin më të lartë të kompozimit arkitektonik dhe përsosmërinë dekorative. Ai vazhdon gjatë viteve 50-80 të shek. XIX. Shembulli i parë (Fig. 18, l) ka kornizën katërkëndëshe këndrejtë, trekëndëshat, pastaj ka një futje më brenda me një bordurë të suvatuar të harkuar, e cila ka formën e një tetëkëndori të përzgjatur, me brinjët të valëzuara. Në qendër rozeta ovale, në një plan me fushën është realizuar me një teknikë të lartë gdhendjeje në thellësi, ndërsa fusha është trajtuar me trekëndorë që vinë e hapen nga qendra drejt perimetrit të onduluar, duke na dhënë imazhin e një luleje të madhe.

Shembulli i dytë ka po këtë trajtim, por me theks drejt linjave të drejta (Fig. 18 m). Bordura e suvatuar, e cila bën dhe thellimin, është tetëkëndore, ndërsa në qendër është rozeta e rrumbullaktë, me punim si në shembullin e parë, nga e cila shpërndahen dy rradhë tetë këndorë në formë ylli të ndërthurur, që formojnë fushën e tavanit. Sipërfaqet e krijuara nga kjo ndërthurje vishen me dekoracion

DOKTORAT

të gdhendur, duke arritur zgjidhjen më të skajme në aspektin estetik. Në këtë fazë, Berati, arrin majat në trajtimin kompozicional dhe dekorativ me një ekspresivitet të theksuar, ndërsa Gjirokastra ka një thjeshtësi në të dy këto aspekte. Pas kësaj periudhe në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX vërehet një rënie e dekoracionit të lulëzuar dhe shihen dy drejtime, njëra për skema të ndërlikuara gjeometrike dhe tjetra për skema të qeta.

VI. **Dritaret** në odën e mirë gjirokastrite i takojmë gjithmonë me grupime treshe ose katërshe në ballë, ndërsa të veçuara në faqet anësore, por gjithmonë pranë pamjes kryesore. Në zgjidhjet e ndryshme të odës së mirë paraqiten gjashtë raste të fluksit të ndriçimit në vartësi të pozicionit të dritareve në pamjen ballore dhe anësore (Fig. 19). Dritaret vendosen shumë ulët, me qëllim që duke qëndruar ulur në nime, pa vështirësi, të shohësh në një kënd vështrimi sa më të shtrirë në planin horizontal dhe vertikal. Trajtimi arkitektonik i pamjes ballore të dritareve, kompozohet në një shirit horizontal, i cili lart dhe poshtë ka fashaturat që krijojnë lidhjen. Ndarja e hapësirave realizohet me fashatura vertikale, me buzët e profiluara. Kufiri i sipërm i tyre përkon me brezin e sergjeneve që qarkojnë odën, ndërsa i poshtmi me brezin e fashaturave, të cilat bashkohen me dollapët.

Dekoracioni i elementeve të dritareve nga ana e brendshme dhe tarabave është trajtuar me të njëjtën frymë me dollapët, dyert, tavanin dhe kompleksin musandër – mafil. Kornizat kanë të njëjtin profil për të gjitha këta elemente dhe përgjithësisht, kanë daltime në formë dhëmbësharre ose forma të lakuara ritmikisht.

Gjatë shek. XIX ky element ka evoluar në kohë, duke kaluar nëpër katër variante kryesore. Forma më e thjeshtë, viti 1811-1812, është ajo me kafaz druri nga brenda dhe kapak dy flegërsh nga jashtë (Fig. 20,a). Trajtimi i tyre është i thjeshtë, pa dekoracion. Këto dritare shoqërohen me mbi dritare fikse prej allçie, të cilat kanë forma të thjeshta dhe bëjnë ndriçimin e odës kur flegrat janë të mbyllura. Varianti i dytë i vitit 1823 (Fig. 20, b) i përbërë nga një kanatë e vetme, e ndarë në dhjetë hapësira xhami vendoset me kllaposje, e cila ngrihet lart, duke u futur në brendësi të çatmasë së ballit. Nga jashtë kanë një kafazlie prej druri ose rrjetë hekuri të ndarë në katrore. Përmasat e kanatës janë 90 x 1,35 m, por në zgjidhjet e mëtejme zvogëlohen. Sipër këtyre dritareve vendosen gjithmonë mbidritare fikse prej allçie, të cilat përmirësojnë ndriçimin e odës në thellësi. Lartësia e odës në këto shembuj shkon deri 3,5 – 4 m. Dekoracioni dhe motivet e këtyre mbidritareve kanë konfiguracione të ndryshme. Në to është përdorur dhe ngjyrosja e xhamave. Ky element është përdorur gjerësisht edhe në qytetet e tjera të vendit, por në Gjirokastër ka realizime më të arrira.



Fig. 20

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 21

Në vitet 1825 deri 1840 filluan të ndërtohen dritaret e variantit të tretë (Fig. 20, c). Në të telajo e xhamit ndahet në dy pjesë dhe prapa saj vendosen tarabat të përbëra prej një ose dy kanate me lëvizje vertikale. Ato trajtohen me dy, tre zemra të thjeshta. Vendi i mbidritareve vizatohet me ngjyra sipas

konfiguracionit të tyre. Në vitet 40 gjejnë përdorim dritaret e pajisura me kanata dhe taraba një flegërshe (Fig. 20, d) me lëvizje horizontale, të cilat futen në brendësi të murit të gurtë anësor, dhe kanë një trajtim të ngjashëm me të mëparshmet. Varianti i tretë vazhdon të përdoret dhe zë shumicën e shembujve.

Pas viteve 40 deri në vitet 90 përdoret varianti i dytë, me përmasat e hapësirës së dritës të zvogëluara në drejtimin horizontal dhe të rritura në lartësi (80 x 145 cm). Në fund të shek. XIX kemi një dukuri të re në trajtimin e hapësirës së dritares, së cilës i shtohet mbi të një hapësirë gjysmërrethore. Teknika e ndërtimit të kanatave të dritareve dhe tarabave është ajo e kllaposjes.

Dritarja në odën e mirë të Beratit është e vendosur, gjithmonë, në ballin e saj, si dhe në Gjirokastër, por në dallim me të, duke patur parasysh dhe konfiguracionin e odës, kemi dhe zgjidhje ku ato zënë dhe dy faqe të saj. Dritaret e ballit trajtohen me grupime treshe, ndërsa në faqet anësore janë të veçuara. Në raport me sasinë dhe pozicionin e dritareve (Fig. 21) dallojmë gjashtë raste të fluksit të ndriçimit të odës së mirë, e cila duke patur një konfiguracion më afër katrorit ndriçohet më mirë se oda gjirokastrite. Pjesët përbërëse dhe trajtimi kompozicional në përgjithësi kanë afëri me Gjirokastrën. Dritarja ka evolucionin e saj në kohë dhe zhvillohet në tri variante kryesore. Forma më e hershme i takon fundit të shek. XVIII. Ajo është me kafaz druri nga brenda dhe jashtë me dy kanata dërrase të trajtuara thjeshtë, pa dekoracion, por krahas saj kemi dhe dritaren me dy kanata xhami me hapje rreth aksit vertikal (Fig. 22), të cilën nuk e gjejmë në Gjirokastër. Kanatet janë të ndara në tri katërkëndësha me kllaposje. Varianti i dytë, i fundit të shek. XVIII, është me dy kanata me hapje vertikale, e sipërmja fikse, ndërsa e poshtmja ngjitet lart. Mbi to vendosen mbidritaret prej allçie, të cilat në Berat janë më të pakta në numër dhe kanë një trajtim jo të përpunuar si në Gjirokastër. Kanata ndahet me rripa të profiluar në katër katrorë me xhama. Varianti i tretë është vazhdimi i të dytit, por në këtë rast nuk trajtohen më dritaret e allçisë, as nuk imitohen ato në ngjyrë, siç ndodh në Gjirokastër. Dritaret pajisen me tarabah një ose dy flegërshe, të cilat punohen me një ose dy zemra të rrafshëta. Ky variant vazhdon gjatë shek. të XIX me shembuj me zgjidhje të ndryshme, në lidhje me lëvizjen e kanatave dhe tarabave, por në thelb kanë të njëjtën zgjidhje kompozicionale. Në fund të shek. XIX shihen dukuri të reja në të cilat



Fig. 22

pjesa e sipërme e dritares trajtohet e harkuar, siç ndodh edhe në elementet e tjera të odës.

Tipar njësues në dy qendrat mbetet gjuha e njëjtë në konceptimin tërësor të odës së mirë, në trajtimin hapësinor dhe të elementeve. Por kemi dhe veçanti në mënyrat e realizimit teknik, të ngarkesës dekorative, motivet dhe mënyrat e dekorimit të elementeve arkitektonike, që lidhen me tipat e ndryshme të banesave dhe traditën lokale.

Deri në gjysmën e parë të shek. XIX elementet arkitektonike në Berat, në përgjithësi, kanë një trajtim më të thjeshtë, se në Gjirokastër. Në aspektin dekorativo estetik Berati, në çerekun e tretë të shek. XIX, ka realizime më të arrira në formë dhe dekoracion. Karakteristikë dalluese është prirja drejt zgjidhjeve dhe formave njësuese dhe gjeometrizimit të tyre në elementet e Gjirokastrës, krahas formave dhe zgjidhjeve të shumëllojshme dhe më të lirëshme të Beratit.

Nga sa parashtruam elementet arkitektonike të trajtuara janë pjesë përbërëse e rëndësishme e brendësisë së odës së mirë, e cila i zgjidh më së miri të gjitha kërkesat funksionale të kohës. Funksioni jetësor i kësaj ode dhe synimi paraqitës bëjnë që elementet arkitektonike të saj krahas anës funksionale të zënë vend dhe të kompozohen edhe si vlera estetike, duke u vështruar si pjesë të një hapësire, trajtuar me njësim stilistik.

DO NOT COPY

Latif LAZIMI

DO NOT COPY

LA CHAMBRE D'AMIS ET SES ELEMENTS ARCHITECTONIQUES DANS L'HABITATION CITADINE DE BERAT ET DE GJIROKASTRA

RESUME

Les habitations de Berat et de Gjirokastra, sont faites connues par les différentes éditions sur la typologie et leurs valeurs architectoniques. Dans cet article nous allons traiter des éléments architectoniques de la «chambre d'amis» de l'habitation de Gjirokastra et de Berat, vus de façon plus détaillée. Il faut souligner que cet article vise à donner chronologiquement la morphologie et les valeurs des éléments architectoniques de la chambre d'amis dans les deux villes musées, leurs affinités et leurs particularités. A cette fin, on s'est fondé sur les habitations de ces deux centres qui conservent le matériel authentique et appartiennent essentiellement au XIXe sc. Dans les deux villes, parmi les autres pièces de l'habitation, la «chambre d'amis», celle où l'on reçoit les hôtes, se distingue par son traitement architectonique et artistique particulier. Selon la tradition cette pièce située sur la partie frontale, est aménagée à l'état supérieur de l'habitation, à l'une de ses ailes qui font saillie par rapport à la partie centrale. Par ces qualités compositionnelles, la «chambre d'amis» s'accentue sensiblement dans l'architecture de l'extérieur de l'habitation et réciproquement gagne les meilleurs paramètres (en comparaison avec les autres unités de l'habitation) pour la contemplation et la communication avec les autres éléments urbains autours de l'habitation.

En traitant la «chambre d'amis» de ces deux centres de notre pays, sous l'aspect fonctionnel, on remarque ces espaces de volume (fig. 1).

1. L'espace de l'activité quotidienne qui se divise en:

a. Espace de communication (actif) (E.A.)

b. Espace de repos et de contemplation (E.C.)

c. Superficie d'éclairage (Les fenêtres supérieures et inférieures) (S.F.).

d. La cheminée et l'espace qui l'entoure (E.Ch.)

e. Le plafond décoratif (P.D.).

2. L'espace des annexes de service de la chambre d'amis composé de:

a. L'espace de communication (corridor) (E.C.)

b. L'espace à hauteur réduite

c. Les toilettes

d. L'espace utilitaire auvert et fermé («musandra – dhipato»)

e. L'entrée:

D'après la combinaison des éléments déjà mentionnés dans la «chambre d'amis» de Gjirokastra on remarque six traitements (fig. 2) tandis que dans celle de Berat sept traitements compositionnels (fig. 3). La composition et le traitement de la «chambre d'amis» ne peuvent pas être conçus sans la présence des éléments architectoniques. Les principaux éléments qui participent à la formulation architectonique de l'intérieur de la «chambre d'amis» à Berat à Gjirokastra sont:

Le complexe «musandër-dhipato», les placards, les portes, la cheminée décorée, le plafond décoré, les fenêtres, etc. Ces éléments, répondant aux besoins et aux conditions économiques-sociales de l'époque, évoluèrent pendant la fin du XVIIIe sc. et au cours du XIXe sc.

Le complexe «musandër-dhipato», toujours, présent dans la «chambre d'amis» de Gjirokastra et de Berat, est aménagé généralement à côté de la porte de la «chambre d'amis». En tant que composition architectonique, il est formé de deux volumes superposés. La partie inférieure comprend deux avant-entrées latérales qui réalisent la communication de cette chambre avec le tchardak et les toilettes et une partie centrale, occupé par «musandra» une sorte de placard aux grandes dimensions flanqué de niches des deux côtés. Dans l'aspect esthétique l'on peut dire que c'est le plus présentable complexe, tant par les dimensions que par le traitement décoratif. Les éléments décoratifs des portes, des placards, des arcades des colonnes etc. qui représentent de différents motifs géométriques combinés aux symboles floraux et aux éléments ornamentaux en fer, sont travaillés avec goût. On pense que dans sa voie d'évolution, ce complexe a connu cinq variantes principales à Gjirokastra (fig. 4-8) et quatre variantes à Berat, ayant comme crièteres de base le traitement de l'espace de la partie frontale, la décoration et la conception fonctionnelle. De la comparaison du complexe dans les deux villes, il ressort que la différence principale réside au traitement du volume supérieur dans les deux premières variantes, tandis que les volumes inférieurs, malgré les différences dans la technique de leur construction, s'approchent quant au traitement compositionnel fonctionnel des éléments constituants. Aux dernières variantes on remarque une ressemblance au traitement de la partie frontale ce qui répond à l'introduction des nouvelles apparences en architecture.

Les placards, dans la «chambre d'amis» des deux villes, sont aménagés des deux côtés de la cheminée. C'est leur place traditionnelle dans toute l'habitation albanaise. Ils sont composés de la corniche, des deux battants et d'une ou deux niches. Les placards qui occupent une surface considérable à l'intérieur de la chambre participent à son traitement architectonique et s'harmonisent avec les autres éléments. Ils représentent également des valeurs esthétiques tant à l'aspect des proportions et de la forme qu'à celui du traitement décoratif. A Gjirokastra on rencontre quatre variantes principales (fig. 13-15) alors qu'à Berat on en rencontre cinq (fig. 16-18).

La porte est un autre élément important soigneusement décoré de la «chambre d'amis» qui se trouve du côté de l'espace de communication. Elle est généralement composée de deux parties principales, de l'encadrement avec la corniche et d'un battant. Etant donné qu'il est le premier élément auquel on se heurte en entrant dans la chambre, on a porté un grand soin à sa décoration, ce qui se reflète à l'arc décoratif ondulé, à la technique de construction et à l'ornamentation des éléments en fer battu. Si l'on compare les portes des deux centres, les parties composantes et leur fonction présentent des affinités alors que la réalisation technique diffère surtout aux premières variantes. Il faut souligner que l'évolution des portes, en lignes générales suit celle des placards. Dans les deux villes, depuis la fin du XVIIIe sc jusqu'à la fin du XIXe on rencontre trois variantes principales (fig. 19-22).

La cheminée dans la «chambre d'amis» de Gjirokastra et de Berat, est amménagée aux murs périmétraux latéraux, laissant la partie frontale au groupe des fenêtres. Le badigeon blanc ou à de différentes couleurs, le contraste avec la couleur du bois de tous les autres éléments, la décoration en stuc-relief, font de la cheminée, l'un des éléments les plus appréciés du point de vue esthétique. Si l'on compare cet élément dans les exemples des deux villes, ou remarque que à Berat, les premières réalisation bien qu'un peu plus anciennes se distinguent d'un traitement simple qui dans les derniers exemples se perfectionne, tandis qu'à Gjirokastra, il arrive le contraire.

Le plafond de la «chambre d'amis» à Gjirokastra représente un rectangle allongé tandis celui de Berat un rectangle qui s'approche au carré.

Du point de vue du traitement architectonique il est en unité stylistique avec les autres éléments. Il est composé d'un encadrement rectangle, de quatre triangles aux coins, d'une bordure, et d'une rasace au milieu.

Les fenêtres dans la chambre d'amis des deux villes musées, se rencontrent en groupe, dans la partie frontale et séparées dans celles latérales. Selon la position des fenêtres dans les parties frontale et latérale, dans les exemples des deux villes on rencontre cinq ou six variantes de l'introduction du flux de lumière (fig. 28-30). La décoration des éléments intérieurs des fenêtres est réalisée par le même esprit que les placards, les portes, le plafond. Au cours de XIXe sc cet élément a évolué dans le temps, donnant quatre variantes principales à Gjirokastra (fig. 29). et trois variantes à Berat (fig. 31). Au traitement de cet élément, dans les deux centres on remarque une tendence d'unification qui s'accentue dans les derniers exemples.

Le trait commun des deux centres demeure la conception en total de la chambre d'amis, le traitement de l'espace et de ses éléments mais il y a aussi des particularités quand au mode de la réalisation technique, aux motifs et à la décoration des éléments architectoniques, qui se rattachent aux différents types d'habitation et à la tradition locale. Les éléments architectoniques de la ville de Berat, jusqu'à la première moitié du XIX sc, représentent un traitement plus simple par rapport à ceux de la ville de Gjirokastra. Sous l'aspect décoratif-esthétique, Berat, au premier quart du XIX sc offre des réalisations plus achevées en forme et en décoration. Une caractéristique particulière est la tendence vers des solutions et des formes d'unification et l'introduction des figures géométriques dans les éléments de Gjirokastra, de pair aux formes et aux solutions multiples et plus anciennes de la ville de Berat. Les éléments architectoniques font partie à l'aménagement de l'intérieur de la «chambre d'amis», laquelle satisfait bien aux exigences fonctionnelles. De pair au côté fonctionnel dans l'aménagement de son espace, ces éléments occupent une place et se composent également en tant que valeurs esthétiques, étant vus comme partie de toute une unité.

DOKTORSKI

DO NOT COPY

Mirela STRAZIMIRI
Eduard SOPPI

RESTAURIMI I TABLLOSË «DASMA SHKODRANE»

Tablloja «Dasma shkodrane» mban nënshkrimin e vetë autorit Kolë Idromeno, si dhe vitin e krijimit të saj. Dihet që piktori punoi me shkëputje prej katër[1] vjetësh dhe e përfundoi atë në vitin 1924. Vepra është e dimensioneve 94 x 133,5 cm dhe e realizuar në teknikën e vajit (fig. 1).

«Dasma shkodrane» u bë e njohur shumë shpejt. Ajo u prit me interes të veçantë për karakterin e motivit të trajtuar. Tablloja paraqet momentin më emocional të një ceremonie dasme, të zhvilluar sipas zakoneve të vendit. Këtë moment sa të hareshëm dhe solemn, Idromeno, arrin ta interpretojë me mjaft çiltërsi e dashuri. Nga ana kompozicionale vepra është harmonike e në unitet me kolloritin e gëzuar e plotë jetë. Grupet e figurave janë të vizatuara me delikatesë. Për t'u vlerësuar është peneli i brishtë e analitik, që e bën atmosferën e ngjarjes të afërt e të dashur.

Piktura jetoi fare pak në qytetin e saj, në Shkodër, pasi më 1925[2] u dërgua në Romë, në një ekspozitë ndërkombëtare. Pas disa vitesh harrese, më 1937, u dërgua në një ekspozitë tjetër ndërkombëtare në



Fig. 1

1) Mikel Prenushi «Kolë Idromeno»
2) Po aty

DO NOT COPY



Fig. 2

Nju – Jork, e vetëm 32 vjet më vonë, më 1956, u kthye në atdhe me kujdesin e shtetit. Që nga kjo kohë është pronë e Galerisë së Arteve Figurative në Tiranë.

Duke qenë pikturë me vlera, por e ruajtur jo mirë, restaurimi i saj përbënte një detyrë të ngutshme.

Në anën e majtë të tablosë, në gjithë gjerësinë, kishte rënie grunti dhe ngjyre (foto 1). Këto dëmtime pikturës iu shkaktuan nga lagështia, si pasojë e lëvizjeve të shumta, pa kushte të përshtatshme teknike (fig. 2-3)[3].

Për përcaktimin e gjendjes së pikturës nuk u kufizuam vetëm në diagnostikimin e materialeve përbërëse, por kryem shqyrtimin e dëmtimeve.

Ndërtimi i tablosë teknikisht, vërejmë se është kryer me njohuri. Këtë e vërejmë edhe në vepra të tjera të autorit, si në kompozimet: «Dy rrugët», «Shën Mëria me Krishtin», «Portreti i gjyshit», etj. Trashësia e shasisë është zgjedhur mirë, në përshtatje me përmasat e tablosë. Lloji i kanavacës bazë 13 fije e ind 15 fije për cm^2 i përgjigjet teknikës së pikturimit me një pastë të hollë e të shtrirë. Kjo ka ndihmuar në kompozimin me shumë figura dhe me detaje të imëta. Duhet përmendur kualiteti i mirë i materialeve, përjashtuar drurin e shasisë prej bredhi të pavjetëruar plotësisht. Kjo është pasqyruar në lirimin e tepërt dhe prishjen e kllapave.

Shasia nuk është zëvendësuar, çka vërehet nga mbërthimi i kanavacës dhe ndryshkja e thumbave dhe e kanavacës rreth tyre.

Pasi e plotësuam njohjen me të dhënat e duhura teknike, vendosëm që kriteri më i drejtë i ndërhyrjes do të ishte konsolidimi i grundit dhe i ngjyrës, përforcimi i kanavacës i dubluar me kanavacë të re, rivënia e shasisë së re, tendosja e telajos dhe pastrimi e ritokimi me ngjyra të heqshme.

Kanavacën për dublurë e gjetëm me bazë 7 fije e ind 9 fije për cm^2, si kanavaca e pikturës origjinale. Duke qenë shtresa e pikturës tepër e dëmtuar, me plasa e ciflosje, sidomos në zonën e majtë, kryem konsolidimin paraprak të ngjyrës e grundit me letër japoneze, duke përdorur si konsolidues solucionin me përmbajtje tutkall peshku, acid acetik, melasë, jod. Shtrimi i letrave japoneze mbi sipërfaqen e pikturës solli lehtësi në punimet me kanavacën e hequr nga telaja, konsolidimin e shtresës grund – ngjyrë dhe shtrirjen e hekurosjen e kanavacës së rrudhosur e të dallgëzuar. Kanavaca e re u tendos në një telajo të përkohshme, me përmasa më të mëdha se tabloja dhe u lye me ngjitës të përbërë nga tutkall kinez, farë liri e thekre, terpentinë, melasë, e fenol. Po me këtë ngjitës u lye edhe ana tjetër e pikturës. Më tej të dy kanavacat u ngjitën bashkë. Mbi to vendosëm disa shtresa me letër thithëse për shmangien e lagështisë, si dhe pesha me sipërfaqe të rrafshta, duke i lënë një periudhë disa ditore, në mënyrë që të bëhej një tharje graduale. Ndërkohë u bë shasia e re me dru pishe të vjetëruar, me kllapa, duke respektuar përmasën e telajos së vjetër. Kana-

3) Falenderojmë sh. Hasan Nallbani për ndihmën e konsultimin gjatë gjithë punës.

vacat e ngjitura mirë u vendosën në shasinë e re duke u tendosur e mbërthyer me kapse. Pasi u hoqën letrat filloi pastrimi i pikturës me sapun neutral, të tretur në ujë të distiluar me 10% shtesë alkoolietilik dhe 1% amonjak. Solucioni u përdor i ngrohur në një temperaturë rreth 30°.

Vendosëm për këtë solucion pasi analiza tregoi për mungesën e vernikut mbi ngjyrë dhe një sërë papastërtish të ndryshme, tymra, yndyrë etj. Me këtë solucion piktura u pastrua lehtë pa ndonjë problem.

Trajtimi i boshllëqeve të krijuara nga rënia e grundit dhe ngjyrës u bë me tempera pa lidhëse, me ton të njëjtë me ngjyrën korresponduese. Kjo u vendos se piktura kishte shumë ciflosje të imëta e të shpërndara, sidomos në zonën e qiellit. Zonat e ritokuara nuk u gruntuan, por u lanë në frakturën e kanavacës së imët, e cila dallon me frakturën e lëmuar të ngjyrës pranë. Kështu u veprua edhe me ritokimin masiv në anën e majtë, duke lënë të duket



Fig. 3



Fig. 4

BOOT COPY

edhe këtu kuadratimi i imët i kanavacës, kurse vizatimi e ngjyra u plotësuan duke ndjekur gjurmët e copëzave të ngjyrës së ngelur në kanavacë. Për këtë ndihmoi dhe një fotografi e vjetër, e bërë para se piktura të dëmtohej.

Ritokimi, ndonëse me vlerë koloristike të barabartë, dallon si i tillë edhe për një ndryshueshmëri të materialit të ngjyrës. Tempera e përdorur nga ne pasi thahet fiton një velaturë të lehtë të bardhë, çka e bën të dallueshëm ritokimin pa e prishur anën tonale e koloristike të gjithë pikturës (fig. 4)[4]. Së fundi për të mbrojtur ngjyrën nga kontakti i drejtpërdrejtë me mjedisin e ritokimin, piktura u lye me një shtresë të hollë verniku mat, të llojit Damar, pasi pikturat e tjera të këtij autori dallojnë gjithaq nga pamja mat e ngjyrës.

Tablloja e restauruar u ekspozua, përkrah veprave më të mira të Kolë Idromenos, në Galerinë e Arteve Figurative në Tiranë.

DO NOT COPY

4) Fotot janë të Kosta Bej.

Mirela STRAZIMIRI Eduard SOPI

LA RESTAURATION DU TABLEAU «NOCE SHKODRANE»

RESUME

Le tableau «Noce Shkodrane» porte l'inscription de l'auteur Kolë Idromeno, ainsi que la date de sa réalisation. On sait que l'auteur interrompt pendant quatre ans ce travail pour le reprendre et le terminer en 1924. C'est une peinture à l'huile, aux dimensions 94x133,5 cm (fig. 1).

Le tableau ne demeura pas longtemps dans sa ville natale puisqu'en 1925 il fut envoyé à Rome, dans une exposition internationale. Après quelques années d'oubli, en 1937, il fut présenté à une autre exposition internationale à New York, et seulement 32 années plus tord, sous le soin de l'Etat, retrouva de nouveau son pays. Depuis ce jour-là il est la propriété de la Galerie des Arts Figuratifs à Tirana.

L'état dans lequel se trouvait cette peinture de valeur exigeait une intervention immédiate.

Après avoir connu les données techniques, on jugea nécessaire la consolidation de l'enduit et de la couleur, le renforcement du canevas pour le rentoilage, l'aménagement d'un nouveau chassis, la tension de la toile, le nettoyage et la retouche avec des couleurs réversibles. Pour la doublure, on trouva un canevas pareil à celui de la peinture originale. Etant donné que la couche de la peinture assez endommagée présentait des craquelures et des lacunes surtout dans la partie gauche, on procéda à la consolidation préalable de la couleur et de l'enduit avec du japon, en utilisant comme matériel de consolidation le mélange: colle de poisson, acide acétique, mélasse, iode. Le papier japon étendu sur la surface de la peinture facilita l'aménagement du canevas déposé, la consolidation de la couche enduit-couleur et le repassage du canevas risé et endulé (f. 4). Le nouveau canevas tendu sur un chassis plus grand fut enduit d'une colle composée de graines de lin, colle chinoise, térébenthine, mélasse et phénol. On imprégna de la même colle le recto de la peinture et on les maroufla ensemble. On mit en dessus du papier buvant pour éviter l'humidité et des masses lourdes à surface plate qui dans quelques jours permettraient un séchage graduel. Entre temps on aménagea le nouveau chassis à clé, en bois de pin bien conditionné en respectant les dimensions de l'ancienne toile où furent arangés les conevas bien collés. Après avoir enlevé le papier, on procéda au nettoyage de la peinture avec du savon neutre dissous dans de l'eau distillée contenant 10% d'alcool et 1% d'ammogniac. On utilisa une solution portée à une température de 30°. On choisit cette solution parce que l'analyse révéla l'absence du vernis et la présence de diverses matières étrangères telles, poussière, matière grasses etc. Pour le traitement des lacunes on procéda à la détrempe sans liants, avec le même ton que la couleur correspondante. Les zones retouchées ne furent pas enduites, pour être distinctes des autres parties. On procéda de la même façon pour la retouche massive à gauche, laissant visible le fin cadrillage du canevas. Le dessin et les couleurs furent complétés suivant les traces des fragments conservés et les indications d'une ancienne photo prise avant l'endommagement de l'oeuvre (fig. 3.4).

Malgré la valeur coloristique égale, la retouche se distingue par le matériel différent de la couleur. La détrempe à huile qu'on a utilisée, après le séchage offre un léger voile blanc ce qui rend distincte la retouche, sans nuire au ton et aux couleurs de toute la peinture (ph. 5). Enfin, pour protéger la couleur contre le contact direct avec la retouche, la peinture fut enduite d'une mince couche de vernis mat du type Dammer, puisque même les autres peintures de cet auteur se font marquer par leurs couleurs mates.

Le tableau restauré fut exposé dans la Galerie des Arts Figuratifs à Tirana, à côté des meilleures oeuvres de Kole Idromeno.

DO NOT COPY

monumentet

MATERIALE E KUMTESA

Valter SHTYLLA
Kliti KALLAMATA

DO NOT COPY

MBI PJESËMARRJEN E VENDIT TONË NË SEMINARIN NDËRKOMBËTAR ME TEMË «PRINCIPET MODERNE TË KONSERVIMIT DHE RESTAURIMIT TË PASURIVE URBANE DHE KULTURORE NË RAJONET SIZMIKE»

Në kryeqytetin e R.S. të Maqedonisë, Shkup, zhvilloi punimet seminari i I ndërkombëtar mbi «Principet Moderne të Konservimit dhe Restaurimit të Pasurive Urbane dhe Kulturore në Rajonet Sizmike» organizuar nga ICCROM-i (Qendra Ndërkombëtare e Studimit, Konservimit e Restaurimit të Pasurive Kulturore me qendër në Romë), nga RZZSK (Instituti Republikan për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës i Shkupit) dhe nga IZIIS-i (Instituti i Inxhinierisë Sizmologjike i Shkupit).

Vendi ynë në këtë aktivitet u përfaqësua nga Valter Shtylla, Kandidat i Shkencave dhe Kliti Kallamata, Inxhinier-Restaurator.

Seminari i zhvilloi punimet prej datës 17-22 tetor 1988 në sallën kryesore të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (MANU). Në të morën pjesë 97 përfaqësues të 40 vendeve të botës. ICCROM-i përfaqësohej nga Bernard M. Filden, Drejtor Nderi i ICCROM-it (Angli) dhe Jukka Jokilekte (Finlandë). Gjatë seancave u lexuan 47 referate dhe kumtesa mbi «Mbrojtjen e Monumenteve dhe Veprave Muzeore nga Lëkundjet Sizmike». Pati kumtesa dhe për objektet e dëmtuara nga tërmeti i 1963 në Shkup, nga tërmeti i 1979-ës në Dubrovnik, për mbrojtjen sizmike të Algjerit, për probleme teorike të llogaritjeve antisizmike, etj. Nga ana jonë seminarit iu dorëzua për botim artikulli i ilustruar «Masa përforcuese në monumentet e dëmtuara nga tërmetet, në Shqipëri». Gjatë qëndrimit në Shkup u vizituan mjaft monumente dhe komplekse monumentale si, Çarshia e Vjetër, Ura e Vardarit, xhami, hane, si dhe Instituti Sizmologjik dhe Muzeu i Tërmetit të vitit 1963.

Më datën 22 tetor me pjesëmarrësit u organizua një ekskursion studimor në qytetin e Ohrit, i cili bën pjesë në listën e Pasurive Kulturore të Rralla të UNESKO-s.

alter SHTYLLA Kliti KALLAMATA

DO NOT COPY

A PROPOS DE LA PARTICIPATION DE NOTRE PAYS AU SEMINAIRE INTERNATIONAL SUR «LES PRINCIPES MODERNES DE LA CONSERVATION ET DE LA RESTAURATION DU PATRIMOINE URBAIN ET CULTUREL DANS LES REGIONS SEISMIQUES».

R E S U M E

A Skopje, la capitale de la R.S. de Macédoine, nt ses travaux le premier Séminaire International sur «Les rincipes modernes de la conservation et restauration du paimoine urbain et culturel dans les régions séismiques», organisé par ICCROM (Centre International de l'Etude, Préservaon et Restauration du Patrimoine Culturel) par R.Z.Z.S.K. (Institut de la Protection des Monuments Culturels de Skopje) et ar IZIIS (Institut de l'Ingénierie Séismologique de Skopje).

Notre pays fut représenté dans cette activité par M. Valter htylla, candidat des sciences et M. Kliti Kallamata, ingénieur éstaurateur.

Les travaux de ce séminaire où participèrent 97 repréentants de 40 pays, se déroulèrent de 17 à 22 octobre 1988 ans la salle principale de l'Académie des Sciences et des rts de Macédoine, ICCROM était représenté par M. Bernard, l. Fielden, directeur honoraire d'ICCROM (Angleterre) et Mme. Jukka Jokinlehto (Finlande). Au cours des séances sont tenues 47 communications sur la «Protection des Monuments et des oeuvres des musées contre les tremblements de terre». Il y eut des communications sur les objets endommagés par le tremblement de terre de 1963 à Skopje, par celui de 1979 à Dubrovnik, sur la protection séismique d'Alger, sur des problèmes théoriques des calculs antiséismiques etc. De notre part, au Séminaire fut remis, dans le but de l'éditer, l'article illustré «Mesures de renforcement dans les monuments endommagés par les tremblements de terre, en Albanie». Au cours de notre séjour à Skopje nous avons visité nombre de monuments et de complexes monumentaux tels le pont de Vardar, des mosquées, des auberges ainsi que l'Institut Séismologique et le Musée du Tremblement de terre de l'année 1963.

Le 22 octobre on organisa avec les participants au séminaire une excursion de recherche dans la ville d'Ohrid.

DO NOT COPY

Moikom ZEQO

NJË MOZAIK TJETËR I LASHTË NË DURRËS

Në truallin prej dheu shtuf të bodrumit të shtëpisë nr. 86, të lagjes nr. 9, në qytetin e Durrësit, në thellësinë 15-20 cm u zbulua një sipërfaqe mozaiku 172 x 166 cm. Mozaiku ndërpritet nga muret e themeleve. Afro 1,5 m në të djathtë u zbulua një sipërfaqe tjetër e të njëjtit mozaik 110 x 78 cm (Fig. 1,2).

Sipërfaqja e parë e mozaikut paraqet fragmentin e një fushe katërkëndëshe, të kufizuar nga e djathta me një buzinë me motivin e njohur të gërshetit. Ajo shërben si kufizim edhe për fragmentin tjetër në vijimësi të të njëjtit mozaik.[1]

Mozaiku ka një numër të madh motivesh gjeometrike dhe floreale. Bien në sy rombet me brinjë 17 cm, brendashkruar të cilëve shohim, rombe me brinjë 6 cm, që të vendosur ngjitur me njëri-tjetrin në brinjët e poshtme formojnë një yll me tetë kulme. Në sipërfaqen e zbuluar janë dy figura të tilla njëra sipër tjetrës, të bashkuara mbi dy kulme rombesh të secilës figurë. Kompozimi i figurave rombike është i tillë që së bashku edhe me dy fragmente të tjera nga ana e majtë të pazbuluara plotësisht, formojnë një figurë katrori me brinjë 34 cm, brenda të cilit mbi një sipërfaqe po të bardhë janë ravizuar në mënyrë të stilizuar një degë mbi të cilën ngrihen duke u spërdredhur tri herë brenda vetes tri degëza më të holla, të cilat përfundojnë me një gjethe në formë zemre. E tërë kjo figurë floreale mbyllet duke zgjatur dhe dy gjethe të tjera drejt fundit të degës. Të tëra gjethet janë të drejtuara në të kundërt të zgjatimit të degës në tri degëzime. Në një katërkëndësh, po me brinjë 34 cm, më sipër, ka gjithashtu një motiv floreal të një dege po me tri degëzime të rrotulluara brenda vetes me një numër më të vogël gjethesh që përfundojnë me nga një frut të rrumbullakët. Anëshkruar vijës kufizuese të pjesës së parë të mozaikut dallohen edhe dy figura katërkëndëshe me brinjë 20 x 34 cm, brenda të cilave ka gjithashtu motive floreale, në njërën, katër degëza të spërdredhura dalin nga e njëjta lidhje me dy gjethe në mes e dy gjysma gjethesh në brinjën e sipërme e të poshtme, kurse në tjetrën shihet një rozetë katërfletëshe.



Fig. 1

1) M. Zeqo, «Dëshmi të artit të lashtë në Durrës», në «Shqipëria e re», 1988 nr. 2.

DO NOT COPY



Fig. 2

Pjesa e mozaikut pas motivit të gërshetës ka një figurë gjeometrike gjashtëkëndëshe brenda së cilës ndodhet ylli gjashtëkëndësh i Solomonit me një rozetë katërfletëshe në trajtë helike në qendër. Gjethet përgjithësisht janë të stilizuara. Kudo mbizotëron stili gjeometrizues.

Sipërfaqja e dytë e mozaikut 1,5 m në të djathtë paraqet një figurë kaprolli, të vizatuar me kokën të ulur poshtë, me një trup të zhdërvjellët. E tërë figura e kaprollit është e përsosur e bërë me gurë të kuq në një sfond të bardhë.

Mozaiku (polikrom) është i punuar sipas teknikës «Opus tasselatum», me gurë katërkëndësh të prerë paraprakisht me përmasa 6 x 4 cm. Gurët me ngjyrë të badhë, të zezë, të gjelbër, të kuqe, të verdhë, janë bashkuar me njëri-tjetrin me mjeshtri.

Ky mozaik ka vlera të veçanta artistike dhe është një tjetër dëshmi e traditave të mëdha të artit në Durrësin e lashtë.

Mozaiku i përket shekujve III-IV të erës sonë, kohë kur mozaiku bardhë e zi nuk përdoret më dhe rishfaqet përsëri mozaiku polikrom.[2]

DO NOT COPY

2) H.P. Lorange und P.J. Northagen, **«Mozaik von der Antike bis zum Mittelaetar»**, Munchen, 1965, f. 53.

Moïkom ZEQO

UNE AUTRE MOSAIQUE ANCIENNE DANS LA VILLE DE DURRËS

Au-dessous du plancher de la cave d'une maison dans la ville de Durrës furent découverts à une distance de 1,5 m, deux fragments de la même mosaïque dont les superficies sont 172 x 166 cm et 110 x 78 cm. Le premier fragment est composé de différentes figures géométriques représentant huit losanges juxtaposés à un côté de 17 cm et d'autres plus petits à un côté de 6 cm qui y sont inscrits. On y distingue aussi des carrés d'où partent des branches qui se ramofient en trois et des quadrangulaires avec d'autres motifs floraux. La première superficie est limitée d'une corniche représentant le motif d'une tresse qui contourne des trapèzes avec des motifs floraux et des hexagones avec des étoiles y inscrites: La deuxième superficie représente l'image d'un chevreuil. C'est une mosaïque réalisée selon la technique «opus tesselatum» avec des tesseles noires, blanches, rouges, jaunes et vertes. Cette mosaïque polychrome remonte aux IIIe-IVe sc.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 1 1989

monumentet

DO NOT COPY

Irma KABASHI

DËSHMI TË REJA NGA DY MONUMENTE TË ANTIKITETIT TË VONË NË QYTETIN E DURRËSIT

Ateljeja e Monumenteve të Kulturës të Durrësit, gjatë punimeve konservuese në monumentet antike të qytetit, ka hasur në gjetje arkitektonike me interes. Në këtë trajtesë të shkurtër do të ndalemi në disa gjetje të reja të zbuluara gjatë punimeve konservuese të ndërtesës me mozaikë pranë pallatit të sportit «Punëtori» dhe në një pikë tjetër, në afërsi të shkollës 8 vjeçare «M. Muço».

Dyshemetë e shtruara me mozaikë shumëngjyrësh pranë pallatit të sportit «Punëtori» i përkasin një ndërtese antike[1]. Vlera e këtij monumenti të pazbuluar tërësisht përcaktohet nga mozaikët, që paraqesin motive të ndryshme gjeometrike e floreale, katrorë, trekëndësha, gjethe akanthi, bisqe, motivin e valëve të detit dhe luspave të peshkut, etj. Ky mozaik është datuar në shek. e III[2].

Mjediset e zbuluara, të ndodhura në një thellësi 1,45-1,70m, për shkak të drenazhimit të pamjaftueshëm, mbuloheshin herë pas here nga ujërat. Për mënjanimin e tyre, sektori i artit, në bashkëpunim me sektorin e monumenteve antike mesjetare, projektoi një kanalizim të ri, të pajisur me tuba betoni. Kanali i ri, në anën lindore të monumentit, u shtri në një gjatësi 150 m, për të arritur në arterien më të afërt të rrjetit hidrosanitar të qytetit. Për hapjen e këtij kanali u krye një prerje e shtresës kulturore në anën lindore të monumentit deri në thellësinë 1,15 m (Fig. 1). Nga gërmimet, pranë dyshemesë me mozaikë, u gjetën fragmente qeramike të shekujve të parë të erës sonë dhe një monedhë bronxi e Kostancit (346-350). Këto gjetje tregojnë përdorimin e kësaj ndërtese edhe në shek. e IV.

Në largësinë 45 m nga dyshemeja me mozaikë dhe në thellësinë 1.60 m u zbulua një kolonë graniti cilindrike e thyer në dy pjesë (Fig. 2). Një pjesë e saj qëndronte vertikalisht, me sa duket **in situ.** Thellësinë e kolonës nuk mundëm ta ndjekim për arsye të pranisë së ujërave që e vështirësonte gërmimin. Pjesa tjetër e kolonës, vazhdim i së parës, ka gjatësi 1.70 m e diametër 0,64 m. Kolona të tilla graniti ose fragmente të tyre janë zbuluar dhe në mjediset e mozaikëve.

Në shtresën kulturore ku u zbulua kolona u gjetën fragmente amforash, enësh balte të zbukuruara me «krëhërim» dhe fragmente qeramike pseudoterasigillata afrikane me lustër të kuqe, që tipologjikisht datohet në shek. IV – VI të erës sonë. Nisur nga këto të dhëna lind mendimi se pranë dyshemeve me mozaikë ka pasur dhe ndërtime të tjera, të cilat mund të kenë përbërë një kompleks unik.

Pranë shkollës 8 vjeçare «M. Muço», që ndodhet jo larg tregut të vjetër të qytetit, para disa vitesh, u zbulua një kolonë dhe një kapitel mermeri. Kolona lishe cilindrike, jo e plotë, ka gjatësi 1.10 m

---

1) Gërmimi për zbulimin e këtij monumenti, i nisur si operacion shpëtimi, është drejtuar nga arkeologu V. Toçi, në vitet 1966-1967. Në vitet 1971-80 nga I.M.K. janë marrë disa fushata restaurimi e konsolidimi për konservimin e sipërfaqes me mozaikë të dyshemesë së këtij monumenti. Në kuadrin e Kongresit të Gruas, që u mbajt në Durrës në pallatin e sportit, në vitin 1987, ky monument u kthye në një pikë të vizitueshme. Për këtë qëllim për të ekspozuar mozaikët e restauruar, e për të shmangur dëmtimet e mundshme të tij nga rreshjet, rrezet e diellit etj., u projektua dhe u ndërtua një mbulesë mbi një konstruksion të lehtë metalik.

2) Shih. S. Anamali – S. Adhami, **«Mosaiques de l'Albanie»** Tiranë, 1974, f. 12, 19-21.



Fig. 1



Fig. 2

dhe diametër 0,36 m. Kapiteli (Fig. 3) me 4 voluta në cepa, është i zbukuruar me dy radhë gjethesh akanthi, që veshin gjithë trungun e tij. Në pjesën e sipërme midis volutave dhe poshtë abakut është gdhendur motivi i vezëve (ove). Ai ka lartësi 0,45 m, diametër 0,31 m dhe abaku 0,45 x 0,45 m. Tipologji-



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5

DO NOT COPY

kisht kapiteli datohet në mesin e shek. IV të erës sonë.[3] Po te ky vend, para disa vitesh, ishte marrë një pllakë mermeri, dalë në dritë rastësisht.[4]. Kjo pllakë kuadratike prej mermeri të bardhë, e thyer në 3 pjesë (fig. 4), ka përmasat 1,75 x 0,75 x 0,06 m. Në njërën faqe ajo ishte zbukuruar me monogramin e Krishtit., ndërsa në faqen tjetër me një kryq të madh (fig. 5) në reliev të cekët. Është e qartë se në këtë rast kemi të bëjmë me një pllakë ikonostasi të një tipi të njohur në monumentet paleokristiane të vendit tonë.[5] Në pllakë përveç thyerjes, shihen edhe 5 bira të shpuara tej për tej, që tregojnë për një ripërdorim të saj. Këto tre detaje arkitektonike dëshmojnë për ekzistencën e një monumenti kulti paleokristian ende të pazbuluar në këtë pikë të qytetit, me sa duket të ndërtuar në mesin e shek. të IV të erës sonë.

Të dhënat e reja të trajtuara më sipër dëshmojnë edhe për monumente të ngritura gjatë antikitetit të vonë, përtej murit të dytë rrethues të qytetit, në sipërfaqen ndërmjet tij dhe asaj që njihet si rrethoja e tretë bizantine.

DO NOT COPY

3) R. Kautzch, **«Kapitellstudien»,** Leipzig, 1936, f. 9 (Tab. I,7).
4) Pllaka sot ruhet në muzeun arkeologjik në Durrës.
5) Shih A. Meksi, **«Arkitektura mesjetare në Shqipëri»** Tiranë, 1983, f. 23, 33.

Irma KABASHI

DO NOT COPY

NOUVEAUX TEMOIGNAGES SUR DEUX MONUMENTS DE LA BASSE ANTIQUITE DANS LA VILLE DE DURRËS

A Durrës, près du palais des sports «Punëtori», furent découverts des planchers pavés de mosaïque multicolore qui appartiennent à un monument antique. Les jolies mosaïques représentent de nombreux motifs géométriques et floraux tels: les carrés, les triangles les feuilles d'acanthe, de petits rameaux, le motif des vagues de la mer ou des écailles du poisson etc. Cette mosaïque remonte au IIIe sc.

Les fouilles effectuées près du plancher mirent au jour des tessons de céramique, datant des premiers siècles de n.è., et une monnaie de bronze de Kostance (346-350). A notre avis, ces trouvailles fournissent une donnée sur la datation de la construction et son utilisation jusqu'au IVe sc. 45 m loin du plancher pavé de mosaïque, à une profondeur de 1,60 m fut découverte une colonne de granit cylindrique, cassée en deux fragments. Il paraît que l'un des fragments, disposé verticalement, était in situ. On ne put pas suivre la profondeur de la colonne à cause de la présence des eaux souterraines qui rendait les fouilles difficiles. L'autre fragment de la colonne, d'une longueur de 1,70 m et d'un diamètre de 0,64 m, par sa forme et les dimensions appartenait au premier fragment. De pareilles colonnes de granit ou des fragments, sont découverts également aux endroits pavés de mosaïque. Quelques-uns sont gardés «in situ».

La couche culturelle mise au jour, à part les colonnes, contenait de nombreux fragments de céramique tels des tessons d'amphores, de récipients ainsi que quelque fragment de céramique africaine en vernis rouge qui typologiquement s'applique aux IVe-VIe sc. de n.è. Ces données nous poussent à penser que à part le plancher pavé de mosaïque il y a eu d'autres constructions qui ont dû former un complexe unique.

Il y a quelques années que près de l'école «N. Muço», furent découverts une colonne et un chapiteau en marbe. La colonne cylindrique, longue de 1,10 m et d'un diamètre de 0,36 m n'était pas complète. Le chapiteau (fig. 3) est orné de deux bandes de feuilles d'acanthe qui l'entoure tout entier et de quatre volutes à chaque coin. Dans la partie supérieure et au-dessous de l'abaque sont gravés des oves. Ce chapiteau est d'une hauteur de 0,45 m et d'un diamètre de 0,31 m tandis que l'abaque mesure 0,45 x 0,45 m. D'après la typologie, il date du milieu du IVe sc de n.è.

Il y a quelques années que de cet endroit on a pris une plaque de marbre aux dimensions 1,75 x 0,75 x 0,06 m. D'un côté elle était ornée de l'emblême connu de Jesus Christ, de l'autre était gravé en bas relief une grande croix. Il est clair qu'on a à faire à une plaque d'iconostase, un type connu aux monuments du culte paléochrétien de notre pays. Les quatre trous qui perforent la plaque montrent qu'elle a été réutilisée. Ces trois détails architectoniques prouvent l'existence d'un monument de culte paléochrétien du milieu du IVe sc de n.è., qu'on n'a pas encore découvert.

DO NOT COPY

Moikom ZEQO

ANDRIJA MUTNJAKOVIQ, «ANDREAS ALEXIUS EPIROTA», PRISHTINË 1981

Monografia «Andreas Alexius Epirota» e Andrija Mutnjakoviçit, botuar në shqip nga «Rilindja» (Prishtinë 1981) përfaqëson përpjekjen më të plotë, deri tani, të ndriçimit historik, si dhe të analizës artistike të jetës dhe veprës së personalitetit të Andrea Aleksit, të mbiquajtur Durrësaku, arkitekt dhe skulptor i Rilindjes dalmatinase.

Libri ka 151 faqe tekst dhe 56 faqe me riprodhime fotografike të veprave arkitekturore e skulpturore të Andreas. Në hyrje autori thekson rëndësinë e figurës së Andrea Aleksit, si një nga protagonistët kryesorë, së bashku me Juraj Dalmatinasin e Nikollë Firentinasin, në proçesin dinamik të kalimit të arkitekturës gotike në Rilindjen dalmatinase, e parë e gjitha kjo në raport me artin rilindas evropian.

Në kapitullin e parë «Prejardhja dhe shkollimi, 1425-1453, analizohet konkretisht prejardhja e artistit. Mbiemri Durachinus është përdorur dhe nga të tjerë me origjinë nga qyteti i Durrësit. Një traditë e tillë nis që në antikitet, ku në disa monumente mortore përdoret si mbiemër emri i qytetit[1], ndërsa Stefan Bizantini shënon dhe mjekun e lashtë Filonid Duraheni. Sipas mendimit tonë Andrea e mbiemëron veten Durrësaku nisur dhe nga koncepet humaniste rilindase, duke patur parasysh dhe historinë dhe emrin e Durrësit.

A. Mutnjakoviqi duke u mbështetur në disa dokumente shkrimore të arkivave të Raguzës si dhe të dokumentave të vetë artistit ku ai nënshkruan si «Andreas de Alexio», ose «Andrea de Alesio» hedh tezën se Alesio duhet të lidhet me emrin e qytetit të Lezhës, që në dokumenta del shpesh në këtë formë («comunita di Alexi», «Seniorum communis Alexi», «vecchi deputati della comunita de Alesso»). Ky identifikim lidhet sipas studiuesit me faktin se Andrea duket të ketë lindur në Lezhë, kurse Durrësin e përmend si emrin përfaqësues të tërë trevës, ku përfshihej dhe qyteti i Lezhës. Në testament, Andrea, e quan veten dhe «Ducassinovich», që mund të interpretohet si formë e kroatizuar e emrit të familjes së njohur shqiptare të fisit të Dukagjinëve, të cilët kanë qenë dhe zotërinj të Lezhës. Autori i librit është i bindur në këtë tezë dhe pothuaj kudo e shkruan emrin e artistit shqiptar në formën Andrea Lleshi (dmth i Lezhës). Po ne mendojmë se kjo tezë ka nevojë shumë më tepër për argumentim, pasi në autografet latinisht dhe në shumë dokumenta artisti e quan veten qartë si Andrea Aleksi (Andreas Alexius)[2].

Nga stili i Gotikut të Vonë të përfaqësuar nga veprat e Juraj Dalmatinasit (me të cilin bashkëpunoi) Andrea nisi të reflektojë ndikimet e para të Rilindjes Evropiane që kish nisur në Itali, tendencat e «stile nuovo». Në sythin «Opusi i Rabit 1453 – 1461» (fq. 30-52) studiuesi vë në dukje veprat e Andreas në qytetin e rabit në këtë lak kohor e bën dhe përshkrimin e tyre. Këto janë: kapela e Zudenikos në katedralen e Rabit, varri i Petro Zarit, portali i pallatit të Kolan Cernotës, varri monumental i Skafës etj.

Sythi tjetër «Pallatet 1451 – 1457» (fq. 41-52) ka në qendër të vëmendjes punën e Andreas si arkitekt i talentuar e me kërkesa të reja për kohën. Në Rab dhe në Trogir ai udhëheq sipas projekteve të konceptuara nga ai vetë disa pallate, ku spikasin pallati i Zudenikos dhe i Koriolan Çipikos në Trogir.

Një syth më vete quhet «Pagëzorja në Trogir 1461 - 1467» (fq. 53-70). Autori flet mbi punën e bërë nga Andrea për ndërtimin e pagëzores në katedralen e Shën Gjonit në Trogir, me koncepte hapësinore të arkitekturës së re të Rilindjes, që zëvendëson Gotikun e Vonë. Ku i mësoi dhe i bëri të vetat këto koncepte

1) V. Toçi, «Mbishkrime e relieve nga Durrësi», BSHSH, 1962, 1.

2) Një Adrea Aleksi tjetër, i biri i Marinit, po nga Durrësi, përmendet në dy dokumenta të vitit 1351-1352, shih Thalloczy, Jireçek e Sufflaj në **«Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia»** si dhe në vështrimin monografik të Ramadan Sokolit **«Andrea Aleksi»**, në librin **«Figura të shquara»** Tiranë 1965, fq. 20-44, Shih dhe zërin «Andrea Aleks Durrësaku» në **«Fjalorin enciklopedik shqiptar»**, Tiranë, 1985, fq. 17.

novatore Andrea? Ne mendojmë se rol këtu do ketë lojtur dhe miqësia me humanistin e eruditin dalmatinas Koriolan Çipiko, i cili në Trogir ishte një mecen i artistëve ashtu siç qe konditieri Malatesta për Riminin, apo Montefeltro për Urbinon, duke u bërë shtytës të vënies në jetë të koncepteve rilindase në arkitekturë. Nga ana tjetër theksojmë se Andrea për botëkuptimin rilindas kishte dhe një arësye tjetër për ta përqafuar më shpejt, sepse siç thekson autori i monografisë me të drejtë «Andrea kishte predispozicione për botëkuptimin antik të arkitekturës dhe nga vendlindja e tij, Durrësi, kishte sjellë kujtimet e një morie gërmadhash të monumenteve antike, kurse në atdheun e vet të ri (në Split) kishte njohur pallatin e perandorit romak me origjinë ilire Dioklicianit dhe mauzoleun e tij si njërin nga monumentet më të ruajtura mbas Koloseut dhe njërin nga objektet më të rëndësishme të arkitekturës romake». Arkitektura e Rilindjes në këtë mënyrë është arkitektura e vjetër e vendlindjes së Andreas. Autori i monografisë shënon se «Andrea nuk përfaqëson ndonjë stil të ri, por vetëm kthehet në botën e fëmijërisë së vet dhe i interpreton elementet e qytetit të vet të lindjes» (fq. 62). Natyrisht ne kemi mendimin se nuk është fjala thjesht në një kthim, por edhe në krijimin e diçkaje të re, që bëri epokë. Pagëzorja e Trogirit, ndërtuar nga Andrea, është vepra e parë, e plotë, e Rilindjes në bregun dalmatin, gati në të njëjtën kohë kur Rilindja kish filluar të formohej në Itali, ose disa dhjetëvjeçarë më parë se të dukej në vendet e tjera të Evropës (në Spanjë në vitet 1480 – 92, në Francë 1495, në Britaninë e Madhe në 1485 – 1509, në Holandë në 1507 – 32, në Poloni në 1518, në Çeki në 1494 etj.)

Dy sythet e tjera «Kapela e Shën Gjonit 1468 – 1482» (fq. 71-86) dhe «Shën Maria në Tremitet 1471 – 1473» (fq. 87-96) analizojnë këto dy monumente arkitektonike të Andreas, ku konceptet e tij rilindase materializohen në vijimësi.

Në sythin «Plastika e Trogirit 1460 – 1480» autori merret me një degë të dytë të krijimtarisë së Andreas: skulpturat e tij. Autori ndalet në vlerat e relievit «Vajtimi» në kishën e Shën Domenikut të Trogirit (punuar në vitet 1460 – 1475), «një Pieta e jashtëzakonshme e Rilindjes» (fq. 101). Në një kohë kur shumë relieve me këtë temë në Itali e në Evropë paraqiten në suazat e stilizimit simbolik gotik, relievi i Trogirit, punuar nga Andrea e Nikollë Fjorentini. «është një vepër e jashtëzakonshme e fillimit të zhvillimit të skulpturës realiste» (fq. 102). Autori shënon se ky reliev «zgjon asosacione të çuditshme të dramatikës dhe të realizmit të shkollës pikturike komnenase (paleologe) të Mihalit e të Eutikit me afreskun e tyre «Vajtimi i Krishtit» në kishën e Shën Klementit në Ohër (viti 1295), që i anticipon të tëra elementet qenësore të «Vajtimit» të Trogirit, si lëvizshmërinë e kompozimit, vajtuesen duar hapur, Shën Pjetrin e kërrusur etj ... Këto janë ngjashmëri tepër të mëdha dhe patjetër duhet të merren paraspsh me rastin e kërkimit të rrethit figurativ ballkanik» (fq. 102). Kësaj vërejtje ne i shtojmë faktin e rëndësishëm se kisha e Shën Klementit në Ohër siç dokumentohet qartë pati si ktitor një fisnik të njohur shqiptar, Progon Zgura, Motiv i shpeshtë i plastikës së Andreas ka qenë figura e eruditit me origjinë ilire të kishës së Shën Jeronimit. Kështu në sythin «Shën Jeronimi 1480 – 1500» flitet për interesimin e Andreas dhe realizimet e 12 relieveve e shtatoreve, paraqesin Jeronimin në kohëra të ndryshme. Andrea kokën e shënjtit «e bën përherë të mprehtë delikoqefale» (fq. 119).

Në «Epilogun» e librit autori boton mbishkrimin e plotë latinisht të varrit, të bërë nga vetë Andrea, në Split më 1503 **(ANDREAS ALEXIUS EPIROTA/ DURACHINUS.NOBILIS GENERE./ CIVIS SPALATINUS OB MERITA/ FACTUS .S. SPIRITUS COL/ LEGIATUS . H(OC) SIBI M(ONUMENTUM)/VIENS/ POSUIT ANNO S. MDIII»** (në shqip: «Andrea Aleksi epirot (shqiptar) durrësak, i fisit fisnik./ Qytetar me meritë i Splitit / anëtar i shoqatës së Shpirtit të shenjtë/ Këtë monument e ndërtoi sa ishte /gjallë. Në vitin 1503.» Në 30 gusht 1504 Andrea bën testamentin, kurse në regjistrimin e qytetarëve të Splitit në 1507 nuk figuron emri i tij. Mendohet të ketë vdekur të paktën në 1506.

Libri i A. Mutnjakoviqit është një ndihmesë e rëndësishme për njohjen e figurës së madhe të këtij artisti me origjinë shqiptare. Autori mund të qe ndalur më tepër në jetën e vetë artistit, për të cilin ka dokumenta etj. të lidhjeve të tjera të tij me artistë e bashkëkohës. Kruno Prijateli, që e citon autori, shprehet se Andrea ka ardhur nga Shqipëria, por është mishëruar në ambjentin tonë. ... Mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk ka patur kontakte me vendlindjen e tij. Ndoshta, për më tepër është e besueshme, ndërmjet figurave delikoqetale dhe ndërmjet formave të shprehjes së tij figurative paraqitet në mënyrë latente fryma shqiptare «gjë që lidhet me atë që ka thënë kohë më parë G. Gelçiç, se shumë vepra të artit në Dalmaci kanë qenë «të gjenisë shqiptare»[3], shprehje e kontributit të bijëve të popullit tonë në kulturën botërore.

3) Gelcich, G. «**La Zedda e la dinastia dei Balscidi**», Spalato, 1899.

Dokument

Moikom ZEQO

DO NOT COPY

ANDRIJA MUTNJAKOVIC «ANDREAS ALEXIUS EPIROTA» PRISHTINA, 1981

La monographie «Andreas Alexius Epirota», écrit par A. Mutnjakoviç et édité en albanais par la maison d'édition «Rilindja» (Prishtina 1981) représente jusqu'à l'heure actuelle, la plus complète étude sur l'éclairage historique et l'analyse artistique de la vie et de l'oeuvre de la personnalité d'Andreas Alexius, surnommé «Durrësaku» architecte et sculpteur de la Renaissance dalmatienne.

C'est une édition de 151 pages de texte et 56 pages de reproductions photographiques des oeuvres architecturales et sculpturales d'Andreas. Au début l'auteur met l'accent sur l'importance de sa figure, en tant que l'un des principaux protagonistes, de pair à Jura Dalmatien et Nikolas Florentin, du porcessus dynamique du passage de l'architecture gothique à la Renaissance dalmatienne, tout cela vu en rapport avec l'art de la Renaissance Européenne.

Au premier chapitre est analysée la descendence de l'artiste. Le nom Durachinus est utilisé même par d'autres, originaires de la ville de Durrës. Une pareille tradition apparut depuis l'Antiquité, lorsque dans quelques monuments funéraires le nom de la ville est utilisé comme nom de famille. C'est ainsi que Etienne de Byzance mentionne le médecin Filonid Duraheni. A notre avis, Andreas se surnomme Durrësaku (de la ville de Durrës), en partant des conceptions humanistes, renaissantes, ayant en vue l'histoire et le nom de la ville de Durrës.

A. Mutnjakovič, s'appuyant sur quelques documents des archives de Raguse ainsi que sur les documents de l'auteur même, où l'artiste signe «Andreas de Alexio» ou «Andrea de Alesio» avance l'idée qu'à Alexio se rattache le nom de la ville de Lezha, laquelle dans les documents apparait sous cette forme: «comunita di Alexi», «seniorum comunis Alexi», «vecchi deputati della comunita de Alesso». Selon l'auteur, cette identification se rapporte au fait que Andreas a dû naître à Lezha, tandis que le nom Durrës est mentionné comme nom représentant toute la contrée où était comprise même la ville de Durrës. Au testament, Andrea se nomme «Ducassinovich» ce qui peut être interprété comme la forme croatisée du nom de la famille renommée albanaise des Dukagjin, qui ont été les seigneurs de Lezha. L'auteur du livre, convaincu de cette thèse écrit presque toujours le nom de l'artiste albanais sous la forme Andrea Lleshi. (c.à.d. Lezha). A notre avis, cette thèse a besoin de plus d'arguments, étant donné que aux autographes latins et à plusieurs autres documents, l'artiste se nomme Andreas Alexius.

Du style du Gothique tardif représenté dans les oeuvres de Juraï Dalmatien avec lequel l'auteur collabora, Andreas commença à refléter les premières influences de la Renaissance Européenne qui avaient déjà aparu en Italie, les tendences du «style nuovo». Au chapitre «L'opus de Rab 1453-1461» (p. 30-52) l'auteur mentionne les oeuvres d'Andrea dans la ville de Rab telles: la chapelle de Zudeniko à la cathédrale de Rab, la tombe de Petro Zari, le portail du palais de Kolan Cernoti, la tombe monumentale de Skafa etc, et en fait une description.

L'autre chapitre «Les palais 1451-1456» (p. 41-52) se concentre au travail d'Andreas comme architecte de talent avec de nouvelles exigences pour l'époque. A Rab et à Trogir il dirige les travaux à la construction de quelques palais, selon des projets élaborés par lui-même. On peut mentionner ceux de Zudeniko et de Koriolan Çipiko à Trogir.

Dans le chapitre «Le Baptistère à Trogir 1461-1467» (p. 53-70), il s'agit du travail effectué par Andreas à la construction du baptistère dans la cathédrale de Saint Jean à Trogir selon des conceptions spatiales de la nouvelle architecture de la Renaissance qui substitua au Gothique tardif. On se demande où l'architecte a étudié et fait siennes ces nouvelles conceptions. A notre avis, un rôle important a dû y jouer l'amitié avec l'humaniste et l'érudit dalmatien Koriolan Çipiko, qui à Trogir était mécénat des artistes. D'autre part, il faut souligner qu'Andreas avait une autre raison pour embrasser plus vite la conception renaissante parce que, comme le souligne à raison l'auteur de la monographie, «Andreas avait des prédispositions pour la conception antique de l'architecture: de sa ville natale, Durrës, il avait apporté les mémoires d'une multitude de ruines de monuments antiques tandis que dans son nouveau pays (Split) il avait connu le mausolée de l'empereur romain d'origine illyrienne, Dioclétien. L'auteur de la monographie souligne que Andreas n'adopte pas quelques nouveaux styles, seulement il retourne au monde de son enfance et interprète les éléments de sa ville natale. Naturellement, nous pensons qu'il ne s'agit pas tout simplement d'un recour, mais de la création de quelque chose de nouveau qui fit école. Le baptistère de Trogir, construit par Andreas fut la première oeuvre complète de la Renaissance sur la côte dalmatienne.

Les deux autres chapitres «La chapelle de Saint Jean» 1468-1482 (p. 71-86) et «La sainte Trinité, 1471-1473» (p. 87-96) analysent ces deux monuments architectoniques d'Andreas, où ses conceptions renaissantes se matérialisent en continuité.

Au chapitre «La plastique de Trogir, 1460-1480», l'auteur traite d'une deuxième branche de l'activité d'Andreas; ses sculptures. L'auteur s'arrête aux valeurs du relief «Lamentation» à l'église de Saint Dominique de Trogir (travaillé pendant les années 1460-1475) «une extraordinaire Piété de la Renaissance» alors que parmi plusieurs reliefs qui traitent de ce sujet, le relief de Trogir, réalisé par Andreas et Nikollas Florentin «est une oeuvre extraordinaire du début de l'évolution de la sculpture réaliste». L'auteur souligne que ce relief «éveille des associations étranges de la dramatique et du réalisme de l'école de peinture des Comnènes paléologue de Mihal et Eutyches par leur fresque «La lamentation du christ» à l'glise de Saint Clément à Ohrid qui anticipe tous les éléments de la «Lamentation» de Trogir, tels le mouvement de la composition, la lamenteuse à bras ouverts, le Saint Pierre le dos voûté etc. Nous ajoutons le fait important que l'église de Sain Clément à Ohrid, a eu comme donateur un noble albanais Progon Zguraj. Le motif fréquent de la plastique d'Andreas fut la figure de l'érudit de l'église Saint Jerôme d'origine illyrienne. Ansi, au chapitre «Saint Jerôme 1480--1500» l'auteur parle des réalisations de douze reliefs et sculptures qui représentent Jerôme. La tête du Saint réalisée par Andreas est toujours dolichocéphale.

A l'épilogue du livre, l'auteur donne la complète inscription latine de la tombe à Split, faite par Andreas en 1503». ANDREAS ALEXIVS EPIROTA/DVRACHINVS, NOBILIS GENERE/ CIVIS SPALATINVS OB MERITA/ FACTVS, S. SPIRITUS COL /LEGIATUS.H. (OC) SIBI M(Onumentum) VIVIS/POSUIT ANNOS.M DIII.

Le 30 aût 1504 Andréas fait son testament tandis qu'au régistre des citadins de Split en 1507 son nom ne figure pas. On pense qu'il est mort au moins en 1506.

Le livre de A. Mutnjokovic apporte une importante contribution à la connaissance de la figure de ce grand artiste d'origine albanaise. A notre avis, l'auteur aurait dû s'arrêter un peu plus sur la vie de l'artiste puisqu'il existe des documents sur ses rélations avec d'autres artistes contemporains. L'opinion de Kruno Prijateli, citée par l'auteur, que: «Andrea est venu de l'Albanie mais s'est incarné dans notre ambiance... Mais cela ne veut pas dire qu'il n'a pas eu des contacts avec son pays natal, Peut-être, cela plutôt est croyable, que, par les images dolichocéphales se présente de façon enfantine l'esprit albanais», se rattache à l'idée avancée il y a longtemps par G. Gelçiç que: nombre d'oeuvres d'art en Dalmatie sont dûes au «génie albanais».

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë